

UNIVERSITETI I EJL
ЈИЕ УНИВЕРЗИТЕТ
SEE UNIVERSITY



FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE
ФАКУЛТЕТ ЗА СОВРЕМЕНИ СОЦИЈАЛНИ НАУКИ
FACULTY OF CONTEMPORARY SOCIAL SCIENCES

CIKLI I TRETË I STUDIMEVE

TEMA E DISERTACIONIT TË DOKTORATËS:

**“ E DREJTA E FEMRËS PËR TRASHËGIMI NË PRONË. ASPEKTE KOMPARATIVE TË BALLKANIT
PERËNDIMOR ME THEKS TË VEÇANTË REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT”**

Kandidatja:

Lindita Neziri

Mentori:

Prof.Dr Abdulla Azizi

Tetovë, 2021

Titulli punues i temës:

**“E drejta e femrës për trashëgimi në pronë. Aspekte komparative të Ballkanit
Perëndimor me theks të veçantë Republika e Maqedonisë së Veriut”**

Përkthim i titullit punues në gjuhën maqedonase:

**“Право на жената на наследство на имот. Компаративни аспекти на западниот
Балкан со посебен осврт на Република Северна Македонија”**

Përkthim i titullit punues në gjuhën angleze:

**“Female right to inheritance in property: Comparative aspects of the Western Balkans
with special emphasis Republic of North Macedonia”**



Deklaratë e autorësisë

Me anë të kësaj deklaratë, unë **Lindita Neziri**, nën përgjegjësi të plotë morale dhe ligjore deklaroj që:

- a. Disertacioni me titull: **“E drejta e femrës për trashëgimi në pronë. Aspekte komparative të Ballkanit Perëndimor me theks të veçantë Republika e Maqedonisë së Veriut”** është punim i punuar në tërësi nga unë në mbikëqyrjen e mentorit Prof. Dr. Abdulla Azizi.
- b. Pjesë të punimit apo punimi në tërësi nuk janë prezantuar as botuar në ndonjë institucion tjetër.
- c. Pjesë të punimit apo punimi në tërësi nuk është kopjuar nga ndonjë punim tjetër.
- d. Burimet në disertacion janë cituar duke respektuar rregullat akademike.

Nënshkrimi i studentes _____

Tetovë më datë _____

Falenderimet

Në mbledhjen e të dhënave deri në finalizimin e disertacionit kanë kontribuar kategori të ndryshme të njerëzve duke filluar nga qytetarët e thjeshtë e deri tek njohësit dhe ekspertët e kesaj lëmie.

Falenderoj anëtarët e komisionit dhe në mënyrë te veçantë falenderoj dhe shpreh mirënjohje të singertë për mentorin. Kam patur nderin dhe kënaqësinë të kem udhëheqës shkencor të temës sime të doktoraturës Prof.Dr. Abdulla Azizi. Realizimi i punimit nuk do të ishte i mundur pa ndihmën, këshillat, bashkëpunimin dhe gatishmërinë e tij për të diskutuar çdo problem të hasur deri në finalizimin e këtij punimi.

Falenderoj qytetarët-pjesmarrës në hulumtim, avokatët: Adem Abduramanov, Irfan Tahiri, Fatmir Musa , Abidin Abduli, Jusuf Huseini, Agron Halimi, Hamim Iseni, Vjosa Xhaferi dhe noterët Arif Neziri, Jasmina Kaptanova- Basnarkova, Zoran Mukelovski, Liljana Trpovska, Nita Xhaferi-Iseni, Lirim Abdili, Ilham Ismani, Ermira Memeti.

Falenderoj familjen, në veçanti prindërit dhe bashkëshortin që ishte përkrahja ime kryesore gjatë këtyre viteve.

Ky punim i dedikohet 2 fëmijëve të mij Anuarit dhe Ajlës, duke dashur t'i inkurajoj në rrugën e dijes dhe për t'ju dëshmuar atyre se asnjëherë nuk është vonë për të arritur pikësynimin që i ke vënë vetes.

Faleminderit!

Abstrakt

E drejta e trashëgimisë në pronë është e drejtë themelore që garantohet me shumë akte juridike nacionale dhe ndërkombëtare. Megjithatë, edhe përkundër kuadrit të plotë ligjor, në praktikën aktuale kjo e drejtë nuk zbatohet në mënyrë të barabartë për të dy gjinitë.

Në literaturat e deritanishme mund të gjejmë informacione dhe analiza të Ligjit mbi trashëgiminë, mirëpo ka mungesë të hulumtimeve shkencore mbi pengesat në sistemin ligjor që pengojnë femrat të trashëgojnë pjesë të pronës familjare që atyre u takon.

Risia që sjell punimi është identifikimi i faktorëve që lejojnë abuzimin e Ligjit mbi Trashëgimi dhe interesat e trashëgimtarëve të domosdoshëm, por edhe mekanizmat që lejojnë abuzimet.

Qëllimi i punimit është nxitja e ndryshimeve ligjore dhe procedurale në përputhje me praktika më të mira evropiane apo ndërkombëtare që mund të kontribuojnë në arritjen e barazisë gjinore në fushën e trashëgimisë.

Përmes metodës historike, deskriptive, krahasuese, analizës së ligjeve për çështjet e trashëgimise, anketës, intervistave dhe metodave tjera ofrohen dëshmi të mjaftueshme për të provuar (mos) pjesmarrjen e trashëgimtarit femër në pjesën ligjore të trashëgimisë si rezultat i ndeshjes së ligjit me religjionin dhe normat zakonore.

Punimi përfundon me rekomandime për masat që duhet t'i ndërmarrin institucionet lidhur me përmirësimin e kuadrit ligjor dhe aplikimit të tij në praktikë, bazuar në praktikat e mira ndërkombëtare.

Fjalë kyçe: trashëgimi pronësore, diskriminim gjinor, norma zakonore, religjioni, femra.

Apstract

The right to inherit property is a fundamental right guaranteed by a number of national and international legal acts. Despite the full legal framework, in practice, this right does not find equal application for both gender.

In literature, we can find some information and analysis of the Law on Inheritance, but there is a lack of scientific research on the barriers in the legal system that prevent female from inheriting part of their family property.

The novelty of this paper is identification of factors that allow the abuse of Law on Inheritance and the interests of indispensable heirs, as well as the identification of mechanisms as a solution of these factors.

The purpose of this paper is to promote legal and procedural changes in compliance with European best practices that can contribute to gender equality in heritage.

Through the historical, descriptive, comparative method, analysis of law, survey, interviews and other methods we provide sufficient evidence to prove (non) participation of the female heir in the legal part of inheritance as a result of the conflict of law with religion and customary norms.

Paper ends with recommendations on measures to be taken to improve the legal framework and its application in practice, based on European good practices.

Keywords: *Property inheritance, gender discrimination, customary norms, religion, women.*

Апстракт

Правото на наследство е основно право гарантирано со национални и меѓународни правни акти. Но, и покрај целосната законска рамка во сегашната пракса ова право не наоѓа еднаква примена за двата пола.

Во досегашната литература можеме да најдеме информации и анализи на Законот за наследување, но недостасуваат научно истражување за пречките во правниот систем кои што ги спречуваат жените да наследуваат дел од семејниот имот што им припаѓа.

Во ова докторска теза се идентификуваат факторите кои дозволуваат злоупотреба на Законот за наследување.

Целта на овој труд е промовирање на законски и процедурални промени во согласност со најдобрите европски практики кои што можат да придонесат за родова еднаквост во наследството.

Преку историски и компаративни методи доктринско истражување, анализа на Законите од областа на наследството, истражување и интервјуа со нотари, судии, адвокати и граѓани на Северна Македонија се обезбедуваат доволно докази за докажување на (не) учество на женската наследничка во правниот дел на наследството, како резултат на судир на закони со религијата и вообичаените норми.

Трудот завршува со препораки за мерките што треба да ги преземат институциите за подобрување на правната рамка.

Клучни зборови: *Наследство на имот, родова дискриминација, вообичаени норми, религија, жени.*

PËRMBAJTJA

DEKLARATË E AUTORËSISË.....	I
FALENDERIMET	II
ABSTRAKT	III
APSTRACT	IV
АПСТРАКТ	V
AKRONIMET	11
LISTA E TABELAVE	12
LISTA E GRAFIKEVE.....	14
HYRJE.....	19
LËNDA E KËRKIMIT	22
QËLLIMI I HULUMTIMIT	24
RËNDËSIA E PUNIMIT	25
HIPOTEZA	26
PYETJET E HULUMTIMIT.....	27
METODOLOGJIA	28
KAPITULLI I	30
ASPEKTI I ZHVILLIMIT HISTORIK TË SË DREJTËS PËR TRASHËGIMI	30
1.1 TRASHËGIMIA E FEMRAVE NË LIGJIN ATHINAS.....	31
1.2 E DREJTA E FEMRËS PËR TRASHËGIMI NË PRONË NË BABILONI	31
1.3. RREGULLIMI I TRASHËGIMISË SIPAS TË DREJTËS ZAKONORE SHQIPTARE	32
1.3.1 RREGULLIMI I TRASHËGIMISË NË KANUNIN E LEKË DUKAGJINIT	33
1.3.2 RREGULLIMI I TRASHËGIMISË NË KANUNIN E SKËNDERBEUT	34
1.3.3. RREGULLIMI I TRASHËGIMISË NË KANUNIN E LABËRISË	35

1.3.4 KANUNI I LUMËS.....	37
1.4. E DREJTA E FEMRËS PËR TRASHËGIMI NE PRONË SIPAS FESË HEBREJE	37
1.4.1 TRASHËGIMIA E HEBRENJËVE SIPAS DHJATËS SË VJETËR DHE NË TALMUD	38
1.4.2 SISTEMI I TRASHËGIMISË TEK HEBRENJËT BASHKËKOHOR.....	38
1.5 E DREJTA E FEMRËS PËR TRASHËGIMI NË PRONË SIPAS FESË KRISHTERE	39
1.6 E DREJTA E FEMRËS PËR TRASHËGIMI NË PRONË SIPAS FESË ISLAME	42
1.6.1 RASTET E TRASHËGIMISË SË FEMRËS SIPAS SHERIATIT ISLAM	44
1.7. VËSHTRIM I SHKURTË I KAPITULLIT TË PARE.....	45
KAPITULLI II	46
INSTRUMENTET DHE MEKANIZMAT NDËRKOMBËTAR PËR BARAZI GJINORE NE TRASHËGIMINË E PRONËS	46
2.1 KONVENTA PËR ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT KUNDËR GRAVE (CEDAW)	46
2.2 KARTA E TË DREJTAVE THEMELORE TË BASHKIMIT EVROPIAN.....	48
2.3 PAKTI NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT EKONOMIKE, SOCIALE DHE KULTURORE	48
2.4 KONVENTA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE (1989)	49
2.5 VËSHTRIM I SHKURTËR I PËRMBAJTJES SË KAPITULLIT TË DYTË.....	50
KAPITULLI III	51
E DREJTA PRONËSORE TRASHËGIMORE DHE BARAZIA GJINORE TEK VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR	51
3.1 E DREJTA PRONËSORE DHE TRASHËGIMORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT	51
3.1.1 ZHVILLIMI HISTORIK I TË DREJTËS TRASHËGIMORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT.....	51
3.1.2 AKTET JURIDIKE PËRMES SË CILËVE GARANTOHET E DREJTA PËR TRASHËGIMI NË PRONË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT.....	52
3.1.3. RREGULLIMI I TRASHËGIMISË LIGJORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT	55
3.1.4 RREGULLIMI I TRASHËGIMISË TESTAMENTARE NË MAQEDONINË E VERIUT	60
3.1.5 PROCEDURA E TRASHËGIMISE NE R. E MAQEDONISE SE VERIUT.....	61
3.1.5.1. AKTVDEKJA.....	62
3.1.5.2. VLERËSIMI DHE REGJISTRIMI I PASURISË TRASHËGIMORE	63

3.1.5.3 MASAT E PËRKOSSHME PËR SIGURIMIN E PASURISË TRASHËGIMORE	64
3.1.5.4. VEPRIME PARAPRAKE NË LIDHJE ME TESTAMENTIN	64
3.1.5.5 AKTVENDIMI PËR TRASHËGIMI	65
3.1.5.6 PRAKTIKA E TRASHËGIMISË PRONËSORE TEK FEMRAT NE R. E MAQEDONISË SË VERIUT.....	66
3.2. E DREJTA PRONËSORE TRASHËGIMORE DHE BARAZIA GJINORE NË KOSOVË.....	67
3.2.1 HISTORIK I SHKURTËR I RREGULLIMIT TË MARRËDHËNIEVE TRASHËGIMORE NË KOSOVË	67
3.2.2 RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË TRASHËGIMISË LIGJORE DHE TESTAMENTARE NË KOSOVË.....	68
3.2.3 PROCEDURA GJYQËSORE DHE PRAKTIKA E TRASHËGIMISË PRONËSORE TEK FEMRAT NË KOSOVË	69
3.3 E DREJTA PRONËSORE TRASHËGIMORE DHE BARAZIA GJINORE NË SHQIPËRI.....	71
3.3.1. HISTORIKU I SHKURTËR I RREGULLIMIT TË MARRËDHËNIEVE TRASHËGIMORE NË SHQIPËRI NGA VITI 1919- DERI MË SOT	71
3.3.2 RREGULLIMI I TRASHËGIMISË LIGJORE DHE TESTAMENTARE NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR	73
3.3.3. PRAKTIKA E TRASHËGIMISË PRONËSORE TEK FEMRAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË	76
3.4 E DREJTA PRONËSORE TRASHËGIMORE DHE BARAZIA GJINORE NË SËRBI	77
3.4.1 HISTORIKU I SHKURTËR I RREGULLIMIT TË MARRËDHËNIEVE TRASHËGIMORE NË SËRBI NGA VITI 1844 DERI MË SOT.....	77
3.4.2 RREGULLIMI I TRASHËGIMISË LIGJORE, TESTAMENTARE DHE PROCEDURA	79
3.5 E DREJTA PRONËSORE TRASHËGIMORE DHE BARAZIA GJINORE NË MAL TË ZI	80
3.6 E DREJTA PRONËSORE TRASHËGIMORE DHE BARAZIA GJINORE NË BOSNJË DHE HERCEGOVINË	82
3.7 ASPEKTE KRAHASUESE TË BALLKANIT PERËNDIMOR NË FUSHËN E TRASHËGIMISË.....	83
3.8 VËSHTRIM I SHKURTËR I KAPITULLIT TË TRETË	91
KAPITULLI IV	94
4. TRADITA PËRKUNDREJT SË DREJTËS NË RMV.....	94
4.1 TRASHËGIMIA DHE PABARAZITË: EFEKTET SOCIO-EKONOMIKE.....	94
4.2 MEKANIZMAT KOMBËTARE PËR TË DREJTAT PRONËSORE TRASHËGIMORE.....	95
4.3 KONTRATA PËR TRASHËGIMI.....	96
4.3.1 KARAKTERISTIKAT E KONTRATËS PËR TRASHËGIMI	98
4.3.2 DALLIMI MES TESTAMENTIT DHE KONTRATËS PËR TRASHËGIMI	101

4.3.3 KONTRATA PËR MBAJTJE TË PËRJETSHME	101
4.3.4 DALLIMET MES KONTRATËS PËR TRASHËGIMI DHE KONTRATËS PËR MBAJTJE TË PËRJETSHME	103
4.3.5 KONTRATA PËR DORËZIM DHE NDARJE TË PASURISË.....	104
4.4 PËRJASHTIMI NGA TRASHËGIMIA	107
4.5 HEQJA DORË NGA TRASHËGIMIA.....	109
4.6 ROLI I NOTERËVE NË PROCEDURËN E TRASHËGIMISË	110
4.7 HAPJA E TRASHËGIMISË NË RRETHIN E GJYKATËS THEMELORE TË TETOVËS NË DHJETËVJEÇARIN E FUNDIT ..	115
4.8 VËSHTRIM I SHKURTËR I KAPITULLIT TË KATËRT	117
KAPITULLI V	118
PRAKTIKAT NDËRKOMBËTARE MBI TRASHËGIMINË PRONËSORE GJINORE	118
5.1 BARAZIA GJINORE PËR TRASHËGIMINË E PRONËS NË VENDET E EVROPËS PERËNDIMORE (FRANCA, GJERMANIA, AUSTRI, ITALI ETJ).....	118
5.2 TRASHËGIMIA E FEMRËS NË PRONË SIPAS TË DREJTËS SË BE-SE	122
5.3 RREGULLORJA E BASHKIMIT EVROPIAN PER TRASHËGIMI (BE) NR. 650/2012	123
5.4 NDALIMI I DISKRIMINIMIT NË TRASHËGIMINË PRONËSORE: PRAKTIKA E GJED, GJEDNJ DHE PRAKTIKAT E GJYKATAVE KOMBËTARE	125
5.5 VËSHTRIM I SHKURTËR I KAPITULLIT TË PESTË	127
KAPITULLI VI: PJESA EMPIRIKE (DISKUTIM)	128
6.1 INSTRUMENTET E HULUMTIMIT	129
6.2.KAMPIONI DHE MOSTRA.....	130
6.3.PROCEDURA E REALIZIMIT TË PYETËSORIT.....	130
6.4.ANALIZA E TË DHËNAVE NGA ANKETA ME QYTETARËT E RMV-SË	132
6.4.1.ANALIZA E TË DHËNAVE DEMOGRAFIKE TË NXJERRA NGA ANKETA ME QYTETARËT E RMV-SË	132
6.4.2.GJETJET DHE ANALIZA E TË DHËNAVE NGA ANKETA ME QYTETARËT E RMV-SË	135
6.4.3.ANALIZA DHE PËRPUNIMI I TË DHËNAVE NGA PYETËSORI PËR NOTERË.....	172
6.5 ANALIZA DHE PËRPUNIMI I TË DHËNAVE NGA PYETËSORI PËR AVOKATË DHE GJYKATËS	190
6.6 INTERVISTA ME AVOKATË DHE NOTERË	196
6.7 INTERVISTA ME QYTETARË TË RASTËSISHËM NË RMV	201

6.7.1 INTERVISTA ME QYTETARË MESHKUJ.....	201
6.7.2 INTERVISTË ME QYTETARË FEMRA	202
PËRFUNDIMI.....	203
REKOMANDIMET	205
BIBLIOGRAFIA	206
SHTOJCA	215

Akronimet

ABGB	Kodi Civil Austriak
BGB	Kodi Civil Gjerman
BE	Bashkimi Evropian
CCS	Kodi Civil i Zvicrës
CEDAË	Konvenat për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas
LAPRMV	Ligji për Avokatin e Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
IAP	Institucioni Avokati i Popullit
LTK	Ligji për Trashëgimi i Kosovës
LTMV	Ligji për Trashëgimi i Maqedonisë së Veriut
LTRS	Ligji për Trashëgimi i Serbisë
LTMZ	Ligji për Trashëgimi i Mal të Zi
LTBH	Ligji për Trashëgimi i Bosnjës dhe Hercegovinës
LPJK	Ligji për Procedurën Jokontestimore i Kosovës
LPJKMV	Ligji për Procedurën Jokontestimore i Maqedonisë
LPJKMZ	Ligji për Procedurën Jokontestimore i Malit të Zi
LPJKRS	Ligji për Procedurën Jokontestimore i Sërbisë
LNRSH	Ligji për Noterinë i Republikës së Shqipërisë
LNRMV	Ligji për noterijat i Republikës së Maqedonisë së Veriut
KLD	Kanuni i Lekë Dukagjinit
KH	Kodi i Hamurabit
KL	Kanuni i Labërisë
KS	Kanuni i Skënderbeut
KCSH	Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë
KCRS	Kodi Civil Serb (1844)
KDF	Konventa për Drejtat e Fëmijës

Lista e tabelave

TABELA 2. Rradhët e thirrjes së trashëgimtarëve ligjorë në vendet e Ballkanit Perëndimor	87
TABELA 3. Mundësia e zvogëlimit të pjesës trashëgimorë në favor të trashëgimtarëve të rradhës së parë.....	88
TABELA 4. . Zotësia për të bërë testament (mosha ligjore në vendet e Ballkanit Perëndimor të përfshira në hulumtim).....	90
TABELA 5. Format e testamenteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme që aplikohen në vendet e Ballkanit Perëndimor.....	90
TABELA 6. Raporti I EULEX-it për Ballkanin Perëndimor, në lidhje me përqindjen e pronave të regjistruara në emër të femrave.....	93
Tabela 7. Të dhëna statistikore për procedurat trashëgimore të inicuar dhe të zgjidhura në Gjykatën Themelore të Tetovës për periudhën 2010-2019	117
Tabela 8. Pyetjet dhe instrumentet e hulumtimit.....	118
Tabela.9 Të dhënat demografike të qytetarëve meshkuj dhe femra të përfshirë në anketë.....	123
Tabela. 10. Femrat më shpesh disponojnë të drejtën e trashëgimisë atëherë kur thirret në roli e bashkëshortes, vajzës, motrës, mbesës?.....	170

LISTA E GRAFIKËVE

<i>Grafiku 1. Komunitet e RMV-së në të cilët është realizuar anketa me qytetarët e RMV-së.....</i>	<i>121</i>
<i>Grafiku 2. Sa keni njohuri mbi të drejtën e trashëgimisë pronësore?.....</i>	<i>124</i>
<i>Grafiku 3. A mendoni se trashëgimtarët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë pa dallim gjinor?</i>	<i>125</i>
<i>Grafiku 4. Sipas mendimit tuaj, kush duhet të trashëgojë pronësinë familjare?.....</i>	<i>127</i>
<i>Grafiku 5. Sipas mendimit tuaj, si duhet të ndahet pasuria trashëgimore mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit?.....</i>	<i>128</i>
<i>Grafiku 6. Sipas mendimit tuaj, vajza/motra juaj a duhet të trashëgojë sende të palëvizshme si shtëpi, tokë apo dyqan në rastë se konkurron në trashëgimi me vëllezërit e saj?</i>	<i>131</i>
<i>Grafiku 7. Sipas mendimit tuaj, a duhet vajza/motra të trashëgojë sende të lëvizshme si: veturë, para, sende të çmueshme?.....</i>	<i>133</i>
<i>Grafiku 8. A do ta ndani pasurinë trashëgimore me motrat tuaja?</i>	<i>134</i>
<i>Grafiku 9. A do të pranoje ndarjen e pasurisë trashëgimore në pjesë të barabartë me motrën/at tuaja?.....</i>	<i>136</i>
<i>Grafiku 10. Si do të ishin marrëdhëniet familjare me vajzat /motrat tuaja në qoftë se ato do të kërkonin pjesën e domosdoshme të trashëgimisë së pronës familjare.....</i>	<i>137</i>
<i>Grafiku 11. A keni dëgjuar apo a dini ndonjë rast në familjen tuaj apo në rrethin më të gjërë, ku vajzat kanë marrë pjesë në trashëgimi së bashku me vëllezërit e tyre?.....</i>	<i>139</i>
<i>Grafiku 12. A keni dëgjuar apo a dini ndonjë rast në familjen tuaj apo edhe më gjërë, ku trashëgimtari femër ka hequr dorë nga pjesa ligjore e trashëgimisë?.....</i>	<i>141</i>
<i>Grafiku 13. A do të preferojë që vajza/motra juaj të heq dorë nga e drejta për trashëgimi në pronën prindërore.....</i>	<i>142</i>
<i>Grafiku 14. Cilat nga opsionet e poshtëshënuar preferoni për ndarjen e pasurisë tuaj?....</i>	<i>144</i>

<i>Grafiku 15. Si ndikon në cilësinë e jetës së një femre, mospjesmarrja e saj në pjesën ligjore të trashëgimisë?.....</i>	<i>146</i>
<i>Grafiku 16. Cilën nga mënyrat e poshtëshënuara e preferoni si mënyrë për ndarjen e pasurisë trashëgimore?.....</i>	<i>147</i>
<i>Grafiku 17. A mendoni që mundësia e ndarjes së pasurisë trashëgimore me marrëveshje paraprak mes trashëgimtarëve krijon mundësi për ndarjen të pasurisë trashëgimore në mënyrë të pafavorshme për trashëgimtarët femra?.....</i>	<i>149</i>
<i>Grafiku 18. A dallon praktika aktuale trashëgimore krahasuar me praktikat zakonore dhe praktikat tjera që kanë egzistuar para hyrjes në fuqi të Ligjit mbi Trashëgiminë dhe akteve tjera juridike përmes së cilëve garantohet barazi dhe mosdiskriminim gjinor?.....</i>	<i>151</i>
<i>Grafiku 19. A pajtoheni që edhe përkundër ekzistimit të kornizës ligjore, institucionale e politike, dispozitat ligjore nuk zbatohen në praktikë dhe si pasojë pabarazia gjinore dhe diskriminimi gjinor në këtë fushë vazhdon të ekzistojë?.....</i>	<i>153</i>
<i>Grafiku 20. Sipas mendimit tuaj, cilët nga faktorët e poshtëshënuar pengon trashëgimtarin femër të realizojë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare?.....</i>	<i>155</i>
<i>Grafiku 21. Sipas mendimit tuaj, në praktikën aktuale të trashëgimisë në RMV, trashëgimtarët femra a disponojnë të drejtën trashëgimore?.....</i>	<i>158</i>
<i>Grafiku 22. Në praktikë, si inicohet procedura për shqyrtim të pasurisë trashëgimore?....</i>	<i>159</i>
<i>Grafiku 23. Në përditshmëri, me kërkesën e cilëve trashëgimtarë më shpesh inicohet procedura për shqyrtim të trashëgimisë?.....</i>	<i>160</i>
<i>Grafiku 24. Në praktikë, Aktvdekja përpilohet:.....</i>	<i>161</i>
<i>Grafiku 25. Noteri, a bashkëpunon me institucionet tjera juridike për verifikimin e informacionit të dhënë në Aktvdekje?.....</i>	<i>161</i>

<i>Grafiku 26. Në praktikë, në raste të dyshimit në lidhje me fshehjen e ndonjë trashëgimtari ligjorë apo vlerësimi të gabuar të vlerës Neto të pjesës trashëgimore në Aktvdekje, Noteri a obligohet të njoftoj zyrën e prokurorit?.....</i>	<i>162</i>
<i>Grafiku 27. A pajtoheni se mungesa e të dhënave elektronike lidhur me organizimin familjar të qytetarëve lehtëson fshehjen e trashëgimtarëve ligjorë?.....</i>	<i>162</i>
<i>Grafiku 28. Cila nga mënyrat e poshtëshënuara të ndarjes së pasurisë trashëgimore aplikohet më shpesh në përditshmëri?.....</i>	<i>163</i>
<i>Grafiku 29. A mendoni se përfitohet nga mjeti ligjor “heqje dorë nga trashëgimia”, duke dal nga konteksti për të cilin është parashikuar?.....</i>	<i>164</i>
<i>Grafiku 30. A pajtoheni që zbrazëtirat ligjore lënë mundësi të influencimit të rregullave të traditës patriarkale?.....</i>	<i>164</i>
<i>Grafiku 31. A pajtoheni se duhet të organizohet seancë e veçantë për trashëgimtarët që heqin dorë nga trashëgimia pronësore?.....</i>	<i>165</i>
<i>Grafiku 32. Noteri, a është i obliguar të informoj trashëgimtarët në lidhje me pasojat nga heqja dorë nga pasuria trashëgimore?.....</i>	<i>165</i>
<i>Grafiku33.Në RMV, në praktikë më shpesh aplikohet trashëgimia ligjore apo testamentare?.....</i>	<i>166</i>
<i>Grafiku 34. Femrat më shpesh heqin dorë në cilësi të trashëgimtares ligjore apo trashëgimtares testamentare?.....</i>	<i>166</i>
<i>Grafiku 35. Cila formë e testamenteve të poshtëshënuara aplikohet më shpesh në praktikë?.....</i>	<i>167</i>
<i>Grafiku 36. Trashëgimtarët testamental më shumë i përkasin gjinisë mashkullore apo gjinisë femërore?.....</i>	<i>167</i>

Grafiku 37. Në RMV më shumë trashëgojnë femrat që i përkasin besimit fetar krishter apo islam? Vlerëso me 1-2, (1-më shumë, 2-më pak)

168

Grafiku 38. Në RMV më shumë trashëgojnë femrat që i përkasin nacionalitetit: shqiptarë, maqedonas, turk, rom, tjetër?.....

168

Grafiku 39. A mendoni se qytetarët e RMV -së, kanë njohuri të mjaftueshme mbi të drejtën trashëgimore si e drejtë themelore që garantohet me ligj?.....

169

Grafiku 40. A dallon praktika aktuale trashëgimore krahasuar me praktikat zakonore dhe praktikat tjera që kanë egzistuar para hyrjes në fuqi të Ligjit mbi Trashëgiminë dhe akteve tjera juridike përmes së cilëve garantohet barazi dhe mosdiskriminim gjinor?

169

Grafiku 41. Në praktikën aktuale, femrat a disponojnë të drejtën për trashëgimi në pronën familjare?.....

170

Grafiku 42. Cilët nga trashëgimtarët (meshkuj dhe femra) të shënuar në Aktvdekje më shpesh disponojnë të drejtën e trashëgimisë në pronën familjare?.....

171

Grafiku 43. Cilët nga trashëgimtarët e shënuar në Aktvdekje më shpesh heqin dorë nga trashëgimia në pronën familjare?.....

172

Grafiku 44. Në lokalet e Noterisë a mbahet evidenc statistikore për qytetarët meshkuj dhe femra që heqin dorë nga trashëgimia?.....

172

Grafiku 45. Në lokalet e Noterisë a mbahet evidenc statistikore për qytetarët meshkuj dhe femra që pranojnë dhe disponojnë të drejtën e trashëgimisë?.....

173

Grafiku 46. Sa ndikon roli i Noterit në mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtës trashëgimore në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminues?.....

173

Grafiku 47. Cili nga aktet noteriale të poshtëshënuara zbatohen më shpesh në përditshmëri?.....

174

Grafiku 48. A mendoni se është e nevojshme të hartohen dhe zbatohen programe dhe strategji afatgjate të cilat do të mund të ndikojnë në ndryshimin e skemave dhe modeleve paragjyquese të sjelljes për rolet e femrave dhe meshkujve në shoqëri?.....

174

Grafiku 49. A pajtoheni se është i domosdoshëm modifikimi i ligjit mbi Trashëgimi i RMV-së nën dritën e praktikave të shteteve evropiane apo edhe më gjërë?.....

175

Grafiku 50. A mendoni që krahas ligjit dhe testamentit në RMV duhet të aplikohet edhe Kontrata për Trashëgimi si bazë më e fortë juridike për fitimin e trashëgimisë?.....

176

Grafiku 51. Në dekadën e fundit, gjatë veprimtarisë suaj si avokatë/gjykatës, më shpesh, me iniciativën e cilëve trashëgimtarë është inicuar procedurë kontestuese trashëgimore (pronësore familjare)?.....

177

Grafiku 52. Në përditshmëri, në Gjykatat Themelore të RMV-së më shpesh si palë procedural në rastet kontestuese trashëgimore (pronësore familjare) paraqiten:.....

177

Grafiku 53. Në dekadën e fundit, në Gjykatën Themelore të Shkupit/Tetovës (apo tjetër), a është inicuar ndonjë procedurë kontestimore ku palë procedural janë djemtë dhe vajzat e trashëgimlënësit, ndërsa fakt kontestues është madhësia e pasurisë trashëgimore?.....

178

Grafiku 54. Në dekadën e fundit, në Gjykatën Themelore të Shkupit/Tetovës (apo tjetër), a është inicuar ndonjë procedurë kontestimore ku palë procedural janë djemtë dhe vajzat e trashëgimlënësit, ndërsa fakt kontestues është e drejta për trashëgimi?

178

Grafiku 55. Në dekadën e fundit, Gjykatën Themelore të Shkupit/Tetovës (apo tjetër), a është inicuar ndonjë procedurë kontestimore mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit si palë, ku fakt kontestues është vlefshmëria apo përmbajtja e testamentit?.....

179

Grafiku 56. Në dekadën e fundit, Gjykatën Themelore të Shkupit/Tetovës (apo tjetër), a është inicuar ndonjë procedurë kontestimore mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit si palë, ku fakt kontestues është cenimi i pjesës së domosdoshme të trashëgimisë të trashëgimtarit femër?.....

180

Grafiku 57. Në kadën e fundit, në Gjykatën Themelore të Shkupit/Tetovës (apo tjetër), a është inicuar ndonjë procedurë kontestimore mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit, ku fakt kontestues janë rrethanat që kanë nxitur “heqjen dorë nga trashëgimia”?

180

<i>Grafiku 58. A mendoni se përfitohet nga mjeti ligjor “heqje dorë nga trashëgimia”, duke dal nga konteksti për të cilin është parashikuar?.....</i>	<i>181</i>
<i>Grafiku 59. Në praktikën aktuale, cili nga aktet juridike të mëposhtme, zbatohet për të arritur qëllimin e trashëgimlënësit- shmangia e trashëgimtarit femër (bashkëshortes, vajzave, motrave, mbesave etj) nga pjesa ligjore e trashëgimisë?.....</i>	<i>181</i>
<i>Grafiku 60. A mendoni që krahas ligjit dhe testamentit në RMV duhet të aplikohet edhe Kontrata për Trashëgimi si bazë më e fortë juridike për fitimin e trashëgimisë?.....</i>	<i>182</i>

Hyrje

Tema e disertacionit: “E drejta e fëmërës për trashëgimi në pronë. Aspekte krahasuese të Ballkanit Perëndimor me theks të veçantë Republika e Maqedonisë së Veriut”, trajton, analizon dhe krahason aspektin historik, religjioz dhe normativ (nacional dhe ndërkombëtar) të drejtës për trashëgimi në pronën familjare.

E drejta e trashëgimisë në pronë si e drejtë themelore garantohet me akte ligjore në nivel nacional dhe ndërkombëtar. Edhe pse në shumë ligje, programe dhe strategji nacionale dhe ndërkombëtare potencohet dhe sigurohet barazi dhe mosdiskriminim gjinore në fushën e trashëgimisë, në praktikë mungon vullneti për realizim. Shpesh femrat përballen me sfida serioze gjatë realizimit të të drejtave të tyre. Ndikimi i kulturës, stereotipet gjinore, mentaliteti, gjendja e dobët ekonomike, niveli i ulët i arsimit, si dhe disa faktorë të tjerë pengojnë arritjen e barazisë së parashikuar me ligj.

Punimi përmban pjesën teorike dhe atë empirike. Pjesa teorike e punimit përfshin pesë kapituj, ku shqyrtohen, analizohen dhe krahasohen të dhëna sekondare të përzgjedhura nga burime të ndryshme. Pjesa e dytë empirike (kapitulli i gjashtë) përfshin analizën e të dhënave të grumbulluara nga pjesëmarrësit në hulumtim.

Kapitulli i parë i titulluar: “Aspekti i zhvillimit historik të së drejtës për trashëgimi” është i ndarë në gjashtë nëntituj. Për të zbuluar arsyet e mospjesëmarrjes së femrës në pjesën ligjore të trashëgimisë, hulumtimin e fillojmë nga zhvillimi historik i të drejtës trashëgimore, kjo sepse duam apo jo, ka efekt pozitiv ose jo, historia e të drejtës trashëgimore ndikon tërthorazi apo edhe drejtpërdrejtë në statusin e të drejtës trashëgimore të femrave edhe në ditët e sotme. Në fillim të kreut trajtohet e drejta e femrës për trashëgimi në antikitetin grek sipas ligjit athinas, ku vërrejmë se roli i gruas në zotërimin dhe shfrytëzimin e pronësisë ishte shumë i shpërfillur. Punimi vazhdon me të drejtën e femrës për trashëgimi në pronë në Babiloni. Sipas dokumenteve babilonase, në familjet patriarkale vajzat nuk llogariteshin si trashëgimtarë të pronës familjare. Trashëgimia kalonte tek vajzat vetëm nëse i vdekuri nuk kishte djem. Në nëntitullin e tretë të këtij kapitulli analizohet pozita e femrës sipas disa kanuneve shqiptare, në veçanti i kushtohet rëndësi fenomenit të përjashtimit dhe heqjes dorë nga trashëgimia të bijave dhe bashkëshortes që në praktikën gjyqësore haset shpesh edhe në ditët e sotme. Në vazhdim të kapitullit të parë, analizohet dhe krahasohet e drejta e femrës për trashëgimi sipas fesë islame, fesë krishtere dhe fesë hebreje. Sipas fesë hebreje të drejtë në trashëgiminë pronësore familjare ka djali por jo edhe vajza. Sipas dekretit të Moisiut, bijat trashëgojnë vetëm nëse nuk ka asnjë trashëgimtarë mashkull, ndërsa gruaja nuk trashëgon as në këto kushte. Sipas rregullave biblike bashkëshortja nuk trashëgon asgjë nga prona e bashkëshortit, kurse vajza mund të trashëgojë vetëm atëherë kur nuk ekziston asnjë trashëgimtar mashkull. Kurani e ka përcaktuar femrën si trashëgimtare. Feja islame trashëgiminë e ndanë në proporcion dy me një, pra dy hise për djalin dhe një për vajzën. Urtësia e këtij dallimi, është se mashkulli është përgjegjësi për mirëmbajtjen e femrës (bashkëshortes dhe fëmijëve), ndërsa femra nuk mban përgjegjësi materiale.

Gjatë shqyrtimit të historisë vërrejmë se femra nuk gëzonte të drejtën e trashëgimisë në pronën familjare, me përjashtime të vogla në disa konfesionet fetare. Ndryshime rrënjësore

pasuan pas Revolucionit Francez, kur edhe filluan të njihen të drejta të barabarta pa dallim gjinor.

Kapitulli i dytë i titulluar: “Instrumentet dhe mekanizmat ndërkombëtar për barazi gjinore në trashëgiminë e pronës”, është i ndarë në katër nëntituj. Këtu shqyrtohen disa instrumente ndërkombëtare që trajtojnë aspekte të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit në jetën familjare e trashëgimore si një prej parimeve themelore për një jetë cilësore. Me ratifikimin e këtyre instrumenteve ndërkombëtare, shtetet e Ballkanit Perëndimor të analizuar në këtë punim, detyrohen të ndryshojnë modelet sociale dhe kulturore të sjelljes së femrave dhe meshkujve si dhe të marrin masa të duhura për eliminimin e diskriminimit ndaj femrës.

Në kapitullin e tretë të titulluar: “E drejta pronësore trashëgimore dhe barazia gjinore tek vendet e Ballkanit Perëndimor” shqyrtohet, analizohet dhe krahasohet kuadri ligjor mbi barazinë gjinore në fushën e trashëgimisë në disa shtete të Ballkanit Perëndimor si: Kosovë, Maqedoni e Veriut, Shqipëri, Mali i Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Serbi, me çrast konstatohen ngjashmëritë dhe dallimet në gëzimin dhe realizimin e të drejtës së femrës për trashëgimi në pronë.

Kapitulli i IV i titulluar: “Tradita përkundrejt së drejtës në RMV” është i ndarë në tetë nëntituj. Ky kapitull trajton zbrazëtitrat ligjore që mundësojnë abuzim me të drejtën trashëgimore, analizon faktorët që pengojnë pjesmarrjen e trashëgimtarit femër në pjesën ligjore të trashëgimisë dhe mekanizmat që u përgjigjen si zgjidhje këtyre faktorëve, analizon disa lloje të kontratave që mundësojnë ndarjen e pasurisë për të gjallë si dhe rolin e noterit në shqyrtimin e pasurisë trashëgimore.

Kapitulli i pestë i titulluar: “Praktikat ndërkombëtare mbi trashëgiminë pronësore gjinore”, është ndarë në katër nëntituj. Në këtë pjesë jepet një pasqyrë e shkurtër e legjislacionit të disa shteteve me traditë të pasur në çështjet civile si: Austria, Franca, Gjermania, Italia etj. Shqyrtimi i praktikave më të mira ndërkombëtare ndihmon në gjetjen e një modeli funksional në trajtimin afirmativ të drejtës për trashëgimi në pronë për grupe të caktuara me pozitë të cënueshme siç janë fëmijët dhe femrat. Në këtë kapitull, rëndësi i kushtohet Rregullores me nr. 650/2012 si një ndër veprat më ambicioze që është ndërmarrë

ndonjëherë nga BE në bashkpunimin gjyqësor për çështje të së drejtës civile. Ajo rregullon në mënyrë të njëjtë institutin e trashëgimisë të të gjitha vendet e UE-së me përjashtim të Danimarkës dhe Irlandës. Në vazhdimësi përmbledhen dhe analizohen disa raste praktike në lidhje me diskriminimin gjinor në fushën e trashëgimisë, raste të përzgjedhura ku Gjykata Evropiane për Drejtat e Njeriut dhe Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka pasur mundësi të garantojë drejtën trashëgimore.

Në kapitullin e gjashtë bëhet interpretimi i të dhënave primare të fituara nga shprehëtarja e pyetësorëve si dhe intervistave të zhvilluara me gjykatës, noterë dhe qytetarë të tjerë.

Punimi mbyllet me konkluzionet ku përmbledhen gjetjet e studimit dhe jepen rekomandime modeste përfshirë masat që duhet të ndërmarrin institucionet në kuadër të përmirësimit të kuadrit ligjor dhe aplikimit të tij në praktikë, ndryshimi i praktikave dhe sjelljeve, si dhe hartimi i politikave të reja.

Lënda e kërkimit

Në aktet juridike nacionale dhe ndërkombëtare garantohet barazi dhe mosdiskriminim gjinorë në çështjet e trashëgimisë, megjithatë në praktikë ndodh shpesh që femrat të pëballen me sfida në realizimin e të drejtave të tyre. Shumë njerëz ende besojnë se pasuria duhet të përcjellet përmes linjës mashkull andaj tendenca për të anashkaluar ligjet vazhdon.

Praktika dëshmon:

- mos trashëgimin e pronës nga ana e femrave si dhe

- mosrespektimin e parimit të barazisë në marrëdhëniet e trashëgimisë.

Zanafilla e këtyre problematikave lidhet me 2 institute juridike të Ligjit për Trashëgiminë: institutin e “heqjes dorë” nga e drejta për të trashëguar dhe shmangia (përrjashtimi) nga trashëgimia. Heqja dorë nga trashëgimia realizohet me mjete të lejuara ligjore por shpesh ndodh edhe si rezultat i presionit nga ana e trashëgimtarëve tjerë ligjor, ndërsa një gjë e tillë është në kundërshtim me qëllimin e ligjit.

Aktet juridike njohin të drejtën e femrës për trashëgimi në pronën prindërore, bashkëshortore dhe familjare, madje kanë përcaktuar edhe pjesën ligjore që i përket varësisht nga cilësia në të cilën ajo thirret në trashëgimi. Kështu, femra në cilësi të bashkëshortes konsiderohet trashëgimtar i rradhës së parë së bashku me fëmijët e trashëgimlënësit, por në mungesë të fëmijëve ajo zbritet në rradhë të dytë të trashëgimisë dhe konkurren me paraardhësit (prindërit e trashëgimlënësit) apo të afërmit e tjerë (vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit). Shpesh ndodh që me rastin e vdekjes së bashkëshortit dhe në mungesë të fëmijëve, ajo rikthehet në familjen e origjinës dhe si pasojë i kontestohet e drejta e trashëgimisë. Mosnjohja e ligjeve ose mungesa e ndërgjegjësimit bën që bashkëshortja mos të kërkojë të drejtën trashëgimore në pronën e bashkëshortit. Veprimi i tillë mbështetet në zakone kulturore dhe tradita por nuk ka asnjë justifikim ligjor.

Femra trashëgon edhe në cilësi të motrës, megjithatë praktika dëshmon se kjo ndodh shumë rrallë. Ato shpesh heqin dorë nga trashëgimia në emër të traditës, në emër të harmonisë familjare, për shkak të frikës, mashtrimit ose dhunës nga anëtarët e familjes - përfitues të trashëgimisë.

Ligji i njeh të drejtën e trashëgimisë edhe vajzave/bijave të trashëgimlënësit, ndërsa fitimin apo humbjen e kësaj të drejte nuk e ndërlidh me arritjen e një moshe të caktuar apo me ndryshimin e statusit martesor. Por në praktikë, shpesh ndodh që me rastin e martesës vajzat heqin dorë nga pasuria trashëgimore në favor të trashëgimtarëve meshkuj - anëtarë të afërm të familjes.

Praktika gjyqësore konstaton se në të shumtën e rasteve, ndarja e pasurisë trashëgimore bëhet në favor të trashëgimtarëve meshkuj, ndërsa femrat marrin pjesë më të vogël të pasurisë trashëgimore, heqin dorë ose përjashtohen nga trashëgimia.

Pabarazitë gjinore në marrëdhëniet trashëgimore pranohen dhe/ose tolerohen nga shoqëria dhe nuk shihen si diskriminuese.

Ndër barrierat që i ndalojnë gratë të trashëgojnë numërohen:

- zbatim joefikas i ligjeve ekzistuese,
- mentaliteti mbizotërues,
- praktika zakonore,
- mosndërgjegjësim i shoqërisë dhe në veçanti mosndërgjegjësim i femrave për të marrë çfarë u takon,
- mungesa e dijes për ekzistencën e ligjeve dhe opsioneve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve,
- niveli i profesionalizmit të aktorëve në sistemin e drejtësi dhe sistemin social në përgjithësi.

Që të përmirësohet situata e trashëgimitarit femër është e nevojshme fushatë sensibilizuese për informim, promovim dhe ndërgjegjësim të shoqërisë mbi të drejtën trashëgimore të femrave.

Qëllimi i hulumtimit

Punimi ka qëllim të shumëfishtë. Synim i përgjithshëm i punimit është nxitje e praktikave pozitive (nxitja e ndryshimeve ligjore dhe procedurale në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare që mund të kontribuojnë në barazinë gjinore në trashëgimi), si dhe edukim i femrave dhe meshkujve me parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit në fushën e

trashëgimisë, në veçanti edukim i trashëgimlënësit për të vepruar në mënyrë proaktive pasurinë në trashëgim. Punimi gjithashtu ka qëllime tjera si:

- Të identifikohen ngjashmëritë dhe dallimet kryesore në legjislacionin pozitiv në fushën e trashëgimisë në vendet e Ballkanit Perëndimor të përfshirë në punim.
- Të sigurojë analizë teorike dhe praktike të zbatimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në fushën e trashëgimisë.
- Të identifikohen faktorët që pengojnë realizimin e të drejtës së femrës për trashëgimi në pronë.
- Të analizohet niveli i respektimit të të drejtave të femrave për trashëgimi në pronën familjare në praktikë.
- Të identifikohen trendet e ndarjes së pasurisë trashëgimore.
- Të analizojë dorëheqjen “vullnetare” nga trashëgimia analizuar nga këndvështrimi gjinor.
- Të sigurohen të dhëna statistikore në terren në lidhje me rastet trashëgimore, kryesisht duke u bazuar në këndvështrimin gjinor dhe nacional.

Rëndësia e punimit

Insituti i trashëgimisë është institut i vjetër, shumë i rëndësishëm që ka zbatim të vazhdueshëm dhe të shpeshtë në praktikën e përditshme. Është institucioni i vetëm që mundëson bartjen e të drejtave dhe detyrimeve të karakterit pasuror nga i vdekuri tek personat e tjerë.

Meqenëse mungojnë hulumtime krahasuese mbi të drejtën trashëgimore në vendet e Ballkanit Perëndimor, disertacioni me temë: “E drejta e femrës për trashëgimi në pronë. Aspekte komparative të Ballkanit Perëndimor me theks të veçantë Republika e Maqedonise së Veriut” do të sjell informacion më të thelluar dhe më të detajuar të kësaj tematike që do të kontribuojnë në nivelin akademik por edhe atë praktikë.

Në punim identifikohen faktorët që lejojnë abuzimin e e drejtës së femrës për trashëgimi në pronë, si dhe identifikohen mekanizmat që iu përgjigjen zgjedhjes së këtyre faktorëve.

Punimi vjen me rekomandime konkrete për ndërhyrjet që duhen bërë me qëllim të përmirësimit të situatës së trashëgimtarit femër në praktikë.

Sugjerohen ndryshime ligjore dhe institucionale, vënie të mekanizmave edukativ në komunitet dhe shkollë, trajnime të gjykatësve dhe noterëve për të evituar të gjitha pengesat deri në barazinë gjinore brenda familjes në çështje pronësore.

Pritjet janë që kërkimi të ketë zbatim në komunitet. Zbatimi në komunitet i referohet kontributit për shkencën dhe institucionet shtetërore që merren me kete problematikë.

Punimi do të jetë në shërbim të çdo personi që nën ligjin zbaton dhe mbart detyra që përkojnë me aplikimin praktik të së drejtës në përgjithësi dhe të drejtës trashëgimore në veçanti.

Uroj që punim të kontribuojë në sjelljen e të dhënave që mund të nxisin debat mbi këtë tematikë dhe të shtyjnë përpara respektimin e ligjeve dhe përmirësimin e situatës në praktikë.

Hipoteza

Punimi bazohet mbi tre hipoteza kryesore dhe tre hipoteza ndihmëse.

Hipotezat kryesore:

1. Gjinia femërore vazhdon të përjashtohet nga e drejta për trashëgimi në pronën familjare.
2. Barazia gjinore vazhdon të mbetet sfidë globale në fushën e trashëgimisë.
3. Heqja dorë nga e drejta e trashëgimisë tregon “solidarizimin” e femrave ndaj trashëgimtarëve meshkuj – anëtarë të afërm të familjes.

Hipotezat ndihmëse:

1. Ndryshimet ligjore përmes të cilave do të futen mekanizma kontrolli mbi proceset e mbaruara për barazi në trashëgimi mund të përmirësojnë gjendjen e palakmueshme të femrave në trashëgiminë e pronës prindore.
2. Trajnimi i gjykatësve dhe noterëve lidhur me dhënien e deklaratës për heqje dorë nga trashëgimia mund të kontribon në procese të drejta të trashëgimisë.
3. Fushata për edukim të popullatës si dhe programet shkollore mund të ndikojnë pozitivisht në emancipimin mbarëpopullor për të kuptuar drejt barazinë gjinore.

Pyetjet e hulumtimit

Pyetjet kryesore të hulumtimit:

1. A respektohet dhe realizohet e drejta e femrës për trashëgimi në pronë në ditët e sotme, në aspektin praktik?
2. Cilat faktorë pengojnë zbatimin e legjislacionit dhe realizimin e drejtës së femrës në trashëgiminë e pronës familjare?
3. Çka mund të kontribuoj në avancimin e barazisë gjinore në trashëgiminë familjare?
4. Cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet në rregullimin e marrëdhënieve trashëgimore mes RMV-së dhe 5 shteteve tjera të Ballkanit Perëndimor të analizuara në punim?

Pyetjet ndihmëse të hulumtimit:

1. A dallon praktika aktuale trashëgimore krahasuar me praktikat zakonore dhe praktikat tjera që kanë egzistuar para hyrjes në fuqi të Ligjit mbi Trashëgiminë dhe akteve tjera juridike përmes së cilëve garantohet barazi dhe mosdiskriminim gjinor?
2. Në ditët e sotme, a ndikojnë normat zakonore dhe religjioze në mosrealizmin e të drejtës së femrës për trashëgimi në pronën familjare?
3. Cilat trende të ndarjes së pasurisë trashëgimore zbatohen në praktikë?
4. Cila bazë juridike e thirrjes në trashëgimi dominon në praktikë?
5. Si ndikon pjesmarrja e femrave në trashëgiminë e pronës familjare në marrëdhëniet me prindërit/ vëllezërit?

Metodologjia

Për nevojat e punimit shfrytëzohen këto metoda:

- Metoda deskriptive -nëpërmjet së cilës bëhet sqarimi i nocioneve që mbart punimi.
- Metoda historike - haset në kapitullin e parë, ku trajtohet e drejta e femrës për trashëgimi në pronë nga pikëpamja historike dhe ajo religjioze.
- Metoda e analizës së legjislacionit – përmes së cilës mundësohet analizë e dispozitave ligjore në nivel nacional (LTMV, LPJK, LN etj) analizë e ligjeve të trashëgimisë në vendet e Ballkanit Perëndimor (KCRSH, LTK, LTRS, LTBH, LTMZ, LPJJK, LPJKRS, LNRSH, LNRKS etj) si dhe analizë e dispozitave të instrumenteve dhe mekanizmave ndërkombëtar për barazi gjinore në marrëdhëniet trashëgimore (KEDNJ, KEGJFD, etj).
- Metoda krahasuese – haset pothuajse në çdo kapitull të punimit. Punimi bën krahasim të drejtës së femrës për trashëgimi në pronë në kohë të ndryshme, tek popuj, religjione dhe shtete të ndryshme.
- Metoda statistikore- për mbledhjen, organizimin dhe prezentimin e të dhënave të mbledhura nga anketimi.

Mbledhja e të dhënave primare është realizuar me ndihmën e disa instrumenteve të hulumtimit si:

- pyetësori (i strukturuar) me pyetje për noterë;
- pyetësori (i strukturuar) me pyetje për gjykatës dhe avokatë të lëndëve civile (pronësore - trashëgimore);
- anketa me qytetarët: veçmas me qytetarët meshkuj dhe veçmas me qytetarët femra;
- intervistë (e gjysmëstrukturuar) me noterë dhe avokatë të lëndëve civile dhe
- intervista (e pastrukturuar) me disa qytetarë të RMV-së (meshkuj dhe femra).

Kampioni dhe mostra - Në hulumtim marrin pjesë qytetarë të rastësishëm (kampion i pa qëllimshëm), por edhe profesionist ligjorë që kanë për detyrë të ushtrojnë drejtësinë si: noterë, avokatë dhe gjykatës të lëndëve civile (pronësore- trashëgimore), përzgjedhja e të cilëve është e qëllimshme (kampion i qëllimshëm).

Në hulumtim kanë marrë pjesë gjithsejt 1295 qytetarë të RMV si:

- 20 noterë;
- 10 avokatë të lëndëve civile (pronësore-trashëgimore);
- 5 gjykatës të lëndëve civile (pronësore-trashëgimore);

- 1260 qytetarë të RMV-së:
 - 630 qytetarë femra shtetase të RMV-së;
 - 630 qytetarë meshkuj shtetas të RMV-së.

Mbledhja e të dhënave sekondare realizohet përmes shfletimit të literaturës. Literatura përfshin: tekste universitare të kësaj fushe, disertacione, dokumente zyrtare (ligje, raporte të komisioneve, etj), interneti, etj. Për nevojat e punimit janë shfrytëzuar disa burime si: ligjet pozitive nacionale dhe ndërkombëtare, mekanizmat dhe instrumentet ndërkombëtare, literatura vendase dhe e huaj, hulumtime shkencore të publikuara në gjuhën shqipe, maqedonase, serbe dhe angleze, etj.

Etika – Të dhënat janë mbledhur dhe përpunuar në mënyrë të ndershme, të drejtë, të ligjshme, të saktë, kurse pjesmarrësit janë njoftuar me qëllimin e hulumtimit .Duke pasur parasysh natyrën delikate dhe komplekse të trashëgimisë, është respektuar konfidencialiteti e cila është mundësuar përmes anonimitetit dhe shkruarjes së inicialeve.

Vendi i studimit- Intervista me noterë dhe gjykatës është realizuar në takime direkte, në vendin e tyre të punës, kryesisht në qytetin e Tetovës dhe Shkup, kurse pyetësorët janë shprëndarë në mënyrë elektronike por edhe në terren në qytete të ndryshme të Maqedonisë së Veriut, sidomos në vendet më të frekuentuara nga qytetarët si: qendrat tregtare, spitale, gjykata etj.

Analizimi i të dhënave – Analiza e të dhënave sasiore mundësohet me programeve kompjuterike: Excel, Ëord etj, përmes të cilëve paraqiten të dhënat në tabela dhe grafikone.

Kufizimet – procesi i hulumtimi dhe mbledhja e të dhënave primare në terren ka konsumuar më shumë kohë dhe është ndër sfidat më të mëdha në realizimin e punimit.

Ky hulumtim është kryer prej 8.10.2019 –14.12.2020.

KAPITULLI I

ASPEKTI I ZHVILLIMIT HISTORIK TË SË DREJTËS PËR TRASHËGIMI

1.1 Trashëgimia e femrave në ligjin athinas

Deri në reformat e Solonit, në Athinë zbatohej vetëm trashëgimia ligjore, ajo rregullohej me të drejtën zakonore greke. E drejta zakonore greke vajzave të pamartuara iu njihte të drejtën në pajë, por jo edhe të drejtën e trashëgimisë në pronën familjare (Ismaili & Sejdiu, 2000: 92).

Trashëgimtarë ligjorë janë konsideruar vetëm fëmijët legjitim meshkuj (Vorpsi, 2015: 28).

Nëse trashëgimlënësi kishte vetëm një djalë legjitim, atëherë e gjithë trashëgimia përfshirë edhe detyrimet e testatorit ndaj kreditorëve i kalonin atij. Nëse i ndjeri kishte më shumë djem legjitim, atëherë pasuria trashëgimore ndahej për të gjithë djemtë në mënyrë të barabartë, shumë shpesh praktikohesh ndarja e pasurisë trashëgimore me bast. Nëse trashëgimlënësi kishte vetëm vajza, pretendohesh se ajo do të martohej dhe do të kishte pasardhës mashkull. Ajo nuk mund të dispononte pronën e trashëguar nga babai i saj, derisa djali i saj arrinte moshën madhore (Foxhall, 1994: 3-4).

Fëmijët jashtëmartesor nuk gëzonin të drejtën e trashëgimisë dhe nuk konsideroheshin pjesë e familjes. Ata barazoheshin më fëmijët martesor, vetëm në qoftëse më parë i kishte adoptuar trashëgimlënësi (Vajs & Kandiq, 1984: 61).

Në mungesë të pasardhësve, pasurinë e trashëgimlënësit e trashëgonin farefisi i tij sipas radhës, në vijën e të atit. Procedura trashëgimore inicohej me padi dhe zhvillohej para organit shtetëror. Kur trashëgonin pasardhësit e trashëgimlënësit, nuk zhvillohej procedurë trashëgimore para organit shtetëror (Ismaili & Sejdiu, 2000: 92).

Në Athinën antike aplikohesh edhe trashëgimia testamentale. Testatori gëzonte të drejtën që me testament të zvogëloj pjesën trashëguese trashëgimtarëve ligjorë, por nuk mund ti përjashtonte plotësisht nga trashëgimi. Femrat nuk kishin aftësi për të vepruar andaj edhe nuk mund të shprehnin vullnetin e tyre për ndarjen e pasurisë trashëgimore me testament (Ismaili & Sejdiu, 2002:92).

1.2 E drejta e femrës për trashëgimi në pronë në Babiloni

Në Lindjen e largët, pasuria shfrytëzohej nga të gjithë anëtarët e familjes përfshirë edhe bashkëshorten dhe vajzat, por mund të trashëgonin vetëm pasardhësit meshkuj (Smith, 1993: 166). Në Babiloni, e drejta në trashëgimi rregullohej nga e drejta zakonore. Çështjet trashëgimore rregulloheshin me nenet 162 – 184 të Kodit të Hamurabit (më tutje KH) (Ismaili & Sejdiu, 2002: 60).

Në Lindjen e largët, trashëgimia kalonte tek pasardhësit (Vorpsi, 2015:27).

Në dispozitat e KH, vërrehet diskriminim i trashëgimtarëve femra si dhe trajtimi jo i barabartë i fëmijëve martesor dhe jashtëmartesor të trashëgimlënësit. Vajzat dhe bashkëshortja e trashëgimlënësit nuk njiheshin si trashëgimtarë ligjorë, ndërsa djemtë konsideroheshin trashëgimtarë të domosdoshëm. Vajzat kishin vetëm të drejtën në prikë¹, vlera e së cilës krahasuar me vlerën e pasurisë trashëgimore ishte më e vogël (Vorpsi, 2015:27).

Pas vdekjes së bashkëshortes, prika kalonte vetëm tek fëmijët e saj por jo edhe te bashkëshorti. Në qoftë se bashkëshortja nuk kishte fëmijë, atëherë prika e saj i kthehej familjes së babait të saj por asnjëherë bashkëshortit (neni 162).

Egzistonte mundësia që babai të favorizonte njërin prej djemve të tij duke i dhuruar pasuri për së gjalli. Pas vdekjes së babait ai merrte pjesë në trashëgimi në mënyrë të barabartë me vëllezërit e tjerë. Babai kishte të drejtë të përjashtojë nga trashëgimia ndonjërin prej djemve të tij, por për këtë nevojitej deklarata e të ndjerit para Gjykatës dhe pëlqimi i Gjykatës. Përjashtimi bëhej vetëm për ndonjë faj të rëndë të parapar shprehimisht në ligj (neni 165-168).

Fëmijët jashtëmartesor kanë mundur të trashëgojnë vetëm pronën e luajtshme. Prona e paluejtshme u takonte vetëm fëmijëve martesor (Ismaili & Sejdiu, 2002: 61).

Në Babiloni ekzistonte vetëm trashëgimia ligjore dhe amaneti gojor si dëshirë e fundit, kurse testamenti nuk është përmendur (Ismaili & Sejdiu, 2002: 61).

1.3. Rregullimi i trashëgimisë sipas të drejtës zakonore shqiptare

¹ Prika apo paga nënkupton formë të dhuratës (kryesisht sende të lëvizshme si: veshje, dhurata për të afërmit e bashkëshortit si dhe artikuj dhe sende për përdorim të përditshëm) që prindi iu jepte vajzave me rastin e martesës. Prika/paja, ishte pasuri personale e gruas të cilën në rast shkurorëzimi kishte të drejtë ta merrte me vete.

Në krahinat ku jetonin shqiptarët, e drejta trashëgimore ka qenë e rregulluar nga e drejta zakonore shqiptare. Familjet ishin patriarkale, ndërsa vendbanimet kishin model patrilokal. Dhëndri me nusen banonin në shtëpinë e prindit të dhëndrit, ndërkaq djemtë ndaheshin vetëm me pëlqimin e babait ose pas vdekjes së tij. Familjet ishin të mëdha: prindërit, djem të martuar me familjet e tyre, si dhe vajza dhe djem të pamartuar. Familja përbëhej deri në katër breza (Lastaria - Cornhiel, & Ëheeler 1998:5). Familja patriarkale kishte ekonomi të përbashkët, burrat ishin bashkëpronar të pronës, ndërsa gratë ekonomikisht mbaheshin nga burrat (Xhafaj & Nrecaj, 2017: 25).

Zotësi për të trashëguar gëzonin djemtë dhe fëmijët e tyre, pra meshkujt që buronin nga trangu i gjakut të babait (Lastaria –Cornhiel & Ëheeler 1998: 8).

E drejta zakonore shqiptare karakterizohet nga trajtim jo i barabartë mes burrit dhe gruas, mes fëmijëve martesor femra dhe meshkuj, si dhe mes fëmijëve martesor dhe jashtëmartesor pavarësisht gjinisë.

Pavarësisht pushtimeve perandorake, e drejta zakonore shqiptare nuk u çrrënjos plotësisht madje pothuajse është e pranishme edhe në ditët e sotme. Zakoni si burim kryesor ka Kanunet. Kanuni mban të drejtën e femrës në trashëgiminë e pronës familjare si në familjen e bashkëshortit ashtu edhe në familjen e saj të origjinës (Gërbeshi-Zylfi, 2008: 191).

Në trevat shqiptare, funksiononin afër dymbëdhjetë kanune të ndryshme. Pushtet absolut legjislativ kishte Kanuni i Lekë Dukagjinit (më tutje KLD), që po sfidon ligjet edhe në kohët e sotme.

1.3.1 Rregullimi i trashëgimisë në Kanunin e Lekë Dukagjinit

KLD, shekuj me rradhë ka qeverisur sjelljen shoqërore në Shqipërinë e veriut, Kosovë si dhe mesin e popullatës shqiptare në Mal të Zi, Serbi dhe Maqedoni (Tërnavci, 2008:1). KLD u formua dhe u ruajt në pjesën veriore të Shqipërisë, Kosovë e sidomos Malësitë (Halimi, 1994:15).

Në KLD, vërrehet pabarazi dhe diskriminim i gruas. Kjo vërrehet edhe në kanunet e tjera (Mandro-Balili, 20116: 37).

Nenet 88- 131 të KLD, rregullojnë marrëdhëniet trashëgimore (Vërbani, 2013: 30).

Sipas KLD (nenet 89-91), vetëm djemtë martesor sipas “Lisit të gjakut”, pavarësisht nga gjendja fiziko-psiqike apo mosha gëzojnë të drejta në trashëgimi, ndërkaq femra nuk gëzon këtë të drejtë as në familjen e origjinës dhe as në familjen e bashkëshortit (Dragovaja, 1996: 9).

KLD, femrën e konsideronte tepricë në shtëpi. Një vajzë nuk trashëgonte edhe nëse ishte i vetmi fëmijë në familje. Në këto raste kërkohej trashëgimtari mashkull deri në brezin e dymbëdhjetë vetëm që pasuria trashëgimore të mos përcillet tek një vajzë. Trashëgimlënësi, nuk gëzonte të drejtën që për së gjalli t’i dhuroj vajzës/ve të tij sende të palëvizshme, përveç sendeve të lëvizshme me vlerë të vogël (Gjeqovi, 1999: 26-28).

Nëse trashëgimlënësi nuk linte djem, atëherë pasuria trashëgimore kalonte tek kushërinjtë më të afërt, e ata kishin për detyrë të kujdesen për vajzat e trashëgimlënësit, në veçanti për vajzat e pamartuara të tij. Përveç vajzave dhe gruas, neni 90 i KLD, nga trashëgimia përjashton edhe nipërit nga ana e vajzave. Kur trashëgimlënësi kishte vetëm djem të mitur, atëherë kushërinjtë më të afërt kishin për detyrë të kujdesen për to dhe të merrnin në administrim pasurinë trashëgimore, por me arritjen e moshës 15 vjeçare ata detyroheshin ta dorëzonin pasurinë ndërsa për punët e kryera mund të kërkonin shpërblim (Gjeçovi, 1999: 26-27).

1.3.2 Rregullimi i trashëgimisë në Kanunin e Skënderbeut

Në trevat ku jetonin shqiptarë njëhej edhe Kanuni i Skënderbeut, i cili zbatohej në Shqipërinë Qëndrore si në : Dibër, Krujë, Mat, Elbasan prej lumenjeve MatFand ne veri dhe deri poshtë lumit Shkumbin në jug dhe prej detit Adriatik në perëndim e deri në kufinjtë lindore të Dibrës e të Ohrit ne lindje (Berisha, 2017: 13).

Edhe Kanuni i Skënderbeut (më tutje KS) njeh si trashëgimtarë ligjorë vetëm meshkujt. KS, njeh barazinë mes djemve në trashëgimi, por jo edhe barazinë mes djemve e vajzave. Pas vdekjes së babait, vajza duhej të jetoj me vëllezërit, por jo edhe të ketë pronë të saj (Berisha, 2017:15).

Në KS, hasen norma të së drejtës së Sheriatit. KS njeh institutin e “Selemi-t”². Me pranimin e Selem-it, vajzat përjashtohen nga trashëgimia në familjen e origjinës dhe atë të bashkëshortit (Mandro-Balili, 2016: 38)

1.3.3. Rregullimi i trashëgimisë në Kanunin e Labërisë

Një rregullim të plotë dhe të detajuar të marrëdhënieve trashëgimore hasim në nenet 581- 609 të Kanunit të Labërisë. Edhe në Kanunin e Labërisë (më tutje KL) vërrehet pabarazi gjinore në marrëdhëniet martesore, familjare dhe ekonomike. Femra nuk gëzonte të drejtën trashëgimore, gruaja pas divorcit nuk mund ta merrte fëmijën pasi i përkiste burrit dhe kursesi nuk merrte pjesë në shitjen dhe blerjen e pronave (Xhafaj, 2010: 18).

Në të drejtën zakonore të Labërisë gruaja gëzonte vetëm të drejtën e disponimit dhe mbajtjes së të hollave dhe dhuratave që kishte pranuar si nuse. Institut i rëndësishëm i KL ishte “paja” apo “prika” e cila kishte lidhje me ritet ortodokse dhe praktikohet në pjesën Jugore të Shqipërisë (Mandro- Balili, 2016: 38).

Sipas nenit 584 të KL, pasurinë trashëgimore e trashëgojnë vetëm meshkujt që burojnë nga trungu i gjakut të babait, si: djemtë e të ndjerit, djemtë e djemve, vëllezërit dhe kushërinjtë nga trungu i babait. Kushërinjtë trashëgonin vetëm nëse i ndjeri nuk lente pas vetes pasardhës djem, nipa ose stërnipa në vijë të drejtë (Elezi, 2006:193-194).

Neni 587 i KL, femrave u njihte të drejta të kufizuara në trashëgimi. Vajza dhe gruaja trashëgonin vetëm sende të lëvizshme, përjashtim nga ky rregull ishin rastet kur në familjen e prindërve nuk kishte meshkuj. Sipas nenit 588 të KL, gruaja përjashtohet nga trashëgimia në dy raste: nëse dyshohej për shkelje të besnikërisë bashkëshortore (për çështje nderi), si dhe kur besonte në një fe tjetër nga ajo e trashëgimlënësit.

KL, rregullonte disa situata të veçanta në marrëdhëniet trashëgimore psh: në qoftë se vajza betohej para dy ose më tepër dëshmitarëve se nuk do të martohej në të ardhmen por do të qëndrojë në shtëpinë e prindërve, shpallej virgjëreshë me çrast gëzonte të drejta të

² Selemi”, nënkupton pasurinë (kafshë dhe çdo pasuri tjetër personale) që me rastin e martesës e sillte gruaja nga familja e saj e origjinës.

pakufizuar sikur të ishte djalë. Pas vdekjes së saj, pasuria trashëgimore kalonte tek kushërinjtë nga trangu i babait (Lastarria-Cornhiel & Ëheeler, 1998:8).

Në qoftë se i ndjeri linte një apo më tepër vajza të mitura, atëherë për ta kujdesej xhaxhai ose kushëriri i parë nga babai (neni 597). Nëse i ndjeri kishte fëmijë të mitur dhe vajzë madhore, ajo kujdesej për ta dhe administronte pasurinë trashëgimore, mirëpo për të disponuar pasurinë e trashëguar i nevojitej leje ose pëlqim nga xhaxhai apo kushërinjtë e parë nga babai (Elezi, 2006: 196).

Me vdekjen e gruas pasuria trashëgimore ndahet mes djemve të saj dhe në mungesë të tyre, mes trashëgimtarëve tjerë të rradhës. Bashkëshortja nuk gëzonte të drejtën e trashëgimisë në pronën e bashkëshortit, por nëse vendoste të mos largohet nga shtëpia e bashkëshortit të ndjerë, atëherë ajo gëzonte të drejtën e banimit dhe mbajtjes sikur edhe para vdekjes së bashkëshortit. Nëse e veja me dëshirë kthehej në shtëpinë e prindërve dhe nuk martohej përsëri, atëherë ajo kishte të drejtë të kërkojë nga vëllezërit që të kujdesen për ushqimin dhe mbajtjen e saj për gjithë jetën, por nuk gëzonte të drejtën e trashëgimisë në pronën e babait (neni 589). Gruas së ve, në familjen prindërore i njihej e drejta e trashëgimisë (miraz) vetëm nëse vdisnin gjithë trashëgimtarët meshkuj (Elezi, 200:194-195).

KL, nuk lejonte trashëgimlënësin që të përjashtojë djalin nga trashëgimia. Këtë nuk duhet ta lejonin vëllezërit, farefisi dhe bashkësia, ndërkaq pleqtë që e ndanin pasurinë trashëgimore duhej t'i ndanin çdonjërit pjesën që i takon. Meshkujt përjashtoheshin nga trashëgimia në rastë se: vrisnin trashëgimlënësin, ishin fëmijë jashtëmartesor ose fëmijë të lindur nga nëna me burrin tjetër pas vdekjes së burrit të pare ose nëse mohonin fenë islame (Elezi, 2006: 194.)

Përderisa fëmijët jashtëmartesor nuk gëzonin të drejtën e trashëgimisë, fëmijët e adoptuar gëzonin të drejtën e barabartë në trashëgimi më fëmijët martesor (neni 598).

KL, njeh trashëgiminë testamentare. Testamentlënësi, kishte të drejtë me testament pronësinë t'ia kalonte vajzave, ndonjë personi tjetër ose ndonjë institucioni fetar apo kulturor, por vetëm pasi të kishte siguruar paraprakish pëlqim apo miratim nga vëllezërit dhe kushërinjtë dhe pasi t'i shlyente borxhet e familjes (Elezi, 2006: 197).

KL, rregullonte edhe procedurën e ndarjes së pasurisë trashëgimore. Pasurinë trashëgimore e ndante vëllau më i madh, kushëri i afërt i babait ose ndonjë nga fqinjët. Nëse vëllezërit nuk pajtoheshin me mënyrën e ndarjes së pasurisë trashëgimore, thirrnin pleq të ndershëm e të paanshëm që njihnin zakonet e vendit. Ata njoftoheshin më vlerën e pasurisë trashëgimore dhe borxhet që kishte trashëgimlënësi, pastaj me hedhjen e shortit ose me marrëveshje mes vëllezërve ndanin pasurinë (Elezi, 2006: 199).

1.3.4 Kanuni i Lumës

Vetëm në Kanunin e Lumës vajzat e martuara njiheshin si trashëgimtare të radhës së dytë (Luarasi, 2001:179). Vajzat e pamartuara gëzonin të drejtën e jetesës në pronën e babait të ndjerë por jo edhe të drejtën e trashëgimisë në pronësinë e tij (1492-1493).

Sipas Kanunit të Lumës, nëse i vdekuri nuk ka djem, atëherë vajza e martuar konkurren me kushërijtë e saj në $\frac{1}{2}$, $\frac{1}{3}$ ose $\frac{1}{5}$ e pasurisë trashëgimore që ndryshe njihet me termin miraz³ (Vërbani, 2013: 30).

Vajza gëzonte të drejtën e uzufruktit⁴ në pasurinë e trashëguar, por me vdekjen e saj ajo pasuri kalonte tek kushërinjtë meshkuj nga trangu i babait dhe jo tek trashëgimtarët e saj (Luarasi, 2001: 152).

1.4. E drejta e femrës për trashëgimi ne pronë sipas fesë hebreje

³ Trashëgimia e vajzës së martuar e cila bëhet pronare e tokës të babait i saj quhet miraz

⁴ Uzufrukti është e drejtë e një personi për të gëzuar një send që është në pronësi të një tjetri, me detyrim që ta ruajë dhe ta mirëmbajë atë.

Tek hebrenjët, Ligjet e trashëgimisë pësuan ndryshime. Kështu, Dhjata e Vjetër dallon nga Ligjet e Talmudit, ndërkaq të dyja ndryshojnë nga ligjet bashkëkohore. Karakteristikë e sistemit hebre është mohimi i drejtës trashëgimore të bashkëshortes dhe vajzës/ve.

1.4.1 Trashëgimia e Hebrenjëve sipas Dhjatës së Vjetër dhe në Talmud

Sistemi i trashëgimisë sipas Dhjatës së Vjetër ishte si vijon:

1. Fëmijët - në qoftë se i vdekuri kishte djem dhe vajza, trashëgonin vetëm djemtë ndërsa vajzat nuk gëzonin te drejtë trashëgimie në pronën e të atit. Me kalimin e viteve vajzat janë pranuar si trashëgimtare por vetëm në qoftë se nuk ka vëllezër dhe me kusht që të martohen në të njëjtin fis, me qëllim që pronësia mos të transferohet jashtë familjes apo fisit .
2. Vëllezërit - nëse i vdekuri nuk kishte fëmijë (djem apo vajza), trashëgonin vëllezërit e tij.
3. Axxhallarët- kur i vdekuri kishte fëmijë dhe vëllezër, trashëgonin axhallarët.
4. Farefisi- nëse i ndjeri kishte axhallarë, atëherë pasuria trashëgimore kalon tek farefisi më i afërt.

Sipas Talmudit, të drejtë trashëgimie gëzojnë vetëm meshkujt kurse femra nuk trashëgon. Nëse i ndjeri kishte një vajzë të pamartuar, djemtë e tij kishin për detyrë që të kujdesen për shpenzimet e martesës së motrës, deri më 1/10 e pasurisë së trashëguar. Nëse ishin më shumë vajza, të gjitha martohen, por nuk tejkalohet vlera 10% e pasurisë së trashëguar (Vërbani, 2013:20- 22).

1.4.2 Sistemi i trashëgimisë tek hebrenjët bashkëkohor

Në të drejtën hebreje trashëgimia është “patrilineale”. Vajza, bashkëshortja, nëna, gjyshja, halla dhe femra tjera të familjes nuk gëzojnë të drejtë trashëgimore në pronën familjare. Vajza trashëgon vetëm nëse i vdekuri nuk ka djem por jo së bashku me djemtë. Në fillim të ndjerin e trashëgon djali. Nëse i vdekuri lë pas vetes djem dhe vajza, trashëgojnë vetëm djemtë. Nëse ka më shumë djem, atëherë të martuarit marrin dy hise ndërsa të pamartuarit nga një hise. Nëse i vdekuri ka vetëm një fëmijë –vajzë, ajo trashëgon tërë pasurinë, nëse ka më shumë vajza, pa marr parasysh statusin martesor ato trashëgojnë njëjtë. Djemtë kanë për detyrë të përkujdesen për motrat e pamartuara deri në vlerë të 10% të pasurisë së trashëguar. Vajzat nuk gëzojnë të drejtë në 10% të pasurisë së babait në qoftë se martohen para vdekjes së babait ose martohen pas vdekjes së tij por nuk kërkojnë asgjë (Vërbani, 2013: 22).

Radhët e trashëgimisë janë përcaktuar në numrat 27:7-11.

- Në fillim trashëgojnë djemtë e të vdekurit, në mungesë të tyre trashëgojnë vajzat (27:8);
- Nëse i ndjeri nuk ka fëmijë, atë e trashëgon babai, kurse nëna nuk trashëgon prej djalit të saj;
- Kur i ndjeri nuk ka pasardhës dhe as prindër, atëherë trashëgojnë vëllezërit e tij (në pjesë të barabarta);
- Kur i vdekuri nuk ka fëmijë, prindër dhe as vëllezër, atëherë trashëgon gjyshi. Gjyshja nuk ka të drejtë trashëgimie;
- Nëse i vdekuri nuk ka fëmijë, prindër, vëllezër, gjysh, atëherë në rradhë vijnë axhallarët, ndërsa hallat nuk trashëgojnë.

Gruaja nuk ka të drejtë trashëgimie në pronësinë e burrit të saj, kurse burri trashëgon gruan e tij (Vërbani, 2013: 22-23).

1.5 E drejta e femrës për trashëgimi në pronë sipas fesë krishtere

Ligji eklestiasitik dhe ai civil i botës krishtere, bijave u mohonte të drejtën për të trashëguar në pronën e babait. Bashkëshortja ishte e privuar nga çfarëdo lloj e drejte trashëgimie. Këto rregulla të padrejta e të pabarabarta mbijetuan deri në shekullin XX (Azim, 2008: 59).

Te krishterët ekzistojnë 2 sisteme të trashëgimisë:

- Sistemi ibnu Kalakut dhe
- Sistemi i Asalit.

Sistemi ibnu Kalakut - trashëgiminë e parasheh sipas këtyre rregullave:

1. Fëmijët, pavarësisht gjinisë apo statusit martesor, të gjithë trashëgojnë në mënyrë të barabartë. Nëse ndonjë djalë ka vdekur dhe ka pasardhës, atëherë djemtë e tij trashëgojnë me axhallarët sikurse të kishte qenë gjallë prindi i tyre.
2. Nëse i ndjeri nuk ka pasardhës apo fëmijë të fëmijëve, atëherë gruaja merr pjesën e saj obligative, ndërsa pjesën tjetër e trashëgojnë babai $\frac{2}{3}$ ndërsa nëna $\frac{1}{3}$. Nëse njëri prind është i vdekur, atëherë pjesën e tij e marrin vëllezërit dhe motrat e të vdekurit, në pjesë të barabarta. Nëse ndonjëri prej vëllezërve ose motrave është i vdekur, atëherë hisen e marrin fëmijët e vëllezërve ose fëmijët e motrave të të vdekurit.
3. Nëse i vdekuri nuk ka fëmijë, baba e as nënë, atëherë trashëgojnë vëllezërit dhe motrat.
4. Nëse i vdekuri nuk ka fëmijë, baba, nënë, gjyshe e gjysh, atëherë trashëgojnë axhallarët dhe dajallarët.
5. Nëse i vdekuri nuk ka fëmijë, baba, nënë, vëllezër, motra, gjyshe, gjysh, axhallarë e as dajallarë atëherë trashëgojnë fëmijët e gjyshit dhe gjyshe.
6. Nëse i ndjeri nuk ka asnjërin prej tyre atëherë trashëgojnë $\frac{2}{3}$ axhallarët dhe hallat e të vdekurit, ndërsa dajallarët e trashëgojnë së paku $\frac{1}{3}$, e nëse ndonjëri prej tyre ka vdekur atëherë trashëgojnë fëmijët e tyre.
7. Nëse i vdekuri nuk ka asnjërin prej tyre, atëherë trashëgimia kalon te gjyshërit dhe gjyshtet, ashtu që loza e atësisë trashëgon $\frac{2}{3}$, ata të mëmësisë $\frac{1}{3}$ e nëse ndonjëri prej tyre trashëgon atë e trashëgojnë fëmijët e tyre.
8. Nëse i vdekuri nuk ka asnjë nga gjeneratat e përmendura, atëherë trashëgojnë axhallarët dhe hallat e gjysheve.

9. Nëse nuk ka asnjë prej tyre atëherë pasuria kalon në shtëpinë e patriarkut.

Këtë sistem e praktikojnë priftërijtë e kohës bashkëkohore (Vërbani, 2013: 26).

Sipas sistemit të Ibni Asalit trashëgimia rregullohet kështu:

1. Në rradhë të parë trashëgojnë fëmijët, djem e vajza në pjesë të barabarta;
2. Djemtë dhe vajzat e djemve;
3. Babai;
4. Nëna, vëllezërit dhe motrat, hise të barabarta;
5. Vëllezërit dhe motrat nga babai;
6. Vëllezërit dhe motrat prej nëne;
7. Fëmijët e vëllezërve dhe motrave;
8. Babai i babait;
9. Nëna e babait;
10. Axhallarët;
11. Djemtë e axhallarëve;
12. Fëmijët e vajzës;
13. Fëmijët e motrës;
14. Hallat;
15. Djemtë dhe vajzat e hallës.
16. Babai i nënës;
17. Nëna e nënës;
18. Dajallarët;
19. Fëmijët e dajallarëve;
20. Tezet;
21. Fëmijët e tezeve;
22. Baballarët e gjyshërve, e kështu me rradhë i afërm e më i afërm (Vërbani, 2013: 26-27).

1.6E drejta e femrës për trashëgimi në pronë sipas fesë islame

Kur'ani përmban udhëzime të detajuara rreth trashëgimisë. Për trashëgiminë flasin disa nga ajetet Kur'anore si: Sure El-Bekare, (kapitulli i dytë, ajetet 180 dhe 240), Sure En-Nisa, (kapitulli i katërt, ajetet: 7, 9, 11, 12, 19, 33, 176) dhe Sure El-Maide, (kapitulli i pestë, ajetet 106-108) (Kerim Naik, 2010: 93).

Sipas Kur'anit, femra gëzon të drejtë trashëgimie në pronën familjare: *“Allahu ju urdhëron për (çështjen e trashëgimisë) fëmijët tuaj: për mashkullin hise sa për dy femra”* (En-Nisa, 11). Përse kjo ndarje, a ka këtu drejtësi? Kjo ndarje bëhet si rezultat i përgjegjësisë financiare që i imponohet mashkullit. Krahasuar me femrat, mashkulli musliman ka barrë më të madhe financiare, andaj edhe rregullat e trashëgimisë shihen si balancues për këtë zhbalancim (Azim, 2008: 61). Në fenë Islame, përgjegjësi për mbajtjen e femrës së pamartuar ka babai ndërsa në mungesë të tij, meshkujt më të afërm të familjes si: vëllezërit, gjyshi dhe axhallarët, kurse bashkëshorti është përgjegjës për mbajtjen e gruas së tij. Gruaja nuk ka obligim financiar dhe çdo gjë që trashëgon apo fiton llogaritet si pasuri e saj personale (Ovolabi, 2018: 122). Femra merr 1/3 e pasurisë dhe e shpenzon si dëshiron, ndërsa mashkulli 2/3 e pasurisë së trashëguar e shpenzon për bashkëshorten, familjen dhe fëmijët e tij.

Në legjislacionin Islam, burim thelbësor është Kur'ani, aty dispozitat e drejtës trashëgimore paraqiten në dy mënyra:

- Dispozita globale, universale, jo të definuara që nuk përcaktojnë në mënyrë të prerë pjesën e trashëgimisë së trashëgimtarit. Këtë e argumenton ajeti i mëposhtëm: *“Meshkujve u takon pjesë nga pasuria që e lënë prindërit e të afërmit (pas vdekjes), edhe femrave ju takon pjesë nga ajo që lënë prindërit e të afërmit, le të jetë pak ose shumë. Kur të prezentojnë (në pjesëtimin e pasurisë që ka lënë i vdekuri) të afërmëve, bonjakëve dhe varfanjakëve (që nuk janë pjestarë nga trashëgimi) jepuni ng ajo (pasuri e lënë) dhe atyre thuajuni fjalë të mira”* (En-nisa, 7).
- Dispozita që me përpikshmëri caktojnë trashëgimtarin dhe pjesën që i takon (Zimeri, 1999:12-13). *“Allahu ju urdhëron për (çështjen e trashëgimisë) fëmijët tuaj: për mashkullin hise sa për dy femra; nëse janë (trashëgimtare) vetëm femra, dy e më shumë, atyre iu takojnë 2/3 e pasurisë që trashëgohet; nëse është një femër atëherë asaj*

i takon gjysma; për prindërit për secilin nga ata, iu takon e gjashta nga ajo që ka lënë (i vdekuri) nëse ka fëmijë; e nëqoftëse ai (i vdekuri) nuk ka fëmijë e atë e trashëgojnë (vetëm) prindërit, atëherë nënës së tij i takon një e treta; nëqoftëse (i vdekuri) ka vëllezër, nënës së tij i takon vetëm një e gjashta, (kjo e drejtë në trashëgim bëhet) pasi të kryhet (vasijjeti) që ka lënë dhe pasi të lahet borxhi, ju nuk e dini se kush është më afër dobisë suaj. (Ky përcaktim është) urdhër ng Allahu. Vërtet Allahu është më i Dijshmi, më i Urti” (En-nisa, 11).

Në ndarjen e trashëgimisë ndikojnë:

- ❖ shkalla e afërsisë familjare – anëtari më i afërt i familjes pavarësisht gjinisë trashëgon pjesë më të madhe të pasurisë në krahasim me anëtarin më të largët.
- ❖ Gjenerata e parardhësve dhe pasardhësve – kur i vdekuri lë pasardhësit dhe parardhësit, atëherë pasardhësit trashëgojnë sasi më të madhe se parardhësit, pavarësisht gjinisë.
- ❖ Përkujdesja të cilën Sheriati e sheh si detyrim (Vërbani, 2013:65).

Sipas Sheriatit Islam të drejtën e trashëgimisë e gëzojnë fëmijët pa dallim gjinor, prindërit, vëllezërit dhe motrat, bashkëshorti e bashkëshortja, kurse sasia e trashëgimisë është relative, ndryshon varësisht nga gjendja e tyre çastin e ndarjes së trashëgimisë. Kjo shihet në ajetin e poshtëshënuar Kur'anor. “*Juve u takon gjysma e asaj (pasurisë) që e lënë gratë e tuaja, nëse ato nuk kanë fëmijë, por nëse ato kanë fëmijë, juve ju takon një e katërta nga ajo që lënë ato, pasi të kryhet testament i tyre dhe pasi të lahet borgji, Atyre (grave) ju takon një e katërta nga ajo që lini ju, nëse nuk keni fëmijë, por nëse keni fëmijë , atyre ju takon një e teta nga ajo që leni pas kryerjes së testamentit që keni përcaktuar ose borxhit. Në qofë se (i vdekuri) është mashkull ose femër, e trashëgohet nga ndonjë i largët (pse ska as fëmijë) por ka një vëlla ose një motër ata janë pjesmarrës të barabartë në të tretën (e tërë pasurisë), pas testamentit të porositur ose borxhit, e duke mos dëmtuar (trashëguesit)” (En-nisa, 12)....*“*kërkojnë përgjigjen tënde. Thuaju: “All-llahu ju pergjigjet për çështjen e “kelale-s” (ai që nuk ka prindër, as fëmijë që e trashëgojnë). Nëse vdes një njeri që nuk ka fëmijë, por ka motër asaj (motrës) i takon gjysma e pasurisë së lënë. Ai (vëllau) trashëgon tërë atë (që lë motra) nëse ajo nuk ka fëmijë. Në qoftë se ato janë dy (motra që trashëgojnë) atyre dyjave u takon dy të treta që lë ai. Në qoftë se janë*

vëllezër dhe të përzier bura dhe gra, atëherë mashkullit i takon hise dyfish më shumë sesa femrës. All-llahu ju sqaron, ashtu që të mos humbni. All-llahu di për çdo send “(En- nisa, 176).

1.6.1 Rastet e trashëgimisë së femrës sipas Sheriatit Islam

Në fenë Islame, femra mund të trashëgojë sa gjysma e mashkullit, barabar me të ose më shumë se mashkulli. Në vazhdim paraqiten disa raste kur femra trashëgon sa gjysma e pasurisë trashëgimore që trashëgon mashkulli:

- Vajza me djalin – Nëse i ndjeri ka pasur një vajzë dhe një djalë, atëherë vajza trashëgon $\frac{1}{3}$ ndërsa djali trashëgon $\frac{2}{3}$ e pasurisë trashëgimore.
- Babai me nënën (vetëm një rast). Nëse i ndjeri nuk ka fëmijë dhe lë pas vetes vetëm prindërit e tij, atëherë nëna trashëgon $\frac{1}{3}$ ndërsa babai $\frac{2}{3}$ e pasurisë trashëgimore. Por, në qoftë se lë fëmijë, atëherë nëna trashëgon pjesë të barabarta sikur edhe babai.
- Vëllezërit me motrat dhe motrat prej babai me vëllezërit prej babai. Nëse i ndjeri nuk lë fëmijë, nipër, mbesa prindër, gjyshër, por vetëm motër dhe vëlla, atëherë një hise i takon motrës dhe dy hise vëllaut (En-nisa, 176).
- Burri dhe gruaja- Sipas Sheriatit Islam, burri trashëgon një hise më shumë. “...*Juve (burrave) ju takon gjysma e asaj që kanë lënë gratë tuaja, nëse nuk kanë fëmijë , e nëse kanë fëmijë atëherë për ju është $\frac{1}{4}$ nga ajo që kanë lënë , pasi të zbatohet testamenti që kanë lënë ose ti paguhet borxhi.” “ Dhe grave ju takon $\frac{1}{4}$ nga ajo që leni ju, nëse nuk keni fëmijë , e në qoftë se keni fëmijë atye u takon $\frac{1}{8}$ ” (En-nisa, 12).*

Rastet kur femra dhe mashkulli janë të barabartë në të drejtën e trashëgimisë:

- Prindërit- nëse i vdekuri pas vetes ka lënë fëmijë, atëherë prindërve të të ndjerit iu takon $\frac{1}{6}$ e pasurisë pa dallim gjinor (Nisa, 12).
- Vëllau dhe motra nga nëna- kur askush nuk i pengon në trashëgimi, secilit prej tyre iu takon $\frac{1}{6}$ e pasurisë . Nëse i ndjeri ka lënë pas vetes dy e më tepër vëllezër nga nëna dhe dy e më tepër motra nga nëna, atëherë vëllezërit së bashku trashëgojnë $\frac{1}{3}$ e pasurisë kurse motrat trashëgojnë $\frac{1}{3}$ (Nisa, 12).

Rast kur femra trashëgon më shumë se mashkulli:

- Nëse gruaja e vdekur lë bashkëshortin dhe një vajzë, atëherë vajza trashëgon $\frac{1}{2}$ e pasurisë kurse babai, gjegjësisht bashkëshorti i së vdekurës trashëgon $\frac{1}{4}$. Ky është një ndër rastet kur femra trashëgon dyfishin e asaj që trashëgon mashkulli.

1.7.Vështrim i shkurtë i kapitullit të parë

Në kapitullin e parë analizohet dhe krahasohet e drejta e femrës për trashëgimi në pronën familjare nga aspekti historik dhe religjioz, kjo me qëllim që të kuptojmë pikënisjen e përjashtimit dhe mospjesmarrjes së femrës në pjesën ligjore të trashëgimisë.

Në këtë pjesë të punimit vehehet në dukje:

- ❖ Lashtësia dhe rëndësia e institucionit të trashëgimisë si institucion i vetëm që mundëson bartjen e të drejtave dhe detyrimeve të karakterit pasuror të personit të vdekur tek trashëgimtarët.
- ❖ Diskriminimi i femrave dhe trajtimi jo i barabartë i fëmijëve martesor dhe jashtëmartesor të trashëgimlënësit deri gjysmën e dytë të shekullit XX.

Duke u nisur që nga Babilonia dhe antikiteti grek, e drejta e femrës për trashëgimi në pronë ishte shumë e shpërfillur. Bashkëshortja nuk gëzonte të drejtën e trashëgimisë në pronën e bashkëshortit, kurse vajzat gëzonin vetëm të drejtën në prikë (pajë), ndërsa trashëgonin vetëm në mungesë të trashëgimtarëve meshkuj.

Situatë pak a shumë e ngjashme haset edhe tek e drejta zakonore shqiptare. Gjatë analizës së disa Kanuneve shqiptare vërrehet prezenca e fenomenit të përjashtimit të bijave dhe bashkëshortes dhe heqja dorë nga trashëgimia që haset shpesh edhe në praktikën aktuale.

Përjashtimi i femrave nga e drejta e trashëgimisë në pronën familjare është prezent edhe tek disa fe. Kështu, sipas fesë hebreje të drejtë në trashëgiminë pronësore familjare gëzon djali por jo edhe vajza. Bijat trashëgojnë vetëm nëse nuk ka asnjë trashëgimtarë mashkull, ndërsa bashkëshortja nuk trashëgon as në këto kushte. Sipas rregullave biblike bashkëshortja nuk trashëgon asgjë nga prona e bashkëshortit, kurse vajza mund të trashëgojë vetëm atëherë kur nuk ekziston asnjë trashëgimtar mashkull. Sipas fesë islame, femra gëzon të drejtën e trashëgimisë në pronën familjare, por sipas Kur'anit trashëgimia duhet të ndahet në proporcion

dy me një, pra dy hise për djalin dhe një për vajzën. Megjithatë njihen edhe raste kur femra trashëgon barabar ose më shumë se trashëgimtari mashkull.

Gjatë shqyrtimit të historisë vërrejmë se femra nuk gëzonte të drejtën e trashëgimisë në pronën familjare, me përjashtime të vogla në disa konfesione fetare. Ndryshime rrënjësore pasuan pas Revolucionit Francez, kur edhe filluan të njihen të drejta të barabarta pa dallim gjinor.

KAPITULLI II

INSTRUMENTET DHE MEKANIZMAT NDËRKOMBËTAR PËR BARAZI GJINORE NE TRASHËGIMINË E PRONËS

Aktet ndërkombëtare por edhe ato nacionale sigurojnë dhe garantojnë të drejta të barabarta pa dallim gjinor. Më poshtë do të rikujtohem në mekanizmat dhe instrumentet ndërkombëtare që sanksionojnë dhe përjashtojnë çdo formë diskriminimi ndaj femrave në ushtrimin dhe gëzimin e drejtave civile dhe ekonomike.

2.1 Konventa për Eliminimin e të Gjitha formave të Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW)

Konventa për Eliminimin e të Gjitha formave të Diskriminimit Kundër Grave (më tutje CEDAË) u miratua nga OKB në vitin 1979, kurse hyri në fuqi më 3 shtator 1981. Konventa është instrument i rëndësishëm në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të femrave. Dispozitat e saj i referohen rolit të grave në familje dhe shoqëri, nevojës për ndarje të përgjegjësisë brenda familjes si dhe nevojës për implementimin e ndryshimeve të pozitës subordinuese të femrave në sistemet kulturore e sociale.

CEDAW si instrument kryesor dhe gjithëpërfshirës parasheh njohjen, gëzimin dhe ushtrimin e drejtave civile, politike, ekonomike, kulturore, etj, pavarësisht gjinisë apo statusit martesor. CEDAW përfshin një “kartë të të drejtave”, përcakton se çka përbën diskriminim ndaj grave si dhe ofron agjendë për t’i dhënë fund diskriminimit (OSCE, 2017:10).

Neni 1 i Konventës jep kuptimin e shprehjes "diskriminimi i gruas". *“Diskriminim i gruas nënkupton çdo dallim, përjashtim ose kufizim në bazë gjinie, që ka për pasojë ose për qëllim të*

dëmtojë ose zhvlerësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gruaja, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile ose në çdo fushë tjetër”.

Neni 2(f), obligon shtetet palë që të përfshijnë parimin e barazisë së burrit dhe gruas në kushtetutat nacionale ose në çdo dispozitë tjetër ligjore. Neni 3, obligon shtetet palë që të miratojnë masa të përshtatshme për ndalimin e çdo diskriminimi ndaj grave dhe po të jetë e nevojshme të shoqërohen edhe me sanksione. CEDAW garanton mbrojtjen e drejtave të femrave përmes Gjykatave nacionale kompetente dhe institucioneve tjera publike. Obligon shtetet të marrin masa të përshtatshme për eliminimin e diskriminimit ndaj grave, që ushtrohet nga ndonjë person, organizatë apo ndërmarje, si dhe të shfuqizojnë ose ndryshojnë ligjet ekzistuese, rregulloret, praktikat dhe zakonet të cilat përbëjnë ndonjë diskriminim ndaj femrës (neni 5).

Konventa kërkon të sigurohen:

- Zotësi juridike të njëjtë dhe barazi në fushën civile pavarësisht gjinisë (neni 13);
- të drejta të barabarta gjatë lidhjes së kontratave e administrimit të pasurisë si dhe trajtim i njëjtë në gjitha fazat e procedurës gjyqësore (neni 14);
- e drejta për hua bankare, ndihma hipotekare dhe forma të tjera të kredisë financiare (neni 15);
- eliminim i diskriminimit ndaj femrës në zonat rurale, duke u garantuar: të drejtën e strehimit, të drejtën për të përfitur kredi dhe ndihma bujqësore, lehtësi tregtimi, trajtim të barabartë në fushën e reformave tokësore e agrare, si dhe në projektet e sistemimit bujqësor.

Neni 16(h), siguron të drejta të barabarta për dy bashkëshortët si në: blerje (trashëgimi), administrim, menaxhim, gëzim dhe disponim të pronës.

Arritjet në fushën e zbatimit të CEDAË shqyrtohen nga “Komiteti për eliminimin e diskriminimit ndaj gruas”, i cili përbëhet nga ekspert (shtetas të shteteve palë) të kësaj fushe (neni 17). Çdo vit, përmes Këshillit Ekonomik e Social, Komiteti informon Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së në lidhje me aktivitetet e tij, si dhe jep sugjerime dhe rekomandime duke u bazuar në raportet dhe informatat që merr nga shtetet palë (neni 21).

Shtetet palë zotohen të marrin masat e duhura për të siguruar ushtrimin e plotë të të drejtave të njohura nga kjo Konventë (neni 24).

2.2 Karta e të drejtave themelore të Bashkimit Evropian

Karta e të drejtave themelore të Bashkimit Evropian Hyri në fuqi më 2009, përfshin listë me të drejtat e njeriut. Neni 17, garanton të drejtën për të zotëruar, disponuar dhe për të lënë në trashëgim pasurinë e fituar legalisht. Askush nuk mund të privohet nga pasuria e tij/saj, përveçse në interes publik, në rastet e parapara me ligj, duke u paguar për humbjen e pësuar. Neni 20, siguron dhe garanton barazi para ligji. Neni 21, ndalon çdo diskriminim gjinore, racor, etnik, fetare, politik etj. Neni 47, garanton të drejtën e ankesës para një Gjykate kompetente, të drejtën për një proces të drejtë dhe efektiv brenda një afati të arsyeshëm, të drejtën për t'u mbrojtur, këshilluar dhe përfaqësuar, si dhe të drejtën për ndihmë juridike për personat që nuk kanë burime të mjaftueshme.

Karta, ripohon të drejtat që burojnë prej traditave kushtetuese dhe detyrimeve ndërkombëtare që janë të përbashkëta për Shtetet Anëtare prej Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Kartave Sociale të miratuara nga Këshilli i Europës si edhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

2.3 Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (më tutje Pakti), hyri në fuqi më 3 janar 1976.

Pakti, obligon shtetet palë që pa kurrfarë diskriminim gjinor, racor, etnik, fetar, politik etj, të garantojnë të drejtat ekonomike, politike e sociale të shpallura në të (neni 2- 3). Shtetet palë në Pakt, zotohen të paraqesin raporte për masat e nevojshme që do të kenë marrë si dhe

për nivelin e përparimit të respektimit të të drejtave të përfshira në Pakt. Raportet i drejtohen Sekretarit të përgjithshëm të OKB-së i cili i transmeton një kopje Këshilit Ekonomik e Social për shqyrtim në përputhje me dispozitat e këtij pakti (neni 16).

2.4 Konventa e të drejtave të fëmijëve (1989)

Konventa e të Drejtave të Fëmijëve (më tutje KDF) është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, në nëntor të vitit 1989. KDF, është instrument i parë ndërkombëtar që në mënyrë të plotë dhe të detajuar parasheh të drejtat dhe detyrimet në të gjitha fushat e jetës së fëmijës. Me ratifikimin e tij, qeveritë kombëtare obligohen të ndërmarrin politika dhe veprime në interes të fëmijës, ata angazhohen për mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave të fëmijës dhe për këtë mbajnë përgjegjësi para bashkësisë ndërkombëtare. KDF, garanton pa diskriminim: të drejtën për mbijetesë, për zhvillim sa më të plotë, për mbrojtjen nga ndikimet e dëmshme, abuzimi dhe shfrytëzimi, të drejtën për të marrë pjesë në jetën familjare, kulturore dhe sociale.

Termi fëmijë nënkupton” çdo qenie njerëzore të moshës 0-18 vjet, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet” (neni 1).

Shtetet Palë duhet të respektojnë dhe garantojnë të drejtat e shpallura në KDF, pavarësisht nga gjinia, ngjyra, gjuha, opinioni politik, feja, prejardhja kombëtare, etnike, familjare, pasuria, paaftësia, apo çdo gjendje tjetër e fëmijës, prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë. Në të gjitha vendimet e marra nga institucionet private apo publike, Gjykata, organet legjislative ose ato administrative, duhet të merret në konsideratë interesi më i lartë i fëmijës.

Shtetet palë duhet të respektojnë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e prindërve e anëtarëve më të gjërë të familjes, kujdestarëve ose personave tjerë përgjegjës për fëmijën. Për

jetësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shpallura në KDF, qeveritë kombëtare duhet që të marrin të gjitha masat e nevojshme legislative dhe administrative, në bazë të burimeve që posedojnë ose kur është e nevojshme edhe në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar (nenet 2-5).

2.5 Vështrim i shkurtër i përmbajtjes së kapitullit të dytë

E drejta trashëgimore sigurohet dhe garantohet nga Kushtetuta dhe shumë akte nacionale e ndërkombëtare. Maqedonia e Veriut dhe 5 shtetet tjera të përfshira në studim, Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia kanë legjislacion të zhvilluar nëpërmjet së cilës garantojnë, mbrojnë dhe sigurojnë barazi gjinore si një vlerë themelore për demokraci dhe për integrim në UE.

Bazuar në Kushtetutën e RMV-së dhe vendeve tjera të përfshira në hulumtim, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara zënë vend të rëndësishëm, rradhiten pas Kushtetutës dhe kanë epërsi mbi ligjet që nuk janë në pajtueshmëri me to.

Në kapitullin e dytë shqyrtohen vetëm disa nga instrumentet ndërkombëtare të rëndësishme në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të femrave si: Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj grave, Karta e të Drejtave Themelore të BE-së, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike dhe Kulturore dhe Konventa për të Drejta e Fëmijëve, me çrast analizohen vetëm nenet që garantojnë barazi gjinore dhe mosdiskriminim në jetën familjare e trashëgimore si një prej parimeve themelore për një jetë cilësore.

Instrumentet ndërkombëtare të lartëpërmendura janë të ratifikuara nga RMV dhe 5 vendet tjera të përfshira në hulumtim: Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia dhe me ratifikimin e tyre, shtetet detyrohen të ndryshojnë modelet sociale dhe kulturore

të sjelljes së femrave dhe meshkujve si dhe të marrin masa të duhura për eliminimin e diskriminimit ndaj femrës.

KAPITULLI III

E DREJTA PRONËSORE TRASHËGIMORE DHE BARAZIA GJINORE TEK VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR

3.1 E Drejta pronësore dhe trashëgimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut

3.1.1 Zhvillimi historik i të drejtës trashëgimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Bazat e të drejtës trashëgimore u vendosën me miratimin e Ligjit mbi Trashëgimi të botuar në vitin 1955, në Gazetën Zyrtare të Republikës Federale Popullore të Jugosllavisë (Trpenovska – Spiroviç, Mickoviç & Ristov, 2011: 47).

Ky ligj përmbante disa parime si: barazia e qytetarëve në trashëgimi, rregullimi unik i trashëgimisë, ligji dhe testamenti si bazë për thirje në trashëgimi, efekti retroaktiv i Ligjit për trashëgimi, procedura trashëgimore si pjesë përbërëse e ligjit për trashëgimi. Këto parimet mbijetuan në sistemin juridik të republikave të ish Jugosllavisë (Trpenovska- Spiroviç & Mickoviç & Ristov, 2010: 13).

Ligji i parë mbi Trashëgiminë i RMV-së u miratua në vitin 1973, kurse më 1996 u miratua Ligjin mbi Trashëgimi (më tutje LTMV) që vazhdon të jetë në fuqi. LTMV, përmban parime të njëjta si edhe Ligji i Trashëgimisë i vitit 1955 dhe ai i vitit 1973, ndërsa është një nga ligjet e

pakta që ndër vite nuk ka pësuar ndryshime. Sidoqoftë, kur identifikohen pika të dobëta atëherë preferohen edhe ndryshime përkatëse, sidomos nën dritën e sistemeve juridike trashëgimore të shteteve më të zhvilluara evropiane.

3.1.2 Aktet juridike përmes së cilëve garantohet e drejta për trashëgimi në pronë në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Barazia gjinore në fushën e trashëgimisë sigurohet dhe garantohet me marrëveshjet ndërkombëtare të cilat Republika e Maqedonisë i ka ratifikuar si dhe përmes akteve juridike nacionale si: Kushtetuta, Ligji për gjykatat (2006), Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi (2010), Ligji për mundësi të barabarta të grave dhe burrave i miratuar në vitin 2006 dhe versioni i konsoliduar i miratuar në vitin 2012, si dhe shumë ligje të tjerë (Haxhijaha-Imeri & Nastovska & Ismaili & Dimitrievska & Asenov, 2012: 9-11).

Aktet juridike përmes të cilëve garantohet e drejta në trashëgimi janë: Kushtetuta e RMV-së, Ligji mbi Trashëgimi i RMV-së, Ligji për pronësi dhe të drejta tjera sendore, Ligji mbi marrëdhënie detyrimore, Ligji mbi Procedurë Jokontestimore dhe Ligji për Noteri (Spiroviç-Trpenovska, 2010: 153-271).

➤ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Kushtetuta garanton të gjitha liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, ndër to edhe të drejtën pronësore dhe trashëgimore. Dispozitat që i referohen sigurimit dhe garantimit të drejtave pronësore-trashëgimore janë nenet: 9, 15 dhe 29-31. Neni 9 i Kushtetutës deklaron se: *“të gjithë qytetarët janë të barabartë para Kushtetutës dhe ligjeve”*. Neni 15, garanton të drejtën e ankesës kundër akteve të veçanta juridike, të miratuara në procedurën e shkallës së parë para Gjykatës, organit administrativ ose institucioneve tjera që kryejnë autorizime publike. Neni 29, të huajve në RMV iu siguron dhe garanton të gjitha liritë dhe të drejtat e parashikuara me Kushtetutë, ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare, ndërsa bazuar në nenin 31, edhe shtetasit e huaj në RMV, mund të fitojnë të drejta pronësore sipas kritereve të parapara me ligj.

E drejta e pronësisë dhe e drejta e trashëgimisë garantohen në nenin 30, i cili shpreh se: *“askujt nuk mund t’i kufizohet apo merret pronësia dhe të drejtat që rrjedhin prej saj, përveçse në rastet të caktuara që kanë të bëjmë me interesin publik, me çrast garantohet kompensimi i drejtë i cili nuk duhet të jetë më i ulët nga vlera e tregut”*.

➤ **Ligji për trashëgimi në RMV⁵**

Përmbajtja e tij është në pajtueshmëri me Konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe standardet europiane e ndërkombëtare. Rregullon procedurat në bazë të cilave Gjykata dhe organet e autorizuar veprojnë lidhur me trashëgiminë ligjore dhe atë testamentare. Nenet 1-22 përmbajnë dispozita të përgjithshme të rregullimit të trashëgimisë, kurse nenet 23-29 përmbajnë dispozita të veçanta për disa trashëgimtarë (të adoptuarit, bashkëshorti, prindërit dhe personat që kanë jetuar në bashkësi me trashëgimlënësin). Nenet 30-61, i referohen trashëgimisë së domosdoshme, ndërsa nenet 61-119 i referohen trashëgimisë testamentare (aftësia për përpilimin e testamentit, llojet e testamenteve, revokimi, anulimi i testamentit etj). Me nenet 120-136, rregullohet kalimi i trashëgimisë tek trashëgimtarët, kurse nenet 137-143 rregullojnë përgjegjësinë e trashëgimtarit ndaj borxheve të trashëgimlënësit.

➤ **Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore⁶**

Rregullon përmbajtjen, krijimin, mbrojtjen, bartjen dhe shuarjen e të drejtës pronësore dhe drejtave tjera sendore në pajtueshmëri me Kushtetutën (neni 1). Pronari i një sendi (paluejtshmëri apo send i lëvishëm) është i autorizuar të disponojë lirshëm me të, shfrytëzojë apo shet dhe të përjashtojë çdokënd nga çfarëdo ndërhyrje në të. Neni 2, deklaron se çdo person qoftë fizik ose juridik, vendas apo i huaj, përfshirë edhe njësitë e vetqeverisjes lokale, mund të fitojnë të drejtën e pronësisë, sipas mënyrës dhe kriterëve të parapara nga ky ligj dhe

⁵ Zakon za nasledstvo, Sl Vesnik na RM br. 47, 12.09.1996

⁶ Zakon za sopstvensot i drugi stvarni prava, Sl Vesnik na RM br, 18, 15.03.2001,

ligjet e tjera. Në nenin 3 thuhet: *“pronësia krijon të drejta dhe obligime dhe duhet të shërbejë për të mirën e individit dhe të bashkësisë”*.

Marrëdhëniet pronësore - trashëgimore rregullohen me nenet: 1-7, 59-65, 82-91, 112, 124-125, 153, 178, 187, 240-252.

Me nenin 6, garantohet mbrojtja ligjore e pronës. Me nenet 82- 91, rregullohen të drejtat dhe përgjegjësitë e bashkëtrashëgimtarëve. Trashëgimtarët që nuk kanë hequr dorë nga trashëgimia deri në plotëfuqishmërinë e aktvendimit konsiderohen si bashkëtrashëgimtarë (neni 82). Nga momenti i vdekjes së trashëgimlënësit deri në plotfuqishmërinë e aktvendimit mbi trashëgiminë, bashkëtrashëgimtarët kanë pronësi të përbashkët mbi pasurinë trashëgimore (Aliu, 2004: 96).

➤ **Ligji mbi Marrëdhënie detyrimore**⁷

Rregullon marrëdhëniet kontraktuese (mënyrën dhe kushtet e përpilimit të kontratave si dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese). Marrëdhëniet trashëgimore iu referohen nenet 1022- 1035, përmes së cilëve rregullohet forma, kushtet dhe menyra e lidhjes së 2 kontratave: asaj për dorëzim dhe ndarje të pasurisë si dhe kontratës për përkujdesje të përhjetshme.

➤ **Ligji për procedurë Jokontestimore**⁸

Me këtë ligj rregullohen procedurat sipas të cilave Gjykata, organet dhe personat tjerë të autorizuar duhet të veprojnë në çështjet që zgjidhen në procedurë jokontestimore përfshirë këtu edhe marrëdhëniet trashëgimore. Çështjet trashëgimore rregullohen më nenet: 1-33, 120-192, 251-294. Nenet 1-33, përmbajnë rregulla për pjesmarrësit në procedurë, kompetencën e organeve, ankesën etj. Nenet 120-192, rregullojnë mënyrën e zhvillimit të procedurës për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, kurse nenet 251-294, përmbajnë rregulla për përpilimin e testamentit gjyqësor.

⁷ Zakonot za obligacionite odnosi, br. 07-761/1, 2001

⁸ Zakon za vonparnicna postapka SI.Vesnik na RMbr. 9/2008

➤ **Ligji për noteri**⁹

Rregullon procedurën e emërimit/shkarkimit të noterëve, përgjegjësinë disiplinore, fushëveprimin dhe kompetencat e noterëve si dhe përpilimin e akteve noteriale. Noteri si përfaqësues i Gjykatës është kompetent për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore atëherë kur nuk ka mosmarrëveshje mes trashëgimtarëve si dhe për përpilimin e akteve të ndryshme juridike në çështjet pronësore përfshirë edhe çështjet trashëgimore.

3.1.3.Rregullimi i trashëgimisë ligjore në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Kalim i pasurisë trashëgimore nga trashëgimlënësi tek trashëgimtarët e tij realizohet nëpërmjet ligjit ose testamentit (neni 6). Testamenti gëzon prioritet në raport me trashëgiminë ligjore. Trashëgimia ligjore aplikohet kur: trashëgimlënësi nuk ka lënë testament, ka lënë testament vetëm për një pjesë të pasurisë ose testamenti është plotësisht apo pjesërisht i pavlefshëm (Aliu, 2007:50).

Trashëgimia hapet kur vërtetohet vdekja e personit fizik qoftë me aktvdekje të lëshuar nga ofiqari, apo me aktvendim gjyqësor me çrast sipas kriterëve të caktuara ligjore personi i zhdukur shpallet i vdekur. Trashëgimia hapet në vendin ku trashëgimlënësi ka pasur vendbanimin e tij të fundit, por në qoftë se vendbanimi nuk dihet, atëherë hapet në vendin ku ndodhet e tërë pasuria apo pjesa më e madhe e saj (neni 129).

Fakte për caktimin e trashëgimtarëve janë: bashkësia martesore, gjinia¹⁰ dhe jetesa e përbashkët (Mickoviç & Ristov 2016: 106). Trashëgojnë personat që janë gjallë në momentin e

⁹ Zakon za notarijat Sl.Vesnik na RM, br. 55/2007 , br. 86/2008

¹⁰ Në legjislacionin pozitiv të RMV-së njihen: gjinia e gjakut, gjinia e birësimit dhe gjinia e krushqisë. Gjinia e gjakut është lidhje natyrore krijohet me lindje, nënkupton lidhje prej gjaku që krijohet mes dy apo më shumë personave që rrjedhin prej një të paralinduri të përbashkët. Gjinia e krushqisë (affinitas) krijohet mes njërit bashkëshort me të afërmit gjini gjaku të bashkëshortit

hapjes së trashëgimisë, si dhe fëmija i mundshëm që lind brenda 9 muajve pas vdekjes së trashëgimlënësit (neni 122). Trashëgimtarë konsiderohen: pasardhësit, të adoptuarit dhe të paslindurit e tyre; bashkëshorti/ja, adoptuesi, prindërit, motrat dhe vëllezërit dhe të paslindurit e tyre; gjyshërit dhe gjyshet dhe pasardhësit e tyre (neni 12). I padenjë për të trashëguar është personi që:

- me dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë trashëgimlënësin;
- me mashtrim, dhunë ose kanosje ka nxitur trashëgimlënësin që të përpilojë ose revokojë testamentin apo ndonjë dispozitë të tij, ose e ka penguar atë që të përpilojë testamentin;
- ka penguar realizimin e dëshirës së fundit të trashëgimlënësit duke falsifikuar, fshehur ose agjësuar testamentin;
- ka shkelur obligimin ligjorë për përkujdesje dhe ndihmë të trashëgimlënësit (neni 123).

Gjykata, vlerëson rrethanat e padenjësisë në bazë të kërkesës së personave të interesuar, ndërsa për shkelje të detyrimit të mbajtjes dhe mosdhënie të ndihmës së domosdoshme ndaj trashëgimlënësit kujdeset zyrtarisht (neni 124 LT). Personi i padenjë nuk mund të trashëgojë, kurse pasardhësit e tij trashëgojnë sipas rregullave të së drejtës së zëvendësimit (përfaqësimit)¹¹. Trashëgimlënësi mund të falë personin e padenjë vetëm në formë të shkruar (psh. testament) duke i zbatuar rregullat që aplikohen për vlefshmërinë e testamentit (neni 124.2).

Trashëgimtari gëzon të drejtën e heqjes dorë nga trashëgimia por vetëm pasi të hapet trashëgimia, e më së vonë deri në përfundimin e seancës mbi trashëgiminë (neni 132). Trashëgimtari që heqë dorë vetëm në emër të vet, konsiderohet sikur nuk është thirrur kurrë në trashëgimi, kurse pasardhësit e tij trashëgojnë sikur ai të ishte i vdekur. Në qoftë se heq dorë edhe në emër të pasardhësve, atëherë pjesa trashëgimore kalon tek trashëgimtarët tjerë të po të njëjtës rradhë, ndërsa në qoftë se është i vetmi trashëgimtar i asaj rradhe, atëherë pjesa trashëgimore kalon tek trashëgimtarët e rradhës tjetër (nenet 129-130, LT). Deklarata për

tjetër. Bazë e krijimit të kësaj gjinie është martesë Gjinia e birësimit (adoptimi) krijohet në mënyrë artificiale, krijohet me akt juridik mes adoptuesit dhe të adoptuarit (Podvorica, 2005: 54).

¹¹ E drejta e përfaqësimit(zëvendësimit), kuptohet si e drejtë e pasardhësit të trashëgimtarit ligjor, të trashëgojë nëse trashëgimtari ligjor ka vdekur para trashëgimlënësit, apo për arsye të parapara me ligj nuk mund të trashëgojë.

heqjen dorë nga trashëgimia nuk mund të revokohet por mund të anulohet në rast se jepet nën kërcnim, dhunë apo mashtrim. Në mungesë të testamentit pasuria trashëgimore kalon tek trashëgimtarët ligjor, sipas rradhës së caktuar në ligj, me çrast trashëgimtarët e rradhës më të afërt përjashtojnë nga trashëgimia trashëgimtarët e rradhës më të largët (nenet 11-20).

Në radhë të parë trashëgojnë fëmijët (martesor, jashtëmartesor dhe të adoptuar) e trashëgimlënësit dhe bashkëshorti pasjetues, me çrast trashëgimia u ndahet në pjesë të barabarta (neni 13). Kusht i domosdoshëm për realizimin e të drejtës së trashëgimit të bashkëshortit është ekzistimi i martesës së vlefshme. Bashkëshorti nuk gëzon të drejtën e trashëgimisë në pronën e bashkëshortit atëherë kur:

- *“ekziston padi për shkurorëzim të martesës;*
- *martesa anulohet pas vdekjes së bashkëshortit, për arsyt të cilat bashkëshorti pasjetues i ka ditur në kohën e lidhjes së martesës;*
- *bashkëshorti pasjetues është fajtor për përfundimin e bashkëjetesës me bashkëshortin e ndjerë”* (neni 26)

LT, garanton trajtim të barabartë të fëmijëve martesor dhe fëmijëve jashtëmartesor, por kjo nuk vlen për bashkëshortët jashtëmartesor (Trpenovska- Spiroviç, 2008: 296).

Përderisa neni 299, parasheh mundësinë e trashëgimit të personave që jetojnë në bashkësinë e vazhdueshme me trashëgimlënësin për së paku 5 vjet si: i ushqyeri, ushqyesi, thjeshtri dhe thjeshtira, njerku dhe njerka, reja dhe vjehri dhe vjehra, dhëndri dhe gjyshi dhe gjyshja dhe persona që janë në gjini të gjakut (me kusht që i ndjeri mos ketë bashkëshort dhe trashëgimtar tjerë të rradhës së parë dhe prindër dhe vëllezër dhe motra), parashatrojmë pyetjen: a duhet t'i njihet e drejta në trashëgimi edhe bashkëshortit jashtëmartesor? Në qoftë se nuk ekzistojnë pengesa martesore mes partnerëve jashtëmartesor, ndërsa bashkësia jashtëmartesore ka zgjatur një kohë të gjatë të caktuar me ligj, atëherë edhe bashkëshortit jashtëmartesor duhet t'i njihet e drejta e trashëgimisë në pronën e bashkëshortit të ndjerë. Ligjdhënësi duhet t'i plotësojë këto zbrazëtira ligjore me çrast bashkëshorti jashtëmartesor do të njihet si trashëgimtarë në radhën e parë dhe të dytë të trashëgimisë (Mickoviç & Ristov, 2016: 87-88).

Në rradhë të dytë trashëgojnë bashkëshorti/ja dhe prindërit e trashëgimlënësit. Bashkëshortit i takon $\frac{1}{2}$ e pasurisë trashëgimore, kurse $\frac{1}{2}$ tjetër u ndahet prindërve në pjesë të barabarta, d.m.th nga $\frac{1}{4}$ për çdonjërinë nga prindërit. Në qoftë se prindërit e trashëgimlënësit kanë ndërruar jetë para trashëgimlënësit dhe nuk kanë lënë asnjë pasardhës, atëherë gjithë pasurinë trashëgimore e trashëgon bashkëshorti pasjetues i trashëgimlënësit (neni 16). Në rradhën e dytë të trashëgimisë zbatohet e drejta e përfaqësimit dhe e drejta e shtimit.

Që të shtohet pjesa trashëgimore e ndonjërit prej trashëgimtarëve ligjor të rradhës së dytë merren parasysh vlera e pasurisë trashëgimore dhe aftësia e trashëgimtarëve ligjor për ekonomizim.

Në rradhën e tretë trashëgojnë: gjyshërit dhe gjyshet e trashëgimlënësit nga ana e babait dhe ana e nënës, kurse pasuria trashëgimore u ndahet në mënyrë të barabartë, kështu $\frac{1}{2}$ e pasurisë trashëgimore u ndahet gjyshit e gjyshes nga babai, ndërsa gjysma tjetër gjyshit e gjyshes nga nëna. Edhe në këtë rradhë aplikohen rregullat e së drejtës së përfaqësimit dhe të drejtës së shtimit (nenet 21-22). Në qoftë se gjyshi dhe gjyshja e të njëjtit trung kanë ndërruar jetë para trashëgimlënësit dhe nuk kanë pasardhës, pjesa e pasurisë trashëgimore që do ta trashëgonin sikur të jetonin ende do t'i shtohet pjesës trashëgimore të gjyshit dhe gjyshes nga trungu tjetër, pasardhësve të tyre, nipave e mbesave dhe pasardhësve tjerë të mëtejme (neni 22). Nëse mungojnë trashëgimtarë të tri rradhëve të caktuara me ligj, atëherë atë pasuri e trashëgon shteti.

Fëmijët, të adoptuarit dhe bashkëshorti/ja e trashëgimlënësit konsiderohen trashëgimtarë të domosdoshëm absolut dhe trashëgojnë nëse plotësojnë kriteret objektive¹². Prindërit dhe vëllezërit e motrat e trashëgimlënësit, konsiderohen trashëgimtarë të domosdoshëm relative, ata përpos kriterëve objektive kërkohet të plotësojnë edhe kritere të caktuara subjektive si: të jenë të paaftë për punë ose të kenë mungesë të mjeteve të nevojshme për jetë. Të paslindurit e pasardhësve të trashëgimlënësit, konsiderohen trashëgimtarë të domosdoshëm nëse: deri në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit kanë jetuar në bashkësi me të, nëse trashëgimlënësi i ka mbajtur ose nëse janë të paaftë për punë dhe nuk kanë mjete të mjaftueshme për jetesë (neni 30).

¹² Kriteret objektive nënkuptojnë se trashëgimtari duhet të jetë gjallë në momentin e hapjes së trashëgimisë (apo fëmija potencial që lind 9 muaj pas vdekjes së trashëgimlënësit) si dhe të jetë i denjë për të trashëguar.

Pjesa e domosdoshme e trashëgimisë e caktuar për trashëgimtarët e domosdoshëm absolut është $\frac{1}{2}$, kurse për trashëgimtarët relativ është $\frac{1}{3}$ (neni 31). Pjesa e domosdoshme e pasurisë trashëgimore llogaritet ashtu që në fillim regjistrohen dhe vlerësohen të gjitha të mirat dhe kërkesat që i ka pasur trashëgimlënësi deri në momentin e vdekjes së tij. Nga vlera e këtyre të mirave zbritet vlera e borxheve që ai i ka lënë, përfshirë këtu edhe shpenzimet e bëra gjatë vlerësimit dhe regjistrimit të pasurisë trashëgimore si dhe shpenzimet për varrimin e tij. Pjesës që mbetet nga kalkulimet e mësipërme, i shtohet vlera e të gjitha dhuratave që ai mund t'i ketë bërë në çfarëdo mënyre në 90 ditë para vdekjes së tij dhe dhuratave që mund të kishte urdhëruar mos t'i llogariten në pjesën trashëguese të trashëgimtarit (neni 33). Në pasurinë trashëgimore nuk bëjnë pjesë sendet të cilat trashëgimlënësi i ka disponuar përmes kontratës për mbajtje të përhershme.

Në rastë se cenohet pjesa e domosdoshme, atëherë bëhet zvogëlimi i disponimit me testament, e nëse edhe më tej nuk plotësohet pjesa e domosdoshme e cenuar, atëherë kthehen dhuratat që trashëgimlënësi i ka dhuruar gjatë 3 muajve të fundit të jetës së tij. E drejta për të kërkuar zvogëlimin e disponimit me testament ose kthimin e dhuratave, u takon vetëm trashëgimtarëve të domosdoshëm dhe nuk është e drejtë e trashëgueshme. Zvogëlimi i disponimit me testament mund të kërkohej në afat prej 3 vjetëve nga shpallja e testamentit, kurse kthimi i dhuratave në afat prej 3 vjetëve nga dita kur vendimi për shpalljen e tij për të vdekur është bërë i plotëfuqishëm (nenet 44-45).

Pavarësisht dëshirës së trashëgimlënësit, trashëgimtari i domosdoshëm ka të drejtë në pjesën e domosdoshme të trashëgimisë. Nëse trashëgimtari i domosdoshëm shkel ndonjë detyrim ligjorë apo moral ndaj trashëgimlënësit, apo me dashje kryen ndonjë vepër penale të rëndë kundër tij, bashkëshortit, fëmijës apo prindërve të tij, atëherë trashëgimlënësit i lejohet që nëpërmjet testamentit ta përjashtojë trashëgimtarin e domosdoshëm plotësisht ose pjesërisht nga pjesa e domosdoshme e pasurisë trashëgimore (nenet 46-47).

Kur trashëgimtari i domosdoshëm ka shumë borxhe ose është plangprishës¹³, trashëgimlënësit i lejohet që me testament ta privojë atë plotësisht ose pjesërisht nga pjesa e domosdoshme, në interes të pasardhësve (neni 49).

3.1.4 Rregullimi i trashëgimisë testamentare në Maqedoninë e Veriut

Testamenti paraqet bazë juridike për kalim të pasurisë trashëgimore tek një apo më shumë trashëgimtarë varësisht nga dëshira e trashëgimlënësit. Nëpërmjet testamentit, testamentlënësit i jepet mundësia e ndërrimit të rradhëve të trashëgimisë ligjore. Në testament caktohen: trashëgimtarët, pasuria që do t'i kalojë trashëgimtarëve, legu, barra dhe ekzekutuesi i testamentit. Testament mund të hartojë çdo person që ka mbushur 15 vjet dhe është i aftë për të kuptuar rëndësinë dhe pasojat që dalin nga testamenti (neni 62.2). Testamenti konsiderohet i pavlefshëm nëse:

- hartohet nga një person pa zotësi për të bërë testament;
- hartohet me mashtrim, kanosje, dhunë, ose lajthim;
- nuk është hartuar në formën e parashikuar me ligj (neni 63).

Shkaqet e lartëpërmendura çojnë deri tek anulimi i testamentit. Anulimin mund ta kërkojë çdo person që ka interes juridik, në afat prej 1 viti nga dita kur kupton se ekzistojnë shkaqet për pavlefshmërinë e testamentit dhe më së largu 10 vjet nga shpallja e testamentit, kurse ndaj personit me keqbesim, mund të kërkohet deri në 20 vjet pas shpalljes së testamentit (neni 64).

Në RMV njihen disa forma të testamenteve të rregullta si: testamenti i shkruar me dorë (olograf)¹⁴, testamenti gjyqësor¹⁵, testamenti me akt notarial¹⁶, testamenti konsular

¹³ Termi plangprishës përdoret për personin i cili në mënyrë të pakuptueshme shpenzon pasurinë e tij, blen sende luksoze të panevojshme apo lidh punë juridike jodobiprurëse deri në atë nivel që rrezikon veten dhe familjen me varfëri.

¹⁴ Testamenti olograf është i plotëfuqishëm atëherë kur testatori e shkruan me dorën e vet dhe e nënshkruan atë.

¹⁵ Testamenti gjyqësor hartohet nga gjyqtari. Egzistojnë 2 forma: testamenti gjyqësor të cilin testatori di ta lexojë dhe e nënshkruan vetëm pasi ta ketë lexuar vet atë dhe testamenti gjyqësor të cilin testatori nuk di ta lexojë me çrast gjyqtari që harton testamentin e lexon atë në prani të testatorit dhe dy dëshmitarëve, kurse testatori në prani të tyre e nënshkruan atë ose e vë shenjën e gishtit të vet, për vlefshmërinë e tij nevojitet edhe nënshkrimi i dëshmitarëve (nenet 67-68).

(diplomatik)¹⁷ dhe ai ndërkombëtar¹⁸. LT, njeh testamentin gojor¹⁹ dhe testamentin e bërë në kohë të luftës si forma të testamenteve të jashtëzakonshme (nenet 73, 90).

3.1.5 Procedura e trashëgimise ne R. e Maqedonise se Veriut

Rregullat për zhvillimin e procedurës trashëgimore përcaktohen me Ligjin për Procedurë Jokontestimore (më tutje LPJK). Kompetent për shqyrtimin e çështjeve të trashëgimisë është Gjykata ose Noteri si përfaqësues i gjykatës, për ta vlejné rregulla të njëjta (neni 126).

Në afat prej 30 ditë nga dita kur regjistrohet vdekja, ofiqari ka për detyrë ta dërgojë Akvdjekjen deri tek Gjykata trashëgimore (neni 142). Posa pranon Aktdjekjen, Gjykata obligohet të fillojë zyrtarisht procedurën për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore (neni 121). Në fillim Gjykata verifikon kompetencën e saj, në qoftë se konstaton se nuk është kompetente atëherë me vendim shpallet jokompetent dhe lëndën ia dorzon Gjykatës, për të cilën vlerëson se është kompetente (nenet 161-163).

Në pikëpamje territoriale, kompetente për zhvillimin e procedurës trashëgimore është Gjykata në rajonin e të cilës trashëgimlënësi në momentin e vdekjes ka pasur vendbanim të përhershëm ose vendqëndrim. E në rast se trashëgimlënësi në momentin e vdekjes nuk ka pasur vendbanim ose vendqëndrim në RMV, për zhvillimin e procedurës trashëgimore e kompetencës territoriale konsiderohet Gjykata në rajonin e të cilës ndodhet trashëgimia.

¹⁶ Testamenti me akt notarial rregullohet me Ligjin për Noteri të RMV-së (2007). E harton noteri sipas fjalëve të testatorit, e nënshkruan testatori në prani të dy dëshmitarëve që personalisht e njohin testatorin, pa marrë parasysh a di testatori të lexoj apo jo (neni 46). Testamenti me akt notarial dallon nga testamenti gjyqësor duke filluar nga organi kompetent për përpilimin e testamentit, forma e përpilimit, procedura, e deri tek dëshmitarët që marrin pjesë gjatë përpilimit të testamentit (Ristov, 2017: 31-34).

¹⁷ Testamenti konsular (diplomatik) paraqet një dokument publik, mund të bëj shtetasi i RMV-s, që ndodhet me punë në shtetet e huaja ose në udhëtim zyrtar apo privat jashtë RMV-së, e përpilon përfaqësuesi konsullar (diplomatik) në botën e jashtme, sipas vullnetit të testatorit, duke respektuar dispozitave që vlejné për përgatitjen e testamentit gjyqësor (Podvorica, 2006: 144).

¹⁸ Testamenti ndërkombëtar bëhet në formë të shkruar, testatori deklaron në gjuhën amtare ose në ndonjë gjuhë të huaj, në prani të 2 dëshmitarëve dhe të një personi të autorizuar (noteri ose gjyqtari) se dokumenti i shkruar është dëshirë e tij dhe se ai di përmbajtjen e tij (Podvorica, 2006: 145-146).

¹⁹ Testamenti me gojë bëhet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Testatori deklaron vullnetin e tij me gojë para dëshmitarëve e ata janë të detyruar që këtë vullnet ta deklarojnë sa më shpejtë para noterit ose gjykatës

Ndërsa, në rastin kur asnjë pjesë e pasurisë trashëgimore nuk ndodhet në RMV, gjykatën kompetente për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, e përcakton Gjykata Supreme e RMV-së (neni 129). Në afat prej 8 ditësh nga dita kur lënda është pranuar në Gjykatë, kryetari i Gjykatës trashëgimore detyrohet që lëndën e trashëgimisë së bashku me dosjet e nevojshme t’ia besoj për zgjidhje noterit, me seli në rajonin e Gjykatës trashëgimore (neni 126). Nëse ka më tepër noterë, atëherë lëndët ndahen sipas rradhitjes alfabetike të mbiemrave të noterëve (neni 135). Gjykata (Noteri), duhet t’i njoftojë trashëgimtarët potencial mbi ekzistencën e testamentit, fillimin e procedurës trashëgimore, veprimet që duhet t’i ndërmarrin dhe pasojat eventuale që mund t’i shkaktoj moskryerja e veprimeve (neni 167).

Para mbajtjes së seancës për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore merren disa veprime paraprake si:

- ❖ përpilimi i aktvdekjes;
- ❖ inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë së trashëgimlënës;
- ❖ caktimi i masave të përkohshme për sigurimin e pasurisë trashëgimore dhe
- ❖ emërimi i kujdestarit të përkohshëm.

Nëse ekziston testament, atëherë ndërmirren veprime lidhur me testamentin.

3.1.5.1. Aktvdekja

Aktvdekja paraqet dokument me të cilin vërtetohet vdekja e personit fizik. Në të shënohen:

- të dhëna personale për trashëgimlënësin, si: emri dhe mbiemri, datëlindja, shtetësia, profesioni , vendbanimi gjegjësisht vendqëndrimi i tij/saj si dhe emrat e prindërve të tij/saj;
- të dhëna për vdekjen e trashëgimlënës, si: dita, muaji,viti,vendi kurse sipas mundësisë edhe ora e vdekjes;
- të dhëna personale për bashkëshortin/en dhe fëmijët (martesor, jashtëmartesor dhe të adoptuar)e trashëgimlënës, si: emri, mbiemri, data e lindjes, profesioni, vendbanimi respektivisht vendqëndrimi i tyre;

- të dhëna personale të kushërinjëve dhe personave tjerë që mund të thirren në trashëgimi në bazë të testamentit ose ligjit;
- të dhëna për pronësin e trashëgimlënsit përfshirë vlerën e përafërt të paluejtshmërive dhe sendeve të luajtshme (neni 145).

Në aktvdekje sipas mundësisë mund të shënohen edhe të dhëna tjera rreth trashëgimlënsit, si:

- vendi ku gjendet pasuria që trashëgohet;
- nëse ka pasur letra me vlerë, të holla, sende të çmueshme, libreza të kursimit ose dokumente tjera të rëndësishme;
- nëse ka lënë borxhe dhe sa;
- nëse ka përpiluar testament, kontratë për mbajtje të përhershme, ose marrëveshje për pjesëtimin e pasurisë për të gjallë me të dhënat se ku gjenden ato;
- nëse ka lënë testament gojor, atëherë shkruhen të dhënat personale të dëshmitarëve para të cilëve është hartuar testamenti gojor;
- në qoftë se pritët lindja e fëmijës së trashëgimlënsit;
- nëse bashkëshorti ose ndonjë nga fëmijët ka ndërruar jetë para vdekjes së trashëgimlënsit, etj.

Të dhënat për përpilimin e Aktvdekjes, merren nga personat që kanë bashkëjetuar me trashëgimlënsin, kushërinjtë e trashëgimlënsit ose personat tjerë që mund të japin informacione të nevojshme.

3.1.5.2.Vlerësimi dhe regjistrimi i pasurisë trashëgimore

Nëse trashëgimlënsi nuk ka lënë pasuri ose ka lënë vetëm pasuri të lëvizshme dhe trashëgimtarët potencial nuk kërkojnë që të shqyrtohet ajo, Gjykatës i lejohet që të mos e shqyrtojë atë (neni 165).

Regjistrohet gjithë pasuria të cilën trashëgimlënsi e ka poseduar deri në momentin e vdekjes. Inventarizimi përfshin: sendet që i takojnë trashëgimlënsit por ndodhen tek një person tjetër, sendet që trashëgimlënsi i ka poseduar por që pretendohet se nuk janë pronë e tij, kreditë, detyrimet e trashëgimlënsit, tatimi i papaguar dhe detyrime tjera ndaj shtetit.

Regjistrimi apo inventarizimi i pasurisë trashëgimore bëhet në qofë se:

- e kërkojnë trashëgimtarët, legatarët apo kreditorët e trashëgimlënësit;
- nuk dihen trashëgimtarët apo vendbanimi i tyre;
- trashëgimtarët janë të mitur, ose persona që për shkak të sëmundjes mendore ose rrethanave tjera nuk janë të aftë që të kujdesen për veprimet e veta;
- pasuria trashëgimore duhet t'i dorëzohet komunës (nenet 146-148).

3.1.5.3 Masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë trashëgimore

Këto masa ndërmerren nëse:

- asnjëri nga trashëgimtarët nuk është i aftë të administroj me pasurinë trashëgimore, kurse kujdestari ligjor mungon;
- trashëgimtarët nuk dihen ose mungojnë. Në këto rrethana, organi komunal administrativ ia dorëzon tërë pasurinë ose vetëm një pjesë të saj, për ruajtje një personi të sigurt dhe për këtë njofton Gjykatën në territorin e së cilës ndodhet pasuria, kurse letrat me vlerë, të hollat e gatshme, sendet e çmueshme, librezat e kursimit dhe dokumentet tjera të rëndësishme ruhen tek Gjykata në territorin e së cilës ndodhet pasuria.

3.1.5.4. Veprime paraprake në lidhje me testamentin

Testamenti hapet dhe lexohet në prani të dy dëshimtarëve të moshës madhore. Për shpallje të testamentit, Gjykata mbanë procesverbal e cila përmban disa të dhëna, si: numri i testamenteve të gjetura, data dhe vendi ku janë gjetur, kush e ka dorëzuar testamentin në Gjykatë, nëse është dorëzuar testamenti i hapur apo i mbyllur, çfarë vule mban, kush ka qenë i pranishëm gjatë hapjes dhe shpalljes së testamentit, nëse vula në testament është e dëmtuar, fshirë, vijëzuar apo është përmirësuar diçka në të. Në procesverbal nënshkruhen dëshimtarët, gjykatësi dhe procesverbalisti (nenet 155-160).

Gjykata (Noteri) vërteton cilat sende i përkasin pasurisë trashëgimore, kush ka të drejtë trashëgimie dhe çështje tjera të rëndësishme që kanë lidhje me pasurinë e të vdekurit. Procedura për shqyrtimin e trashëgimisë përfundon me nxjerren e aktvendimit për trashëgimi, me çrast shpallen trashëgimtarët dhe konstatohet pjesa nga pasuria trashëgimore që secilit i takon (neni 171). Nëse mes trashëgimtarëve ka kontest lidhur me faktet ose zbatimin e të drejtës, atëherë Gjykata (Noteri) duhet të ndërprejë procedurën për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore dhe t'i udhëzojë trashëgimtarët potencial që të inicojnë procedurën kontestimore ose administrative.

Kontestuese janë:

- faktet nga të cilat varet e drejta për trashëgim, si psh: përmbajtja e testamentit, vlefshmëria e tij, marrëdhënia mes trashëgimlënësit dhe trashëgimtarit në bazë të së cilës realizohet trashëgimia sipas ligjit, etj;
- faktet nga të cilat varet madhësia e pjesës që trashëgohet apo vlera e pjesës së domosdoshme;
- faktet prej të cilave varet themelësia ligjore e përjashtimit të trashëgimtarëve ligjorë apo ekzistimi i shkaqeve që bëjnë të padenjë për të trashëguar;
- faktet lidhur me heqjen dorë nga e drejta e trashëgimit;
- faktet prej të cilave varet themelësia e kërkesës së pasardhësve të trashëgimlënësit ose e bashkëshortit pasjetues, (nëse kanë bashkëjetuar me trashëgimlënësin) që nga masa trashëgimore t'u veçohen sendet e amvisërisë që janë të nevojshme për plotësimin e nevojave të përditshme (neni 173.1).

3.1.5.5 Aktvendimi për trashëgimi

Aktvendimi për trashëgimi përmban:

- të dhëna personale për trashëgimlënësin, si: emri e mbiemri i tij, emri e mbiemri i njërit prind, data e lindjes, shtetësia, mundësisht edhe numri personal i trashëgimlënësit;

- të dhëna për sendet e paluajtshme dhe të luejtshme që janë në pronësi të trashëgimlënësit si dhe për të drejtat tjera sendore të cilat bëjnë pjesë në pasurinë trashëgimore;
- të dhëna personale për trashëgimtarët, si: emri dhe mbiemri, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimin i tyre, profesioni, nëse trashëgon si trashëgimtar ligjor apo testamentar, marrëdhënia e trashëgimtarit/ve ndaj trashëgimlënësit;
- të dhëna lidhur me të drejtën e trashëgimit të trashëgimtarit/ve si psh: nëse kjo e drejtë është e kushtëzuar, e afatizuar, kufizuar apo ngarkuar;
- të dhëna personale të personave të cilëve u ka takon e drejta e legatit, ose ndonjë e drejtë tjetër nga trashëgimia (neni 177).

Aktvendimin e formës së prerë, Gjykata (Noteri) obligohet t'ia dorëzojë organit administrativ kompetent për mbajtjen e librave publik.

3.1.5.6 Praktika e trashëgimisë pronësore tek femrat ne R. e Maqedonisë së Veriut

Maqedonia si shtet që pretendon anëtarësim në UE, promovon të drejta të plota dhe mekanizma që synojnë barazinë gjinore. Në shumë aktet nacionale dhe ndërkombëtare theksohet e drejta e mosdiskriminimit, e drejta në pavarësi financiare, e drejta e strehimit, e drejta në menaxhim, posedim dhe tjetërsim të pronës, etj.

Sidoqoftë, edhe përkundër ekzistimit të kornizës ligjore, institucionale e politike, shumë dispozita ligjore nuk zbatohen në praktikë dhe si pasojë pabarazia gjinore vazhdon të ekzistojë. RMV, ka një popullsi prej 2.06 milion qytetarë, nga të cilët 50.1% janë meshkuj kurse 49.9% janë femra. Duke u bazuar në të dhënat e Agjencisë për Kadastër të Pasurive të patundshme në RMV, afër 83% e pronave janë të regjistruara në emër të meshkujve dhe 17% në emër të femrave (Risteska, 2016: 32).

Ligji mbi trashëgiminë, trashëgimtarët ligjor i trajton në mënyrë të barabartë, por si pasojë e paragjykimeve nga rrethi familjar ose edhe më gjërë, ndodh që një trashëgimtare të përmbahet nga pranimi trashëgimisë dhe kjo situatë shihet si normale dhe jodiskriminuese. Një traditë e këtillë haset tek të gjitha komunitetet që jetojnë në RMV (maqedon, shqiptar, turk, rom) në veçanti në zonat rurale, por është e zakonshme edhe tek familjet në zonat urbane. Të

drejtat e femrave në trashëgiminë pronësore nuk aplikohen përgjithësisht në RMV. Pothuajse në çdo hulumtim rreth të drejtave të femrave, kategoria e qytetarëve musliman dhe kategoria etnike (shqiptar, turq dhe rom) sfidohen nga traditat specifike të komunitetit të tyre. Femrat, duket se nuk janë mirë të informuara për sa i përket të drejtave themelore që u garantohet me ligj.

Mundësia deri në Gjykatë duket më e vështirë për to edhe për shkak të pamundësive financiare *“Në procesin e trashëgimisë vlera e kostove të ngarkuara nga noteri është diku rreth 150 euro, që mund të jetë gjithashtu një nga arsyet që shtyjnë femrën të përmbahet nga ushtrimi i drejtës së saj të pronësisë, veçanërisht duke marrë parasysh situatën ekonomike në vend”* (Cenova- Mitrevska, 2017: 34- 35). Këtë e konstaton edhe Komisioni Evropian në një raport vjetor lidhur me progresin e RMV-së ku thuhet: *“Institucionet nuk ushtrojnë në mënyrë të duhur rolin e tyre në sigurimin e integritetit më të mirë të perspektivës gjinore në fushat e politikave, dhe nuk ka qasje strategjike për zbatimin e strategjive kombëtare dhe planit të veprimt”* (Commission, 2012).

Përkundër përpjekjeve të shumta për avansimin e barazisë gjinore, në praktikën e përditshme femrat dhe meshkujt nuk gëzojnë të njëjtat të drejta. Kjo pabarazi është si pasojë e stereotipeve gjinore të pranishme në familje, në jetën publike, në proceset politike, në procedurat administrative dhe në organizimin e shoqërisë (Van der Leest & Xhelo & Ehittberger 2012: 7).

3.2. E DREJTA PRONËSORE TRASHËGIMORE DHE BARAZIA GJINORE NË KOSOVË

3.2.1 Historik i shkurtër i rregullimit të marrëdhënieve trashëgimore në Kosovë

Duke u bazuar në të dhënat historike-juridike, gjatë sundimit Osman (1455- 1912), marrëdhëniet trashëgimore janë rregulluar sipas institucioneve juridike turke, ndërsa në viset malore sipas të drejtës zakonore shqiptare (Statovci, 2009:123). Në periudhën prej 1912 - 1918, janë zbatuar akte ligjore të shteteve nën sundimin e të cilëve ishin pjesët e Kosovës si: Mbretërisë Serbe, shtetit malazez, Bullgarisë e Austrisë (Aliu, 2013: 152). Pas vitit 1918, me rënien e Kosovës nën sundimin e Mbretërisë Serbe, marrëdhëniet trashëgimore janë rregulluar

sipas Kodit Civil Serb (i vitit 1844, më tutje KCS), i cili mbështetej në të drejtën kishtare dhe të drejtën zakonore serbe. E drejta zakonore serbe, nuk iu njihte të drejtën e trashëgimisë vajzave dhe bashkëshortes së trashëgimlënësit. Bashkëshortja mund të trashëgonte vetëm nëse nuk kishte trashëgimtarë ligjorë deri në shkallën e dhjetë (Kozar & Radumillo, 2015: 370). Në këtë kohë, si burim subsidiar është zbatuar e drejta zakonore shqiptare (Statovci, 2009: 129).

Gjatë viteve 1941-1945 pjesë të Kosovës ishin nën sundimin e Bullgarisë, Gjermanisë dhe Italisë, ndërsa marrëdhëniet trashëgimore rregulloheshin sipas të drejtës zakonore dhe drejtës së sheriatit. Pas Luftës së Dytë Botërore, Kosova ra nën sundimin e Jugosllavisë, respektivisht Serbisë, me çrast zbatoheshin ligje të miratuara nga Serbia. Më 1974 u nxjerr Ligji për Trashëgimi (Fletorja zyrtare KSAK nr.43/1974), i cili potenconte parimin e barabarësisë së të gjithë personave pa dallim gjinor. Ligji u plotësua dhe u ndryshua 2 herë dhe u aplikua deri në vitin 2004 (Aliu, 2013:160-175).

Në vitin 2004, Kuvendi i Kosovës miratoi “Ligjin për Trashëgimi” (Nr 2004/26), që aktualisht është në fuqi dhe garanton mundësi të barabarta për të gjithë qytetarë, pavarësisht përkatësisë etnike, gjinore, sociale etj. Në ditët e sotme, përpos me Ligjin për Trashëgimi, barazia gjinore dhe mosdiskriminim në fushën e trashëgimisë garantohet me Kushtetutë, instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara dhe disa akte nacionale, ndër to: Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi²⁰, Ligji për barazi gjinore, Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore në Kosovë²¹, Ligji për Kadastër²², Ligji mbi familjen²³; Ligji për Procedurë Jokontestimore²⁴, Ligji mbi Procedurë Kontestimore, Ligji për marrëdhëniet detyrimore, Ligji për noteri²⁵, etj (Avdiu&Pollozhani, Huseionoviç, Popadiç, 2014: 25).

3.2.2 Rregullat e përgjithshme të trashëgimisë ligjore dhe testamentare në Kosovë

²⁰ Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi (nr. 05/L-021, i cili hyri në fuqi më 15.06.2015).

²¹ Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore në Kosovë nr. 2009/03-L-154 (hyri në fuqi 15.07.2009).

²² Ligji për Kadastër nr. 04/L-013 (hyri në fuqi 12.08.2011).

²³ Ligji Ligji Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës

²⁴ Ligjit Nr. 03/L-007 Për Procedurën Jokontestimore, Kosovë

²⁵ Ligjit Nr. 03/L-010 për Noterin, Kosovë

Sipas Ligjit për Trashëgimi i Kosovës (më tutje LTK), ligji dhe testament janë bazë juridike për kalim të pasurisë së trashëgimlënësit tek trashëgimtarët apo legatarët e tij. Rregullat që kanë të bëjnë me kohën dhe vendin e hapjes së trashëgimisë janë të njëjta me rregullat e trashëgimisë në RMV. Të ngjashme janë edhe rregullat tjera si: aftësia për të trashëguar, rradhët e trashëgimisë, heqja dorë, padenjësia për të trashëguar, përjashtimi dhe privimi nga trashëgimia.

Për dallim nga RMV, në Kosovë edhe bashkëshortët jashtëmartesor gëzojnë të drejtën e trashëgimisë, megjithatë për të realizur këtë të drejtë kërkohen 2 kushte: në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit të mos egzistojë marrëdhënia martesore me ndonjë person të tretë, ose të jetë ngritur padi për shkurorëzim ose anulim të martesë me personin e tretë; dhe bashkëjetesa e bashkëshortëve jashtëmartesor të ketë zgjatur së paku 10 vite, ose 5 vite nëse nga marrëdhënia e tyre ka lindur fëmijë (neni 28).

Krahasuar me rregullat e trashëgimisë të RMV-së, në Kosovë në grupin e trashëgimtarëve të domosdoshëm absolut përveç pasardhësve dhe bashkëshortit të trashëgimlënësit, bëjnë pjesë edhe prindërit e trashëgimlënësit, kurse në grupin e trashëgimtarëve të domosdoshëm relativ përfshihen edhe gjyshërit e trashëgimlënësit (neni 31).

Rregullat e trashëgimisë testamentare si: aftësia për të trashëguar dhe aftësia për të përpiluar testament janë të ngjashme me LTRMV me një dallim tek mosha e parashikuar për përpilim të testamentit që sipas LTK është 18 vjet ose 16 nëse është i martuar (neni 71).

Për dallim nga LTMV, në Kosovë ndër të tjera aplikohet edhe testamenti notarial si formë e testamenteve të rregullta, kurse si formë e testamentit të jashtëzakonshëm aplikohet vetëm testamenti gojor (nenet 74- 81).

3.2.3 Procedura gjyqësore dhe praktika e trashëgimisë pronësore tek femrat në Kosovë

Aktualisht në Kosovë, Noterët por edhe Gjykata kanë juridiksion mbi kërkesat jokontestimore të trashëgimisë. Trashëgimia hapet posa organi komunal gjegjësisht nëpunësi i

gjendjes civile njofton Gjykatën për vdekjen e personit fizik (neni 133, Ligji për procedurë jokontestimore). Gjithsesi, duhet të theksohet se Ligji për Gjendjen Civile, nuk përmban dispozita që kërkojnë nga organi komunal të njoftojë Gjykatën apo noterin pas regjistrimit të vdekjes. Në mungesë të njoftimit trashëgimtarët potencial vetë inicojnë procedurën.

Në kulturën kosovare, trashëgimia zakonisht ndahet jashta sistemit gjyqësor, mes trashëgimtarëve meshkuj, pa pjesmarrjen e trashëgimtarëve femra (Macula – Krasniqi & Craëford, 2015: 2). Mentaliteti patriarkal i ndarjes së pasurisë duke u bazuar në vullnetin e kryefamiljarit ose trashëgimtarëve meshkuj, është i ngulitur tek komunitetet që jetojnë në Kosovë (Gjinovci, 2016:7). Në praktikën kosovare njihen disa mënyra të ndarjes së trashëgimisë:

- ❖ ndarja e trashëgimisë me pjesmarrja të meshkujve të familjes, qoftë si ndërmjetësues për zgjedhjen e kontesteve në rast të mosmarrëveshjeve mes vëllezërve, ose pjesmarrja e tyre vetëm si një akt solemn nëse vëllezërit paraprakisht janë pajtuar mes vete kujt çka i përket;
- ❖ ndarja e trashëgimisë pa ndërmjetësues, atëherë kur vëllezërit merren vesh mes vete për ndarjen e pasurisë trashëgimore, nuk e regjistrojnë pronën në organet kompetente për një kohe të gjatë, kurse motrat heqin dorë nga pjesa që u takon;
- ❖ trashëgimia si amanet, në rastet kur trashëgimlënësi i njofton trashëgimtarët e tij paraprakisht për pronën e lënë amanet dhe ata respektojnë dëshirën e tij;
- ❖ trashëgimia e mirazit, në rast se mungojnë trashëgimtarë meshkuj atëherë zbatohet e drejta zakonore shqiptare, me çrast vajzat mund të trashëgojnë nga $\frac{1}{2}$, $\frac{1}{3}$ dhe $\frac{1}{5}$ e pasurisë së të atit varrësisht nga rrethanat (Vërbani, 2013:32).

Këto mënyra tradicionale të ndarjes së pasurisë, stereotipet gjinore, mosnjohja e ligjeve si dhe zbraztirat ligjore që krijojnë mundësi të ndikimit të normave zakonore mbeten faktor që vështirësojnë realizimin e drejtës trashëgimore të femrës.

Sipas Entit Statistikor të Kosovës, nga afërsisht 2.100.000 banorë të Kosovës, gjysma e popullatës i përket gjinisë femërore. Ndërsa, duke u bazuar në statistikat zyrtare, në vitin 2015 vetëm 16% pronave ishin të regjistruara në emër të femrave, kurse vetëm 3.8% nga to ishin trashëgimtare të pronave, ky numër është rritur në 7.5 % në vitin 2017. Edhe përkundër një

progresi të madh, fakt i mësipërm lë të kuptohet se drejtësia dhe barazia gjinore në fushën e trashëgimisë nuk është as afërsisht e realizuar (Gjinovci, 2016: 9).

Çka pengon realizimin e barazisë dhe drejtësisë gjinore në marrëdhëniet trashëgimore?

Kosova përballët me zbatim të dobët të LTK-së dhe mbisundim praktik të normave zakonore, e që më shpesh haset përmes heqjes dorë të femrës nga trashëgimia gjatë procedurës gjyqësore. Edhe pse në shumë ligje, strategji dhe programe nacionale e ndërkombëtare potencohet barazi gjinore, raportet statistikore nga hulumtimet e shumta tregojnë që në praktikë mungon vullneti për realizimin e drejtësisë gjinore. Se femrat nuk gëzojnë të drejtën e trashëgimisë mbi pronën e familjes së tyre, paraqet një normë të sjelljes së pashkruar, e cila e sfidon seriozisht edhe LTK (Berisha, 2018:1).

Gjithsesi, po të krahasojmë praktikën aktuale në fushën e trashëgimisë me atë të para 20 viteve, vërrehet progres. Gjetjet nga studimet e fundit të realizuara nga USAID-i në Kosovë, tregojnë se qëndrimet dhe praktikat në lidhje me të drejtën e femrës në pronë po ndryshojnë, kurse zakoni i ndarjes së trashëgimisë vetëm mes meshkujve nuk e ka popullaritetin e dikurshëm.

3.3 E DREJTA PRONËSORE TRASHËGIMORE DHE BARAZIA GJINORE NË SHQIPËRI

3.3.1. Historiku i shkurtër i rregullimit të marrëdhënieve trashëgimore në Shqipëri nga viti 1919- deri më sot

Në Shqipëri, prej vitesh njëhej e drejta e pronësisë dhe instituti i trashëgimisë. Në periudhën 1912-1929, e drejta e pronësisë rregullohej nga Kodi Civil otoman i njohur si “Mexheleja” dhe disa ligje të tjera, kurse marrëdhëniet trashëgimore rregulloheshin sipas të drejtës së Sheriatit. Trashëgimia ligjore rregullohej sipas normave të Sheriatit, kurse trashëgimia testamentale sipas rregullave të fesë të cilës i përkiste trashëgimlënësi. Nga 1 Prill 1929 deri më

1949, çështja e trashëgimi u rregullua nga Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare, i cili garantonte dhe sanksiononte barazi të plotë mes femrave dhe meshkujve (Mandro- Balili, 2016: 20-39).

Pas çlirimit të Shqipërisë dhe vendosjes së regjimit komunist, marrëdhëniet trashëgimore pjesërisht rregulloheshin nga Kodi Civil i vitit 1929 dhe pjesërisht nga praktika gjyqësore, veçanërisht nga vendimet dhe udhëzimet e Gjykatës së Lartë. Trashëgimtarët ligjorë konsideroheshin fëmijët, bashkëshorti, fëmijët e fëmijëve, prindërit dhe personat e tjerë të paaftë për punë që kishin bashkëjetuar me trashëgimlënësin një vit para vdekjes. Fëmijët martesor dhe jashtëmartesorë trashëgonin në mënyrë të barabartë pa dallim gjinor (Sulçe, 2017: 11).

Në vitin 1954, marrëdhëniet trashëgimore rregulloheshin me Dekretin nr.1892, “Mbi trashëgiminë”, një akt i veçantë i cili garantonte dhe siguronte barazi të plotë pa dallim gjinor.

Në vitin 1976, e gjithë prona private mbi sendet palëvizshme kaloi në pronësi të shtetit, andaj edhe u kufizua e drejta e individit për të trashëguar (Latifi, 2009: 20).

Në vitin 1982, hyri në fuqi Kodi Civil i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë i cili përmbante 25 dispozita për rregullimin e çështjeve të trashëgimisë dhe individit mund të trashëgonte ose të linte në trashëgim vetëm pronën e lëvizshme (Biçoku, 1995: 28).

Më 1 nëntor 1994, hyri në fuqi Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë (më tutje KCRSH). Çështjet e trashëgimisë rregullohen në pjesën e III, nenet 316-418. KCRSH, sanksionon barazinë gjinore në marrëdhëniet pronsore dhe trashëgimore.

Shqipëria ka zhvilluar një kuadër institucional dhe ligjor për mbrojtjen e të drejtave të femrave dhe nxitjen e barazisë gjinore. Neni 18 i Kushtetutës (1998) garanton barazi gjinore, neni 41 siguron dhe garanton të drejtën e pronës duke specifikuar edhe mënyrat e fitimit të pronës, kurse neni 42 garanton proces të rregullt ligjor në rast të cenimit të drejtave të shpallura në Kushtetutë.

Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri”²⁶, mbron qytetarët nga diskriminimi gjinor si dhe garanton mundësi dhe çasje të barabartë pavarësisht gjinisë. Kodi Civil dhe ai i Procedurës Civile garantojnë të drejtat pa dallim gjinor. Neni 253 i Kodit Penal sanksionon dallimet mbi bazë

²⁶ Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri” nr. 9970 dt. 24.07.2008

gjinore, origjine... që kryhen nga të punësuarit shtetëror ose në shërbim publik kur refuzohet ndonjë e drejte ose krijohen privilegje të padrejta.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”²⁷ (2010), sanksionon diskriminimin në sferat politike, ekonomike dhe shoqërore në bazë gjinie, race, etnie, paaftësie feje.

Kodi i Familjes (2003), nënvizon barazin morale, dhe juridike ndërmjet burrit dhe gruas si bashkëshortë (neni 1) dhe si prindër kundrejt fëmijëve të tyre (neni 50). Barazia shprehet si në aspektet e të drejtave personale ashtu edhe të atyre pasurore/pronësore.

3.3.2 Rregullimi i trashëgimisë ligjore dhe testamentare në legjislacionin shqiptar

Sipas nenit 316 të KCRSH, pasuria trashëgimore tek trashëgimtarë kalon nëpërmjet testamentit ose ligjit. Karakteristikë e legjislacionit shqiptarë është aplikimi i ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit, që do të thotë se ligje të kohëve të ndryshme përcaktojnë rregullime të ndryshme për pasurinë e fituar me trashëgimi (Mandro – Balili, 2016:72). Rregullat e trashëgimisë në përgjithësi janë të ngjashme me rregullat e trashëgimisë së legjislacionit maqedonas me disa dallime të vogla. Në legjislacionin shqipëtarë në vend të drejtës në pjesën e domosdoshme të pasurisë trashëgimore ekziston termi rezerva ligjore²⁸, që nënkupton pjesë të pasurisë të cilën testatori nuk mund ta disponojë me testament apo në çfarëdo mënyre tjetër. Trashëgimtarët ligjorë që iu garantohet e drejta në rezervën ligjore njihen si rezervatarë ligjorë (trashëgimtarë të domosdoshëm) (Hakani, 2010: 185).

Rezervatar ligjor llogariten fëmijët e mitur dhe fëmijët e fëmijëve të mitur të trashëgimlënësit si dhe personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit²⁹ (neni 379).

²⁷ Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” nr 10221, dt. 2010

²⁸ Rezerva ligjore nënkupton që trashëgimlënësi nuk mund të përjashtojë nga trashëgimia ligjore pasardhësit e tij të mitur ose trashëgimtarët e tjerë të mitur që trashëgojnë me zëvendësim, në vend të prindërve të vdekur si dhe trashëgimtarëve tjerë të paaftë për punë në qoftë se thirren në trashëgim dhe as të cenojë me testament pjesën që u takon këtyre trashëgimtarëve në bazë të trashëgimisë ligjore, përveç kur këta janë bërë të padenjë për të trashëguar.

²⁹ Trashëgimtarë të paaftë për punë konsiderohen trashëgimtarët që në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit nuk kanë mbushur 16 vjet ose 18 vjet kur vazhdojnë mësimet, burrat që kanë mbushur moshën 60 vjeç dhe gratë që kanë mbushur moshën 55 vjeç dhe pavarësisht nga mosha ata që janë ivalid të grupit të parë dhe të dytë (neni 371, KCRSH). Që një trashëgimtarë të thirret në cilësinë e të qenit person i paaftë për punë duhet ti plotësojë dy

Në këtë rast vërehet që bashkëshortja nuk konsiderohet rezarvatar ligjor që do të thotë se nuk gëzon të drejtën e rezervës ligjore.

Trashëgimtarë ligjorë konsiderohen: fëmijët, fëmijët e fëmijëve, bashkëshorti, prindërit, vëllezërit e motrat dhe fëmijët e vëllezërve e të motrave të paravdekur, gjyshi e gjyshja e të paralindurit e tjerë, personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit, të afërmit e tjerë deri në shkallën e gjashtë dhe në fund shteti. Grupimi i trashëgimtarëve bëhet në 5 rradhë.

Në rradhë të parë, në pjesë të barabarta trashëgojnë fëmijët dhe bashkëshorti pasjetues. Fëmijët (martesorë dhe jashtëmartesor) janë trashëgimtarë ekskluziv të rradhës së parë (neni 360). Në mungesë të fëmijëve, bashkëshortja zbret në radhën e dytë dhe konkurron me trashëgimtarët e radhës së dytë (prindërit e trashëgimlënësit dhe personat e paaftë për punë të cilët të paktën 1 vit para vdekjes së trashëgimlënësit, bashkëjetonin dhe ishin në ngarkim të tij), kurse në mungesë edhe të trashëgimtarëve të rradhës së dytë, ajo konkurron me trashëgimtarët e rradhës së tretë (gjyshi e gjyshja, vëllezërit e motrat, si dhe fëmijët e vëllezërve e të motrave të paravdekur) (neni 364). Në radhën e dytë dhe të tretë bashkëshorti pasjetues çdoherë trashëgon $\frac{1}{2}$ e pasurisë trashëgimore. Në mungesë edhe të trashëgimtarëve të rradhës së tretë, bashkëshortit pasjetues i mbetet gjithë trashëgimia pasi që llogaritet trashëgimtarë ekskluziv i rradhës së tretë (neni 364, KCRSH).

Bashkëshorti jashtëmartesor nuk gëzon të drejtë trashëgimie në pronën e bashkëshortit, këtë të drejtë e gëzon vetëm nëse trashëgimlënësi ka lënë testament, mirëpo të mos jetë prekur pjesa e domosdoshme e rezervuar për një kategori të caktuar të trashëgimtarëve ligjorë (Mandro, 2009:218).

Në rradhë të katërt thirren: stërgjyshërit si dhe fëmijët e vëllezërve dhe motrave më të paslindurit e tyre. Në rradhë të pestë trashëgojnë të afërmit e tjerë të trashëgimlënësit deri në shkallën e gjashtë. Në mungesë të trashëgimtarëve deri në rradhë të katërt, në trashëgim thirret shteti (neni 366, KCRSH).

Karakteristikë që dallon legjislacionin shqiptarë nga legjislacioni maqedonas është afati i heqjes dorë nga trashëgimia i cili ndryshon për trashëgimtarët që banojnë në Shqipëri (tre muaj

kushte: të jetë i paaftë për punë në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit dhe të ketë bashkëjetuar si anëtarë i familjes jo më pak se 1 vjet dhe të ketë qenë nën kujdesin e trashëgimlënësit (Nun&Hasneziri, 2010: 62).

nga hapja e trashëgimisë) dhe trashëgimtarët që jetojnë jashtë Shqipërisë (gjashtë muaj nga hapja e trashëgimisë) (neni 333-340).

Testamenti gëzon prioritet në krahasim me trashëgiminë ligjore. Me testament disponojnë personat fizik që kanë zotësi veprimi dhe kanë mbushur moshën 18 vjeç, gruaja nën këtë moshë kur është e martuar dhe personi mbi 14 vjeç vetëm për pasurinë e fituar me punën e tij (neni 373). Testatori në çdo rast duhet të ketë kujdes mos të cenojë pjesën e pasurisë që garantohet për kategorinë e ashtuquajtur rezervatarët ligjorë.

Nenit 377 shpreh: *“Trashëgimlënësi që nuk lë të paslindur ose të paralindur, ose vëllezër apo motra, ka të drejtë të disponojë me testament pasurinë e vet, në favor të çdo personi fizik apo juridik”*. Bie në sy që në këtë nen nuk përfshihet bashkëshorti/ja, kjo ngjall komente. Duket sikur legjislatori ka përjashtuar gruan nga rrethi i trashëgimtareve që përfitojnë me testament. Formulimi i dispozitës mund të ishte: *“Trashëgimlënësi që nuk ka lënë trashëgimtarë ligjorë, ka të drejtë të disponojë me testament pasurinë e vetë, në favor të çdo personi fizik apo juridik* (Mandro- Balili, 2016: 81).

Në Shqipëri aplikohen dy lloje të testamenteve të rregullta: testamenti ollograf (neni 393) dhe testamenti notarial (neni 397) dhe disa forma të testamentit të jashtëzakonshëm: testamenti në anije (neni 400), testamenti ushtarak (neni 399) dhe testamenti i bërë në vendet ku nuk ka noterë që vërtetohet nga kryetari ose sekretari i bashkësisë ose i komunës.

Shqyrtimi i trashëgimisë zhvillohet vetëm tek noteri i njësisë vendore në territorin e të cilës trashëgimlënësi ka pasur vendbanim ose noteri i njësisë vendore në territorin e të cilës ndodhet pasuria e trashëgimlënësit (neni 348). Noteri sapo pranon kërkesën për shqyrtimin e trashëgimisë, verifikon kompetencën vendore të tij, pastaj dërgon një kërkesë pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë, të cilës ia bashkangjitë kopjen e kërkesës së personit të interesuar (trashëgimtarit) dhe kopjen e certifikatës së vdekjes së trashëgimlënësit. Brenda 3 ditëve pas marrjes së kërkesës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, kontrollon në Regjistrin Kombëtar të Testamenteve dhe Regjistrin Kombëtar të Dëshmimeve të Trashëgimisë, se a ka lënë trashëgimlënësi testament dhe a është shqyrtuar pasuria trashëgimore dhe a është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore apo testamentare nga ndonjë noter tjetër (neni 111, LNRSH).

Noteri mban originalin e dëshmisë së trashëgimisë, kurse kërkuesit ose çdo personi, që ka një interes të ligjshëm, i lëshohen një ose disa kopje të dëshmisë së trashëgimisë. Noteri, në një regjistër të posaçëm shënon të dhënat e çdo personi, të cilit i ka lëshuar një kopje të dëshmisë së trashëgimisë.

3.3.3. Praktika e trashëgimisë pronësore tek femrat në Republikën e Shqipërisë

Rajonet gjeografike të Shqipërisë u korespondojnë strukturave të ndryshme kulturore dhe shoqërore. Në zonat qendrore dhe veriore e në veçanti në zonat rurale, vazhdon tradita e ndarjes së tokës sipas Kanunit, vajzat trashëgojnë vetëm sendet personale dhe nuk kërkojnë realizimin e drejtës së trashëgimisë, kjo pasiqë nuk e shohin të nevojshme të kenë qasje në pronën prindërore meqenëse supozohet se ato do të martohen dhe do të kenë qasje në pronën e familjes së bashkëshortit. Gjithsesi, shumë qytetarë pohojnë se në qytetet e mëdhaja të zonave të lartëpërmendura trashëgojnë edhe vajzat (Cornhiel- Ëheeler, 1998: 9- 15).

Sipas disa hulumtimeve shkencore, në pjesën jugore të Shqipërisë ndarja e trashëgimisë nuk mbështetet në traditë. Femrat në këtë rajon cilësohen me “karakter të fortë”, dhe konsiderohen se janë më të pavarura dhe kanë një status të barabartë me meshkujt (Cornhiel Ëheeler, 1998: 11).

Përkundër përpjekjeve të shumta për të trajtuar barazinë gjinore, në jetën e përditshme femrat dhe meshkujt nuk gëzojnë të njëjtat të drejta dhe pabarazitë kulturore, shoqërore, ekonomike e politike vazhdojnë (Van der Leest & Xhelo & Eittberger 2012: 7).

Edhe pse Kanuni nuk është i ligjshëm vazhdon të praktikohet dhe respektohet në pjesët e Shqipërisë dhe Kosovës (Krasniqi & Boman, 2012).

Pabarazitë gjinore pranohen dhe tolerohen nga shoqëria, sidomos në zonat rurale. Kjo përbën një sfidë përsa i përket zbatimit të ligjeve dhe politikave për barazinë gjinore. Ka një preferencë që paluejtshmëria t’i përcjellet trashëgimtarit mashkull (OKB, 2016: 11- 13).

Në praktikën gjyqësore konstatohet se në pjesën më të madhe të rasteve, kur trashëgimlënësi disponon me testament, disponon në favor të trashëgimtarëve meshkuj, ndërsa gratë dhe vajzat ose përjashtohen nga trashëgimia ose edhe nëse caktohen si trashëgimtare testamentare, marrin pjesë më të vogël të pasurisë trashëgimore (Mandro- Balili, 2016: 79).

Sipas të dhënave nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës në vitin 2016: *“Pronësia mbi pasuritë e paluajtshme private të llojeve truall, tokë bujqësore, pyll dhe kullotë është në raportin 18.5% në emër të grave dhe 81.5% në emër të burrave,” “Pronësia mbi pasuritë e paluajtshme private të regjistruara të llojit banesë është në raportin 18.7% në emër të grave dhe 81.3% në emër të burrave”.*

Sipas kësaj rezulton që pengesat kryesore që ndikojnë në realizimin e drejtës trashëgimore për femrat janë: zbatimi i dobët i ligjit dhe mentaliteti i shoqërisë. Që te përmirësohet gjendja e trashëgimtarit femër në praktikë nevojitet mbështetja e femrës në kërkimin e të drejtave të saj, respektimi dhe promovimi i barazisë gjinore në aspektin ligjor dhe praktik, ndërgjegjësimi i femrës dhe shoqërisë mbi të drejtat pronësore të grave, fushata sensibilizuese për informimin dhe promovimin e të drejtave të grave.

3.4 E E DREJTA PRONËSORE TRASHËGIMORE DHE BARAZIA GJINORE NË SËRBI

3.4.1 Historiku i shkurtër i rregullimit të marrëdhënieve trashëgimore në Sërbë nga viti 1844 deri më sot

Nga viti 1844 deri 1946, marrëdhëniet trashëgimore janë rregulluar nga Kodi Civil Serb (Më tutje KCS), i cili aplikohet në Mbretërinë Serbe, Kroaci, Slloveni dhe Jugosllavi. KCS i vitit 1844, u hartua sipas modelit të Kodit Civil Austriak. Për afro 100 vjet vlente dhe u aplikua në vendet që pas kongresit të Berlinit përkatësisht pas Luftërave Ballkanike i përkisnin Serbisë.

E drejta trashëgimore rregullohet në kreun IX-XVI, respektivisht paragrafet 394-530. Karakteristikë të KCS janë:

- ❖ mbivlerësim i parimit të afërsisë së gjakut;
- ❖ Patriarkalizmit që shumë vërrehet në rradhën e parë të trashëgimisë ku sipas KCS, në rradhë të parë trashëgojnë fëmijët meshkuj të trashëgimlënësist dhe në rastin e vdekjes së tyre atëherë me zëvendësim trashëgojnë djemtë e djemve. Neni 396 i KCS, përjashton vajzat dhe bashkëshorten. Gjithsesi, vajzat gëzonin të drejtën e pajës me rastin e martesës (sende të luajtshme: flori dhe objekte tjera me vlerë). Në mungesë të djemve vajzat trashëgonin në rradhë të dytë.
- ❖ Fëmijët jashtëmartesor nuk gëzonin të drejtë trashëgimore por ekzistonte mundësia për të trashëguar nëpërmjet testamentit ose kontratës për trashëgimi .
- ❖ Rradha më e afërt e trashëgimisë përjashton rradhën e mëpasme. Kështu, në rast se mungonin pasardhësit e trashëgimlënësist atëherë trashëgonte babai. Në mungesë edhe të babait trashëgonin vëllezërit dhe fëmijët e tyre me zëvendësim. Në mungesë të rradhës së katërt të trashëgimisë atëherë trashëgonte nëna dhe motrat e trashëgimlënësist në pjesë të barabarta. Në rradhën e gjashtë trashëgonte: gjyshi, axhallarët, pasardhësit e ungjve atëror, hallat, bijat e gjyshit, pasardhësit e tyre. Në rradhë të shtatë trashëgon stërgjyshi atëror dhe në mungesë të tij pasardhësit e stërgjyshit. Në rradhë të tetë trashëgonte stër-stërgjyshi atëror e në mungesë të tij gruaja dhe pasardhësit e tij. Në rradhën e nëntë trashëgon fisi amësor në të njëjtën rrenditje sikur me fisin atëror. Në rradhën e dhjetë trashëgon gruaja e ve e trashëgimlënësist. Në mungesë të nëntë rradhëve, e veja trashëgon tërë pasurinë e bashkëshortit.³⁰
- ❖ Trashëgimia ligjore hapet vetëm në mungesë të testamentit;

³⁰ (DOC) Trashëgimia ligjore në Kodin Civil Serb të vitit 1844 | Kris Hasa - Academia.edu, fq.2-9, dt 22.02.2021

- ❖ trashëgimia hapet me ligjin e kohës së vdekjes së trashëgimlënësit.

3.4.2 Rregullimi i trashëgimisë ligjore, testamentare dhe procedura

E drejta e trashëgimisë rregullohet me Ligjin për Trashëgimi i Republikës së Serbisë nr.1/2009, 55/2009, 91/2016 (më tutje LTRS). Ligji garanton dhe siguron barazi gjinore dhe mosdiskriminim në fushën e trashëgimisë. Grupimi i trashëgimtarëve ligjorë bëhet në pesë rradhë, kur nuk ekzistojnë trashëgimtarë ligjorë të asnjë rradhe, trashëgimia i kalon shtetit (neni 9-20). Trashëgimtarë të rradhës së parë janë pasardhësit e trashëgimlënësit dhe bashkëshorti pasjetues, ata trashëgojnë në mënyrë të barabartë (neni 9).

Fëmijët martesor/jashtëmartesor dhe të adoptuarit, janë barabartë në trashëgimi. Bashkëshortët kanë të drejta e barabarta në trashëgimi. E drejta e trashëgimit mes bashkëshortëve pushon me shkurorëzim ose anulim të martesë (neni 22). Bashkëshortët jashtëmartesorë trashëgojnë njëri-tjetrin vetëm nëse:

- ❖ bashkësia jashtëmartesorë ekziston në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit;
- ❖ bashkësia jashtëmartesorë ka zgjatur të paktën 7 vite ose 3 vite nëse kanë fëmijë;
- ❖ bashkëshortët jashtëmartesor nuk janë në afërsi gjaku në vije të drejtë pakufi dhe
- ❖ asnjëri nga bashkëshortët jashtëmartesor nuk është legalisht i martuar me një person të tretë.

Në mungesë të pasardhësve, në radhën e dytë të trashëgimisë thirret bashkëshorti pasjetues dhe prindërit e trashëgimlënësit, me çrast bashkëshorti trashëgon $\frac{1}{2}$ e pasurisë trashëgimore dhe nga $\frac{1}{2}$ trashëgojnë të dy prindërit në pjesë të barabarta (baba $\frac{1}{4}$ dhe nëna $\frac{1}{4}$) (neni 11). Në radhën e tretë thirren gjyshërit dhe gjyshet e trashëgimlënësit nga ana e babait dhe ana e nënës. Njëra gjysëm e pasurisë trashëgimore u ndahet gjyshit e gjyshes nga ana e babait, ndërsa gjysma tjetër gjyshit dhe gjyshës nga ana e nënës (neni 16). Në radhë të katërt trashëgojnë stërgjyshërit dhe stërgjyshet e trashëgimlënësit (neni 19). Në radhë të pestë trashëgojnë të afërmit e tjerë dhe në mungesë të tyre pasuria trashëgimore i kalon shtetit.

Trashëgimia kalon nëpërmjet ligjit ose testamentit. E drejta për të hartuar testament i njihet çdo personi që ka arritur moshën 15 vjeç dhe është i aftë që të kuptojë rëndësinë dhe pasojat e veprimeve të tij (neni 64).

LTRS, njih këto testamente të rregulla: testamenti i shkruar me dorë (ollograf) (neni 67), testamenti në praninë e dëshmitarëve (alografik)(neni 69), testamentin gjyqësor (neni 70), testamenti notarial (neni 72), testamentin ndërkombëtar (neni 83), testamentin konsular-diplomatik (neni 76) dhe këto testamente të jashtëzakonshme: testamenti konsular, testamenti i bërë në anije (neni 77), testamenti gojor (neni 79), testamenti i bërë gjatë kohës së luftës (neni 78).

Procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore zhvillohet nga Gjykata dhe Noteri. Rregullat e procedurës rregullohen me Ligjin për Procedurë Jokontestimore.

Rregullat e përgjithshme të trashëgimisë ligjore, testamentare dhe procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore në përgjithësi janë të ngjashme me rregullat e legjislacionit maqedonas.

3.5 E DREJTA PRONËSORE TRASHËGIMORE DHE BARAZIA GJINORE NË MAL TË ZI

Trashëgimia ligjore dhe testamentare rregullohet me Ligjin për Trashëgimi (më tutje LTMZ). LTMZ garanton dhe siguron barazi gjinore. Në përgjithësi, rregullat e trashëgimisë ligjore, testamentare dhe procedura janë të ngjashme me rregullat e trashëgimisë së legjislacionit maqedonas dhe legjislacionet e vendeve tjera të përfshira në hulumtim.

LTMZ, numëron 4 rradhë të trashëgimisë. Në rradhë të parë trashëgojnë fëmijët dhe bashkëshorti pasjetues, ndarja e trashëgimisë bëhet në pjesë të barabarta për kokë pavarësisht gjinisë. Në mungesë të fëmijëve, bashkëshorti zbret në rradhë të dytë ku konkurron së bashku me prindërit e trashëgimlënësit, me çrast $\frac{1}{2}$ e pasurisë trashëgimore e trashëgon bashkëshorti pasjetues dhe $\frac{1}{2}$ prindërit ($\frac{1}{4}$ babai dhe $\frac{1}{4}$ e pasurisë trashëgimore nëna). Në rradhën e tretë thirren gjyshërit dhe gjyshet e trashëgimlënësit nga ana e babait dhe ana e nënës, kurse në rradhën e katërt trashëgojnë stërgjyshërit dhe stërgjyshet e trashëgimlënësit (neni 17-20).

LTMZ, njeh të drejtën e trashëgimlënësit që nëpërmjet testamentit të shpreh vullnetin e tij për ndarjen e pasurisë me rastin e vdekjes. Kjo e drejtë i njihet çdo personi të moshës 15 vjet i aftë për kuptuar rëndësinë dhe pasojat e veprimeve të tij (neni 61).

LTMZ, njeh disa forma të testamenteve të rregullta si: testamenti i shkruar më dorë (ollograf), testamenti në praninë e dëshmitarëve (alografik), testamenti gjyqësor, testamenti notarial, testamenti konsular-diplomatik, testamenti ndërkombëtar (neni 66-71) si dhe testamentet e jashtëzakonshme: testamentin gojor, testamenti i bërë gjatë gjendjes së luftës dhe testamentin në anije (neni 72-89).

Procedura trashëgimore rregullohet më dispozitat e Ligjit për Procedurën Jokontestimore Kompetent për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore është Gjykata ose Noteri publik (neni 94). Rregullat e shqyrtimit të pasurisë janë të ngjashme me LPJMV.

3.6 E DREJTA PRONËSORE TRASHËGIMORE DHE BARAZIA GJINORE NË BOSNJË DHE HERCEGOVINË

Trashëgimia ligjore, testamentare dhe procedura rregullohen me Ligjin për trashëgimi të Bosnjës dhe Hercegovinës (më tutje LTBH). LTBH, garanton barazi dhe mosdiskrimin gjinorë.

E drejta në trashëgimi fitohet me ligj, testament dhe kontratë të trashëgimisë (neni 5). Çdo person fizik i moshës madhore i aftë për të kuptuar pasojat e veprimeve të tij/saj mund të disponojë pasurinë përmes testamentit apo kontratës trashëgimore, por duke respektuar kushtet dhe kufizimet e parapara me LTBH (neni 6). Kontrata e trashëgimisë është bazë më e fortë juridike se testament dhe ligji (neni 129) ndërsa lejohet të lidhet vetëm mes bashkëshortëve martesor apo jashtëmartesor (neni 126).

Trashëgimlënësin e trashëgojnë: pasardhësit, të adoptuarit dhe pasardhësit e tyre, bashkëshorti, prindërit, adoptuesit e tij, motrat/vëllezërit dhe pasardhësit e tyre, gjyshërit/gjyshet dhe pasardhësit e tyre dhe paraardhësit e tjerë. Këta trashëgojnë sipas rradhëve të caktuara me LTBH. Trashëgimlënësin e trashëgon edhe bashkëshorti jashtëmartesorë, me kusht që të plotësohen kushtet e nevojshme për vlefshmërinë e martesës (neni 9). Trashëgimtarët ligjorë grupohen në pesë rradhë (neni 10-20). Kuri i ndjeri nuk ka lënë asnjë trashëgimtarë, pasuria trashëgimore i kalon komunës, respektivisht qytetit ku ndodhet paluejtshmëria (neni 21).

LTBH njeh: testamentin ollograf, testamentin alografik, testamenti gjyqësor, testamenti notarial (nenet 66-72) dhe disa forma të testamenteve të jashtëzakonshme si: testamenti i përpiluar para përfaqësuesve diplomatik apo konsular jashtë vendit, testamenti i bërë në anije dhe aeroplan, testamenti i bërë gjatë gjendjes së luftës, testamenti gojor dhe testamenti ndërkombëtar (nenet 75-80).

Kompetentë për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore është Gjykata dhe Noteri. Procedura trashëgimore rregullohet ngjashëm sikur edhe në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor të përfshira në hulumtim.

3.7 Aspekte krahasuese të Ballkanit Perëndimor në fushën e trashëgimisë

Gjetjet nga analiza e ligjeve mbi: trashëgiminë, procedurën jokontestimore dhe noterinë të shteteve të përfshira në hulumtim (ngjashmëritë dhe dallimet)

Baza juridike për fitimin e trashëgimisë - Në të gjitha ligjet e analizuar: LTK (neni 1), LTMV (neni 6), LTRS (neni 2), LTMZ (neni 6), dhe në KCSH (neni 316) *”trashëgimia fitohet me ligj ose testament, ndërsa përparësi i jepet testamentit.* Sipas LTBH (neni 6), trashëgimia fitohet edhe me kontratë trashëgimie por lejohet vetëm mes bashkeshortëve martesor dhe jashtëmartesor.

Koha dhe vendi i çeljes së trashëgimisë - Të gjitha ligjet e analizuar në hulumtim: LTK (neni 124) LTMV (neni 120), LTRS (neni 206), LTBH (neni 155), KCSH (neni 318), LTMZ (neni 124-125) përmbajnë rregullën e njëjtë: *”trashëgimia çelet më vdekjen e personit ose më shpalljen e tij si të vdekur”.* Në të gjitha ligjet e analizuar: LPJK, KCSH (neni 318/1), LPJMV (neni 129), LPJS (neni 88), LPJMZ (neni 95), LTBH (neni 201), vlen rregulla e njëjtë: *”trashëgimia hapet në vendin ku ka pasur vendbanimin e fundit trashëgimlënësi, ndërsa kur vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit nuk dihet, trashëgimia hapet në vendin ku ndodhet e gjithë pasuria ose pjesa kryesore e saj”.*

Aftësia për të trashëguar - Në të gjitha ligjet e analizuar: LTK (neni 7), LTMV (neni 122), LTBH (neni 157), LTMZ (neni 126) dhe KCSH (neni 320) vlen rregulla që: të aftë për të trashëguar janë personat të cilët janë gjallë në momentin e hapjes së trashëgimisë si dhe fëmijët e mundshëm të trashëgimlënësit të cilët kanë lindur pas vdekjes së tij në afat të logjikshëm ligjorë.

Padenjësia - Instituti i padenjësis njihet në të gjitha ligjet e analizuar. Në të gjitha ligjet e analizuar: LTK (neni 110), LTMV (neni 124), LTRS (neni 6), LTBH (neni 159), LTMZ (neni 127) vlen rregulla e njëjtë: *”pasardhësit e personit të padenjë trashëgojnë pjesën trashëgimore që do t’i përkiste personit të padenjë në rast se ai nuk do shpallej i padenjë”.* Në të gjitha ligjet e analizuar: LTK (neni 113), KCSRH (neni, 324) LTMV (neni 124), LTRS (neni 5), LTBH (neni 159), LTMZ (neni 127), *”trashëgimlënësit i njihet e drejta që të falë personin e padenjë dhe që të konsiderohet e plotëfuqishme, falja duhet të bëhet shprehimisht me testament”.* Shkaqet për të

cilat një person i thirrur si trashëgimtarë nuk mund të trashëgojë janë të ngjashme me disa dallime të cilat do të paraqiten përmes tabelës së mëposhtme.

TABELA 1. Shkaqet e padenjësisë në ligjet e analizuara në hulumtim

Shkaqet e padenjësisë në ligjet e analizuara në hulumtim	Shteti
▪ me dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë trashëgimlënësin ▪ me mashtrim, kanosje apo dhunës e ka shtyrë trashëgimlënësin që të bëjë, revokojë testamentin ose ndonjë dispozitë të tij, apo e ka penguar trashëgimlënësin që ta bëjë testamentin; ▪ me qëllim që të pengojë realizimin e vullnetit të fundit të trashëgimlënësit e ka fshehur, agjësuar ose falsifikuar testamentin e trashëgimlënësit; ▪ ka shkelur detyrimin ligjorë për ta mbajtur ose ndihmuar trashëgimlënësin kur ai ka pasur nevojë	LTMV (neni 123) LTRS (neni 4) LTMZ (neni 127) LTBH (neni 158)
▪ me dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë trashëgimlënësin, bashkëshorten, fëmijët dhe prindërit e tij; ▪ ka bërë ndaj trashëgimlënësit kallëzim ose dëshmi të rreme, për kryerjen e një vepre penale për të cilën parashikohet dënim me vdekje ose me heqje lirie mbi 10 vjet, kur kallëzimi ose dëshmia janë deklaruar të rreme në një gjykim penal; ▪ me mashtrim, kanosje e dhunë ka shtyrë trashëgimlënësin që të bëjë, të ndryshojë ose të shfuqizojë testamentin ose ka përpiluar vetë një testament të rreme ose e ka përdorur atë për interesa të tij apo të të tjerëve; ▪ është sjellë ndaj trashëgimlënësit në mënyrë poshtëruese dhe e ka keqtrajtuar atë.	KCRSH (neni 322)
▪ me dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë trashëgimlënësin, bashkëshortin, fëmijët dhe prindërit e tij; ▪ ka bërë ndaj trashëgimlënësit kallëzim ose dëshmi të rreme, për kryerjen e një vepre penale për të cilën parashikohet dënim me heqje lirie; ▪ me mashtrim, kanosje e dhunë ka shtyrë trashëgimlënësin të bëjë, të ndryshojë ose të shfuqizojë testamentin ose ka përpiluar vetë një testament të rremë ose e ka përdorur atë për interesa të tij apo të të tjerëve; ▪ është sjellë ndaj trashëgimlënësit në mënyrë poshtëruese dhe e ka keqtrajtuar atë; ▪ nuk e ka përmbushur detyrimin për të mbajtur apo ndihmuar trashëgimlënësin.	LTK (neni 111)

Heqja dorë nga trashëgimia - Në të gjitha ligjet e analizuar: LTK (neni 134), LTMV (neni 132), LTRS (neni 218), LTBH (neni 167 par.1), LTMZ (neni 135) dhe KCSH (neni 337) trashëgimtarit i garantohet e drejta që të heqë dorë nga e drejta trashëgimore. Deklarata për heqje dorë nga trashëgimia, jepet pasi hapet trashëgimia e deri në përfundim të seancës trashëgimore. Në të gjitha ligjet e analizuar: LTK (neni 135), LTMV (neni 133), LTRS (neni 214), LTBH (neni 168), LTMZ (neni 136) dhe KCRSH (neni 339), vlen rregulla e njëjtë që deklarata për heqjen dorë nga trashëgimia nuk mund të revokohet por kur vullneti i deklaruar përmban të meta, lejohet anulimi i deklaratës. Dallime ka në afatin për heqjen dorë nga trashëgimia, kështu sipas LTK (neni 130), LTMV (neni 128), LTRS (neni 213), LTBH (neni 163) dhe LTMZ (neni 131) deklarata për heqjen dorë nga trashëgimia duhet të jepet më së vonë deri në përfundimin e seancës mbi trashëgiminë, ndërsa KCSRH (neni 335) parashikon dy lloje të afateve (3 dhe 6 muaj) të cilat dallojnë varësisht nga fakti nëse trashëgimtari ndodhet jashtë ose brenda shtetit. Sipas LTK (neni 130), LTMV (neni 128), LTBH (neni 163), LTMZ (neni 131), trashëgimtarit i njihet e drejta që të heqë dorë nga trashëgimia edhe në emër të pasardhësve të vet, kurse LTRS (neni 213) nuk i lejon trashëgimtarit të heqë dorë nga trashëgimia në emër të pasardhësve të vet.

Rrethi i personave që trashëgojnë (rradhët e trashëgimisë) - Në legjislacionet e të gjitha shteteve të analizuar, trashëgimtarët ligjorë caktohen sipas gjinisë së gjakut dhe gjinisë civile (adoptimi, martesë). Në të gjitha ligjet e analizuar në punim, fëmijët konsiderohen trashëgimtarë ekskluziv të rradhës së parë, ndërsa bashkëshorti konsiderohet trashëgimtarë ekskluziv në rradhën e dytë të trashëgimisë, përjashtimisht në KCRSH bashkëshortët konsiderohen trashëgimtarë ekskluziv në rradhën e tretë të trashëgimisë.

Grupimi i trashëgimtarëve ligjorë në radhë, nuk rregullohet në mënyrë të njëjtë në të gjitha ligjet e analizuar. Kështu: sipas LTRS, LTBH dhe KCSH, grupimi i trashëgimtarëve ligjorë bëhet në pesë radhë, sipas LTMK dhe LTK trashëgimtarët ligjorë radhiten në tri rradhë; ndërkaq sipas LTMZ trashëgimtarët ligjorë radhitën në katër rradhë. Dallimi në rradhët e thirrjes së trashëgimtarëve ligjorë do të paraqiten përmes tabelës në vijim.

TABELA 2. Rradhët e thirrjes së trashëgimtarëve ligjorë në vendet e Ballkanit Perëndimor

Maqedoni (nenet 13-22, LTRMV) dhe Kosovë (nenet 12-18, LTK)	
Radha e parë	▪ Fëmijët dhe bashkëshorti pasjetues
Radha e dytë	▪ Bashkëshorti dhe prindërit e trashëgimlënësit (në mungesë të prindërve trashëgojnë vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit)
Radha e tretë	▪ Gjyshi dhe gjyshja e trashëgimlënës (në mungesë të tyre trashëgojnë pasardhësit e tyre)
Shqipëri (nenet 361- 366, KCRSH)	
Radha e parë	▪ Fëmijët dhe bashkëshorti pasjetues
Radha e dytë	▪ Bashkëshorti, prindërit e trashëgimlënësit dhe personat e paaftë për punë
Radha e tretë	▪ Bashkëshorti, personat e paaftë për punë, gjyshi dhe gjyshja, vëllezërit dhe motrat
Radha e katërt	▪ Stërgjyshërit si dhe fëmijet e vëllezërve dhe motrave më të paslindurit e tyre
Radha e pestë	▪ Të afërmit e trashëgimlënësit deri në shkallën e gjashtë.
Mal i zi (nenet 12-20, LTMZ)	
Radha e parë	▪ Fëmijët dhe bashkëshorti pasjetues
Radha e dytë	▪ Bashkëshorti dhe prindërit e trashëgimlënësit (në mungesë të prindërve trashëgojnë vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit)
Radha e tretë	▪ Gjyshi dhe gjyshja e trashëgimlënësit
Radha e katërt	▪ Stërgjyshërit e trashëgimlënësit
Serbi (nenet 10-2, LTRS) dhe Bosnjë dhe Hercegovinë (nenet 11-19, LTBH)	
Radha e parë	▪ Fëmijët dhe bashkëshorti pasjetues
Radha e dytë	▪ Bashkëshorti dhe prindërit e trashëgimlënësit (në mungesë të prindërve trashëgojnë vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit)
Radha e tretë	▪ Gjyshi dhe gjyshja e trashëgimlënësit
Radha e katërt	▪ Stërgjyshërit e trashëgimlënësit
Radha e pestë	▪ Të afërmit e tjerë të trashëgimlënësit

Zvogëlimi ose shtimi i pjesës së trashëgimisë në favor të trashëgimtarëve të rradhës së parë - Të gjitha ligjet e analizuara (më përjashtim të KCRSH) parashohin mundësinë e shtimit të pjesës trashëgimore të bashkëshortit pasjetues ose të prindërve.

Në disa prej ligjeve të analizuara lejohet mundësia për reduktim apo shtimi të pjesës së pasurisë trashëgimore në favor të trashëgimtarëve. Dallimi do të paraqitet përmes tabelës së mëposhtme.

TABELA 3. Mundësia e zvogëlimit të pjesës trashëgimore në favor të trashëgimtarëve të rradhës së parë

Zvogëlimi i pjesës trashëgimore në favor të trashëgimtarëve të rradhës së parë	Shteti
Lejohet që të zvogëlohet pjesa trashëgimore e bashkëshortit pasjetues në favor të fëmijëve	▪ Kosovë (neni 13, LTK) ▪ Maqedoni e Veriut (neni 15. LTMV) ▪ Serbi (neni 23. LTRS) ▪ Mal i Zi (neni 23, LTRMZ)
Lejohet zvogëlim i pjesës trashëguese të bashkëshortit në favor të fëmijëve, por edhe zvogëlimi i pjesës trashëguese të fëmijëve në favor të bashkëshortit pasjetues	▪ Bosnjë dhe Hercegovinë (neni 24, LTBH)
Nuk lejohet zvogëlimi i pjesës trashëguese as të fëmijëve dhe as të bashkëshortit	▪ Shqipëria

Trashëgimtarët e domosdoshëm – Rregullat në lidhje me trashëgiminë e domosdoshme në përgjithësi janë të ngjashme në të gjitha ligjet e shteteve të përfshira në hulumtim. Në LTMV, LTRS, LTK, LTBH dhe LTMZ, trashëgimtarët e domosdoshëm ndahen në trashëgimtarët e domosdoshëm absolute (pjesa e domosdoshme e tyre është $\frac{1}{2}$) dhe trashëgimtarët e domosdoshëm relative (pjesa e domosdoshme e tyre është $\frac{1}{3}$). Në KCRSH, njihen si rezarvatar ligjor. Rrethi i trashëgimtarëve të domosdoshëm dallon në legjislacionet e vendeve të përfshira në hulumtim. Në RMV, Sërbi, Mal të Zi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë trashëgimtarë të domosdoshëm absolut janë: pasardhësit dhe bashkëshorti pasjetues ndërsa trashëgimtarë të

domosdoshëm relative konsiderohen prindërit, vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit. Në Kosovë trashëgimtarë të domosdoshëm absolut konsiderohen: pasardhësit e trashëgimlënsit, të paslindurit e tyre dhe bashkëshorti pasjetues, kurse trashëgimtarë të domosdoshëm relative përpos prindërve dhe motrave e vëllëzërve të trashëgimlënësit llogariten edhe gjyshërit.

Në Shqipëri, trashëgimtarët e domosdoshëm njihen si rezervatar ligjorë. Rezervatar ligjorë konsiderohen: fëmijët dhe personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit.

Përrjashtimi i trashëgimtarëve të domosdoshëm nga trashëgimia - LTMV (neni 46), LTRS (neni 61), LTMZ (neni 44), LTK (neni 114), trashëgimlënësit i lejon që të përjashtojë nga trashëgimia trashëgimtarin që ka të drejtë në pjesën e domosdoshme, në qofë se ai ka shkelur ndonjë detyrim ligjorë ose moral të rëndë ndaj trashëgimlënësit dhe në qoftë se me dashje ka kryer ndonjë vepër penale të rëndë kundër trashëgimlënësit, bashkëshortit, fëmijës ose prindit të tij. Përveç shkaqeve të përmendura më sipër, sipas LTBH (neni 45), trashëgimlënësit i lejohet që të përjashtojë trashëgimtarin e domosdoshëm nga trashëgimia edhe atëherë kur ai ka kryer një krim kundër integritetit të shtetit boshnjak ose kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura nga e drejta ndërkombëtare. Në të gjitha ligjet e analizuara, shkaku për përjashtim duhet të ekzistojë në kohën e përpilimit të testamentit (me përjashtim të Ligjit për Trashëgimi i Serbisë sipas të cilit shkaku i përjashtimit duhet të ekzistojë në kohën e hapjes së trashëgimisë). Në të gjitha ligjet e analizuara: LTMV (neni 118), LTMV (neni 49), LTRS (neni 64 dhe 65), LTMZ (neni 47), LTBH (neni 48), trashëgimlënësit i mundësohet që të privojë pasardhësin e tij nga pjesa e domosdoshme më qëllim të mbrojtjes së interesit të pasardhësve të tij.

Zotësia për të trashëguar me testament - Të gjitha ligjet e analizuara: LTK (neni 7), LTMV (neni 122), LTS (neni 3), LTBH (neni 157), LTMZ (neni 126) dhe KCRSH (neni 320) mund të trashëgojë *personi që në momentin e hapjes së trashëgimisë është gjallë ose është zënë para vdekjes së trashëgimlënësit dhe ka lindur i gjallë brenda 300 ditëve nga vdekja e trashëgimlënësit*. Në të gjitha ligjet, për të përpiluar testament duhet të plotësohen 2 kushte: mosha e parashikuar me ligjin e vendit dhe zotësia e veprimit. Mosha e paraparë për përpilimin e testamentit dallon në ligjet e analizuara. Dallimi do të paraqitet përmes tabelës së mëposhtme.

TABELA 4. . Zotësia për të bërë testament (mosha ligjore në vendet e Ballkanit Perëndimor të përfshira në hulumtim)

Shteti	Zotësia për të bërë testament (mosha)
Maqedoni e Veriut (neni 62, LTMV) Serbi (neni 79, KCRS) Mal i Zi (neni 61, LTMZ)	• çdo personi që ka mbushur moshën 15 vjeç
Shqipëri (neni 373, KCRSH)	• çdo person që ka mbushur moshën 18 vjeç, • gruaja nën 18 vjeç kur është e martuar • personit mbi moshën 14 vjeç për pasurinë që e ka fituar më punën e vet të pavarur
Kosovë (neni 70, LTK)	• çdo person që ka mbushur 18 vjeç • çdo personi në moshën 16 vjeç vetëm kur janë të martuar

Pavlefshmërinë e testamentit - Arsytet e pavlefshmërisë së testamentit dhe afati për anulimin e testamentit janë të njëjta në të gjitha ligjet e analizuara në hulumtim. Në vendet e Ballkanit Perëndimor njihen teste të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

TABELA 5. Format e testamenteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme që aplikohen në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Format e testamenteve	Maqedonia e Veriut	Shqipëria	Kosova	Sërbia	Mali i Zi	Bosnja dhe Hercegovina
T. ollografik	✓	✓	✓	✓	✓	✓
T. alografik			✓	✓	✓	✓
T. gjyqësorë	✓		✓	✓	✓	✓
T. me akt notarial	✓	✓	✓	✓	✓	✓
T. ndërkombëtar	✓			✓	✓	✓
T. konsular-diplomatik	✓			✓	✓	✓
T. i bërë gjatë gjendjes së luftës	✓		✓	✓	✓	✓
T. gojor	✓		✓	✓	✓	✓
T. në anije		✓		✓	✓	✓

T.ushtarak		✓				
T.i bërë në vende ku nuk ka noterë		✓				

3.8 Vështrim i shkurtër i kapitullit të tretë

Në kapitullin e tretë trajtohet, analizohet dhe krahasohet aspekti normative i institutit të trashëgimisë në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor: R.e Maqedonisë së Veriut, Kosova, Shqipëria, Serbia, Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina, ku edhe konstatohen ngjashmëritë dhe dallimet në institutin e trashëgimisë.

Kapitulli i tretë nxjerr në pah mangësitë ligjore në rregullimin e marrëdhënieve trashëgimore në mënyrë të veçantë për çdo vend të përfshirë në hulumtim si:

- ❖ *Mungesa e inicimit të rasteve të trashëgimisë sipas parimit ex-officio* – edhe pse Ligji për Procedurë Jokontestimore detyron organin komunal gjegjësisht nënpunësin e gjendjes civile kompetent për mbajtjen e librit amzë të vdekjeve, që brenda një afati të caktuar me ligj të dërgojë aktvdekjen tek Gjykata trashëgimore, në praktikën aktuale Gjykata nuk merr njoftim nga organi komunal ashtu siç parashihet me dispozita ligjore dhe në mungesë të njoftimit i është lënë trashëgimtarëve të mundshëm që vetë të inicojnë procedurën. Si rezultat, ndodh që pasuria trashëgimore të mos shqyrtohet edhe disa vite pas vdekjes së trashëgimlënësit dhe kjo sjell pasoja.
- ❖ *Nuk ka kërkesë ligjore për verifikimin e informacionit të dhënë në Aktvdekje.* Aktvdekja hartohet në bazë të të dhënave që merren nga personat që kanë bashkëjetuar me trashëgimlënsin ose kanë qenë të afërt me të, por informacioni i dhënë zakonisht nuk verifikohet dhe nuk bëhen hulumtime për ekzistimin e trashëgimtarëve tjerë përveç atyre të rradhitur në Aktvdekje.
- ❖ *Mungesa e të dhënave elektronike lidhur me organizimin familjar të qytetarëve* - le mundësinë e deklarimeve të rrejshme apo mashtrimeve të formave të ndryshme.
- ❖ *Mundësia e ndarjes së pasurisë trashëgimore me marrëveshje mes trashëgimtarëve ligjorë* - në kontekstin e traditës mundëson ndarjen e pasurisë në mënyrë të pafavorshme për trashëgimtarët femra.

- ❖ *Mundësia e heqjes dorë nga trashëgimia* - Shpesh përfitohet duke dal nga qëllimi për të cilin është parashikuar. Heqja dorë dhe përjashtimi i femrave nga trashëgimi realizohet edhe nëpërmjet veprimeve që mbartin elemente të veprës penale (kërcnim, dhunë, mashtrim, lajthim) e që me gjithë këtë ndodh të aplikohen.
- ❖ *Mostrashëgimi i bashkëshortit jashtëmartesor në legjislacionin maqedonas dhe shqipëtar*. LTMV, përjashton mundësinë e trashëgimit të bashkëshortit jashtëmartesor, por duke pasur parasysh mundësinë e trashëgimit të personave që jetojnë në bashkësi të vazhdueshme me trashëgimlënësin si: ushqyesi, i ushqyeri, thjeshtira /thjeshtri, njerku/njerka, reja dhe vjehri/vjehra, dhëndri dhe gjyshi/gjyshja konsiderojmë që zbrazëtira ligjore duhet të plotësohet dhe që bashkëshorti jashtëmartesor duhet do të trashëgoj në rradhën e parë dhe në rradhën e dytë të trashëgimisë sikur edhe bashkëshorti martesor, megjithatë çdoherë duhet pasur parasysh plotësimin e disa kriterëve si: bashkësia jashtëmartesore të ketë zgjatur një kohë të gjatë të caktuar me ligj dhe të mos ketë pengesa martesore ndërmjet partnerëve jashtëmartesorë.
- ❖ Përderisa në të gjitha legjislacionet e analizuara në punim në grupin e trashëgimtarëve të domosdoshëm absolut hyjnë fëmijët dhe bashkëshorti pasjetues, në legjislacionin shqiptarë rezervatar ligjorë llogariten vetëm pasardhësit e trashëgimlënësit dhe personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit. Ajo që bien në sy është që në formulim nuk theksohet bashkëshorti/ja pasjetues. Poashtu vlen të ndalemi në kuptimin e nenit 377 të KC: *“Trashëgimlënësi që nuk lë të paslindur ose të paralindur, ose vëllezër apo motra, ka të drejtë të disponojë me testament pasurinë e vet, në favor të çdo personi fizik apo juridik”*. Bie në sy mungesa e bashkëshortit/es në formulim. Formulimi i dispozitës mund të ishte: *“Trashëgimlënësi që nuk ka lënë trashëgimtarë ligjore, ka të drejtë të disponojë me testament pasurinë e vetë, në favor të çdo personi fizik apo juridik”* (Mandro- Balili, 2016: 81).

Në këtë kapitull trajtohet praktika e trashëgimisë pronësore tek 6 vendet e Ballkanit Perëndimore. Duke pasur parasysh pretendimin e këtyre shteteve për anëtarësim në UE, ata janë të detyruara të promovojnë të drejta të plota dhe mekanizma që synojnë barazinë gjinore. Por edhe përkundër përpjekjeve të shumta për avansimin e barazisë gjinore, në praktikën e

aktuale hasim në zbatim të dobët të ligjit për trashëgimi dhe mbisundim praktik të normave zakonore që shpesh haset përmes heqjes dorë të femrës nga trashëgimia gjatë procesit gjyqësorë. Sipas studimeve të fundi rezulton se qëndrimet dhe praktikat rreth të drejtës së femrave në pronë po ndryshojnë dhe se tradita e bartjes së trashëgimisë vetëm tek meshkujt ka filluar të humbas popullaritetin në shoqëri. Raporti i EULEX-it 2016, thekson se në përgjithësi në vendet e Ballkanit Perëndimorë mbretëron mentaliteti i njëjtë. Kështu, në Serbi 49% e pronave janë regjistruar në pronësi të femrave, Shqipëri 29%; Mali i Zi 26%; Bosnjë dhe Hercegovinë me 25%; Maqedoni 17-18% dhe Kosovë 16% e pronave janë të regjistruara në pronësi të femrave (Gjinovci, 2016: 16).

TABELA 6. Raporti i EULEX-it për Ballkanin Perëndimor, në lidhje me përqindjen e pronave të regjistruara në emër të femrave

Shteti	Prona regjistruar në emër të femrave e shprehur në përqindje
Sërbi	49%
Shqipëri	29%
Mali i Zi	26%
Bosnjë dhe Hercegovinë	25%
Maqedoni	17-18%
Kosovë	16%

Forumi Ekonomik Ndërkombëtar, në raportin e vitit 2017, tregon se Shqipëria gjendet e 38-a në rang global për hendekun gjinor, e krahasuar me një vit më parë, Shqipëria është përmirësuar me 23 vende, ku renditej e 61 në botë. Serbia është e renditur në vendin e 40, Maqedonia e 67-a, Mali i Zi në vend të 77, Bosnja dhe Hercegovina e 66 (Gjinovci, 2016: 17).

Që të përmirësohet gjendja e trashëgimitarit femër nevojitet: fushatë intensive publike për të informuar qytetarët për të drejtat në trashëgimi, mbështetje e femrës në kërkimin dhe ushtrimin e drejtave pronësore, modifikim i institutit të heqjes dorë nga trashëgimia etj.

KAPITULLI IV

4. TRADITA PËRKUNDREJT SË DREJTËS NË RMV

4.1 Trashëgimia dhe pabarazitë: efektet socio-ekonomike

Instrumentet ndërkombëtare, Kushtetuta dhe ligjet specifike, promovojnë të drejta ekonomike, civile e politike pavarësisht gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, fetare..., por në realitet si në familje ashtu dhe në shoqëri roli i mashkullit mbetet dominant (OKB, 2016: 13).

Të shumta janë rastet kur femra nuk njeh ose nuk e vlerëson si të domosdoshme që të kërkojë të drejtën pronësore-trashëgimore dhe me vetëdije heq dorë nga e drejta trashëgimore në favor të vëllezërve dhe/ose pasardhësve të tyre djem (USAID, 2017: 33).

Femrat akoma nuk janë të barabarta me meshkujt kur bëhet fjalë për të drejtën e trashëgimisë së pronës prindërore. Rrallë ndodh që trashëgimia të ndahet në mënyrë të barabartë mes vajzave dhe djemve të trashëgimlënësit (Avdiu & Pollozhani & Huseionoviç & Popadic, 2014: 30).

Tradita ka forcë të heshtur, ndonjëherë ngulitet në memorien e njërëzve dhe respektohet me fanatizëm duke injoruar parimet e barazisë dhe duke favorizuar trashëgimtarët meshkuj. Në kuadër të hulumtimit të kryer nga Institucionet Sociale dhe Indeksi Gjinator, në nivel botëror, nga 160 shtete, vetëm në 55 shtete, me ligj dhe në praktikë femrës i garantohen të drejta trashëgimore të njëjta me meshkujt (SIGI, 2014: 6). Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Kosova dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, bëjnë pjesë në grupin e shteteve me nivel të lartë diskriminimi gjinator në institucionet sociale, sidhe karakterizohen me ndikimin e traditës dhe autoritetit prindëror në fushat nga e drejta familjare dhe trashëgimore (SIGI, 2014: 7).

Femrat zotërojnë vetëm rreth 1%-2% të të gjithë tokës të regjistruar në botë dhe në mënyrë të vazhdueshme u mohohet e drejta e trashëgimisë (Xhafaj, 2017: 6).

Ndër faktorët që ndikojnë në pabarazinë gjinore në trashëgiminë e pronës numërohen: sistemi joadekuat i aplikimit të ligjeve, praktika tradicionale dhe religjioze, stereotipet gjinore, gjendja socio-ekonomike, mosnjohja e ligjeve, mungesa e ndërgjegjësimit mbi pasojat ekonomike dhe sociale nga mostrashëgimi i pasurisë, etj.

4.2 Mekanizmat kombëtare për të drejtat pronësore trashëgimore

Në RMV, përgjegjësi në mbrojtjen dhe zbatimin e drejtave të femrave në pronë kanë shumë institucione si psh:

Gjykata – Funkcioni i Gjykatave është që të mbrojë sundimin e ligjit si dhe të drejtat dhe liritë e popullit. Supozohet të jetë i pavarur, i paanshme, apolitik, të siguroj qasje të barabartë për të gjithë pa diskriminim në bazë të ngjyrës, racës, gjinisë, besimit fetar, gjuhës, mendimit politik, origjinës kombëtare a shoqërore, pronës, gjendjes sociale- ekonomike ose çfarëdo statusi tjetër personal.

Policia – roli i policijës është që: të mbrojë të drejtat dhe liritë themelore të njerëzve, të mbrojë jetën, pronën, të mbajë rendin dhe sigurinë publike si dhe të ofrojë siguri për të gjithë qytetarët.

Zyra e avokatëve - Avokati jep ndihmë juridike në mënyrë të ndërgjegjshme dhe profesionale në përputhje me ligjin dhe kodin e mirësjelljes (Avdiu & Pollozhani & Huseionoviç & Popadiç 2014: 63).

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) - Avokati i Popullit si insitucion i pavarur kushtetues ka për detyrë të trajtojë rastet e diskriminimit në bazë gjinore dhe në baza të tjera, heton veprimin apo mosveprimin e autoriteteve publike për mosrespektimin e kornizës ligjore nacionale dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (neni 2, LAPRMV).

Organizatat joqeveritare (më tutje OJQ), grupet punuese komunale - luajnë rol të rëndësishëm në përkrahjen e atyre që iu janë shkelur të drejtat e njeriut.

Noteria- Me veprimtarinë e vet mund të ndikojë në mbrojtjen e respektimin e të drejtave pronësore të grave.

Mbrojtja ligjore - çështjet që lidhen me të drejtat pronësore mund të përfaqësohen prej padive si: padia për mbrojtjen e pronësisë, padi për pavlefshmërinë e veprimeve juridike (absolute dhe relative), padi që burojnë nga kontratat, padi të shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor.

4.3 Kontrata për trashëgimi

Me rastin e vdekjes së një personi fizik, është e nevojshme të bëhet transfer i pasurisë dhe drejtave që mund të trashëgohen. Që të mundësohet kjo, duhet të ekzistojnë persona tek të cilët kalon trashëgimia por duhet të ekzistojë edhe bazë juridike.

Në disa legjislacione, përveç ligjit dhe testamentit ekziston një bazë e tretë juridike për të thirrur në trashëgimi - kontrata e trashëgimisë. Kontrata e trashëgimisë është baza më e fortë juridike dhe ka përparësi ndaj testamentit dhe ligjit, mirëpo për sa i përket aplikimit në praktikë ajo vjen pas testamentit dhe ligjit. Shumica e të drejtave trashëgimore bashkëkohore ndalojnë aplikimin e kontratës së trashëgimisë.

Në të drejtën krahasuese kontrata për trashëgimi është paraparë në: Francë, Gjermani, Austri, Zvicër, Turqi, Spanjë, Hungari dhe në vende të tjera (Mickoviç & Ristov, 2008: 72).

Kontrata për trashëgimi është e lejuar edhe me Konventën e Hagës të vitit 1989. Shtetet që kanë ratifikuar këtë Konventë nuk janë të obliguar ta pranojnë kontratën për trashëgimi në sistemin e tyre juridik, megjithatë të gjitha kontratat konsiderohet të plotëfuqishme që nga momenti i ratifikimit.

Në ligjin mbi Trashëgimi të RMV ndryshe nga disa vende evropiane, kontrata e trashëgimisë është e ndaluar dhe lidhja e një kontrate të tillë është e pavlefshme. Në vend të saj, në praktikë shpesh aplikohen: Kontrata për mbajtje të përhjetshme dhe Kontrata për dorëzim dhe ndarje të pasurisë.

Shtetet që ndalojnë kontratën për trashëgimi janë: Rusia, Bullgaria, shtetet e ish Jugosllavisë, Italia dhe Suedia. Duke pasur parasysh specifikën e kontratës së trashëgimisë, në teori nuk ka ndonjë përkufizim të qëndrueshëm që e përcakton atë, por ekzistojnë disa përkufizime të përgjithshme. Më shpesh, kontrata e trashëgimisë definohet si: *“punë juridike me të cilën palët kontraktuese disponojnë me pasurinë trashëgimore”* gjegjësisht *“punë juridike me të cilën palët kontraktuese rregullojnë trashëgiminë mes vete ose në interes të personit të tretë”* (Ristov, 2008: 86).

Në legjislacionin maqedonas kontrata për trashëgimi përkufizohet si: *“kontratë me të cilën personi ia le pasurinë e vet ose një pjesë të saj bashkëkontraktuesit apo personit të tretë.”* (Ristov, 2008: 87).

Në shkencë theksohet që kontrata për trashëgimi aplikohet si instrument për planifikimin e trashëgimisë dhe përdoret në kombinim me rregullimin e regjimit martesor dhe trashëgiminë mes bashkëshortëve, por ndonjëherë përfshin edhe antarët e tjerë të familjes (Ristov, 2008:88).

Ka edhe autorë të cilët pohojnë se kontrata e trashëgimisë është *“një punë juridike e dyanshme, ku palët kontraktuese ose vetëm njëri prej tyre rregullon pasurinë në rast vdekje”* (Djordjevic, 1997: 369) ose *“punë juridike e dyanshme e parevokueshme, efekti juridik i së cilës nuk rrjedh vetëm nga dëshira e trashëgimlënësit por edhe nga pala tjetër kontraktuese”* (Antiç, 1986: 512) ose *“kontrata e trashëgimisë paraqet bazë juridike përmes së cilës palët kontraktuese disponojnë me pasurinë trashëgimore”* (Stojanović, 2003: 163).

Nisur nga përkufizimet e tilla mund të përfundojmë që kontrata e trashëgimisë është punë juridike me të cilën një person disponon me gjithë pasurinë trashëgimore apo një pjesë të saj në rast vdekje. Kjo kontratë ofron mundësi që çdo person sipas vullnetit të vet të rregulloj pasojat juridike të trashëgimisë pas vdekjes së tij në mënyrën që i përshtatet më së miri.

Ekzistojnë mendime të ndryshme për sa i përket historikut të krijimit të kësaj kontrate. Sipas disa autorëve, ajo është hasur në të drejtën e lashtë greke dhe egjiptiane. Sipas disa të tjerëve, kontrata e trashëgimisë ekzistonte në të drejtën e lashtë babilonase, ndërsa një grup tjetër autorësh mendojnë se rrënjët e krijimit të kontratës për trashëgimi nuk dihen. Kontratat bashkëkohore të trashëgimisë burojnë drejtpërdrejtë nga e drejta mesjetare prusiane dhe gjermane (Ristov, 2011: 3).

Në teori bëhet dallim mes kontratave pozitive dhe negative për trashëgimi.

Kontrata pozitive për trashëgimi janë kontratat në të cilët përcaktohet një ose disa trashëgimtarë (contract d’institution d’heritier) ose përcaktohen një ose disa shfrytëzues të kontratës (contract de leges).

Kontrata negative për trashëgimi (pacte successoral negative), e njohur ndryshe edhe si kontrat për heqje dorë nga trashëgimia (pacte de renunciation a la succession). Trashëgimtari i domosdoshëm plotësisht ose pjesërisht heq dorë nga e drejta në trashëgimi.

Në të drejtën franceze, kontrata për trashëgimi njihet si kontratë për dhurimin e sendeve të ardhshme (la donation des biens a venir).

Kontrata e trashëgimisë, më e përhapur është në të drejtën gjermane. Kontrata e trashëgimisë në Gjermani rregullohet me Kodin Civil Gjerman (nenet 2274-2303, BGB). Kodi Civil Gjerman parasheh tri forma të kontratave për trashëgimi: kontrata e trashëgimisë në kuptim të ngushtë, legu³¹ dhe kontrata negative për trashëgimi.

Te kontrata për trashëgimi në kuptim të ngushtë, palët kontraktuese rregullojnë që trashëgimtarë do të jetë pala pasjetuese ose eventualisht ndonjë person i tretë.

Kontrata e legut - palët kontraktuese si objekt të kontraktës parashohin një send të caktuar ose ndonjë të drejtë nga trashëgimia.

Kontrata negative për trashëgimi (pacte successoral negative), e njohur ndryshe edhe si kontratë për heqje dorë nga trashëgimia (pacte de renunciation a la succession).

Nën ndikimin e drejtës gjermane edhe Kodi Civil Zvicerian i vitit 1907 parasheh kontratën për trashëgimi si bazë juridike për thirrje në trashëgimi.

Kodi Civil Austriak (Allgemeins burgerliches Gesetzbuch-ABGB) i vitit 1811 parasheh kontratën e trashëgimisë. Në të drejtën austriake, është e vlefshme vetëm kontrata e trashëgimisë mes bashkëshortëve, të cilët përmes kësaj kontrate mund të disponojnë vetëm me $\frac{3}{4}$ e pasurisë dhe për $\frac{1}{4}$ mund të lënë testament.

Sipas Kodit Civil Francez, kontrata trashëgimore lejohet vetëm midis bashkëshortëve dhe është një mekanizëm me të cilën bashkëshortët mund të disponojnë pjesën e tyre të disponueshme në rast vdekje me anë të një kontrakte revokuese e njohur si “donation au dernier vivant”, gjegjësisht si një dhuratë në interes të bashkëshortit pasjetues.

4.3.1 Karakteristikat e kontratës për trashëgimi

Sipas efektit juridik, kontrata për trashëgimi është punë juridike “mortis causa” me të cilën palët kontraktuese disponojnë me trashëgiminë e tyre në rast vdekje. Efekti i kësaj kontrate pushon në qoftë se trashëgimtari kontraktues vdes para trashëgimtarit.

³¹ Legu nënkupton urdhër në testament, me çrast testatori legatarit i lë një apo më shumë sende apo të drejta dhe e urdhëron trashëgimtarin ose personin tjetër që nga pasuria e trashëguar ti jep ndonjë send një personi të caktuar, ti paguajë një shumë të hollash, ta lirojë nga ndonjë borxh.

Kontrata e trashëgimisë është një punë juridike e dyanshme në të cilën palët kontraktuese, të dy palët apo vetëm njëri nga ta, disponon me pasurinë trashëgimore në rast vdekje. Si akt juridik, kontrata e trashëgimisë duket si një mënyrë për të shmangur rradhët e trashëgimisë dhe rregullim i një rendi të trashëgimisë ngjashëm me rendin që mund të krijohet me testament.

Objekt i kontratës për trashëgimi mund të jetë një pjesë e pasurisë trashëgimore ose e gjithë pasuria. Gjithsesi, liria për të disponuar me të, kufizohet me të drejtën në pjesën e domosdoshme (neni 2303, BGB, neni 1254, ABGB, neni 913- 914 Code Civil). Në rast të shkeljes të pjesës së domosdoshme, trashëgimtarët mund të kërkojnë zvogëlim të disponimeve të bëra me kontratën për trashëgimi.

Palë kontraktuese tek kontrata e trashëgimisë mund të paraqitet çdo person, mirëpo në numrin më të madh të shteteve si palë kontraktuese lejohen vetëm bashkëshortët.

Në të drejtën krahasuese ka zgjidhje të ndryshme në lidhje me atë se kush mund të jetë palë kontraktuese. Kontrata e trashëgimisë lidhet nga një i rritur me aftësi të plotë veprimi ose person me aftësi të kufizuar veprimi me pëlqimin e përfaqësuesit ligjor ose organit kompetent.

Sipas drejtës gjermane dhe zviceriane, kontrata për trashëgimi mund të lidhet mes çdokujt me kusht që të jetë i moshës madhore dhe të ketë zotësi veprimi (neni 2275.1, BGB, neni 468, CCS). Me përjashtim, kontrata e trashëgimisë mund të lidhet edhe mes personave me aftësi të kufizuar, por është e nevojshme pëlqim nga përfaqësuesi ligjor dhe organi kompetent (neni 2275.2.3 BGB, neni 1250, ABGB).

Në të drejtën krahasuese ekzistojnë disa zgjidhje kush mund të jetë palë kontraktuese tek kontratat trashëgimore. Sipas të drejtës gjermane dhe zviceriane, kontrata për trashëgimi mund të lidhet nga çdo kush. Për dallim, në të drejtën franceze, kontrata për trashëgimi mund të lidhet vetëm në interes të bashkëshortit (neni 1093, 1096 Code Civil), mund të lidhet mes bashkëshortëve reciprokisht ose në interes të paardhësve të tyre, pa marrë parasysh nëse kjo kontratë është pjesë e kontratës martesore apo është lidhur si kontratë e veçantë.

Edhe Kodi Austriak njejtë si Kodi Civil i Francës, lejon lidhjen e kontratës vetëm mes bashkëshortëve (neni 602, 1249, ABGB).

Kontrata për trashëgimi paraqet punë juridike reptësisht formale. Për të qenë e plotëfuqishme, kontrata për trashëgimi, patjetër të bëhet në formën e paraparë me ligj. Për lidhjen e kontratës është e nevojshme të plotësohen disa kushte. Në disa shtete është e nevojshme prezenca e noterit dhe dy dëshmitarëve, ndërsa në vende të tjera kjo kontratë lidhet në formë të dokumentit publik.

Në të drejtën gjermane kontrata për trashëgimi mund të lidhet në formë të dokumentit publik, e cila përpilohet nga noteri në prezencë të dy palëve, sipas rregullave për përpilimin e testamentit gjyqësor. Nëse kontrata për trashëgimi mes bashkëshortëve ose të fejuarve është e lidhur me kontratën martesore me një dokument, atëherë është e mjaftueshme vetëm forma e nevojshme për lidhjen e kontratës martesore (neni 2276.2 BGB). Pas lidhjes së kontratës, palët kontraktuese mund ta marrin me vehte për rrualtje ose ta dërgojnë tek organi kompetent.

Në Zvicër, kontrata për trashëgimi është e plotëfuqishme nëse përpilohet sipas rregullave, sikur edhe për testamenti gjyqësor (neni 512, CCS). Palët kontraktuese shprehin dëshirën e vet para zyrtarit publik dhe e nënshkruajnë në prani të dy dëshmitarëve (512, CCS).

Për plotfuqishmërinë e kontratës për trashëgimi në të drejtën austriake, ligjvënësi ka paraparë formë që është e domosdoshme për plotëfuqishmërinë e testamentit të shkruar (neni 1249, ABGB). Megjithatë, në praktikë kontrata e trashëgimisë krijohet nga noteri në formë të dokumentit publik që duhet të vërtetohet nga një noter tjetër ose nga dy dëshmitarë. Në të drejtën austriake palët kontraktuese mund të disponojnë vetëm me $\frac{3}{4}$ e pasurisë së vet. Me kontratën për trashëgimi bashkëshortët nuk mund krejtësisht të heqin dorë nga e drejta e krijimit të testamentit. Objekt i kontratës mund të jenë gjithë pasuria, një apo disa sende të caktuara.

Në të drejtën francize, kontrata për dhurat të sendeve të ardhshme patjetër të lidhet në formë të shkruar dhe të verifikohet tek noteri (neni 931 Code Civil). Për plotëfuqishmërinë e saj duhet të plotësohen kushtet në lidhje me formën dhe aftësinë për dhuratat e rëndomta. Nëse kontrata për trashëgimi nuk është bërë në formën e kontratës martesore, ajo lejohet vetëm në mes bashkëshortëve.

Kontrata për trashëgimi parqet punë juridike me të cilën trashëgimlënësi me dëshirë disponon me pasurinë e vet (plotësisht ose pjesërisht) në interes të palës kontraktuese ose

personit të tretë në rast vdekje (Ristov, 2008: 92). Nga ky përkufizim vërrejmë që kontrata për trashëgimi ka natyrë juridike të dyfishtë. Në njëërën anë është kontratë, dhe nga ana tjetër ajo paraqet disponim me pasurinë në rast vdekje.

Gjatë përpilimit të kontratës, prezent duhet të jenë, trashëgimlënësi, trashëgimtarët dhe persona tjerë eventualisht të involvuar dhe të gjithë së bashku me shkrim do ta vërtetojnë se si do të ndahet pasuria, pas vdekjes së trashëgimlënësit. Kjo kontratë e trashëgimisë nuk lenë paqartësi në një familje me marrëdhënie komplekse (shkurorëzimi, rimartesë). Këtu është çdo gjë e paraparë dhe e rregulluar.

Kontrata e trashëgimisë është për të gjithë palët e obligueshme dhe mund të ndryshohet apo pezullohet vetëm me pëlqimin dhe nënshkrimin e të gjitha palëve.

4.3.2 Dallimi mes testamentit dhe kontratës për trashëgimi

Derisa testamenti paraqet punë juridike të njëanshme, si shprehje e vullnetit të fundit të testatorit, kontrata për trashëgimi është punë juridike e dyanshme ose e shumëanshme, që varet edhe nga dëshira e palëve tjera kontraktuese.

Testamenti mund të revokohet ose ndryshohet vetëm nga testatori, kurse kontrata e trashëgimisë nuk mund të revokohet vetëm nga njëra palë.

Testamenti është çdoherë punë juridike bamirëse, ndërsa kontrata për trashëgimi mund të paraqitet edhe si punë juridike ngarkuese në qoftë se është kontraktuar mbajtja, kompensimi etj. Kontrata e trashëgimise pëpilohet në formë më të rreptë për dallim nga testamenti.

Testamenti krijohet në formë të aktit privat (psh. testament i shkruar me dorë), për dallim nga testamenti kontrata për trashëgimi krijohet vetëm në formë të dokumentit publik, kurse gjatë përpilimit të saj marrin pjesë noteri dhe dëshmitarët.

4.3.3 Kontrata për mbajtje të përhjetshme

Me kontratën për mbajtjen e përhjetshme dhënësi i mbajtjes obligohet të mbajë pranuesin e mbajtjes ose ndonjë person të tretë dhe pranuesi i mbajtjes në këmbim do t'ia le gjithë pasurinë apo një pjesë të pasurisë, dorëzimi i sendit që është objekt i kontratës shtyhet deri në kohën e vdekjes së pranuesit të mbajtjes (neni 1029, Ligji mbi marrëdhënie detyrimore i RMV-së).

Karakteristikat e kësaj kontrate janë:

- Është punë juridike e dyanshme – me lidhjen e saj lindin detyrime për të dy palët kontraktuese;
- Është kontratë me barrë për të dy palët, njëra palë merr ushqimin për pasurinë e dhënë, kurse tjetra merr pasurinë për dhënien e ushqimit.
- Është kontratë aleatore, pasi që nuk dihet se sa do të zgjasë detyrimi për dhënien e ushqimit, sa do të jetojë ushqimmarrësi.
- Përpilohet në formë të shkruar, vërtetohet nga Gjykata/Noteri. Gjykatësi ua lexon palëve kontratën në prani të dy dëshmitarëve që i njohin palët dhe ua tërheqë vërejtjen për pasojat që dalin me lidhjen e kontratës (neni 1030, Ligji për marrëdhënie detyrimore i RMV-së).

Nisur nga praktika e deritashme, kontrata për mbajtje të përhjetshme është paraqitur në trajta të ndryshme: si premtim i trashëgimisë, për jetë të përbashkët, për bashkim të pasurisë, për kryerjen e punëve në pasurinë e tjetrit, për angazhim rreth varrimit në rast vdekjeje dhe kryerjen e ceremonive fetare, si dhe në trajta të tjera (Berisha, 2013 : 168)

Pasuria që është objekt i kontratës nuk bën pjesë në masën trashëgimore të ushqimmarrësit, as që mund të shqyrtohet më rastin e shqyrtimit të trashëgimisë së tij, pasi që gjatë jetës është tjetërsuar nga ai, ashtu që në momentin e vdekjes së tij ajo përbën një pasuri në pronësi të tjetrit (Berisha, 2013: 169).

Pas vdekjes së marrësit të mbajtjes, dhënësi i mbajtjes nuk është përgjegjës për borxhet e lidhura me të, por në kontratë mund të përcaktohet që dhënësi i mbajtjes do të jetë përgjegjëse për borxhet ekzistuese të marrësit të mbajtjes ndaj kreditorëve të caktuar (neni 1032, Ligji për marrëdhënie detyrimore i RMV-së)

Palët kontraktuese kanë mundësi që kontratën për mbajtje të përjetshme ta shkëpusin me marrëveshje, madje edhe pasi të kenë filluar me përmbushjen e saj. Nëse sipas kontratës për mbajtje të përjetshme, palët kontraktuese jetojnë së bashku dhe marrëdhënia e tyre përkeqësohet deri në atë masë sa që jeta e përbashkët bëhet e patolerueshme, secila palë mund të kërkojë që gjykata ta anulojë kontratën. Secila palë mund të kërkojë shkëputjen e kontratës nëse pala tjetër nuk i përmbushë detyrimet e saj. Në rast të shkëputjes së kontratës pala që nuk është përgjegjëse për prishjen ka të drejtë të kërkojë nga pala tjetër dëmshpërblim për dëmin (neni 1033, Ligji për marrëdhënie detyrimore i RMV-së).

Nëse dhënësi i mbajtjes vdes atëherë detyrimet nga kjo marrëdhënie transferohen tek bashkëshorti/ja pasjetues dhe tek pasardhësit e të ndjerit nëse ata japin pëlqimin për një gjë të tillë. Nëse nuk e japin pëlqimin për vazhdimin e kontratës për mbajtje të përjetshme, kontrata prishet dhe ata nuk kanë të drejtë të kërkojnë kompensim për mbajtjen e mëparshme. Nëse bashkëshorti/ja, dhe pasardhësit e tij nuk kanë mundësi të përmbushin detyrimet kontraktore, ata kanë të drejtë të kërkojnë shpërblim nga marrësi i mbajtjes. Gjykata përcakton shpërblimin e tillë në bazë të diskrecionit, duke marrë parasysh gjendjen financiare të palës së mbajtur si dhe gjendjen financiare të atyre që janë të thirrur që ta vazhdojnë kontratën për mbajtje të përjetshme (neni 1035, Ligji për marrëdhënie detyrimore i RMV –së).

4.3.4 Dallimet mes kontratës për trashëgimi dhe kontratës për mbajtje të përjetshme

E përbashkëta e kontratës për trashëgimi me kontratën për mbajtje të përjetshme qëndron në shprehjen e vullnetit të palës kontraktuese, lidhja e kontratës në formë të rreptë formale dhe efekt juridik “mortis causa”.

Kontrata e trashëgimisë dallohet nga kontrata për mbajtje të përjetshme që doli nga ajo sipas dy karakteristikave: e para, tek kontrata e trashëgimisë, trashëgimlënsi nuk mund të disponojë me pjesën që u takon trashëgimtarëve të domosdoshëm dhe e dyta, me kontratën e trashëgimisë, trashëgimtarët trashëgojnë të drejtat dhe obligimet e trashëgimlënësit, me këtë sigurohen edhe të drejtat e kreditorëve (Ristov & Micković, 2008: 72).

Tek kontrata për trashëgimi asnjëherë nuk rezikohet pjesa që i takon trashëgimtarëve të domosdoshëm. Me kontratën për mbajtje të përhjetshme, pranuesi i mbajtjes mund të disponojë me gjithë pasurinë e tij pa marrë parasysh kufizimet në të drejtën tek pjesa e domosdoshme. Si rezultat i kësaj, ekziston mundësia që trashëgimtarët të mos mundin ti realizojnë drejtat e tyre në pjesën e domosdoshme. Kjo situatë në praktikë është e shpeshtë.

Te kontrata e mbajtjes së përhjetshme, dhënësi i mbajtjes përvetëson vetëm të drejtat nga pranuesi i mbajtjes. Ai nuk përgjigjet për detyrimet (borxhet) e pranuesit të mbajtjes, vetëm nëse nuk është kontraktuar ndryshe. Kontrata për trashëgimi nuk mund të revokohet apo të shkëputet siç është rasti tek kontrata për dorëzim të pronës dhe kontrata për mbajtje të përhjetshme.

Duke pasur parasysh karakteristikat pozitive të kontratës për trashëgimi, konsiderojmë se kontrata për trashëgimi duhet të pranohet si bazë juridike edhe në sistemin tonë juridik. Me këtë do ti jepet më shumë hapësirë dëshirës së një personi që ai të mund të disponojë me pasurinë e tij në rast vdekje.

4.3.5 Kontrata për dorëzim dhe ndarje të pasurisë

Kontrata për dorëzimin dhe ndarje të pasurisë në RMV rregullohet me Ligjin mbi marrëdhënie detyrimore të vitit 2001.

Për dalim nga kontrata e mbajtjes së përhjetshme ku dhënësi i mbajtjes fiton pronën pas vdekjes së mbajtësit, në bazë të kontratës për dorëzim dhe ndarje të pronës, pasardhësit marrin trashëgiminë derisa trashëgimlënësi është gjallë d.m.th shkakton efekt juridik “inter vivos”.

Kjo kontratë është mënyra më e thjeshtë dhe më e sigurtë për shprëndarjen e pasurisë në kohë të jetës, atëherë kur ekziston pajtueshmëri mes trashëgimtarëve - pasardhësve dhe bashkëshortit të atij që disponon me pasurinë.

Me kontratën për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë, paraardhësi si palë kontraktuese bën ndarjen edhe dorëzimin e një pjese apo të gjithë pasurisë që ka, duke ua kaluar atë pasardhësve të tij, zakonisht pa ndonjë detyrim për ta. Në këtë mënyrë, kjo kontratë është e

afërt me kontratën e dhurimit. Përpos dorëzuesit të pasurisë, palë kontraktuese, në anën tjetër, duhet të jenë të gjithë pasardhësit e dorëzuesit dhe bashkëshorti/ja të cilët do të thirreshin në trashëgimi si trashëgimtarë ligjor (neni 1023, Ligji për marrëdhënie detyrimore i RMV-së). Kjo nuk nënkupton detyrimin e dorëzuesit për t'ua ndarë pasurinë pasardhësve në pjesë të barabarta dhe as detyrimin që t'ua kalojë pjesët e pasurisë të gjithëve.

Pasardhësit e trashëgimlënësit duhet të dorëzojnë Çertifikatat e lindjes si provë për të vërtetuar që ata mund të jenë palë në kontratën e dorëzimit dhe ndarjes së pronës. Bashkëshorti duhet të dorëzojë çertifikata nga libri amzë i të kurorëzuarve për të vërtetuar se në momentin e lidhjes së kontratës martesë ka qenë e vlefshme.

Kontrata për dorëzim dhe ndarje të pronës lidhet në formë të dokumentit publik që kërkon pjesëmarrje aktive të gjykatës apo noterit. Gjatë verifikimit të kontratës, Noteri gjegjësisht Gjykatësi është i detyruar të lexoj kontratën në prani të palëve dhe ti paralajmëroj palët për pasojat që dalin nga ajo. Noteri duhet të mësojë trashëgimlënësin se mundet që për vehte apo për bashkëshortin e tij të mbaj të drejtën e uzufuktiti³² të të gjitha të mirave ose të disa prej tyre (neni 1026, Ligji për marrëdhënie detyrimore).

Kontrata për dorëzim dhe ndarje të pronës është e vlefshme vetëm nëse për të jepet pëlqimi nga të gjithë pasardhësit dhe bashkëshorti i trashëgimlënësit, të cilët sipas ligjit do të thirreshin për të trashëguar. Në të kundërtën, në qoftë se me dorëzimin dhe ndarjen e pronës nuk pajtohet ndonjëri nga trashëgimtarët, kjo kontratë do të konsiderohet si kontratë për dhuratë. Në të njëjtën mënyrë do të veprohet edhe në qoftë se pas cedimit trashëgimlënësit i lind fëmijë ose paraqitet trashëgimtari i zhdukur i shpallur si i vdekur (neni 1025, Ligji mbi marrëdhënie detyrimore).

Secili pasardhës që nuk e jep pëlqimin, mund ta bëjë atë më vonë në të njëjtën formë siç është përpiluar më parë. Dhënia e pëlqimit më vonë nënkupton pranimin e efekteve dhe kushteve të kontratës çfarë ishin në momentin e lidhjes së saj. Me dhënien e pëlqimit për këtë kontratë, konsiderohet se është hequr dorë nga e drejta për të kërkuar pjesën e domosdoshme. (Berisha, 2013 :147).

³² E drejta e një personi për të gëzuar një send që është në pronësi të një tjetri, me detyrim që të ruaj dhe të mirëmbajë atë.

Dorëzimi dhe ndarja mbetet e vlefshme edhe nëse një pasardhës i cili nuk ka dhënë pëlqimin vdes para dorëzimit duke mos lënë ndonjë pasardhës, nëse heq dorë nga trashëgimia, nëse është përjashtuar nga trashëgimia, apo nëse nuk është i denjë të trashëgojë (neni 1023, Ligji mbi marrëdhënie detyrimore i RMV-së).

Kontrata e dorëzimit dhe ndarjes së pasurisë, prodhon efekt juridike vetëm nëse kanë dhënë pëlqim të gjithë trashëgimtarët e rradhës së parë: pasardhësit e trashëgimlënësit dhe bashkëshorti/ja. Nëse pëlqimi i pasardhësve nuk ekziston në momentin e vdekjes së dorëzuesit, atëherë kjo kontratë shndërrohet në kontratë të dhurimit (neni 1027, Ligji mbi marrëdhënie detyrimore i RMV-së).

Objekt i kontratës për dorëzim dhe ndarje të pasurisë mund të jetë vetëm një pjesë e pasurisë ose gjithë pasuria ekzistuese e dorëzuesit që ekziston në momentin e lidhjes së kontratës (1024, Ligji mbi marrëdhëniet detyrimore i RMV-së).

Kontrata për dorëzim dhe ndarje të pasurisë zakonisht është kontratë me detyrim të njëanshëm, është formale dhe mirëbërëse .

Nga momenti i lidhjes së kontratës, pasardhësit fitojnë të drejtën e pronësisë mbi pasurinë që është objekt i kontratës.

Pasuria që është objekt i kontratës për dorëzim dhe ndarje të pasurisë nuk llogaritet në masën trashëgimore të dorëzuesit dhe as në pjesën trashëgimore të trashëgimtarëve ligjorë të tij. Por, nëse ndonjëri nga trashëgimtarët e rradhës së parë nuk ka dhënë pëlqim deri në momentin e vdekjes së dorëzuesit, kontrata e humb efektin ndaj të gjithë trashëgimtarëve dhe konsiderohet si kontratë për dhuratë (Berisha, 2013: 152).

Për arsye të mbrojtjes së interesave ekonomike ose morale (mosmirënjohja) me dispozita ligjore parashihet mundësia e revokimit të kontratës (neni 1028, Ligji mbi marrëdhëniet detyrimore i RMV-së).

4.4 Përrjashtimi nga trashëgimia

Edhepse trashëgimtarët e domosdoshëm kanë të drejtë në pjesën e domosdoshme, ekziston mundësia që nëpërmjet testamentit testatori të përjashtojë tërësisht ose pjesërisht trashëgimtarin e domosdoshëm nga trashëgimia, por me kusht që të ekzistojë ndonjëra nga arsyet e parapara me ligj (neni 46, LTMV).

Me përjashtim nga trashëgimia kuptojmë heqjen e cilësisë së trashëgimtarit ligjor përmes deklaramit të vullnetit të fundit të trashëgimlënësit, ashtu që trashëgimtari i domosdoshëm humb të drejtat trashëgimore në vëllimin në të cilin është përjashtuar (Galgano, 1999: 839).

Përjashtimi nga e drejta në pjesën e domosdoshme të trashëgimisë është një lloj dënimi civil për trashëgimtarin e domosdoshëm, si pasojë e sjelljeve sociale të paparanueshme ndaj trashëgimlënësit. Përjashtimi varet nga vullneti i trashëgimlënësit, por vullneti mund të realizohet vetëm nëse plotësohen kriteret ligjore. Përjashtimi mund të jetë:

- ❖ i pjesërishtëm – kur trashëgimtari humb pjesërisht të drejtën në trashëgimi, d.m.th nuk i ka humbur të gjitha të drejtat ose
- ❖ i plotë – kur trashëgimtari nuk mund të trashëgojë asgjë nga pasuria trashëgimore

Në nenin 46 të LTRMV, theksohen arsyet e përjashtimit të trashëgimtarit të domosdoshëm nga pasuria trashëgimore:

- Shkelja e ndonjë detyrimi ligjorë ose moral ndaj trashëgimlënësit;
- Kryerja e ndonjë veprë penale të rëndë kundër trashëgimlënësit, bashkëshortit, fëmijës ose prindit të trashëgimlënësit.

Vullneti për përjashtimin e trashëgimtarit duhet të shprehet në testament, në mënyrë të qartë duke theksuar shkakun e përjashtimit, i cili duhet të ekzistojë në kohën e përpilimit të testamentit (neni 47, LTMV).

Nëse trashëgimtari i domosdoshëm e kundërshton shkakun e përjashtimit, ai udhëzohet në procedurë kontestimore për të provuar bazën e përjashtimit nga trashëgimia. Padia për mbrojtjen e së drejtës në pjesën e domosdoshme quhet padia supletoria (Podvorica, 2006: 71).

Nëse trashëgimtari i domosdoshëm ka shumë borxhe aq sa shuma e borxheve tejkalon vlerën e pasurisë së përgjithshme, lidh punë juridike jodobiprurëse, në mënyrë të pakuptueshme shpenzon pasurinë e tij, blen pa nevojë sende luksoze të panevojshme, etj deri në atë masë sa ai rrezikon veten ose familje e tij me varfëri, atëherë trashëgimlënësi mund ta privojë atë pjesërisht ose në tërësi nga pjesa e domosdoshme në dobi të pasardhësve të të privuarit.

Privimi nga pjesa e domosdoshme, konsiderohet i plotëfuqishëm vetëm nëse në momentin e hapjes së trashëgimisë i privuari ka fëmijë të mitur ose nip të mitur nga fëmija i vdekur më parë, ose ka fëmijë madhor ose nip madhor nga fëmija i vdekur dhe janë të paaftë për punë (neni 49, LTMV).

Instituti i përjashtimit dhe privimit dallohen nga njëri tjetri:

- ❖ për të qenë i plotëfuqishëm privimi nga pjesa e domosdoshme, është kusht që privimi të bëhet në momentin e hapjes së trashëgimisë, kurse në rast të përjashtimit të trashëgimtarit të domosdoshëm arsyeja duhet të ekzistojë në momentin e përpilimit të testamentit,
- ❖ instituti i privimit nuk prodhon efekt juridik nëse në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit fëmijët e të privuarit nuk janë të mitur ose madhorë por të paaftë për punë.

Trashëgimtari i padenjë për të trashëguar, ex lege humb autorizimet juridike të trashëgimtarit dhe nuk mund të trashëgojë as në bazë të në bazë të testamentit dhe as në bazë të trashëgimit me ligj. Sipas nenit 123 të LTMV, i padenjë për të trashëguar konsiderohet personi që: me dashje ka vrarë ose ka tentuar të vrasë trashëgimlënësin, me kanosje, mashtrim apo dhunë e ka nxitur trashëgimlënësin që të bëjë/revokojë testamentin ose ndonjë dispozitë të tij ose e ka penguar trashëgimlënësin që ta bëjë testamentin, me qëllim që të pengojë realizimin e dëshirës së fundit të trashëgimlënësit e ka agjësuar ,fshehur ose ka falsifikuar

testamentin e trashëgimlënësit ose ka shkelur detyrimin ligjorë për ta mbajtur ose ndihmuar trashëgimlënësin kur ai ka pasur nevojë.

Trashëgimlënësi mund të falë personin e padenjë por falja duhet të bëhet në formën me shkrim sipas rregullave që aplikohen për vlefshmërinë e testamentit (neni 124.2, LTMV).

4.5 Heqja dorë nga trashëgimia

Deklarata për heqje dorë nga trashëgimia paraqet një akt juridik nëpërmjet të cilit trashëgimtari shpreh vullnetin e lirë se nuk dëshiron të marrë të drejta dhe detyrime nga trashëgimia, pra nuk do të trashëgojë. Nga çasti i vdekjes së trashëgimlënësit e deri në momentin e heqjes dorë nga trashëgimia, trashëgimtari konsiderohet si trashëgimtar i përkohshëm. Kurse, në momentin e heqjes dorë nga trashëgimia ai humb të gjitha autorizimet juridike trashëgimore të cilat fitohen me vdekjen e trashëgimlënësit (Podvorica, 2006: 84).

Pjesa e trashëgimtarit që ka hequr dorë nga trashëgimia trashëgohet sikur ky trashëgimtar të kishte vdekur para trashëgimlënësit.

Kur trashëgimtari heqë dorë nga trashëgimia ligjore, pjesa trashëgimore e tij u kalon trashëgimtarëve të tjerë të po njëjtës rradhë. Po qe se trashëgimtari që heqë dorë nga trashëgimia është i vetmi trashëgimtar i asaj rradhe, trashëgimia u kalon trashëgimtarëve të radhës pasuese.

Trashëgimtari mund të heq dorë si nga trashëgimia me ligj ashtu edhe nga trashëgimia me testament. Deklarata për heqje dorë nga trashëgimia duhet të jetë e kuptueshme, e lejueshme si dhe të shprehet vullneti i lirë i trashëgimtarit që heq dorë nga trashëgimi.

Deklarata për heqjen dorë nga trashëgimia nuk mund të revokohet. Nëse vullneti i deklaruar përmban të meta, lejohet anulim i deklaratës nëse ajo është dhënë më kanosje, me dhunë me mashtrim apo edhe me lajthitje (neni 133, LTMV).

Kur trashëgimtari ka hequr dorë nga trashëgimia me testament, pjesa e tij trashëgimore do tu ndahet trashëgimtarëve ligjorë në qoftë se në testament testatori nuk ka shënuar emrin e personit që do ta zëvendësoj atë në rast të heqjes dorë nga trashëgimia.

Ndryshe është kur kemi të bëjmë me trashëgiminë me ligj. Trashëgimtari i cili ka hequr dorë në emër të vet nga trashëgimia, konsiderohet sikur nuk ka qenë kurrë trashëgimtarë. Prandaj, pjesën e pasurisë trashëgimore që atij do ti takonte tani, do ta trashëgojnë trashëgimtarët e tjerë ligjorë. Trashëgimtari duhet të shprehet nëse heq dorë vetëm në emër të vet apo edhe në emër të trashëgimtarëve të tjerë.

4.6 Roli i noterëve në procedurën e trashëgimisë

Shërbimi noterial konsiderohet si pjesë e një reforme strategjike të sistemit të drejtësisë, qëllimi i i së cilës është krijimi i një sistem funksional dhe efikas të drejtësisë (Arsllani & Aliu, 2018: 36).

Vendlindje e noterisë moderne evropiane (latine) konsiderohet Italia, ku noteria u njoh nga koha e Friedrich Barbarossa dhe Papa Aleksandrit. Noterët publik ekzistonin në Romën e Lashtë, boten helenistike dhe në Bizant. Shërbimi i noterit është aplikuar edhe në një numër të madh të shteteve evropiane dhe njihet me emërtime të ndryshme. Në shekujt XII dhe XIII shërbimi i noterisë praktikohet nga klerikët dhe më pas gjithnjë e më tepër praktikohet nga juristët e shkolluar. Në shtetet e ish Republikës së Jugosllavisë, noteri paraqitet shumë herët, së pari u krijua në qytetet bregdetare të Dalmacisë dhe Malit të Zi (Dhoma e Noterëve e RMV-së, 2013: 3-4).

Epoka moderne karakterizohet me 3 grupe kryesore të noterëve publik: latin, anglo-amerikan dhe skandinav. Në Evropën kontinentale, tradita juridike bazohet në noterinë latine. Ky lloj i noterit është i pëfaqësuar në vendin tonë. Dhoma e Noterisë në RMV është anëtare e plotë e Unionit Ndërkombëtar të noterijatit latin që nga shtatori 2001 dhe është pjesëmarrëse në punën dhe takimet e Komisioneve për çështje evropiane dhe mesdhetare (Dhoma e Noterise, 2013: 5).

Në sistemin gjyqësor të RMV-së, institucioni i noterit publik u promovua në dispozitat e Ligjit për kryerjen e veprimtarive noteriale të vitit 1996 dhe brenda kësaj periudhe u vendos në pozicionin e saj të merituar. Futja e institucionit të noterit në RMV, ka reflektuar pozitivisht në funksionimin e sistemit gjyqësor në përgjithësi. Në RMV shërbimi i noterit daton që nga viti

1998. Sfera e punëve dhe kompetencave të noterëve në RMV, është e rregulluar me Ligjin për Noterinë të vitit 1996 (tani e tutje LNRMV) dhe ligje të tjera. Noterët e parë në RMV filluan me punë më 15 qershor 1998 dhe menjëherë atë vit u krijua Dhoma e Noterisë (Janeski, 2001: 26).

Noteri është një jurist profesionist, i emëruar nga shteti përkatësisht Ministria e Drejtësisë. Shërbimet që kryen noteri kanë natyrë private por janë shërbime në interes publik. Ai e kryen veprimtarinë me kërkesë të palëve, por vepron sipas detyrës zyrtare (neni 3, 5 LNRMV).

Në kompetencë të noterëve janë kryesisht çështjet që bien në fushën e jurisprudencës Jokontestimore. Me sjelljen e Ligjit për Procedurë Jokontestimore, noterët si të besuar të gjykatës fituan kompetencë edhe në shqyrtimin e trashëgimisë (neni 131-141).

Me sjelljen e Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore të vitit 2008 dhe Ligjit për Procedurë Jokontestimore të vitit 2008, noterët fituan kompetenca të reja në fushën e trashëgimisë dhe pasurisë trashëgimore. Kështu, noterët fituan të drejtën e verifikimit të kontratës për mbajtje të përjetshme dhe kontrata për dorëzim dhe ndarje të pasurisë, për të gjallë (Mickoviç, Ristov, 2008: 71). Noterët kanë të drejtë ti përpilojnë këto kontrata në formë të aktit notarial (neni 4, LNRMV). Në procedurën e shqyrtimit të trashëgimisë, si një punë e besuar, Noteri vepron vetëm nëse nuk ka kontest as ndaj fakteve e as ndaj aplikimit të së drejtës (Janevski & Zoroska-Kamilovska, 2010:116).

Sipas nenit 138 të LPJMV dhe neni 136 të Ligjit për noterijat, punën e Noterit si i besuar i Gjykatës e kontrollon Gjykata që ia ka besuar punën. Procedura trashëgimore fillon me përgatitjen e propozimit për shqyrtimin e trashëgimisë së të ndjerit. Propozimi i paraqitet Gjykatës dhe pastaj Gjykata ia dorëzon Noterit që vepron si i besuar i Gjykatës. Propozuesi duhet të dorëzoj Çertifikatë nga libri amzë i të vdekurve, Çertifikatën e lindjes së trashëgimtarëve, Vërtetim të pronësisë së trashëgimtarëve, Dëshmi për pagesë të tarifës gjyqësore (në shumë prej 480 denarë) dhe prova tjera që do të kontribuonin në shqyrtim më të shpejtë dhe më efikas të trashëgimisë. Në përgjithësi, procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore përfundon shpejt, mirëpo varet nga angazhimi i avokatëve (përgatitja dhe dorëzimi i propozimit) dhe angazhimi i noterëve (si: caktimi i seancës dëgjimore për transferin e

pasurisë trashëgimore). Gjithsesi procedura nuk duhet të zgjasë më shumë se 30 ditë (Dhoma e Noterëve, 2013: 40).

Në rastin e vdekjes së një personi fizik, organi përgjegjës për regjistrimin e vdekjes në librin amzë të të vdekurve është i detyruar në afat brenda 30 ditësh nga dita e vdekjes të dorëzoj Aktvdekjen në Gjykatën trashëgimore (neni 142, LPJRMV). Gjykata në afat prej 8 ditëve do t'ia besoj noterit shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, duke ia dorëzuar lëndën e trashëgimisë me të gjitha shkresat tjera të nevojshme. Në qoftëse ekzistojnë më shumë noter, shprëndarja e lëndës së trashëgimisë bëhet sipas rradhitjes alfabetike (neni 135, LPJRMV).

Noterët si të besuar të gjykatës marrin veprime dhe vendosin në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi Procedurë Jokontestimore dhe Ligjit mbi Trashëgimi. Noteri nuk mund të refuzojë punën e besuar, përjashtimisht në qoftë se ekzistojnë arsye të justifikueshme, dhe për arsyetimin e shkaqeve vendos Gjykata që ia ka besuar punën. Megjithatë, ekziston mundësia që Gjykata pasi ia ka besuar lëndën Noterit, ta merr nga Noteri shqyrtimin e mëtutjeshëm të procedurës trashëgimore dhe procedurën ta vazhdoj vet ose t'ia besoj një Noteri tjetër. Kjo, veçanërisht në rastet e paaftësisë së Noterit për të shqyrtuar trashëgiminë si rezultat i sëmundjes, neglizhencës profesionale ose shkaqe tjera të arsyetuar për të cilat vendos Gjykata (neni 132, LPJMV).

Nëse Noteri e refuzon punën e besuar ose në qoftë se Gjykata ia merr punën e besuar, Gjykata do ta urdhëron Noterin ti dorëzoj të gjitha shkresat. Në qoftëse Noteri refuzon të ekzekutojë urdhërin e Gjykatës ose refuzon t'ia jep shkresat nga puna e besuar, Gjykata mundet ta gjobit në mënyrën e përcaktuar me Ligjin për përmbarrim. Kundër vendimit për dënim të Noterit, Noteri ka të drejtë në ankesë deri te Gjykata e shkallës së dytë (e Apelit), kundër vendimit nuk lejohet mjete të jashtëzakonshme juridike.

Pas pranimit të lëndës, Noteri duhet të kryej kontroll të shkresave si:

- ❖ Të kontrollojë nëse Aktvdekja është e plotë dhe i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme;
- ❖ Nëse Aktvdekja nuk i ka të gjitha të dhënat ose ka vetëm Çertifikat vdekjeje, Noteri mundet hartimin e Aktvdekjes t'ia besoj organit kompetent ose vet ta hartoj duke u

bazuar në të dhënat e fituara nga të afërmit e të ndjerit ose persona që kanë jetuar me të;

- ❖ Në qoftë se nga të dhënat e Aktvdekjes vërrehet që i ndjeri nuk ka pasuri, trashëgimia nuk do të shqyrtohet (Dhoma e noterëve, 2013: 41).

Në Aktvdekje, përpos të dhënave personale (emri, mbiemri, vendbanimi, profesioni, data e lindjes dhe e vdekjes) të të ndjerit dhe trashëgimtarëve të mundshëm të tij duhet të shënohen edhe të dhëna tjera si : vendi ku ndodhet pasuria që ka lënë trashëgimlënësi, në qoftë se ka letra me vlerë, sende të vlefshme, librezë kursimi, ose dokumente tjera të rëndësishme, nëse trashëgimlënësi ka lënë borxhe, kontratë për mbajtje të përhjetshme ose marrëveshje për cedimin dhe pjestimin e pasurisë për të gjallë, në qoftë se ka lënë testament atëherë shënohet edhe emri, mbiemri, dhe vendbanimi i dëshmitarëve para së cilëve është përpiluar testamenti. Në Aktvdekje shënohet nëse pritët lindja e fëmiut, nëse fëmijët e tij apo bashkëshorti pasjetues kanë kujdestar. Në qoftë se para vdekjes së trashëgimlënësit ka vdekur bashkëshorti apo ndonjëri prej fëmijëve të tij, që do të thirrej në trashëgimi, shënohet edhe data dhe vendi i vdekjes (neni 145, LPJRMV).

Noteri duhet të kujdeset për të drejtat dhe interesat e të miturve që u mungon përkujdesja prindërore si dhe për personat tjerë që nuk janë në gjendje të kujdesen për të drejtat dhe interesat e veta (neni 4, 5, 164, LPJMV) ,gjithashtu duhet të merr masa për sigurimin e pasurisë.

Më kërkesë të trashëgimtarëve ose legatarëve Noteri është i obliguar të kryej inventarizim dhe vlerësim të pasurisë trashëgimore në përputhje me dispozitat ligjore. Kjo kryhet në rastet kur nuk dihen trashëgimtarët ose nuk dihet vendbanimi i tyre, nëse trashëgimtarë janë të mitur, persona me sëmundje mendore ose janë të paaftë vet të kujdesen për punët e tyre, kur pasuria trashëgimore duhet ti dorëzohet RMV –së si dhe në raste të tjera të arsyeshme. Inventarizimi dhe vlerësimi kryhet në prani të dy dëshmitarëve të moshës madhore dhe kur është e nevojshme edhe në prezencë të ekspertëve. Në invenatrizim dhe vlerësim mund të merr pjesë çdo person i interesuar. Të dhënat nga vlerësimi dhe inventarizimi, Noteri ia dorëzon Gjykatës trashëgimore. Sendet e luejtshme shënohen sipas, llojit, gjinisë, numrit, masës, gjatësisë ose veçmas. Paluejtshmërit shënohet veç e veç duke

shënuar vendin ku gjenden, të dhënat nga libri publik ku shënohen të drejtat në paluejtshmërinë dhe të dhënat tjera kadastrale (neni 146 – 148, LPJRMV).

Në shqyrtimin e pasurisë trashëgimore vërtetohen tri fakte: ekzistenca e trashëgimtarëve, pasuria që përbën pasurinë trashëgimore, madhësia e pjesës trashëgimore të çdo trashëgimtari dhe e drejta e legut (neni 171, LPJRMV). Për të gjitha këto çështje do të vendos vetëm pasi të merren deklaratat nga trashëgimtarët. Për të drejtën e personave që nuk kanë ardhur në seancë dhe rregullisht janë thirrur, Noteri do të vendos në bazë të të dhënave me të cilët disponon, duke marrë parasysh deklaratat e tyre të shkruara që do të arrijnë deri në marrjen e vendimit. Deklarata për pranim apo heqje dorë nga trashëgimia nuk është e patjetërsueshme të jepet në prani të personave të interesuar.

Në qoftë se Noteri nuk ka njohuri për ekzistencën e trashëgimtarëve, me shpallje do ti thërret personat që kanë të drejtë në trashëgimi të paraqiten në afat prej 1 viti nga dita e shpalljes në Gazetën Zyrtare dhe vendoset në tabelën e shpalljes në Gjykatë. Pas kalimit të afatit 1 vit nga shpallja në Gazetën Zyrtare të RMV-së, në qoftë se personat e interesuar nuk paraqiten dhe nuk japin deklaratat e duhura, Noteri do të shqyrtojë trashëgiminë në bazë të deklaratave dhe të dhënave me të cilët disponon (neni 168, LPJRMV).

Pas përfundimit të procedurës, Noteri si i besuar i Gjykatës, pasi të vërtetojë cilëve persona iu takon e drejta në trashëgimi, me vendim do ti shpall trashëgimtarë. Në qoftë se në procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë të gjithë trashëgimtarët me marrëveshje propozojnë mënyrën e ndarjes, Noteri atë marrëveshje do ta shënoj në vendim për trashëgimi, në qoftë se disponimi i tillë nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe dispozitat nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me kushtetutën dhe moralin (Dhoma e Noterëve, 2013: 43). Sipas nenit 173 të LPJMV, Noteri do ta ndërpres procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë dhe do ti udhëzoj palët në procedurë kontestimore, nëse mes palëve lind kontestet për faktet nga të cilat varet e drejta e tyre. Vendimin për trashëgimi, Noteri ua dorëzon të gjithë trashëgimtarëve dhe personave të cilët gjatë procedurës trashëgimore kanë paraqitur kërkesë për trashëgimi. Në qoftë se Noteri vërteton që nuk ka trashëgimtarë ose nuk dihet nëse ka trashëgimtar dhe në afatin e paraparë nuk paraqitet asnjë trashëgimtar që provon se ka të drejtë në trashëgimin e shqyrtuar, Noteri do të vendos që trashëgimia ti dorëzohet RMV-së. Në

qoftë se pas hyrjes në fuqi të vendimit mbi trashëgimi gjendet pasuria e trashëgimlënësit që nuk është ditur se ekziston kur është sjellë vendimi për trashëgimi, Noteri trashëgiminë e gjetur do ta ndajë me vendim të ri duke u bazuar në vendimin e mëparshëm (neni 185, LPJRMV).

Në qoftë se trashëgimtari më herët ka dhënë deklaratë se ka hequr dorë nga trashëgimia, Noteri do ta thërret të jep deklaratë të re për trashëgiminë e re.

Pas përfundimit të procedurës trashëgimore, gjegjësisht pas hyrjes në fuqi të vendimit, lëndën trashëgimore Noteri ia kthen Gjykatës që ia ka besuar dhe në arkivin e tij mban kopje ose shkresa të skenuara të lëndës në formë elektronike.

Shpërblimi për punën e kryer bie në ngarkesë të trashëgimtarëve. Varësisht nga vlera e trashëgimisë do të caktohet edhe shpërblimi për Noterin gjegjësisht kostot noteriale.

4.7 Hapja e trashëgimisë në rrethin e Gjykatës Themelore të Tetovës në dhjetëvjeçarin e fundit

Trashëgimia hapet (dellatio) në çastin e vdekjes së trashëgimlënësit dhe rregullohet sipas ligjit të kohës së vdekjes së trashëgimlënësit, d.m.th sipas ligjit të kohës kur është hapur trashëgimia (Podvorica, 2006: 39).

Që të realizohet trashëgimi duhet të ndodh vdekja e trashëgimlënësit, të egzistoj baza e thirrjes për trashëgim, si dhe të egzistojnë trashëgimtarët. Trashëgimlënës mund të jetë çdo person fizik, pa dallim gjinie, moshe, etj. Kusht për të fituar cilësinë e trashëgimlënësit është që personi fizik të ketë vdekur dhe pas vetes të ketë lënë pasuri trashëgimore (Trpenovska-Spiroviq, 2009: 32-33).

Vdekja duhet të jetë faktike, të pushojnë të gjitha funksionet e jetës. Vdekja dokumentohet me Çertifikatë nga libri amzë i të vdekurve, po ajo mund të dokumentohet edhe me prova të tjera psh: me raportin e Gjykatës apo raport gjyqësor mbi ekzekutimin e dënimit me vdekje ose me raportin mbi vdekjen në luftë të atij personi.

I vdekur mund të shpallet edhe personi fizik i zhdukur, por për këtë është e nevojshme të plotësohen disa prezumime substancialo-juridike të parapara me ligj si:

- ❖ I vdekur shpallet personi fizik i zhdukur, që ka mbushur moshën 60 vjet, ndërsa 5 vitet e fundit nuk ka pasur asnjë lajm për jetën e tij.
- ❖ Personi fizik i zhdukur, për jetën e të cilit gjatë 5 viteve të fundit nuk ka pasur kurrfarë lajmesh e rrethanat me të cilat është zhdukur besohet se nuk është i gjallë;
- ❖ Personi fizik që është zhdukur në një fatkeqësi komunikacioni, anijethyerje, zjarr, tërmet përmbajtje, ose në ndonjë rrezik tjetër të drejtpërdrejt për jetën , kurse për jetën e tij nuk ka pasur asnjëfarë lajmi për 6 muaj nga dita e heqjes së rrezikut;
- ❖ Personi që është zhdukur gjatë luftës dhe lidhur me ngjarjet e luftës, për jetën e të cilit nuk ka pasur kurrfarë lajmi për 1 vit nga dita e pushimit të armiqësisë (neni 81, LPJMV).

Afatet e përmendura në dy pikat e para llogariten nga dita në të cilën sipas lajmeve të fundit personi i zhdukur ka qenë gjallë.

Propozimin për shpalljen e personit fizik si të vdekur ka të drejtë ta parashtroj çdo person që për një gjë të tillë ka interes juridik të drejtpërdrejt (trashëgimtarët e tij) si dhe prokurori.

Pasurinë trashëgimore e përbëjnë të drejtat dhe detyrimet me karakter pasuror që mund të trashëgohen e që në momentin e vdekjes i kanë takuar trashëgimlënësit. Të drejtat personale nuk mund të barten gjatë jetës prandaj as me rastin e vdekjes nuk mund të barten në persona të tjerë. Prej të drejtës personale kalojnë vetëm të drejtat e autorit të karakterit pasuror-deri në 5 vjet pas vdekjes së trashëgimlënësit (Aliu, 2004: 79).

Në vazhdim nëpërmjet tabelës do të paraqiten të dhëna statistikore për rastet kontestimore të inicuar dhe të zgjidhura në Gjykatën Themelore të Tetovës gjatë dekadës së fundit.

Viti	Numri i procedurave trashëgimore të inicuar në Gjykatën Themelore të Tetovës	Numri i procedurave trashëgimore të zgjidhura në Gjykatën Themelore të Tetovës

2010	602	582
2011	1270	879
2012	1747	1475
2013	1792	1680
2014	1435	1640
2015	1348	1432
2016	1158	1048
2017	1038	1286
2018	1104	1379
2019	975	1031

Tabela 7. Të dhëna statistikore për procedurat trashëgimore të inicuar dhe të zgjidhura në Gjykatën Themelore të Tetovës për periudhën 2010-2019³³

4.8 Vështrim i shkurtër i kapitullit të katërt

Kapitulli i katërt nxjerr në pah:

- ❖ faktorët që ndikojnë në mospërfshirjen e femrës në pjesën ligjore të trashëgimisë duke filluar që nga tradita e religjioni e deri tek mangësitë ligjore;
- ❖ mekanizmat përmes së cilëve mund të kërkohet mbrojtja e drejtës trashëgimore si psh: Gjykata, Organizatat Joqeveritare, zyra e avokatëve, policija dhe paditë e ndryshme për mbrojtjen e pronësisë ose për pavlefshmërinë e punëve juridike;
- ❖ dy institutet juridike të trashëgimisë që parashihen me dispozita ligjore por që në praktikë shfrytëzohen në kundërshtim me qëllimin e ligjit: përjashtimi dhe heqja dorë nga trashëgimia. Ligjvënësi nuk ka paraparë traditën si mënyrë e anashkalimit të drejtës së femrës për trashëgimi në pronë andaj, vlerësojmë që ndikim pozitiv mund të sjell një

³³ Të dhënat statistikore janë siguruar nga Arkivi i Gjykatës Themelore në Tetovë, më datë 20 prill 2020

kufizim në të drejtën e heqjes dorë për një kohë të kufizuar. Së pari (femra) posedon pjesën trashëgimore e më pastaj vendos brenda një afati të caktuar se çfarë dëshiron të bëj, ta dhurojë ose ta ndalë për vete;

- ❖ karakteristikat, dallimet dhe ngjashmëritë e kontratave për ndarje të pasurisë për të gjallë që njihen në RMV si: kontrata për ndarje dhe dorëzim të pasurisë dhe kontrata për mbajtje të përhjetshme dhe në veçanti karakteristikat dhe anët positive të kontratës për trashëgimi e cila nuk njihet në legjislacionin pozitiv të RMV-së, por gjithsesi njihet në vendet evropiane më të zhvilluara si: Gjermania, Franca, Italia, Austria, Zvicra etj. Megjithatë, duke pasur parasysh karakteristikat pozitive të saj konstatojmë se duhet të pranohet si bazë juridike për fitmin e trashëgimisë krahas ligjit dhe testamentit edhe në RMV. Kontrata për trashëgimi është bazë më e fortë juridike dhe ka përparësi ndaj testamentit dhe trashëgimisë me ligj. Anë pozitive konsiderohet fakti që: asnjëherë nuk rrezikohet pjesa që i takon trashëgimtarëve të domosdoshëm pasi që trashëgimlënësi nuk mund të disponojë me pjesën që u takon trashëgimtarëve të domosdoshëm si dhe sigurohen të drejtat e kreditorëve pasi që trashëgimtarët përveç të drejtave të trashëgueshme të trashëgimlënësit trashëgojnë edhe obligimet e trashëgimlënësit;
- ❖ roli dhe funksioni i Noterit në shqyrtimin e pasurisë trashëgimore.

KAPITULLI V

PRAKTIKAT NDËRKOMBËTARE MBI TRASHËGIMINË PRONËSORE GJINORE

5.1 Barazia gjinore për trashëgiminë e pronës në vendet e Evropës Perëndimore (Franca, Gjermania, Austri, Itali etj)

Gjermania – çështjet trashëgimore rregullohen në Kodit Civil (BGB) në nenet 1922-2385 si dhe me Ligjin për të drejtën private ndërkombëtare dhe Ligjin për trashëgimi të fermave. E drejta për të trashëguar pronë fitohet me ligji, testament dhe kontratë për trashëgimi (Spiroviç-Trpenovska & Mickoviç & Ristov, 2011: 80).

BGB parasheh numër të pafund të rradhëve trashëgimore (Trpenovska- Spiroviç & Mickoviç & Ristov, 2011: 80-81).

Përfitues të pjesës së domosdoshme janë: fëmijët e trashëgimlënësit, prindërit dhe bashkëshorti/ja. Nëse trashëgimlënësi nuk ka bashkëshort dhe as fëmijë, atëherë pasurinë trashëgimore e trashëgojnë prindërit dhe pasardhësit e tyre. Nëse i ndjeri nuk ka lënë bashkëshort/e por ka lënë fëmijë, pasuria do të ndahet në pjesë të barabarta mes fëmijëve. Në mungesë të trashëgimtarëve të rradhës së parë dhe të dytë bashkëshorti/ja do të trashëgojë gjithë pasurinë trashëgimore.

E drejta e trashëgimisë së bashkëshortit/es rregullohet me regulla të posaçme. Kështu:

- bashkëshorti pasjetues trashëgon $\frac{1}{4}$ e pasurisë trashëgimore nëse konkurren me pasardhësit e trashëgimlënësit,
- $\frac{1}{2}$ e pasurisë trashëgimore nëse konkurren me prindërit e trashëgimlënësit në vijë të drejtë dhe në vijë të tërthortë me vëllezërit e motrat e tij ose me pasardhësit e tyre ,
- $\frac{3}{4}$ nga pasuria trashëgimore nëse konkurren me gjyshërit dhe gjyshet në rradhën e tretë, dhe
- gjithë masën trashëgimore në mungesë të trashëgimtarëve tjerë (Trpenovska- Spiroviç & Mickoviç & Ristov, 2011: 84-85).

Pjesa e pasurisë së bashkëshortit pasjetues varet nga rregullimi bashkëshortor i çiftit. Bashkëshorti/ja do të trashëgojë $\frac{1}{2}$ e pasurisë trashëgimore nëse çifti ka qenë i martuar sipas sistemit ligjor të pronës së bashkësisë së fitimeve të përlllogaritura (pjesëmarrjes në pronën e përvetësuar pas martesës) (neni 1931.1), dhe $\frac{1}{4}$ si përfitim kompensues martesor ndërsa fëmijët trashëgojnë pjesën e ngelur. Nëse çifti përjashton rregullimin ligjor të pronës atëherë bashkëshorti pasjetues trashëgon $\frac{1}{2}$ e pasurisë dhe fëmijët $\frac{1}{2}$ tjetër në pjesë të barabarta (Projekt i financuar, 2015: 30).

BGB, ka paraparë afat për heqje dorë nga trashëgimia (gjashtë javë deri në gjashtë muaj) dhe me kalimin e këtij afati, trashëgimtari nuk mundet të heq dorë. Heqja dorë bëhet personalisht, para Gjykatës ose Noterit. Nëse fëmija ende nuk ka mbushur moshën 18 vjeç, në emër të fëmijës të dy prindërit deklarojnë heqjen dorë nga trashëgimia (neni 1943- 1944, BGB). BGB, njeh disa lloje të testamenteve si:

- testament me deklaratë nga testatori,
- me deklaratë tek noteri,
- testamente reciproke për bashkëshortët dhe
- testament emergjent (neni 2231).

Francë – çështjet trashëgimore rregullohen me dispozitat e Kodit Civil. E drejta për trashëgimi në pronën familjare fitohet në bazë të ligjit dhe testamentit. Kodi Civil njeh 4 rradhë të trashëgimisë. Trashëgimtarë të rradhës së parë konsiderohen: fëmijët (martesore, jashtmartesore apo të adoptuar) dhe në mungesë të tyre pasardhësit e tjerë të trashëgimlënësit. Fëmijët trashëgojnë në pjesë të barabarta. Në rradhë të dytë trashëgojnë: prindërit e trashëgimlënësit, vëllezërit dhe motrat e tij/saj. Në rradhë të tretë, në pjesë të barabarta trashëgojnë: gjyshërit dhe gjyshet e trashëgimlënësit kurse në rradhë të katërt trashëgojnë kushërinjtë anësorë (axhallarët, hallat ,dajat, tezet e trashëgimlënësi (neni 731-751).

E veçanta e legjislacionit francez është që: bashkëshorti pasjetues gëzon të drejtën e uzufuktit kur konkuron me trashëgimtarët në tre rrradhët ligjore (Trpenovska- Spiroviç & Mickoviç & Ristov, 2011: 90).

Në legjislacionin pozitiv francez, përpara se të bëhet ndarja e trashëgimisë rregullohet regjimi martesor i bashkëshortëve dhe më pas nëse nuk është lënë testament, Kodit Civil Francez ofron:

- Kur i ndjeri lë prapa bashkëshortin/en dhe prindërit, atëherë $\frac{1}{2}$ e pasurisë i takon bashkëshortit, kurse babai dhe nëna marrin çdonjëri nga një çerek. Nëse ndonjëri nga prindërit ka vdekur atëherë çereku i takon bashkëshortit pasjetues të trashëgimlënësit. Nëse i ndjeri nuk ka pasardhës dhe as prindër atëherë gjithë pasuria përcillet tek bashkëshorti pasjetues.
- Nëse nuk ka prindër, atëherë vëllau dhe motra e trashëgimlënësit, apo pasardhësit e tyre marrin $\frac{1}{2}$ e pasurisë të përfshirë në trashëgimi që është marrë nga trashëgimlënësi prej parardhësve të ti/saj qoftë edhe si dhuratë. Të gjithë pasuritë tjera i takojnë bashkëshortit pasjetues.

- Kur trashëgimlënësi lë bashkëshortin/en dhe fëmijë, atëherë bashkëshorti/ja pasjetues mund të zgjedh mes mbajtjes së çerekut të pasurisë apo uzufuktit të të gjithë pasurisë ekzistuese kur të gjithë fëmijët kanë lindur nga të njëjtit prindër dhe mes marrjes së çerekut të pasurisë, në rast se një apo më shumë fëmijë nuk janë fëmijët (biologjik) të të dy bashkëshortëve (neni 757).

Nëse nuk ka fëmijë, gjithë pasuria mund të kalojë tek bashkëshorti pasjetues. Megjithatë, nëse prindërit e të vdekurit janë gjallë, ata mund të parashtrojnë kërkesë pronësore, për atë që ia kanë dhënë fëmijës së tyre të vdekur deri në limitin e një çereku të pasurisë për secilin prind që është gjallë. Nëse në pasurinë trashëgimore hyn edhe shtëpia e përbashkët, atëherë bashkëshorti pasjetues ka mundësi zgjedhjeje:

- të fitoj të drejtën e pronësisë në $\frac{1}{4}$ nga pasuria trashëgimore,
- të fitoj të drejtën e uzufuktit në gjithë pasurinë trashëgimore.

Nëse bashkëshorti pasjetues konkuron me prindërit e trashëgimlënësit, atëherë bashkëshorti fiton $\frac{1}{2}$ masës trashëgimore, nëse jeton vetëm njëri prind dhe nuk kanë pasardhës tjerë (vëllezër apo motra të trashëgimlënësit), bashkëshorti pasjetues trashëgon $\frac{3}{4}$ e të drejtës së pronësisë. Nëse në trashëgimi thirren vetëm bashkëshorti pasjetues dhe vëllezërit/motrat e trashëgimlënësit, atëherë bashkëshorti e trashëgon tërë masën trashëgimore (Spiroviç – Trpenovska & Mickoviç & Ristov, 2011: 91).

Nëse trashëgimlënësi nuk ka fëmijë dhe as bashkëshort/e, atëherë pasuria kalon tek prindërit e të ndjerit, vëllezërit dhe motrat si dhe pasardhësit e këtyre të fundit (neni 734).

Austria - Sipas Kodit Civil Austriak (ABGB), nëse i ndjeri ska qenë i martuar dhe ska pasur fëmijë, masa trashëgimore i takon prindërve dhe pasardhësve tyre (nenet 735-736). Nëse i vdekuri lë fëmijë, pasuria ndahet në pjesë të barabarta mes fëmijëve. Nëse trashëgimlënësi nuk ka fëmijë dhe pas vete lë bashkëshorten/tin, atëherë bashkëshortit pasjetues i takon $\frac{2}{3}$ e pasurisë, kurse pjesa e mbetur kalon te prindërit, vëllezërit dhe motrat e të ndjerit.

Italia - Marrëdhëniet trashëgimore rregullohen me Kodin Civil. Trashëgimia fitohet në bazë të ligjit dhe testamentit. Në mungesë të testamentit aplikohen këto rregulla:

- Nëse i vdekuri nuk ka fëmijë dhe bashkëshort, atëherë trashëgojnë prindërit e trashëgimlënësit dhe pasardhësit e tyre d.m.th. vëllezërit/motrat e trashëgimlënësit (neni 571).
- Nëse i vdekuri nuk ka bashkëshort por ka fëmijë atëherë fëmijët e trashëgojnë gjithë pasurisë trashëgimore (neni 566).
- Nëse trashëgimlënësi nuk ka fëmijë (pasardhës të tyre), dhe as prindër (dhe pasardhës të tyre), por ka lënë bashkëshort, atëherë bashkëshorti pasjetues do të trashëgojë gjithë pasurinë trashëgimore (neni 583).
- Nëse ka lënë pasardhës dhe bashkëshort/e, atëherë bashkëshorti pasjetues trashëgon deri në $\frac{1}{2}$ e pasurisë nëse konkuron me një fëmijë, kurse $\frac{1}{3}$ nëse konkuron me dy ose më shumë fëmijë (neni 581).
- Në qoftë se trashëgimlënësi nuk ka fëmijë, por ka bashkëshort/e, prindëri dhe pasardhës të tyre, atëherë $\frac{2}{3}$ e masës trashëgimore e trashëgon bashkëshorti/ja, kurse $\frac{1}{3}$ prindërit (neni 579).

Bashkëshorti/ja gëzon të drejtën e jetesës në shtëpinë bashkëshortore si dhe të drejtën e shfrytëzimit të amvisërisë, që kanë qenë në pronësi të trashëgimlënësit apo në pronësi të përbashkët (Trpenovska- Spiroviç & Mickoviç & Ristov, 2011: 101).

Nëse asnjëri prej tyre nuk është gjallë, atëherë pasuria trashëgimore i kalon të afërmeve tjerë nga shkalla më e afërt e deri tek shkalla e gjashtë. Në mungesë të trashëgimtarëve të rradhës së gjashtë, trashëgimia i kalon shtetit (Galgano, 2006: 993).

5.2 Trashëgimia e femrës në pronë sipas të drejtës së BE-se

BE, kërkon ratifikimin e Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) si kusht për anëtarësim në BE. KEDNJ dhe Protokollet ndalojnë diskriminimin (neni14) ndër të tjera garantojnë drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 8).

Neni 1 i Protokollit nr. 12 të KEDNJ- ndalon diskriminimin nga autoritetet publike. Neni 1 i Protokollit nr. 1 garanton posedimin e papenguar si dhe ndalon privimin nga posedime përveçse në rastet për interes publik.

Kontribut në çështjet e trashëgimisë ka edhe Traktati për Funksonimin e Bashkimit Evropian (TFBE), i cili jep udhëzime në lidhje me parimet specifike në fushën e trashëgimisë:

- a) E drejta komunitare ndalon diskriminimin në bazë të shtetësisë (neni 12 i TFBE);
- b) Neni 21 lufton diskriminimin për shkak të: gjinisë, racës, përkatësisë etnike ose fetare, aftësisë së kufizuar, orientimi seksual, mosha etj;
- c) Nenet 81 - 81 (2) bëjnë thirrje për bashkëpunim gjyqësor në marrëdhëniet civile me implikime ndërkufitare.

Në vitin 1972, Këshilli i Evropës miratoi Konventën e Bazelit mbi Krijimin e Skemës së Regjistrimit të Testamenteve: Konventa parasheh ngritjen e një skeme regjistrimi që lehtëson dhe thjeshtëson gjetjen e testamentit menjëherë pas vdekjes së testatorit në veçanti të testamenteve të bëra jashtë vendit. Konventën e Bazelit mbi Krijimin e Skemës së Regjistrimit të Testamenteve parasheh caktimin e një organi të vetëm kombëtar për kryerjen e regjistrimit të cilit i besohet detyra e aranzhimit të regjistrimit jashtë vendit pa qenë nevoja për të shkuar përmes kanaleve diplomatike.

Instituti Ndërkombëtar për Unifikimin e së Drejtës Private (UNIDROIT) ka punuar në Konventën për Përcaktimin e një Ligji Uniform për Formën e Testamentit Ndërkombëtar, për ta krijuar një testament ndërkombëtar me qëllim të eliminimit të nevojës për t'iu përmbajtur ligjeve të shteteve kontraktuese për përpilimin e testamentit. Kjo Konventë jep zgjidhje për problemin me konfliktet e ligjeve që zbatohen për testamentet dhe ekzekutimin e tyre në shtete të ndryshme. Testamenti është i vlefshëm pavarësisht vendit ku është bërë , pavarësisht shtetësisë, vendbanimit apo vendqëndrimit së testatorit. Testamenti ndërkombëtar është i vlefshëm edhe në shtete të tjera që nuk janë palë nënshkruese të kësaj Konvente (Projekt i financuar nga BE, 2015: 8-9).

5.3 Rregullorja e Bashkimit Evropian për trashëgimi (BE) Nr. 650/2012

Rregullorja Nr.650/2012, është ndër instrumentet kryesor në të drejtën ndërkombëtare private. Në mënyrë të njëjtrajtshme rregullon institutin e trashëgimisë në të gjithë vendet e Bashkimit Evropian (me përjashtim të Irlandës Danimarkës dhe Mbretërisë së Bashkuar) (Vorpsi, 2017).

Ky instrument rregullon marrëdhëniet trashëgimore me element të huaj: lehtëson procedurat trashëgimore, ofron siguri juridike në marrëdhëniet trashëgimor me karakter ndërkufitar si dhe rregullon njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, pranimin dhe ekzekutimin e instrumenteve autentike dhe marrëveshjeve gjyqësore.

Standardet kryesore të saj janë:

- Respektimi i parimi të "pjesës së rezervuar", që nënkupton se një pjesë e masës trashëgimore patjetër duhet të rezervohet për familjarët më të afërt të të vdekurit kurse testatori gjatë përpilimit të testamentit duhet t'i nënshtrohet këtyre kufizimeve;
- Mundësia e organizmit paraprak të suksedimit (pika 7 , Preambula e Rregullores nr. 650/2012);
- Garantimi i drejtave të trashëgimtarëve dhe/ose legatarëve, kreditorëve si dhe të personave të tjerë të afërt me trashëgimlënësin (pika 7 e Preambulës së Rregullores nr. 650/2012);
- Gjatë përcaktimit të pasurisë trashëgimore të të vdekurit, autoritetet që merren me një suksedim të caktuar, duhet të marrin parasysh likuidimin e regjimit të pasurisë martesore ose të regjimit të ngjashëm pasuror të të vdekurit dhe pjesët përkatëse të përfituesve (pika12 e Preambulës së Rregullores nr. 650/2012);
- disponimet testamentare me shkrim në rast vdekje duhet të jenë në pajtim me ato të Konventës së Hagës të 5 tetorit 1961 mbi konfliktet e ligjeve në lidhje me formën e disponimeve testamentare (pika 52 e Preambulës së Rregullores nr. 650/2012).
- pengesat ndaj lëvizjes së lirë të personave të cilat rrjedhin nga dallimet mes rregullave të shteteve anëtare për suksedimet trashëgimore ndërkombëtare duhet të eliminohen;
- të sigurohet dhe respektohet ushtrimi i plotë i së drejtës private në pronë.

Suksesi i Rregullores ishte krijimi i të ashtuquajturës “Çertifikata evropiane e trashëgimisë” që përbën një akt të vetëm, i njëjtë dhe i aplikueshëm menjëherë për të gjithë shtetet anëtare të BE-së.

5.4 Ndalimi i diskriminimit në trashëgiminë pronësore: Praktika e GJED, GJEDNJ dhe praktikat e gjykatave kombëtare

Rastet gjyqësore nga praktika e GJED, GJEDNJ

Marckx kundër Belgjikës 13 qershor 1979 (kërkesa nr. 6833/74).

Nëna belge e pamartuar dhe bija e saj nuk janë trajtuar njëjtë me nënat e martuara dhe fëmijët e tyre. Ajo duhej që ta njihte formalisht fëmijën e saj (ose të paktën të fillonte procedurë ligjore) për ta përcaktuar lidhjen amësore, derisa nënat e martuara mund të mbështeteshin vetëm në Çertifikatën e lindjes. Ky detyrim e kufizonte që t’i japë apo t’i dhurojë pronë fëmijës. Vetëm duke u martuar dhe duke ndjekur një proces legjitimimi, ajo do të siguronte për të bijën të njëjtat të drejta si një fëmijë i ligjshëm.

Gjykata konstatoi shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe një shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit).

Camp dhe Bourimi kundër Holandës (3 tetor 2000) (Kërkesa nr.. 28369/95)

Nëna e pamartuara dhe djali i saj (fëmijë jashtmartesor) duhej ta lironin shtëpinë bashkëshortore pasi që partneri i nënës kishte vdekur para se të martoheshin dhe para se të njihte fëmijën si të tijin, ndërsa nuk kishte as testament.

Sipas ligjit holandez të asaj kohe, pronën e trashëguan prindërit, vëllezërit dhe motrat e të ndjerit. Ata u shpërngulën në shtëpinë e tij. Kur fëmija u shpall legjitim nuk konsiderohej trashëgimtar i të atit pasi që vendimi gjyqësor nuk ishte retroaktiv.

Gjykata në Holandë vërrejti se marrëdhënia familjare me të atin nuk ishte vendosur ligjërisht deri dy vjet pas lindjes së fëmijës prandaj fëmija nuk mund ta trashëgonte pasurinë e të atit. Duke pasur parasysh se vdekja e papritur pengoi lidhjen e martesës dhe si pasojë

mosnjohjen e fëmijës, GjED nuk i pranoi argumentet e qeverisë holandeze dhe e vlerësoi përjashtimin e fëmijës nga trashëgimia e të atit si joproporcional. GjED, konstatoi shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) dhe nenit 8 (e drejta e respektimit të jetës familjare) të Konventës.

Inze v. Austrisë , 28 tetor 1987 (Inze v. Austria (1987) 10 EHRR 394)

Paditësi nuk mund të trashëgonte fermën e nënës së tij, sepse ishte fëmijë jashtëmartesorë, kurse nëna kishte vdekur pa lënë testament. Paditësi kishte punuar në fermë deri në moshën 23 vjeç, por vetëm gjysmë-vëllai i tij më i vogël kishte trashëguar të gjithë fermën. GjED, konstatoi shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit).

Mazurek v. Francë, 1 shkurt 2000 (Mazurek vs France (2006) 42 EHRR 9)

Paditësi i lindur nga një marrëdhënie jashtëmartesore, nuk kishte të drejtë për të trashëguar. Ai u ndëshkua gjatë ndarjen së pasurisë pasi që ishte fëmija i një bashkimi që ka shkelur kurorën. Gjykata konstatoi shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës në lidhje me nenin 1 të protokollit nr.1 (e drejta për gëzimin paqësor të pronës së) të Konventës.

Apostolidi & të tjerë kundër Turqisë (27 mars 2007) (Kërkesa nr. 45628/99).

Çështja ka të bëjë me pengimin e pronës së trashëguar jashtë vendit për shkak të mungesës së reciprocitetit. Pesë shtetas grekë jetonin në Greqi, kurse halla e tyre me nënshtetësi turke vdiq në vitin 1984, duke lënë apartament në Turqi të regjistruar në emrin e saj.

Gjykata turke regjistroi tokën në emër të një fondacioni. Pasi morën Çertifikatën e trashëgimisë, parashtruesit e regjistruan apartamentin në emrin e tyre në regjistrin e tokave. Duke u bazuar në këtë Çertifikatë ata kërkuan edhe titullin e pronësisë mbi tokën. Gjykatat turke konstatoi që ata mund ta trashëgonin pronën vetëm nëse shtetasit turq e gëzonin të njëjtën të drejtë në Greqi. Meqenëse kusht i reciprocitetit nuk ishte përmbushur trashëgimtarët grek nuk kishin zotësinë për ta trashëguar tokën që pretendonin se ishte e tyre, me këtë rast u anulua titulli i pronësisë mbi apartamentin, por mbi bazën e Çertifikatës së trashëgimisë që

dëshmon marrëdhënien familjare me të trashëgimlënësin, ai u regjistrua në emrin e trashëgimtarëve.

Përkundër konstatimit të gjykatës turke se kushti i reciprocitetit nuk ishte përmbushur në Greqi, nuk u dëshmua nëse në Greqi ekzistonte ndonjë ndalesë për shtetasit turk që të fitonin pasuri përmes trashëgimit. GJED, konstatoi shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 (mbrojtja e pronës), për shkak të anulimit të certifikatës së trashëgimisë të parashtruesve, dhe të nenit 6 (e drejta për një proces të rregullt), për shkak të kohëzgjatjes së tepërt të proceduarve përpara gjykatave vendore.

**Merger dhe Cross v Francë (22 dhjetor 2004) Juridiksioni i Gjykatës Europiane të të
Drejtave të Njeriut (Application no. 68864/01) ECHR**

Çështja ka të bëjë me dallimi midis fëmijëve martesor dhe jashtëmartesorë. Ankuesi ishte trajtuar ndryshe në ndarjen e pasurisë për shkak të pozitës së saj si një fëmijë i paligjshëm.

GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 8 mbi bazën që sillte diskriminim bazuar në lindjen jashtë martese.

5.5 Vështrim i shkurtër i kapitullit të pestë

Në kapitullin e pestë trajtohet:

- barazia gjinore për trashëgiminë e pronës në vendet e Evropës Perëndimore si: Gjermania, Austria, Franca, Italia;
- trashëgimia e femrës sipas të drejtës së BE-së;
- rregullorja e BE-së për trashëgimi nr. 650/2012 dhe
- raste gjyqësore nga fusha e trashëgimisë, raste të gjykuara nga praktika gjyqësore e GJED dhe GJEDNJ.

Nga shqyrtimi i marrëdhënieve trashëgimore sipas praktikave më të mira evropiane del në pah:

- Aplikimi i kontratës së trashëgimisë, si bazë juridike për fitimin e trashëgimisë krahas testamentit dhe ligjit;
- Likuidimi i regjimit të pasurisë martesore ose të regjimit të ngjashëm pasuror të të vdekurit para ndarjes së pasurisë trashëgimore;
- Rezervimi i një pjese të masës trashëgimore për familjarët më të afërt të të vdekurit;
- Kufizimi i testatori gjatë përpilimit të testamentit (duhet patjetër të rezervojë një pjesë të masës trashëgimore për anëtarët më të afërt);
- Mundësia e organizmit paraprak të suksedimit;
- Garantimi i drejtave të trashëgimtarëve dhe/ose legatarëve, kreditorëve si dhe të personave të tjerë të afërt me trashëgimlënësin;
- Garantim dhe respektim i plotë i së drejtës private në pronë.

Duke pasur parasysh praktikat ndërkombëtare në fushën e trashëgimisë si dhe suksesin e këtyre vendeve në sigurimin barazisë gjinore, vlerësojmë se të njëjta duhet të pranohen dhe zbatohen edhe në sistemin ligjorë të RMV-së por dhe në vendet tjera të analizuara në punim.

KAPITULLI VI: Pjesa empirike (Diskutim)

6.1 Instrumentet e hulumtimit

Mbledhja e të dhënave primare është realizuar me ndihmën e disa instrumenteve të hulumtimit si:

- *Pyetësori (i strukturuar) me pyetje për noterë/ pyetësori (i strukturuar) me pyetje për gjykatës dhe avokatë të lëndëve civile* (pronësore - trashëgimore).
- *Anketa me qytetarët:* veçmas me qytetarët meshkuj dhe veçmas me qytetarët femra.
- *Intervistë (e gjysmëstrukturuar)* me noterë dhe avokatë të lëndëve civile dhe
- *Intervista (e pastrukturuar)* me disa qytetarë të RMV-së (meshkuj dhe femra).

Tabela 8. Pyetjet kërkimore dhe instrumentet e hulumtimit

Pyetjet e hulumtimit	Instrumentet e hulumtimit
1. Në praktikën aktuale, a disponojnë femrat të drejtën për trashëgimi në pronën familjare?	Pyetësor për noterë Anketa me qytetarë
2. Cilët faktorë pengojnë trashëgimtarin femër të disponojë me të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare?	Pyetësorë për noterë Anketa me qytetarë
3. A dallon praktika aktuale trashëgimore krahasuar me praktikën zakonore dhe praktikën tjera që kanë egzistuar para hyrjes në fuqi të Ligjit mbi Trashëgiminë dhe akteve tjera juridike përmes së cilëve garantohet barazi dhe mosdiskriminim gjinor?	Pyetësor me noterë Intervista me avokatë/noterë Anketa me qytetarë Intervista me noterë
4. Cilat janë trendet aktuale të ndarjes së pasurisë trashëgimore?	Pyetësor me noterë Anketa me qytetarë
5. Cilët nga trashëgimtarët (meshkuj apo femra) të shënuar në Aktvdekje më shpesh disponojnë të drejtën e trashëgimisë në pronën familjare?	Pyetësorë me noterë Intervista me noterë/avokatë
6. Cilët nga trashëgimtarët (meshkuj apo femra) të shënuar në Aktvdekje më shpesh heqin dorë nga trashëgimia në pronën familjare?	Pyetësorë me noterë Intervista me noterë/avokatë
7. Cila bazë juridike e thirrjes në trashëgimi dominon në praktikën aktuale në RMV?	Pyetësorë me noterë
8. Çka mund të kontribuoj në avancimin e barazisë gjinore në trashëgiminë familjare?	Pyetësorë me noterë/avokatë Intervista me noterë/avokatë
9. Cila nga aktet noteriale për ndarje të pasurisë zbatohen më shpesh në praktikën aktuale?	Pyetësorë për noterë Intervista me noterë/avokatë
10. Sa ndikon roli i Noterit në mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtës trashëgimore në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminues?	Pyetësorë për noterë
11. Si ndikon në cilësinë e jetës së një femre, mospjesmarrja e saj në pjesën ligjore të trashëgimisë?	Anketa me qytetarë
12. Si është ndarë pasuria trashëgimore mes trashëgimtarëve ligjorë	Intervistë me qytetarë

6.2.Kampioni dhe mostra

Në hulumtim marrin pjesë qytetarë të rastësishëm (kampion i pa qëllimshëm), por edhe profesionist ligjorë që kanë për detyrë të ushtrojnë drejtësinë si: noterë, avokatë dhe gjykatës të lëndëve civile (pronësore- trashëgimore), përzgjedhja e të cilëve është e qëllimshme (kampion i qëllimshëm). Në hulumtim kanë marrë pjesë gjithsejt 1295 qytetarë të RMV si:

- 20 noterë;
- 10 avokatë të lëndëve civile (pronësore-trashëgimore);
- 5 gjykatës të lëndëve civile (pronësore-trashëgimore);
- 1260 qytetarë të RMV-së:
 - 630 qytetarë femra shtetase të RMV-së;
 - 630 qytetarë meshkuj shtetas të RMV-së

6.3.Procedura e realizimit të pyetësorit

Me qëllim që të fitojmë informacione më të thelluara dhe më të detajuara në lidhje me këtë tematikë, janë formuluar 4 lloje të pyetësorëve:

- Pyetësori për noterë- me pyetje dedikuar noterëve,
- Pyetësori për avokatë dhe gjykatës të lëndëve civile,
- Pyetësori për qytetarët e RMV-së: veçmas pyetësor për femra dhe veçmas për meshkuj.


Pyetësori për noterë ka formë të strukturuar, përmban 30 pyetje dhe çdonjëra nga pyetjet përmban 2-4 opzione të mundshme të përgjigjes. Pyetjet kanë të bëjnë kryesisht me rolin dhe ndikimin e noterit në çështjet e trashëgimisë, qëndrimet dhe vlerësimet e tyre për këtë tematikë. Pyetësori është përpiluar dhe shpërndarë në dy gjuhë: në gjuhën shqipe dhe në gjuhën maqedonase. Pyetësori është shpërndarë drejtpërsëdrejti në lokalet e noterisë në qytetet: Shkup, Tetovë dhe Gostivar, kurse në lokalet e noterisë të qyteteve tjera të RMV –së, është shpërndarë nëpërmjet e-mail-it (pyetësori elektronik). Procedura e shpërndarjes së pyetësorëve dhe mbledhjes së të dhënave ka zgjatur 3 muaj, kryesisht gjatë muajve shtator-nëntorë të vitit 2020.

Pyetësi për avokatë/gjykatës ka formë të strukturuar, është përpiluar në dy gjuhë: shqip dhe maqedonisht. Pyetësi përmban 10 pyetje dhe çdonjëra nga pyetjet ka 2-4 alternativa të mundshme të përgjigjeve. Përmes pyetjeve tentohet të kuptohet shpeshësia e inicimit të rasteve kontestuese mes trashëgimtarëve, ne veçanti mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit. Pyetësi për avokatë/gjykatës është shprëndarë drejtpërsëdrejti në zyrën ku ata punojnë, por edhe nëpërmjet e-mailit me ndihmën e pyetësorit elektronik. Procedura e shprëndarjes së pyetësorëve dhe mbledhjes së të dhënave nga avokatët dhe gjykatësit e lëndëve civile që veprojnë në RMV, ka zgjatur 3 muaj, duke filluar nga fundi i muajit gusht e deri në fillim të muajit nëntor të vitit 2020.

Për nevojat e punimit, është realizuar edhe anketa me qytetarët e RMV-së, me tendencë që të kuptojmë edhe qëndrimet dhe mendimet e qytetarëve në lidhje me temën e trajtuar. Janë formuluar 2 forma të pyetësorëve: pyetësi me pyetje dedikuar qytetarëve femra dhe pyetësi për qytetarët meshkuj. Pyetësorët janë përpiluar në gjuhën shqipe dhe maqedonase, kanë formë të strukturuar, në përgjithësi përmbajnë pyetje të njëjta por në këndvështrim të ndryshëm gjinor.

Përmes anketës me qytetarët e RMV-së synojmë të nxjerrim informacione nga këndvështrimi gjinor. Pyetësi përmban gjithsej 28 pyetje dhe është i ndarë në dy pjesë. Në 8 pyetjet e pjesës së parë mblidhen informacione të përgjithshme rreth pjesmarrësve në hulumtim si: mosha, vendbanimi, niveli i arsimimit, statusi socio-ekonomik, perkatësia fetare dhe nacionale. Në pjesën e dytë përmbledhen 20 pyetjet që kanë të bëjnë me njohuritë, qëndrimet dhe vlerësimet e qytetarëve të RMV-së për të drejtën e femrës për trashëgimi në pronën familjare. Anketa me qytetarë është realizuar në qytete të ndryshme të RMV-së, në vendet më të frekuentuara nga qytetarët si: komuna, spitale, qendra tregtare etj. 500 pyetësorë janë shprëndarë në Shkup, 240 në Tetovë, 100 në Gostivar, 60 në Kumanovë, 60 në Dibër, 80 në Strugë, 60 në Prilep, 60 në Manastir, 60 në Koçan dhe 40 në Kërçovë. Më poshtë është dhënë grafiku që shpreh me përqindje komunat e RMV-së në të cilat është realizuar anketa me qytetarët meshkuj dhe femra.

Grafiku 1. Komunitat e RMV-së në të cilët është realizuar anketa me qytetarët e RMV-së



6.4. Analiza e të dhënave nga anketa me qytetarët e RMV-së

6.4.1. Analiza e të dhënave demografike të nxjerra nga anketa me qytetarët e RMV-së

Për nevojat e hulumtimit janë anketuar 1260 qytetarë të RMV-së. Të anketuarit kanë status socio ekonomik të ndryshëm. 12% e të anketuarve janë të moshës 18-25 vjet, 32% e të anketuarve janë të moshës 26-35 vjet, 42% janë të moshës 46-55 vjet dhe 3% e të anketuarve janë mbi 56 vjec. Të anketuarit vijnë nga zona urbane të ndryshme. 78% e tyre jetojnë në qytet dhe 22% nga ta jetojnë në fshat. Të anketuarit kanë nivel të ndryshëm të arsimit. 6% e të anketuarve kanë përfunduar vetëm shkollën fillore, 21% e të anketuarve kanë përfunduar shkollën e mesme, 56% e të anketuarve kanë kryer arsimin universitar ndërsa 17% e të anketuarve kanë kryer arsimimin pasuniversitar. Të anketuarit kanë status martesor të ndryshëm. Kështu, 14% e të anketuarëve janë të pamartuar, 82% janë të martuar, asnjëri nga të anketuarit nuk është i divorcuar, kurse 4% e të anketuarve janë të ve. Të anketuarit kanë status të ndryshëm ekonomik. 70% nga ta janë të punësuar dhe 30% të papunësuar. Pjesëmarrësit në hulumtim janë të nacionaliteteve të ndryshme, 39% i përkasin nacionalitetit shqiptar, 59% nacionalitetit maqedonas dhe 2% nacionalitetit turk. Të anketuarit i përkasin besimeve fetare të ndryshme. Kështu, 41% nga ta i përkasin besimit fetar islam dhe 59% besimit fetar krishter.

Meqenëse anketa është realizuar veçmas me secilën gjini, do të analizojmë edhe të dhënat demografike për secilën gjini veçmas.

Në hulumtim kanë marrë pjesë 630 qytetarë meshkuj. 127 apo 20% nga ta i përkasin moshës 18-25 vjet, 178 apo 28% janë të moshës 26-35 vjet, 274 ose 44% kanë moshë ndërmjet 36-45 vjet, 44 ose 7% kanë moshë 46-55 vjet dhe 7 meshkuj ose 1% e pjesëmarrësve meshkuj kanë moshë mbi 56 vjet. Qytetarët meshkuj jetojnë në zona urbane të ndryshme. Kështu 417 ose 66% nga të anketuarit jetojnë në qytet, kurse 213 ose 34% nga ta jetojnë në fshat. Të anketuarit kanë shkallë të ndryshme të arsimimit. 28 apo 4% qytetarë meshkuj të anketuar kanë kryer vetëm shkollën fillore, 173 apo 27% kanë kryer shkollën e mesme, 331 apo 53% kanë diplomë universitare kurse 98 ose 16% nga të anketuarit meshkuj kanë diplomë pasuniversitare. Të anketuarit meshkuj kanë status të ndryshëm martesor, 97 apo 15% nga ta janë të pamartuar, 527 apo 84% janë të martuar, asnjëri nga të anketuarit nuk është i divorcuar, kurse 6 ose 1% nga të anketuarit meshkuj janë të ve. Të anketuarit meshkuj kanë status ekonomik të ndryshëm. 522 ose 83% nga ta janë të punësuar, kurse 108 ose 17% nuk janë të punësuar. Të anketuarit meshkuj kanë përkatësi etnike të ndryshme. Kështu, 243 ose 39% janë qytetarë shqiptarë, 372 ose 59% janë qytetarë maqedonas dhe 15 ose 2% nga të anketuarit meshkuj kanë përkatësi etnike turke. Të anketuarit meshkuj kanë përkatësi të ndryshme fetare. 258 apo 51% nga ta i përkasin besimit fetar islam dhe 372 apo 59% nga të anketuarit meshkuj i përkasin besimit fetar krishter.

Për nevojat e hulumtimit është shprehëndarë edhe pyetësorë për femra, të cilën e kanë plotësuar 630 femra. Qytetaret femra i përkasin gropmoshave të ndryshme. Kështu, 86 apo 14% janë të moshës 18-25 vjet, 203 ose 32% nga të anketuarit femra janë të moshës 26-35 vjet, 217 ose 34% kanë moshë ndërmjet 36-45 vjet, 92 ose 15% kanë moshë mes 46-55 vjet dhe 32 ose 5% nga të anketuarit femra kanë moshë mbi 56 vjet. Qytetarët femra jetojnë në zona të ndryshme urbane. Kështu 398 ose 63% jetojnë në qytet dhe 232 ose 37% jetojnë në fshat. Të anketuarit femra kanë nivel të ndryshëm të arsimimit. 42 ose 7% nga ta kanë përfunduar vetëm shkollën fillore, 97 apo 15% nga të anketuarit femra kanë përfunduar shkollën e mesme, 374 ose 59% kanë diplomë universitare kurse 117 ose 19% nga të anketuarit femra kanë diplomë pasuniversitare. Të anketuarit femra kanë status të ndryshëm socio ekonomik. Kështu, 84 ose

13% nga ta janë të pamartuara, 503 ose 80% janë të martuara, nuk ka asnjë të anketuar të divorcuar dhe 43 ose 7% janë të ve. 378 po 60% nga të anketuarit femra janë të papunësuar, kurse 252 apo 40% janë të punësuar. Të anketuarit femra kanë përkatësi të ndryshme nacionale, 243 ose 39% nga ta janë qytetarë shqiptarë, 372 ose 59% janë qytetarë maqedonas dhe 15 apo 2% janë qytetarë turk. Pjesmarrësit femra i përkasin besimeve të ndryshme fetare. 258 ose 41% janë musliman dhe 372 ose 59% i përkasin besimit fetar krishter. Të dhënat nga anketa janë përpunuar me ndihmën e programit kompjuterik Microsoft Office Excel. Në vazhdim me ndihmën e tabelës do të jepen të dhënat demografike për qytetarët e anketuar në RMV, të dhëna në total por edhe të dhëna demografike veçmas për secilën gjini.


Tabela.9 Të dhënat demografike të qytetarëve meshkuj dhe femra të përfshirë në anketë

Gjinia	Meshkuj		Femra		Gjithsej qytetarë	
Mosha	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja
18-25	127	20%	86	14%	213	12%
26-35	178	28%	203	32%	381	32%
36-45	274	44%	217	34%	491	42%
46-55	44	7%	92	15%	136	11%
Mbi 56	7	1%	32	5%	39	3%
Vendbanimi	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja
Qytet	417	66%	398	63%	815	78%
Fshat	213	34%	232	37%	445	22%
Niveli i arsimit	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja
Fillor	28	4%	42	7%	70	6%
I mesëm	173	27%	97	15%	270	21%
Universitar	331	53%	374	59%	705	56%
Pasuniversitar	98	16%	117	19%	215	17%
Statusi martesor	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja
i/e pamartuar	97	15%	84	13%	181	14%
i/e martuar	527	84%	503	80%	1030	82%
i/e divorcuar	/	/	/	/	/	/
i/e ve	6	1%	43	7%	49	4%
Statusi ekonomik	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja
I/e punësuar	522	83%	378	60%	900	70%
I/ e pa punësuar	108	17%	252	40%	360	30%
Përkatësia etnike	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja
Shqiptarë	243	39%	243	39%	486	39%
Maqedonas	372	59%	372	59%	744	59%
Turq	15	2%	15	2%	30	2%

Përkatësia fetare	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja
Musliman	258	41%	258	41%	516	41%
Krishterë	372	59%	372	59%	744	59%

6.4.2.Gjetjet dhe analiza e të dhënave nga anketa me qytetarët e RMV-së

Grafiku 2. Sa keni njohuri mbi të drejtën e trashëgimisë pronësore?



Siç shihet në grafikun 2 në pyetjen: “Sa keni njohuri mbi të drejtën e trashëgimisë pronësore?” shumica nga të anketuarit meshkuj (413 ose 66%) mendojnë se kanë shumë njohuri për të drejtën e trashëgimisë pronësore, 178 ose 28% e të anketuar meshkuj mendojnë se kanë njohuri të mjaftueshme mbi këtë tematik, 39 ose 6% mendojnë se kanë pak njohuri mbi të drejtën e trashëgimisë në pronën familjare.

Në grafikun 2 vërrejmë se 234 ose 37% nga të anketuarit femra mendojnë se kanë shumë njohuri mbi të drejtën e trashëgimisë pronësore, 279 ose 44% nga ta mendojnë se kanë njohuri të mjaftueshme në lidhje me të drejtën në trashëgiminë pronësore familjare, 69 ose 11% nga të anketuarit femra kanë pak njohuri mbi këtë tematike, kurse 48 ose 8% nga ta mendojnë se nuk kanë aspak njohuri mbi këtë tematikë.

Pyetjes së grafikut 2 i janë përgjigjur qytetarë të nacionaliteteve të ndryshme që jetojnë në Maqedoninë e Veriut. Kështu, shumica nga qytetarët maqedonas , gjegjësisht 417 ose 56 % mendojnë se kanë shumë njohuri për të drejtën e trashëgimisë pronësore. 284 ose 38% nga ta mendojnë se se kanë njohuri të mjaftueshme në lidhje me të drejtën në trashëgiminë

pronesore familjare, 33 ose 5% të anketuar të përkatësisë nacionale maqedonase mendojnë se kanë pak njohuri mbi këtë tematikë, kurse 10 ose 1% mendojnë se nuk kanë aspak njohuri mbi këtë tematikë.


Në anketë kanë marrë pjesë gjithsej 486 qytetarë të përkatësisë etnike shqipëtare, nga ta 218 ose 45% mendojnë se kanë shumë njohuri për të drejtën e trashëgimisë pronësore, 165 ose 34% mendojnë se se kanë njohuri të mjaftueshme në lidhje me të drejtën në trashëgiminë pronësore familjare, 65 ose 13% mendojnë se kanë pak njohuri mbi këtë tematikë, kurse 38 ose 5% mendojnë se nuk kanë aspak njohuri mbi këtë tematikë.

Në anketë kanë marrë pjesë edhe 30 qytetarë turq, shtetas të RMV-së, nga ta 12 ose 40% mendojnë se kanë shumë njohuri për të drejtën e trashëgimisë pronësore, 8 ose 27% mendojnë se se kanë njohuri të mjaftueshme në lidhje me të drejtën në trashëgiminë pronësore familjare, 10 ose 33% mendojnë se kanë pak njohuri mbi këtë tematikë.

Në përgjithësi nga 1260 të anketuar, shumica nga ta gjegjësisht 647 ose 51 % mendojnë se kanë shumë njohuri mbi të drejtën e trashëgimisë në pronën familjare. 457 ose 36% kanë njohuri të mjaftueshme, 108 ose 9% kanë pak njohuri dhe vetëm 48 ose 4% nga të anketuarit janë shprehur se nuk kanë aspak njohuri mbi të drejtën e trashëgimisë në pronën familjare.

Duke u bazuar në rezultatet e dhëna në grafikun 2, mund të përfundojmë se në përgjithësi qytetarët në RMV nga aspekti nacional por edhe ai gjinorë kanë njohuri mbi të drejtën e trashëgimisë në pronën familjare. Nga këndvështrimi gjinor, vërrejmë që shumica nga qytetarët meshkuj deklarohen se kanë shumë njohuri mbi tematikën e trajtuar, kurse të anketuarit femra deklarohen se kanë njohuri të mjaftueshme mbi këtë tematikë.

Grafiku 3. A mendoni se trashëgimtarët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë pa dallim gjinor?



Nga rezultatet e paraqitura në grafikun 3 shohim se shumica nga qytetarët e anketuar, përkatësisht 789 ose 63% mendojnë se trashëgimtarët ligjorë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë duke mos bërë dallime në baza të gjinisë. 272 ose 21% nga të anketuarit mendojnë se duhet të bëhen dallime në bazë të gjinisë mes trashëgimtarëve, kurse 199 ose 16% nga të anketuarit nuk kanë përgjigje.

Nga grafiku 3, vërrejmë se shumica nga 630 qytetarë meshkuj pjesmarrës në hulumtim, (417 ose 66 %) mendojnë se të gjithë trashëgimtarët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë pa dallim gjinor. 168 ose 27% mendojnë se trashëgimtarët nuk duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë pa dallim gjinor, kurse 45 ose 7% e qytetarëve nuk kanë përgjigje.

Nga rezultatet e grafikut 3, shohim se shumica nga të anketuarit femra 372 ose 59 % mendojnë se trashëgimtarët ligjorë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë pa dallim gjinor, 104 ose 17 % nga ta nuk mendojnë se trashëgimtarët duhet të trajtohen barabar pa dallim gjinor, kurse 154 ose 24% e të anketuarve femra nuk kanë përgjigje në lidhje me këtë pyetje të parashtruara në pyetësor.

Sipas të dhënave të paraqitura në grafikun 3. shohim që nga 486 qytetarë shqipëtarë pjesmarrës në hulumtim, shumica nga ta përkatësisht 212 ose 44% mendojnë se trashëgimtarët ligjorë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë duke mos bërë dallime në baza të gjinisë. 168 ose 34 % nga të anketuarit mendojnë se duhet të bëhen dallime në bazë të gjinisë mes trashëgimtarëve, kurse 106 ose 22% pjesmarrës shqipëtarë nuk kanë përgjigje.


Nga 744 qytetarë të përkatësisë nacionale maqedonase shumica nga ta përkatësisht 553 ose 74% mendojnë se trashëgimtarët ligjorë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë duke

mos bërë dallime në baza të gjinisë, 98 ose 13% të aketuar maqedonas mendojnë se duhet të bëhen dallime në bazë të gjinisë mes trashëgimtarëve dhe 93 ose 13% nga ta nuk kanë përgjigje.

Nga 30 pjesmarrës të përkatësisë etnike turke, 24 ose 80% mendojnë se trashëgimtarët ligjorë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë duke mos bërë dallime në baza të gjinisë kurse 8 ose 20% mendojnë se duhet të bëhen dallime në bazë të gjinisë mes trashëgimtarëve.

Duke analizuar të dhënat nga grafiku 3 mund të përfundojmë që në përgjithësi në aspektin nacional dhe gjinorë nuk ka dallime në mendim të qytetarët në RMV dhe nga numri i përgjithshëm i të anketuarve shumica mendojnë se trashëgimtarët ligjorë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë pa dallim gjinorë.

Grafiku 4. Sipas mendimit tuaj, kush duhet të trashëgojë pronësinë familjare?



Nga rezultatet e grafikut 4, shohim që shumica e të anketuarve, gjegjësisht 862 ose 68% mendojnë se pasurinë trashëgimore duhet të trashëgojnë të gjithë trashëgimtarët ligjorë pa dallim gjinor. 398 ose 32% mendojnë se duhet të trashëgojnë vetëm trashëgimtarët djem dhe asnjëri nga të anketuarit nuk mendon se duhet të trashëgojnë vetëm trashëgimtarët femra.

Nga 630 të anketuar qytetarë meshkuj, shumica nga ta, përkatësisht 437 ose 69% mendojnë se duhet të trashëgojnë të gjithë trashëgimtarët ligjorë pa dallim gjinor. 193 ose 31% mendojnë se duhet të trashëgojnë vetëm trashëgimtarët djem. Asnjëri nga ta nuk mendon se duhet të trashëgojnë vetëm femrat.

Nga 630 të anketuar femra, shumica nga ta, përkatësisht 425 ose 67% mendojnë se duhet të trashëgojnë të gjithë trashëgimtarët ligjorë pa dallim gjinor. Kurse 205 ose 33% nga të anketuarit femra mendojnë se duhet të trashëgojnë vetëm trashëgimtarë djem dhe asnjëra nga ta nuk mendon se duhet të trashëgojë vetëm trashëgimtari femër.


Nga 744 qytetarë të përkatësisë nacionale maqedonase, shumica nga ta përkatësisht 620 ose 83% mendojnë se duhet të trashëgojnë të gjithë trashëgimtarët ligjorë pa dallim gjinorë. 124 ose 17% mendojnë se duhet të trashëgojnë vetëm trashëgimtarë djem dhe asnjëri nga qytetarët maqedonas nuk mendon se duhet të trashëgojë vetëm trashëgimtari femër.

Në hulumtim kanë marrë pjesë 486 qytetarë të përkatësisë etnike shqipëtare, shumica nga ta gjegjësisht 268 ose 55% mendojnë se duhet të trashëgojnë të gjithë trashëgimtarët ligjorë pa dallim gjinorë, 218 ose 45% mendojnë se duhet të trashëgojnë vetëm trashëgimtarë djemtë dhe asnjëri nga qytetarët shqipëtarë nuk mendon se duhet të trashëgojë vetëm trashëgimtari femër.

Nga 30 qytetarë turk pjesmarrës në hulumtim shumica nga ta, 16 ose 53% mendojnë se duhet të trashëgojnë të gjithë trashëgimtarët ligjorë pa dallim gjinorë, kurse 14 ose 47 % mendojnë se duhet të trashëgojnë vetëm trashëgimtarë djemtë.

Bazuar në të dhënat nga grafiku 4, mund të përfundojmë që nga aspekti gjinor edhe nga ai nacional , në përgjithësi nga 1260 pjesmarrës në hulumtim, shumica mendojnë që pasuria trashëgimore duhet të ndahet mes të gjithë trashëgimtarëve ligjorë pa dallim gjinor.

Grafiku 5. Sipas mendimit tuaj, si duhet të ndahet pasuria trashëgimore mes djemve dhe vajzave të trashëgimtarëve?



Nga rezultatet e grafikut 5 vërrejmë që shumica nga qytetarët e anketuar, gjegjësisht 540 ose 43% mendojnë se pasuria trashëgimore duhet të ndahet në pjesë të barabartë mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit. 409 ose 32% mendojnë se pasuria trashëgimore duhet të ndahet mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit ashtuqë pjesa më e madhe e pasurisë i takon djalit kurse pjesa më e vogël i takon vajzës. 160 ose 13% nga qytetarët e anketuar mendojnë se pasuria trashëgimore duhet të ndahet vetëm mes djemve në pjesë të barabarta, kurse 151 ose 12% kanë mendim tjetër për ndarje të pasurisë trashëgimore mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit.

Shumica nga të anketuarit meshkuj, gjegjësisht 308 ose 49% mendojnë se pasuria trashëgimore duhet të ndahet mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit në pjesë të barabarta. 151 ose 24% mendojnë se pasuria trashëgimore duhet të ndahet mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit ashtuqë pjesa më e madhe e pasurisë i takon djalit kurse pjesa më e vogël i takon vajzës. 107 ose 17 % kanë mendim tjetër nga opcionet e parashtruara në pyetësorë, kurse 64 ose 10 % nga qytetarët e anketuar mendojnë se pasuria trashëgimore duhet të ndahet vetëm mes djemve në pjesë të barabarta.

Shumica nga të anketuarit femra, përkatësisht 258 ose 41% mendojnë se pasuria trashëgimore duhet të ndahet mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit ashtuqë pjesa më e madhe e pasurisë do t'i takon djalit kurse pjesa më e vogël i takon vajzës. 232 ose 37 % nga të anketuarit femra mendojnë se pasuria trashëgimore duhet të ndahet në pjesë të barabartë mes

djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit. 96 ose 15% nga të anketuarat femra mendojnë se pasuria trashëgimore duhet të ndahet vetëm mes djemve në pjesë të barabarta. Kurse vetëm 44 ose 7% nga të anketuarit femra ka mendim tjetër nga ai i shprehur në opcionet e përgjigjeve në anketë.

Nga 744 qytetarë maqedonas pjesmarrës në hulumtim, shumica nga ta përkatësisht 436 ose 59 % mendojnë se pasuria trashëgimore duhet të ndahet në pjesë të barabartë mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit. 148 ose 20% kanë mendim tjetër nga opcionet e parashtruara në pyetësorë. 92 ose 12% mendojnë se pasuria trashëgimore duhet të ndahet mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit ashtuqë pjesa më e madhe e pasurisë do t'i takon djalit kurse pjesa më e vogël i takon vajzës. Kurse, 68 ose 9% mendojnë se pasuria trashëgimore duhet të ndahet vetëm mes djemve në pjesë të barabarta.


Nga 486 qytetarë shiptarë pjesmarrës në hulumtim, shumica 298 ose 61% mendojnë se pasuria trashëgimore duhet të ndahet mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit ashtuqë pjesa më e madhe e pasurisë do t'i takon djalit kurse pjesa më e vogël i takon vajzës. 101 ose 21% mendojnë se pasuria trashëgimore duhet të ndahet në pjesë të barabartë mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit. 87 ose 18% mendojnë se pasuria trashëgimore duhet të ndahet vetëm mes djemve në pjesë të barabarta.

Nga 30 qytetarë turq pjesmarrës në hulumtim, shumica nga ta gjeëgjësisht, 19 ose 63% mendojnë se pasuria trashëgimore duhet të ndahet mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit ashtuqë pjesa më e madhe e pasurisë do t'i takon djalit kurse pjesa më e vogël i takon vajzës. 5 ose 10% mendojnë se pasuria trashëgimore duhet të ndahet vetëm mes djemve në pjesë të barabarta. 3 ose 10% mendojnë se pasuria trashëgimore duhet të ndahet në pjesë të barabartë mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit.

Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 5, vërrejmë që qytetarët meshkuj dhe femra kanë mendime të ndryshme në lidhje me pyetjen nga grafiku 5. Kështu, shumica nga qytetarët meshkuj mendojnë se pasuria trashëgimore duhet të ndahet në pjesë të barabartë mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit, ndërsa shumica nga të anketuarit femra mendojnë që pasuria trashëgimore duhet të ndahet mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit ashtuqë pjesa më e madhe e pasurisë do t'i takon djalit kurse pjesa më e vogël

i takon vajzës. Dallime vërrejmë edhe në aspektin nacional. Shumica nga të anketuarit e përkatësisë nacionale maqedonase mendojnë se pasuria trashëgimore duhet të ndahet në pjesë të barabartë mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit, kurse shumica nga të anketuarit e përkatësisë nacionale shqipëtare dhe turke mendojnë se pasuria trashëgimore duhet të ndahet mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit ashtuqë pjesa më e madhe e pasurisë do t'i takon djalit kurse pjesa më e vogël i takon vajzës

Grafiku 6. Sipas mendimit tuaj, vajza/motra juaj a duhet të trashëgojë sende të palëvizshme si shtëpi, tokë apo dyqan në rastë se konkurron në trashëgimi me vëllezërit e saj?



Nga rezultatet e paraqitura në grafikun 6. vërrejmë që në përgjithësi, nga numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në hulumtim, shumica nga ta, gjegjësisht 530 ose 42% mendojnë se vajza/ motra a do të trashëgojë sende të palëvizshme si: shtëpi, tokë apo dyqan në qoftë se

konkurron në trashëgimi së bashku me djemtë e trashëgimlënësit përkatësisht vëllezërit e saj varret nga kushtet ekonomike me të cilat ballafaqohen. 515 ose 41% nga qytetarët e anketuar mendojnë që vajza duhet të trashëgojë sende të palëvizshme nga prona e prindërve, kurse 215 ose 17 % mendojnë se vajza e trashëgimlënësit nuk duhet të trashëgojë sende të palëvizshme nga prona e prindërve.

Shumica nga të anketuarit meshkuj gjegjësisht 398 ose 55% mendojnë se vajza duhet të trashëgojë sende të palëvizshme nga prona e prindërve. 181 ose 25% mendojnë se se varret nga kushtet ekonomike, kurse 146 ose 20% mendojnë se vajza nuk duhet të trashëgojë sende të palëvizshme nga prona e prindërve të saj.

Shumica nga të anketuarit femra, përkatësisht 349 ose 65% mendojnë se mundësia e vajzës për të trashëguar sende të palëvizshme si: shtëpi, tokë apo dycan nga prona e prindërve varret nga kushtet ekonomike. 117 ose 22% mendojnë se vajza duhet të trashëgojë sende të palëvizshme nga prona e prindërve të saj. Kurse, 69 ose 13% nga të anketuarit femra mendojnë se vajza nuk duhet të trashëgojë sende të palëvizshme nga prona e prindërve të saj.


Nga 744 pjesmarrës të nacionalitetit maqedonas, shumica 403 ose 53% mendojnë se vajza duhet të trashëgojë sende të palëvizshme. 248 ose 33% mendojnë se kushtet ekonomike do të përcaktonin nëse vajza do të trashëgojë sende të palëvizshme nga pronësia e familjes së saj. 105 ose 33% mendojnë se vajza nuk duhet të trashëgojë sende të palëvizshme.

Nga 486 qytetarë shqopëtarë pjesmarrës në hulumtim, shumica nga ta 269 ose 55% mendojnë se mundësia e vajzës për të trashëguar sende të palëvizshme në rast se konkurron në trashëgimi me vëllezërit e saj varret nga kushtet ekonomike. 112 ose 23 % mendojnë se vajza duhet të trashëgojë sende të palëvizshme. 105 ose 22% mendojnë se vajza nuk duhet të trashëgojë sende të palëvizshme.

Nga 30 qytetarë pjesmarrës të përkatësisë etnike turke , shumica 13 ose 62% mendojnë se mundësia e vajzës për të trashëguar sende të palëvizshme në rast se konkurron në trashëgimi me vëllezërit e saj varret nga kushtet ekonomike. 5 ose 24% mendojnë se vajza duhet të trashëgojë sende të palëvizshme, kurse 3 ose 14% mendojnë vajza duhet të trashëgojë sende të palëvizshme.

Nëse krahasojmë mendimet e qytetarëve nga këndvështrimi gjinor dhe ai nacional, do të vërrejme diferencë statistikore. Kështu sipas të dhënave në grafikun 6. shohim që shumica nga qytetarët meshkuj mendojnë se vajza duhet të trashëgojë sende të palëvizshme edhe atëherë kur ajo konkurron në trashëgimi me vëllezërit e saj, ndërsa shumica e femrave pjesmarrëse në hulumtim mendojnë se kushtet ekonomike do të përcaktonin nëse ajo do të trashëgojë sende të palëvizshme nga pronësia e familjes së saj. Dallime vërrehen edhe në aspektin nacional. Kështu shumca nga qytetarët maqedonas mendojnë se vajza duhet të trashëgojë sende të palëvizshme, kurse nga ana tjetër shumica nga qytetarët e përkatësisë nacionale shqipëtare dhe turke mendojnë se kushtet ekonomike do të përcaktonin nëse vajza/motra do të trashëgojë sende të palëvizshme nga pronësia e familjes së origjinës.

Grafiku 7. Sipas mendimit tuaj, a duhet vajza/motra të trashëgojë sende të lëvizshme si: veturë, para, sende të çmueshme?



Në grafikun 7 vërrejme që nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, shumica përkatësisht 1160 ose 92% mendojnë se vajzat/ motrat e trashëgimlënësit duhet të trashëgojnë sende të lëvizshme si: veturë, para, sende të çmueshme. 100 ose 8% nga qytetarët

e anketuar mendojnë se vajza/motra nuk duhet të trashëgojë sende të lëvizshme si: veturë, para, sende të çmueshme.

Shumica nga të anketuarit meshkuj, përkatësisht 587 ose 93 % mendojnë se vajza/motra duhet të trashëgojë sende të lëvizshme si: veturë, para, sende të çmueshme. 43 ose 7% nga të anketuarit meshkuj mendojnë që vajza/motra e trashëgimlënësit nuk duhet të trashëgojë sende të lëvizshme si: para, veturë, sende të çmueshme.

Shumica nga të anketuarit femra 573 ose 91% mendojnë se vajza/motra duhet të trashëgojë sende të lëvizshme si : veturë, para, sende të çmueshme. 57 ose 9% mendojnë se vajza/ motra nuk duhet te trashegoje sende te levizshme.

Nga 744 qytetarë maqedonas, shumica përkatësisht 738 ose 99% mendojnë vajza/motra duhet të trashëgojë sende të lëvizshme, kurse vetëm 6 ose 1% mendojnë vajza/ motra nuk duhet të trashëgoje sende të lëvizshme.


Nga 486 qytetarë shqipëtar pjesmarrës në hulumtim, shumica përkatësisht 401 ose 83% mendojnë se vajza/motra duhet të trashëgojë sende të lëvizshme, kurse 85 ose 17 % mendojnë se vajza/motra nuk duhet të trashëgojë sende të lëvizshme.

Nga 30 qytetarë turk pjesmarrës në hulumtim, shumica nga ta 21 ose 70% mendojnë se vajza/motra duhet të trashëgojë sende të lëvizshme, kurse 9 ose 30% mendojnë se vajza/motra nuk duhet të trashëgojë sende të lëvizshme.

Analizuar nga këndvështrimi gjinor por edhe ai nacional, shumica nga numri i përgjithshëm i pjesmarrësve në hulumtim preferojnë që vajza/motra të trashëgojë sende të lëvizshme.

Grafiku 8. A do ta ndani pasurinë trashëgimore me motrat tuaja?(pyetje për qytetarët meshkuj)

A do të merrni pjesë në trashëgimi së bashku me vëllezërit tuaj? (pyetje për qytetarët femra)



Duke u bazuar në rezultatet nga grafiku 8, shohim që shumica e pjesëmarrësve në hulumtim, përkatësisht 586 ose 47% mendojnë të ndajnë pasurinë trashëgimore së bashku me motrat/vëllezërit. 252 ose 33% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve nuk duan të ndajnë apo të marrin pjesë në trashëgimi së bashku me motrat/ vëllezërit, kurse sipas 422 ose 20% nga të anketuarit varret nga kushtet ekonomike nëse ata do të ndanin pasurinë trashëgimore së bashku me motrat/vëllezërit.

Shumica nga të anketuarit meshkuj, gjegjësisht 318 ose 51% mendojnë se do të ndajnë pasurinë trashëgimore së bashku me motrat e tyre. 134 ose 21% nga të anketuarit nuk duan të ndajnë pasurinë trashëgimore me motrat e tyre dhe sipas 178 ose 28% nga të anketuarit meshkuj, varret nga kushtet ekonomike nëse ata do të ndanin pasurinë trashëgimore së bashku me motrat/vëllezërit.

Shumica nga të anketuarit femra, përkatësisht 268 ose 42% mendojnë se do të marrin pjesë në trashëgimi së bashku me vëllezërit e tyre, sipas 244 ose 39% varret nga kushtet ekonomike nëse do të ndanin pasurinë trashëgimore së bashku me motrat/vëllezërit, kurse 118 ose 19% nga të anketuarit femra nuk duan të marrin pjesë në trashëgimi së bashku me vëllezërit e tyre.

Shumica nga të anketuarit e përkatësisë etnike maqedonase respektivisht 481 ose 65% mendojnë të ndajnë pasurinë trashëgimore së bashku me motrat/vëllezërit. 160 ose 21% mendojnë se varret nga kushtet ekonomike nëse do të ndanin pasurinë trashëgimore së

bashku me motrat/vëllezërit, kurse 103 ose 14% nuk duan të marrin pjesë në trashëgimi së bashku me motrat/vëllezërit e tyre.


Shumica nga të anketuarit e përkatësisë etnike shqipëtare, gjegjësisht 245 ose 50% mendojnë se varret nga kushtet ekonomike nëse do të ndanin pasurinë trashëgimore së bashku me motrat/vëllezërit, 141 ose 29% nuk duan të marrin pjesë në trashëgimi së bashku me motrat/ vëllezërit e tyre dhe 100 ose 21% mendojnë të ndajnë pasurinë trashëgimore së bashku me motrat/vëllezërit.

Shumica nga të anketuarit e përkatësisë etnike turke, respektivisht 17 ose 56% mendojnë se varret nga kushtet ekonomike nëse do të ndanin pasurinë trashëgimore së bashku me motrat/vëllezërit, 8 ose 27% nuk duan të marrin pjesë në trashëgimi së bashku me motrat/ vëllezërit e tyre, kurse 5 ose 17% mendojnë të ndajnë pasurinë trashëgimore së bashku me motrat/vëllezërit.

Gjatë analizës së të dhënave statistikore nga grafiku 8, vërrejmë që në aspektin gjinor numri më i madh i pjesmarrësve meshkuj dhe pjesmarrësve femra mendojnë të ndajnë pasurinë trashëgimore së bashku me motrat/vëllezërit. Në aspektin nacional shohim që numri më i madh i qytetarëve maqedonas mendojnë të ndajnë pasurinë trashëgimore së bashku me motrat/vëllezërit, kurse numri më i madh i pjesmarrësve shqipëtar dhe turk mendojnë se varret nga kushtet ekonomike nëse do të ndanin pasurinë trashëgimore së bashku me motrat/vëllezërit.

Grafiku 9. A do të pranoje ndarjen e pasurisë trashëgimore në pjesë të barabartë me motrën/at tuaja? (pyetje për qytetarët meshkuj)

A do të pranoje ndarjen e pasurisë trashëgimore në pjesë të barbartë me vëllaun/vëllezërit tuaj?(pyetje për qytetarët femrat)



Nga rezultatet e paraqitura në grafikun 9, vërrejmë që nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, shumica nga ta, gjegjësisht 547 ose 43% mendojnë se a do të ndajnë pasurinë trashëgimore me motrat/vëllezërit varret nga kushtet ekonomike. 362 ose 29% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve pranojnë ndarje të pasurisë në pjesë të barabarta me motrat/vëllezërit, kurse 351 ose 28 % nuk pranojnë ndarje të pasurisë në pjesë të barabarta me motrat/vëllezërit.

Shumica nga të anketuarit meshkuj, gjegjësisht 309 ose 49% mendojnë që kushtet ekonomike nuk iu mundësojnë ndarje të barabartë të pasurisë trashëgimore me motrat e tyre. 203 ose 32% nga të anketuarit meshkuj pranojnë ndarje të pasurisë në pjesë të barabarta me motrat, kurse 118 ose 19% nuk pranojnë ndarje të pasurisë në pjesë të barabarta me motrat/vëllezërit.

Shumica nga të anketuarit femra, përkatësisht 293 ose 46% nuk pranojnë ndarje të pasurisë në pjesë të barabarta me vëllezërit. 238 ose 38% nga ta mendojnë që kushtet ekonomike nuk iu mundësojnë ndarje të barabartë të pasurisë trashëgimore me motrat/vëllezërit e tyre. 99 ose 16% nga të anketuarit femra pranojnë ndarje të pasurisë në pjesë të barabarta me motrat/vëllezërit e tyre.

Nga 744 qytetarë të përkatësisë etnike maqedonase, shumica nga ta përkatësisht 317 ose 43% mendojnë që kushtet ekonomike nuk iu mundësojnë ndarje të barabartë të pasurisë trashëgimore me motrat/vëllezërit e tyre. 249 ose 33% pranojnë ndarje të pasurisë në

pjesë të barabarta me motrat/vëllezërit e tyre, kurse 178 ose 24% nuk pranojnë ndarje të pasurisë në pjesë të barabarta me motrat/ vëllezërit.


Nga 486 qytetarë të përkatësisë etnike shqiptare pjesmarrës në hulumtim, shumica nga ta gjegjësisht 216 ose 45% mendojnë që që kushtet ekonomike nuk iu mundësojnë ndarje të barabartë të pasurisë trashëgimore me motrat/vëllezërit e tyre. 162 ose 33% nuk pranojnë ndarje të pasurisë në pjesë të barabarta me motrat/ vëllezërit, kurse 108 ose 22% pranojnë ndarje të pasurisë në pjesë të barabarta me motrat/vëllezërit e tyre.

Nga 30 qytetarë të përkatësisë etnike turke, shumica përkatësisht 14 ose 47% mendojnë që që kushtet ekonomike nuk iu mundësojnë ndarje të barabartë të pasurisë trashëgimore me motrat/vëllezërit e tyre. 11 ose 36% nuk pranojnë ndarje të pasurisë në pjesë të barabarta me motrat/ vëllezërit, kurse 5 ose 17% pranojnë ndarje të pasurisë në pjesë të barabarta me motrat/vëllezërit e tyre.

Analizuar nga këndvështrimi gjinorë, shohim që shumica nga të anketuarit meshkuj mendojnë që kushtet ekonomike nuk u mundësojnë ndarje të barabartë të pasurisë trashëgimore me motrat e tyre, kurse shumica nga të anketuarit femra nuk preferojnë ndarje të pasurisë trashëgimore në pjesë të barabartë me motrat/ vëllezërit e tyre.

Grafiku 10. Si do të ishin marrëdhëniet familjare me vajzat /motrat tuaja në qoftë se ato do të kërkonin pjesën e domosdoshme të trashëgimisë së pronës familjare? (pyetje dedikuar qytetarëve meshkuj)

Si do të ishin marrëdhëniet familjare me vëllaun/vëllezërit tuaj në qoftë se ju do të kërkonte të merrni pjesën e domosdoshme të trashëgimisë së pronës familjare? (pyetje dedikuar qytetarëve femra)



Nga rezultatet e paraqitura në grafikun 10, vërrejmë që nga numri i përgjithshëm i të anketuarve shumica nga ta 495 ose 43% nuk e dinë se si do të ishin raportet familjare mes vëllezërve dhe motrave kur ato do të kërkonin pjesën ligjore të trashëgimisë së pronës së familjes. 450 ose 39% mendojnë se raportet familjare do të ishin të mira. 215 ose 18% mendojnë se raportet mes vëllezërve dhe motrave do të përkeqësoheshin.

Shumica nga të anketuarit meshkuj, 369 ose 50% mendojnë se raportet familjare mes vëllezërve dhe motrave do të ishin të mira. 194 ose 27% nuk e dinë se si do të ishin raportet familjare mes motrave dhe vëllezërve, 167 ose 23% nga të anketuarit meshkuj mendojnë se raportet familjare do të ishin të këqia.

Shumica nga të anketuarit femra, 301 ose 48% nuk e dinë se si do të ishin raportet familjare mes vëllezërve dhe motrave, 181 ose 29% mendojnë se raportet familjare do të ishin të mira. 148 ose 23% mendojnë se raportet familjare mes vëllezërve/ motrave do të përkeqësoheshin ato do të kërkonin pjesën e domosdoshme të trashëgimisë.

Nga 744 qytetarë të përkatësisë etnike maqedonase pjesmarrës në hulumtim, shumica 368 ose 61% mendojnë se raportet familjare do të ishin të mira. 189 ose 32% nuk e dinë se si do të ishin raportet familjare mes motrave dhe vëllezërve, kurse 43 ose 5% mendojnë se raportet familjare do të ishin të këqia nëse vajza/motra kërkon pjesën e domosdoshme të trashëgimisë.

Nga 486 qytetarë të përkatësisë etnike shqiptare, shumica 287 ose 46% nuk e dinë se si do të ishin raportet familjare mes motrave dhe vëllezërve. 176 ose 28% mendojnë se raportet


familjare do të ishin të mira, kurse 167 ose 28% mendojnë se raportet familjare mes vëllezërve dhe motrave do të përkeqësoheshin nëse vajza/motra kërkon pjesën e domosdoshme të trashëgimisë.

Nga 30 qytetarë turk pjesmarrës në hulumtim, shumica nga ta 19 ose 63% nuk e dinë se si do të ishin raportet familjare mes vëllezërve dhe motrave, 6 ose 20% mendojnë se raportet familjare do të ishin të mira, kurse 5 ose 17% mendojnë se raportet familjare mes vëllezërve nuk do të jenë të mira nëse vajza/motra kërkon pjesën e domosdoshme të trashëgimisë.

Analizuar nga këndvështrimi gjinorë shohim që shumica nga qytetarët meshkuj mendojnë që raportet familjare do të jenë të mira, kurse nga ana tjetër të anketuarit femra kanë dyshime dhe nuk e dinë se si do të jenë raportet familjare me trashëgimtarët meshkuj nëqoftëse vajza/motra kërkon pjesën e domosdoshme –pjesën që garantohet me ligj. Kjo le të nënkuptohet që tek femrat në përgjithësi ekziston friga e prishjes së marrëdhënieve familjare, prandaj shpesh edhe preferojnë të heqin dorë nga pjesa që u garantohet me dispozita ligjore.

Në lidhje me pyetjen nga grafiku 10. vërrejmë dallime edhe në aspektin nacional. Kështu, shumica nga qytetarët e përkatësisë nacionale maqedonase mendojnë që raportet familjare do të jenë të mira, kurse shumica nga qytetarët e përkatësisë nacionale shqipëtare dhe turke nuk e dinë se si do të jenë raportet familjare nëse trashëgimtari femër do të kërkonte pjesën e domosdoshme të trashëgimisë.

Grafiku 11. A keni dëgjuar apo a dini ndonjë rast në familjen tuaj apo në rrethin më të gjërë, ku vajzat kanë marrë pjesë në trashëgimi së bashku me vëllezërit e tyre?



Nga rezultatet e grafikut 11, shohim që nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, shumica respektivisht 652 ose 52% kanë dëgjuar dhe dinë raste në familje ne tyre apo më gjërë, ku pasuria trashëgimore është ndarë në mes djemve dhe vajzave të të ndjerit, kurse 608 ose 48% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve nuk dinë ose nuk kanë dëgjuar ndonjë rast të tillë.

Shumica nga të anketuarit meshkuj, 445 ose 71% dinë ose kanë dëgjuar raste ku pasuria trashëgimore është ndarë mes djemve dhe vajzave të të ndjerit, kurse 185 ose 29% nga të anketuarit meshkuj nuk dinë ose nuk kanë dëgjuar për raste të tilla.

Shumica nga të anketuarit femra 423 ose 67% kanë dëgjuar dhe dinë raste raste ku pasuria trashëgimore është ndarë mes djemve dhe vajzave të të ndjerit, kurse 207 ose 33% nga të anketuarit femra nuk dinë ose nuk kanë dëgjuar për raste të tilla.

Nga 744 të anketuar maqedonas, shumica përkatësisht 489 ose 66% dinë ose kanë dëgjuar raste ku pasuria trashëgimore është ndarë mes djemve dhe vajzave të të ndjerit, kurse 255 ose 34% nuk dinë ose nuk kanë dëgjuar për raste të tilla.


Nga 486 të anketuar shqipëtar, shumica gjegjësisht 330 ose 68% nuk dinë ose nuk kanë dëgjuar për raste të tilla, kurse 156 ose 32% dinë ose kanë dëgjuar raste ku pasuria trashëgimore është ndarë mes djemve dhe vajzave të të ndjerit.

Nga 30 pjesmarrës turk, shumica përkatësisht 23 ose 77% nga ta nuk dinë ose nuk kanë dëgjuar për raste të tilla, kurse 7 ose 23% dinë ose kanë dëgjuar raste ku pasuria trashëgimore është ndarë mes djemve dhe vajzave të të ndjerit.

Nga rezultatet e dhëna në grafikun 11, shohim që ka dallime në dhënien të përgjigjeve si në aspektin gjinor gjithashtu edhe në aspektin nacionale.

Kështu në aspektin gjinorë, numër më i madh i qytetarëve meshkuj dinë dhe kanë dëgjuar raste kur trashëgimtari femër merr pjesë në trashëgimi së bashku me trashëgimtarët ligjorë meshkuj, kurse nga ana tjetër numri më i madh i pjesmarrësve femra nuk dinë për raste të tilla. Në aspektin nacional shohim që numri më i madh i qytetarëve maqedonas dinë dhe kanë dëgjuar raste të tilla, ndërsa numri më i madh i pjesmarrësve shqipëtarë dhe turk nuk dinë dhe nuk kanë dëgjuar epër raste ku pasuria trashëgimore është ndarë mes djemve dhe vajzave të të ndjerit.

Grafiku 12. A keni dëgjuar apo a dini ndonjë rast në familjen tuaj apo edhe më gjërë, ku trashëgimtari femër ka hequr dorë nga pjesa ligjore e trashëgimisë?



Nga rezultatet e grafikut 12, vërrejmë që në përgjithësi shumica nga qytetarët e anketuar, d.m.th 968 ose 77% dinë apo kanë dëgjuar raste kur trashëgimtari femër ka hequr dorë nga pjesa ligjore e trashëgimisë, kurse 292 ose 23% nga qytetarët e anketuar nuk dinë apo nuk kanë dëgjuar raste kur trashëgimtari femër ka hequr dorë nga pjesa ligjore e trashëgimisë.

Shumica nga të anketuarit meshkuj, 485 ose 77% dinë apo kanë dëgjuar raste kur trashëgimtari femër ka hequr dorë nga pjesa ligjore e trashëgimisë, ndërsa 145 ose 23% nuk dinë dhe nuk kanë dëgjuar raste të tilla.

Shumica nga të anketuarit femra, përkatësisht 483 ose 77% dinë apo kanë kanë dëgjuar raste kur trashëgimtari femër ka hequr dorë nga pjesa ligjore e trashëgimisë ndërsa 147 ose 23% nuk dinë dhe nuk kanë dëgjuar raste të tilla.


Nga 744 të anketuar maqedonas, shumica nga ta respektivisht 536 ose 72% dinë apo kanë kanë dëgjuar raste kur trashëgimtari femër ka hequr dorë nga pjesa ligjore e trashëgimisë, ndërsa 209 ose 28% nuk dinë dhe nuk kanë dëgjuar raste të tilla.

Nga 486 të anketuar shqipëtar, shumica nga ta gjegjësisht 416 ose 86% dinë apo kanë kanë dëgjuar raste kur trashëgimtari femër ka hequr dorë nga pjesa ligjore e trashëgimisë, kurse 70 ose 14% nuk dinë dhe nuk kanë dëgjuar raste të tilla.

Nga 30 të anketuar turk, shumica gjegjësisht 17 ose 57% dinë apo kanë kanë dëgjuar raste kur trashëgimtari femër ka hequr dorë nga pjesa ligjore e trashëgimisë, kurse 13 ose 43% nuk dinë dhe nuk kanë dëgjuar raste të tilla.

Nga të dhënat statistikore nga grafiku 12. nga aspekti nacional por edhe ai gjinor, shumica nga numri i përgjithshëm i pjesmarrësve në hulumtim dinë apo kanë kanë dëgjuar raste kur trashëgimtari femër ka hequr dorë nga pjesa ligjore e trashëgimisë.

*Grafiku 13. A do të preferoje që vajza/motra juaj te heq dorë nga e drejta për trashëgimi në pronën prindërore (pyetje nga pyetësi për qytetarët meshkuj)
A do të heqësh dorë nga trashëgimia e pronës familjare? (pyetje drejtuar qytetareve femra)*



Nga rezultatet e paraqitura në grafikun 13, vërrejmë që shumica nga qytetarët e anketuar gjegjësisht 556 ose 44% mendojnë se heqja dorë nga trashëgimia e pronës së prindërve varret nga gjendja ekonomike. 383 ose 30% % preferojnë të heqin dorë nga trashëgimia e pronës së prindërve , kurse 321 ose 26% nuk preferojnë të heqin dorë nga trashëgimia.

Shumica nga të anketuarit meshkuj, gjegjësisht 322 ose 51% mendojnë që varret nga gjendja ekonomike nëse ata do të dëshironin që vajza/motra të heq dorë nga pjesa ligjore e pasurisë trashëgimore 182 ose 29% preferojnë që vajza/motra të heq dorë nga pjesa ligjore e trashëgimisë. Kurse 126 ose 20% nuk dëshirojnë që vajza/motra të heq dorë nga trashëgimia në pronën e familjes.

Shumica nga të anketuarit femra, përkatësisht 234 ose 37% mendojnë që varret nga gjendja ekonomike nëse do të heqin dorë nga pjesa e garantuar e trashëgimisë në pronën e familjes. 201 ose 32% mendojnë se do të heqin dorë nga pjesa e trashëgimisë që garantohet me dispozita ligjore dhe 195 ose 31% nuk duan të heqin dorë nga pjesa ligjore e trashëgimisë.


Nga 744 qytetarë maqedonas, shumica nga ta 316 ose 42% mendojnë se kushtet ekonomike do të përcaktonin nëse do të preferonin që trashëgimtari femër të heq dorë nga trashëgimia, 264 ose 36% nuk dëshirojnë që vajza/motra të heq dorë nga trashëgimia në pronën e familjes, kurse 164 ose 22% dëshirojnë që vajza/motra të heq dorë nga trashëgimia në pronën e familjes.

Nga 486 të anketuar shqipëtar, shumica nga ta gjegjësisht 219 ose 45% mendojnë se kushtet ekonomike do të përcaktonin nëse do të preferonin që trashëgimtari femër të heq dorë nga trashëgimia, 213 ose 44% dëshirojnë që vajza/motra të heq dorë nga trashëgimia në pronën e familjes, kurse 54 ose 11% nuk dëshirojnë që vajza/motra të heq dorë nga trashëgimia në pronën e familjes.

Nga 30 të anketuar turk, shumica nga ta 21 ose 70% mendojnë se kushtet ekonomike do të përcaktonin nëse do të preferonin që trashëgimtari femër të heq dorë nga trashëgimia, 0 ose 20% dëshirojnë që vajza/motra të heq dorë nga trashëgimia në pronën e familjes ndërsa 3 ose 10% dëshirojnë që vajza/motra të heq dorë nga trashëgimia në pronën e familjes.

Analizuar nga këndvështrimi gjinorë por edhe ai nacional, shohim që shumica nga pjesmarrësit në hulumtim mendojnë se kushtet ekonomike do të përcaktonin nëse do të preferonin që trashëgimtari femër të heq dorë nga trashëgimia.

Grafiku 14 Cilat nga opcionet e poshtëshënuar preferoni për ndarjen e pasurisë tuaj?



Nga rezultatet e grafikut 14, shohim që shumica nga të anketuarit, përkatësisht 496 ose 39% preferojnë të ndajnë pasurinë e tyre mes bashkëshortes/it dhe fëmijëve ashtuqë pjesa më e madhe e pasurisë do t'i takon djalit dhe një pjesë më e vogël për vajzat. 421 ose 39% preferojnë ndarje të trashëgimisë në pjesë të barabarta mes bashkëshortit dhe fëmijëve pa dallim gjinor. 343 ose 27% preferojnë ndarje të pasurisë së tyre mes bashkëshortes dhe fëmijëve në ndonjë mënyrë tjetër që nuk është përfshirë si alternativë në anketë dhe asnjëri

nga qytetarët e anketuar nuk preferon ndarje të pasurisë mes bashkëshortit/es dhe fëmijëve ashtuqë pjesa më e madhe e pasurisë t'i kalojë vajzës dhe një pjesë më e vogël për djemtë.

Shumica nga të anketuarit meshkuj gjegjësisht 268 ose 43% preferojnë të ndajnë pasurinë e tyre mes bashkëshortes/it dhe fëmijëve ashtuqë pjesa më e madhe e pasurisë do t'i takon djalit dhe një pjesë më e vogël për vajzat. 227 ose 36% preferojnë ndarje të trashëgimisë në pjesë të barabarta mes bashkëshortit dhe fëmijëve pa dallim gjinor. 135 ose 21% preferojnë ndarje të pasurisë së tyre mes bashkëshortes dhe fëmijëve në ndonjë mënyrë tjetër që nuk është përfshirë si alternative në pyetësorë dhe asnjëri nga të anketuarit meshkuj nuk preferon ndarje të pasurisë mes bashkëshortit/es dhe fëmijëve ashtuqë pjesa më e madhe e pasurisë t'i kalojë vajzës dhe një pjesë më e vogël për djemtë.

Shumica nga të anketuarit femra , 228 ose 36% preferojnë të ndajnë pasurinë e tyre mes bashkëshortes/it dhe fëmijëve ashtuqë pjesa më e madhe e pasurisë do t'i takon djalit dhe një pjesë më e vogël për vajzat. 208 ose 33% nga të anketuarit femra preferojnë ndarje të pasurisë së tyre mes bashkëshortes dhe fëmijëve në ndonjë mënyrë tjetër që nuk është përfshirë si alternative e përgjigjes së mundshme në anketë. 194 ose 31 preferojnë ndarje të trashëgimisë në pjesë të barabarta mes bashkëshortit dhe fëmijëve pa dallim gjinor.

Nga 744 të anketuar maqedonas, shumica 324 ose 44% preferojnë ndarje të trashëgimisë në pjesë të barabarta mes bashkëshortit dhe fëmijëve pa dallim gjinor. 234 ose 31% preferojnë ndarje të pasurisë së tyre mes bashkëshortes dhe fëmijëve në ndonjë mënyrë tjetër që nuk është përfshirë si alternative e përgjigjes së mundshme në anketë. 186 ose 25% preferojnë të ndajnë pasurinë e tyre mes bashkëshortes/it dhe fëmijëve, ashtuqë pjesa më e madhe e pasurisë do t'i takon djalit/djemve dhe një pjesë më e vogël për vajzën/at, ndërsa asnjëri nga të anketuarit e përkatësisë nacionale maqedonase nuk preferon ndarje të pasurisë mes bashkëshortit/es dhe fëmijëve ashtuqë pjesa më e madhe e pasurisë t'i kalojë vajzës dhe një pjesë më e vogël për djemtë.

Nga 486 qytetarë të përkatësisë nacionale shqipëtare shumica nga ta, gjegjësisht 297 ose 51% preferojnë të ndajnë pasurinë e tyre mes bashkëshortes/it dhe fëmijëve, ashtuqë pjesa më e madhe e pasurisë do t'i takon djalit/djemve dhe një pjesë më e vogël për vajzën/at. 96 ose 20% preferojnë ndarje të pasurisë së tyre mes bashkëshortes dhe fëmijëve në ndonjë mënyrë


tjetër që nuk është përfshirë si alternative e përgjigjes së mundshme në anketë. 93 ose 19% preferojnë ndarje të trashëgimisë në pjesë të barabarta mes bashkëshortit dhe fëmijëve pa dallim gjinor. Asnjëri nga të anketuarit shqipëtar nuk preferon ndarje të pasurisë mes bashkëshortit/es dhe fëmijëve ashtuqë pjesa më e madhe e pasurisë t'i kalojë vajzës dhe një pjesë më e vogël për djemtë.

Nga 30 të anketuar turk, 13 ose 44% preferojnë të ndajnë pasurinë e tyre mes bashkëshortes/it dhe fëmijëve, ashtuqë pjesa më e madhe e pasurisë do t'i takon djalit/djemve dhe një pjesë më e vogël për vajzën/at, 13 ose 44% preferojnë ndonjë mënyrë tjetër që nuk është përfshirë si alternative në pyetësorë dhe 4 ose 12% preferojnë ndarje të trashëgimisë në pjesë të barabarta mes bashkëshortit dhe fëmijëve pa dallim gjinor.

Analizuar nga këndvështrimi gjinorë, shumica nga të anketuarit meshkuj dhe femra preferojnë të ndajnë pasurinë e tyre mes bashkëshortes/it dhe fëmijëve, ashtuqë pjesa më e madhe e pasurisë do t'i takon djalit/djemve dhe një pjesë më e vogël për vajzën/at.

Në aspektin nacional vërrejmë që shumica nga pjesëmarrësit e përkatësisë nacionale maqedonase preferojnë ndarje të trashëgimisë në pjesë të barabarta mes bashkëshortit dhe fëmijëve pa dallim gjinor, kurse shumica nga pjesëmarrësit e përkatësië etnike shqipëtare dhe turke preferojnë ndarje të pasurisë trashëgimore mes bashkëshortes/it dhe fëmijëve, ashtuqë pjesa më e madhe e pasurisë do t'i takon djalit/djemve dhe një pjesë më e vogël për vajzën/at.

Grafiku 15. Si ndikon në cilësinë e jetës së një femre, mospjesmarrja e saj në pjesën ligjore të trashëgimisë?



Duke u bazuar në rezultatet nga grafiku 15, shohim që shumica nga qytetarët e anketuar, 1055 ose 84% mendojnë se mospjesmarrja e femrës në pjesën ligjore të trashëgimisë

ndikon negativisht në cilësinë e jetës së saj. 205 ose 16% mendojnë se mospjesmarrja e femrës në pjesën ligjore të trashëgimisë ndikon pozitivisht në cilësinë e jetës së saj.

Shumica nga të anketuarit meshkuj , 473 ose 75% mendojnë se mospjesmarrja e femrës në pjesën ligjore të trashëgimisë ndikon negativisht në cilësinë e jetës së saj. 157 ose 25% nga të anketuarit meshkuj mendojnë se mospjesmarrja e femrës në pjesën ligjore të trashëgimisë ndikon pozitivisht në cilësinë e jetës së saj.

Shumica nga të anketuarit femra 582 ose 92% mendojnë se mospjesmarrja e femrës në pjesën ligjore të trashëgimisë ndikon negativisht në cilësinë e jetës së saj. 48 ose 8% mendojnë se mospjesmarrja e femrës në pjesën ligjore të trashëgimisë ndikon pozitivisht në cilësinë e jetës së saj.


Nga 744 qytetarë maqedonas pjesmarrës në hulumtim, shumica nga ta 658 ose 88% mendojnë se mospjesmarrja e femrës në pjesën ligjore të trashëgimisë ndikon negativisht në cilësinë e jetës së saj. 86 ose 12% mendojnë se mospjesmarrja e femrës në pjesën ligjore të trashëgimisë ndikon pozitivisht në cilësinë e jetës së saj.

Nga 486 qytetarë shqipëtarë pjesmarrës në hulumtim, shumica nga ta respektivisht 379 ose 78% mendojnë se mospjesmarrja e femrës në pjesën ligjore të trashëgimisë ndikon negativisht në cilësinë e jetës së saj, kurse 107 ose 23% mendojnë se mospjesmarrja e femrës në pjesën ligjore të trashëgimisë ndikon pozitivisht në cilësinë e jetës së saj.

Nga 30 qytetarë turq pjesmarrës në hulumtim, shumica nga ta gjegjësisht 18 ose 60% mendojnë se mospjesmarrja e femrës në pjesën ligjore të trashëgimisë ndikon negativisht në cilësinë e jetës së saj, kurse 12 ose 40% mendojnë se mospjesmarrja e femrës në pjesën ligjore të trashëgimisë ndikon pozitivisht në cilësinë e jetës së saj.

Analizuar nga aspekti gjinor por edhe ai nacional, vërrejmë që numri më i madh i pjesmarrësve në hulumtim mendojnë që mospjesmarrja e femrës në pjesën ligjore të trashëgimisë ndikon negativisht në cilësinë e jetës së saj.

Grafiku 16. Cilën nga mënyrat e poshtëshënuara e preferoni si mënyrë për ndarjen e pasurisë trashëgimore?



Nga rezultatet e grafikut 16 shohim që shumica nga qytetarët e anketuar, 773 ose 61% preferojnë ndarje të trashëgimisë sipas marrëveshjes paraprake mes trashëgimtarëve të mundshëm duke respektuar dispozitat ligjore. 314 ose 25% nga qytetarët e anketuar preferojnë ndarje të trashëgimis sipas marrëveshjes paraprake mes trashëgimtarëve të mundshëm por duke respektuar rregullat e besimit fetar të cilit i përket. 173 ose 14 % preferojnë ndarje të pasurisë trashëgimore duke respektuar traditën (rregullat zakonore).

Shumica nga të anketuarit meshkuj, përkatësisht 325 ose 52% preferojnë ndarje të pasurisë trashëgimore duke respektuar dispozitat ligjore, 209 ose 33% preferojnë ndarje të pasurisë trashëgimore duke respektuar rregullat e besimit fetar të cilit i përket, 96 ose 15% preferojnë ndarje të pasurisë trashëgimore sipas traditës.

Shumica nga të anketuarit femra 448 ose 71% preferojnë ndarje të pasurisë trashëgimore duke respektuar dispozitat ligjore, 105 ose 17% preferojnë ndarje të pasurisë trashëgimore duke respektuar rregullat e besimit fetar të cilit i përket, kurse 77 ose 12% preferojnë ndarje të pasurisë trashëgimore sipas traditës.

Nga 744 të anketuar të përkatësisë nacionale maqedonase, shumica respektivisht 668 ose 90% preferojnë ndarje të pasurisë trashëgimore duke respektuar dispozitat ligjore, 59 ose 8%


Preferojnë ndarje të pasurisë trashëgimore duke respektuar rregullat e besimit fetar të cilit i përket dhe 17 ose 2% preferojnë ndarje të pasurisë trashëgimore sipas traditës.

Nga 486 të anketuar shqipëtarë, shumica nga ta respektivisht 236 ose 48% preferojnë ndarje të pasurisë trashëgimore duke respektuar rregullat e besimit fetar të cilit i përket. 149 ose 31% preferojnë ndarje të pasurisë trashëgimore sipas traditës dhe 101 ose 21% preferojnë ndarje të pasurisë trashëgimore duke respektuar dispozitat ligjore.

Nga 30 pjesmarrës të përkatësisë etnike turke, shumica nga ta gjegjësisht 19 ose 64% preferojnë ndarje të pasurisë trashëgimore duke respektuar rregullat e besimit fetar të cilit i përket. 7 ose 23% preferojnë ndarje të pasurisë trashëgimore sipas traditës, kurse 4 ose 13% preferojnë ndarje të pasurisë trashëgimore duke respektuar dispozitat ligjore.

Analizuar nga këndvështrimi gjinorë, shumica nga pjesmarrësit meshkuj dhe shumica nga pjesmarrësit femra preferojnë që pasuria trashëgimore të ndahet me marrëveshje mes trashëgimtarëve të mundshëm por duke respektuar dispozitat ligjore. Nërsa në aspektin nacional vërrejmë që shumica nga pjesmarrësit maqedonas preferojnë pasuria trashëgimore të ndahet me marrëveshje mes trashëgimtarëve të mundshëm por duke respektuar dispozitat ligjore, ndërsa shumica nga pjesmarrësit shqipëtarë dhe turq preferojnë ndarje të pasurisë trashëgimore duke respektuar rregullat e besimit fetar të cilit i përket.

Grafiku 17. A mendoni që mundësia e ndarjes së pasurisë trashëgimore me marrëveshje paraprak mes trashëgimtarëve krijon mundësi për ndarjen të pasurisë trashëgimore në mënyrë të pafavorshme për trashëgimtarët femra?



Nga të dhënat në grafikun 17. vërrejmë që shumica nga qytetarët pjesmarrës në hulumtim 505 ose 40% mendojnë se marrëveshja mes trashëgimtarëve potencial krijon

mundësi për ndarje të pronës në mënyrë të pafavorshme për trashëgimtarët femra. 403 ose 32% nuk dinë nëse marrëveshja paraprake mes trashëgimtarëve ndikon në mënyrë të pafavorshme për trashëgimtarët femra. 353 ose 28% mendojnë se marrëveshja paraprake mes trashëgimtarëve të mundshëm nuk krijon mundësi të pafavorshme për trashëgimtarët femra.

Shumica nga të anketuarit meshkuj, përkatësisht 261 ose 49% nuk e dinë nëse marrëveshja paraprake mes trashëgimtarëve të mundshëm krijon mundësi të pafavorshme për trashëgimtarët femra. 248 ose 34% mendojnë se marrëveshja paraprake mes trashëgimtarëve të mundshëm nuk krijon mundësi të pafavorshme për trashëgimtarët femra, kurse 121 ose 17% mendojnë se marrëveshja mes trashëgimtarëve të mundshëm me qëllim të ndarjes së pronës familjare krijon mundësi për ndarje të pronës në mënyrë të pafavorshme për trashëgimtarët femra.

Shumica nga të anketuarit femra, gjegjësisht 384 ose 61% mendojnë se marrëveshja paraprake për ndarje të trashëgimisë mundëson ndarje të pronësisë familjare në mënyrë të pafavorshme për trashëgimtarët femra. 141 ose 22% nuk e dinë nëse marrëveshja paraprake mes trashëgimtarëve të mundshëm mundëson ndarje të pronësisë familjare në mënyrë të pafavorshme për trashëgimtarët femra. 105 ose 17% mendojnë se marrëveshja paraprake mes trashëgimtarëve për ndarje të pronësisë familjare nuk ndikon në mënyrë të pafavorshme për trashëgimtarët femra.

Nga 744 pjesmarrës maqedonas, shumica nga ta rrespektivisht 272 ose 37% nuk e dinë nëse marrëveshja paraprake mes trashëgimtarëve të mundshëm mundëson ndarje të pronësisë familjare në mënyrë të pafavorshme për trashëgimtarët femra. 264 ose 35% mendojnë se marrëveshja paraprake mes trashëgimtarëve për ndarje të pronësisë familjare nuk ndikon në mënyrë të pafavorshme për trashëgimtarët femra. 208 ose 28% mendojnë se marrëveshja paraprake për ndarje të trashëgimisë mundëson ndarje të pronësisë familjare në mënyrë të pafavorshme për trashëgimtarët femra.


Nga 486 pjesmarrës shqipëtarë, shumica gjegjësisht 289 ose 60% mendojnë se marrëveshja paraprake për ndarje të trashëgimisë mundëson ndarje të pronësisë familjare në mënyrë të pafavorshme për trashëgimtarët femra. 113 ose 23% nuk e dinë nëse marrëveshja paraprake mes trashëgimtarëve të mundshëm mundëson ndarje të pronësisë familjare në

mënyrë të pafavorshme për trashëgimtarët femra, kurse 84 ose 17% mendojnë se marrëveshja paraprake mes trashëgimtarëve për ndarje të pronësisë familjare nuk ndikon në mënyrë të pafavorshme për trashëgimtarët femra.

Nga 30 pjesmarrës turk, shumica nga ta, 12 ose 50% nuk e dinë nëse marrëveshja paraprake mes trashëgimtarëve të mundshëm mundëson ndarje të pronësisë familjare në mënyrë të pafavorshme për trashëgimtarët femra, 8 ose 33% mendojnë se marrëveshja paraprake për ndarje të trashëgimisë mundëson ndarje të pronësisë familjare në mënyrë të pafavorshme për trashëgimtarët femra, kurse 4 ose 17% mendojnë se marrëveshja paraprake mes trashëgimtarëve për ndarje të pronësisë familjare nuk ndikon në mënyrë të pafavorshme për trashëgimtarët femra.

Bazuar në të dhënat nga grafiku 17, vërrejmë që numri më i madh i qytetarëve meshkuj nuk e dinë nëse marrëveshja paraprake për ndarje të pasurisë trashëgimore krijon mundësi për ndarje të pasurisë në mënyrë të pafavorshme për trashëgimtarët femra, kurse shumica nga të anketuarit femra mendojnë se mundësia për marrëveshja paraprake të ndarjes së trashëgimisë pronësore është e pafavorshme për ta. Nga ana tjetër dallime vërrehen edhe nga aspekti nacional, kështu, numri më i madh nga të anketuarit maqedonas dhe të anketuarit turk nuk e dinë nëse marrëveshja paraprake mes trashëgimtarëve të mundshëm mundëson ndarje të pronësisë familjare në mënyrë të pafavorshme për trashëgimtarët femra, kurse shumica nga pjesmarrësit shiptarë mendojnë se marrëveshja paraprake për ndarje të trashëgimisë mundëson ndarje të pronësisë familjare në mënyrë të pafavorshme për trashëgimtarët femra.

Grafiku 18. A dallon praktika aktuale trashëgimore krahasuar me praktikat zakonore dhe praktikat tjera që kanë egzistuar para hyrjes në fuqi të Ligjit mbi Trashëgiminë dhe akteve tjera juridike përmes së cilëve garantohet barazi dhe mosdiskriminim gjinor?



Nga grafiku 18, vërrejmë që shumica nga të qytetarët e anketuar, gjegjësisht 791 ose 63% mendojnë se praktika aktuale e ndarjes së trashëgimisë dallon shumë në krahasim me praktikat zakonore dhe praktikat tjera që kanë ekzistuar para hyrjes në fuqi të Ligjit mbi Trashëgimi dhe akteve tjera nacionale e ndërkombëtare të cilët garantojnë barazinë gjinore dhe mosdiskriminim në fushën e trashëgimisë. 288 ose 23% mendojnë se praktika aktuale dallon pak nga praktikat e mëhershme. Kurse 181 ose 6% mendojnë se në ditët e sotme nuk ka shumë dallim nga praktikat e kaluara të ndarjes së trashëgimisë.

Shumica nga të anketuarit meshkuj, 468 ose 74% mendojnë se praktika aktuale e ndarjes së trashëgimisë dallon shumë nga praktikat zakonore dhe praktikat tjera të aplikuar në vitet para hyrjes në fuqi të Ligjeve të ndryshme me të cilat garantohet barazi dhe mosdiskriminim gjinor në çështjet e trashëgimisë. 149 ose 24% mendojnë se ka pak dallim kurse 13 ose 2% mendojnë se nuk ka aspak dallim mes praktikave aktuale dhe praktikave të mëhershme të ndarjes së trashëgimisë pronësore familjare.

Shumica nga të anketuarit femra, 323 ose 51% mendojnë se praktika aktuale e ndarjes së trashëgimisë pronësore familjare dallon shumë krahasuar me praktikat e mëhershme, 169 ose 27% mendojnë se ka shumë pak dallim, dhe 139 ose 22% mendojnë se praktika aktuale e ndarjes së trashëgimisë nuk dallon nga praktikat tjera që kanë ekzistuar para hyrjes në fuqi të

akteve të ndryshme juridike që grantojnë barazinë dhe mosdiskrimin në çështjet e trashëgimisë.

Shumica nga të anketuarit maqedonas, 612 ose 63% mendojnë se praktika aktuale e ndarjes së trashëgimisë pronësore familjare dallon shumë krahasuar me praktikën e mëhershme, 87 ose 23% mendojnë se ka shumë pak dallim, kurse 45 ose 14% mendojnë se praktika aktuale e ndarjes së trashëgimisë nuk dallon nga praktikën tjetër që kanë ekzistuar para hyrjes në fuqi të akteve të ndryshme juridike që grantojnë barazinë dhe mosdiskrimin në çështjet e trashëgimisë.

Shumica nga të anketuarit shqipëtar, 184 ose 38% mendojnë se praktika aktuale e ndarjes së trashëgimisë dallon pak nga praktikën zakonore dhe praktikën tjetër të aplikuar në vitet para hyrjes në fuqi të Ligjeve të ndryshme me të cilat garantohet barazi dhe mosdiskrimin gjinor. 176 ose 36% mendojnë se praktika aktuale e ndarjes së trashëgimisë pronësore familjare dallon shumë krahasuar me praktikën e mëhershme, kurse 126 ose 26% mendojnë se praktika aktuale e ndarjes së trashëgimisë nuk dallon aspak nga praktikën tjetër që kanë ekzistuar para hyrjes në fuqi të akteve të ndryshme juridike që grantojnë barazinë dhe mosdiskrimin në çështjet e trashëgimisë.


Shumica nga të anketuarit turq, respektivisht 17 ose 57% mendojnë se praktika aktuale e ndarjes së trashëgimisë dallon pak nga praktikën tjetër që kanë ekzistuar para hyrjes në fuqi të akteve të ndryshme juridike që grantojnë barazinë dhe mosdiskrimin në çështjet e trashëgimisë.

10 ose 33% mendojnë se praktika aktuale e ndarjes së trashëgimisë nuk dallon aspak nga praktikën tjetër që kanë ekzistuar para hyrjes në fuqi të akteve të ndryshme juridike që grantojnë barazinë dhe mosdiskrimin në çështjet e trashëgimisë, kurse 3 ose 10% mendojnë se praktika aktuale e ndarjes së trashëgimisë pronësore familjare dallon shumë krahasuar me praktikën e mëhershme.

Shikuar nga këndvështrimi gjinor, numri më i madh i të anketuarve meshkuj dhe numri më i madh i të anketuarve femra mendojnë që ka shumë dallim mes praktikave aktuale të ndarjes së trashëgimisë dhe praktikave të viteve para hyrjes në fuqi të ligjeve që garantojnë barazi dhe mosdiskrimin gjinor.

Analizuar nga aspekti nacional vërrejmë që shumica nga të anketuarit maqedonas mendojnë se praktika aktuale e ndarjes së trashëgimisë pronësore familjare dallon shumë krahasuar me praktikën e mëhershme, kurse të anketuarit shqipëtarë dhe turk se praktika aktuale e ndarjes së trashëgimisë dallon pak nga praktikën tjetër që kanë ekzistuar para hyrjes në fuqi të akteve të ndryshme juridike që grantojnë barazinë dhe mosdiskriminim në çështjet e trashëgimisë.

Grafiku 19. A pajtoheni që edhe përkundër ekzistimit të kornizës ligjore, institucionale e politike, dispozitat ligjore nuk zbatohen në praktikë dhe si pasojë pabarazia gjinore dhe diskriminimi gjinor në këtë fushë vazhdon të ekzistojë?



Nga rezultatet e grafikut 19, vërrejmë që shumica nga të anketuarit meshkuj, gjegjësisht 276 ose 44% nuk pajtohen që dispozitat ligjore nuk zbatohen në praktikë dhe si pasojë pabarazia gjinore dhe diskriminimi gjinor në fushën e trashëgimisë nuk ekziston. 261 ose 41% pajtohen që edhe përkundër ekzistimit të kornizës ligjore, institucionale e politike, dispozitat ligjore nuk zbatohen në praktikë dhe si pasojë pabarazia gjinore dhe diskriminimi gjinor në këtë fushë vazhdon të ekzistojë, kurse 93 ose 15% nga të anketuarit meshkuj kanë dyshime, prandaj kanë rrethuar opcionin pajtohem edhe nuk pajtohem.

Shumica nga të anketuarit femra, 296 ose 47%, edhe pajtohen edhe nuk pajtohen që dispozitat ligjore nuk zbatohen në praktikë dhe që pabarazia dhe diskriminimi gjinor në çështjet e trashëgimisë vazhdon të ekzistojë. 200 ose 32% nga të anketuarit femra nuk pajtohen që dispozitat ligjore nuk zbatohen në praktikë dhe që pabarazia dhe diskriminimi gjinor në çështjet e trashëgimisë vazhdon të ekzistojë. 134 ose 21% nga ta pajtohen që edhe përkundër ekzistimit të kornizës ligjore, institucionale e politike, dispozitat ligjore nuk zbatohen në praktikë dhe si pasojë pabarazia gjinore dhe diskriminimi gjinor në këtë fushë vazhdon të ekzistojë.

Nga 744 qytetarë maqedonas pjesmarrës në hulumtim, shumica nga ta respektivisht 401 ose 54% nuk pajtohen që dispozitat ligjore nuk zbatohen në praktikë, 272 ose 36% edhe pajtohen edhe nuk pajtohen që dispozitat ligjore nuk zbatohen në praktikë, kurse 73 ose 10% ta pajtohen që edhe përkundër ekzistimit të kornizës ligjore, institucionale e politike, dispozitat ligjore nuk zbatohen në praktikë dhe si pasojë pabarazia gjinore dhe diskriminimi gjinor në këtë fushë vazhdon të ekzistojë.


Nga 486 qytetarë shqipëtarë pjesmarrës në hulumtim, shumica nga ta respektivisht 311 ose 64% pajtohen që edhe përkundër ekzistimit të kornizës ligjore, institucionale e politike, dispozitat ligjore nuk zbatohen në praktikë, 107 ose 22% edhe pajtohen edhe nuk pajtohen që dispozitat ligjore nuk zbatohen në praktikë, kurse 68 ose 14% nuk pajtohen që dispozitat ligjore nuk zbatohen në praktikë.

Nga 30 qytetarë turk pjesmarrës në hulumtim, shumica gjegjësisht 11 ose 64% pajtohen që dispozitat ligjore nuk zbatohen në praktikë, 10 ose 22% edhe pajtohen edhe nuk pajtohen që dispozitat ligjore nuk zbatohen në praktikë, ndërsa 9 ose 14% nuk pajtohen që dispozitat ligjore nuk zbatohen në praktikë.

Nëqoftëse krahasojmë përgjigjet e qytetarëve pjesmarrësve në hulumtim, vërrejmë dallime të shumta si nga aspekti gjinorë dhe ai nacional. Kështu, shumica nga qytetarët meshkuj nuk pajtohen që dispozitat ligjore nuk zbatohen në praktikë kurse shumica nga qytetarët femra edhe pajtohen edhe nuk pajtohen që dispozitat ligjore nuk zbatohen në praktikë. Dallime vërrehën edhe në aspektin nacional, përderisa shumica nga qytetarët maqedonas nuk pajtohen që dispozitat ligjore nuk zbatohen në praktikë, shumica nga qytetarët shqipëtarë dhe turk

pajtohen që edhe përkundër ekzistimit të kornizës ligjore, institucionale e politike, dispozitat ligjore nuk zbatohen në praktikë.

Grafiku 20. Sipas mendimit tuaj, cilët nga faktorët e poshtëshënuar pengon trashëgimtarin femër të realizojë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare?



Nga rezultatet e paraqitura në grafikun 20 vërrejmë që nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, shumica gjegjësisht 491 ose 39% mendojnë që mentaliteti mbizotërues është faktorë që pengon trashëgimtarin femër të realizojë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare, 461 ose 37 % mendojnë që mosnjohja e dispozitave ligjore nga qytetarët është faktorë që pengon trashëgimtarin femër të realizojë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjarekurse 308 ose 24% mendojnë që faktor që pengon trashëgimtarin femër të realizojë të drejtën trashëgimore mbi pronësinë e familjes është praktika zkonore.

Nga të dhënat e paraqitura në grafikun 20 shohim që shumica nga të anketuarit meshkuj 253 ose 40% nga ta mendojnë se mosnjohja e ligjeve nga ana e qytetarëve është faktorë që pengon trashëgimtarin femër të realizojë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare. 204 ose 32% e të anketuarve meshkuj mendojnë se faktor që pengon trashëgimtarin femër të realizojë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare është mentaliteti mbizotërues, kurse

174 ose 28% nga të anketuarit meshkuj mendojnë se praktika zakonore është një ndër faktorët që pengon trashëgimtarin femër të realizojë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare.

Në grafikun 20 vërrejmë që shumica nga të anketuarat femra, përkatësisht 288 ose 46% mendojnë se faktorë që pengon trashëgimtarin femër të realizojë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare është mentaliteti mbizotërues. 208 ose 33% si faktorë që pengon trashëgimtarin femër të realizojë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare është mosnjohja e ligjeve nga ana e qytetarëve, kurse 134 ose 21% nga të anketuarit femra mendojnë se faktorë që pengon trashëgimtarin femër të realizojë të drejtën e trashëgimisë mbi pronën familjare është praktika zakonore.

Nga 744 pjesmarrës maqedonas, shumica respektivisht 341 ose 46% mendojnë se faktorë që pengon trashëgimtarin femër të realizojë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare është mosnjohja e ligjeve nga ana e qytetarëve, 224 ose 30% mendojnë se faktorë që pengon trashëgimtarin femër të realizojë të drejtën e trashëgimisë mbi pronën familjare është praktika zakonore dhe 179 ose 24% mendojnë se faktorë që pengon trashëgimtarin femër të realizojë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare është mentaliteti mbizotërues.


Nga 486 pjesmarrës shqipëtarë, shumica gjegjësisht 301 ose 62% mendojnë se faktorë që pengon trashëgimtarin femër të realizojë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare është mentaliteti mbizotërues. 107 ose 22% nga ta mendojnë se faktorë që pengon trashëgimtarin femër të realizojë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare është mosnjohja e ligjeve nga ana e qytetarëve dhe 78 ose 16% mendojnë se faktorë që pengon trashëgimtarin femër të realizojë të drejtën e trashëgimisë mbi pronën familjare është praktika zakonore.

Nga 30 pjesmarrës turk, shumica respektivisht 13 ose 43% mendojnë se faktorë që pengon trashëgimtarin femër të realizojë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare është mosnjohja e ligjeve nga ana e qytetarëve. 11 ose 37% mendojnë se faktorë që pengon trashëgimtarin femër të realizojë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare është mentaliteti mbizotërues dhe 6 ose 20% mendojnë se faktorë që pengon trashëgimtarin femër të realizojë të drejtën e trashëgimisë mbi pronën familjare është praktika zakonore.

Në pyetjen në grafikun 20. vërrejmë dallimë në dhënie të përgjigjeve si në aspektin gjinor gjithashtu edhe në atë nacional. Kështu, përderisa shumica nga pjesmarrësit meshkuj

mendojnë se faktor që pengon trashëgimarin femër të realizojë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare është mosnjohja e ligjeve nga ana e qytetarëve, shumica nga pjesmarrësit femra mendojnë se faktorë që pengon trashëgimtarin femër të realizojë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare është mentaliteti mbizotërues. Përderisa shumica nga pjesmarrësit e përkatësisë etnike maqedonase dhe turke mendojnë se faktorë që pengon trashëgimarin femër të realizojë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare është mosnjohja e ligjeve nga ana e qytetarëve, shumica nga pjesmarrësit shqipëtarë mendojnë se faktorë që pengon trashëgimtarin femër të realizojë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare është mentaliteti mbizotërues.

Grafiku 21. Sipas mendimit tuaj, në praktikën aktuale të trashëgimisë në RMV, trashëgimtarët femra a disponojnë të drejtën trashëgimore?



Nga grafiku 20, shohim që shumica nga të anketuarit, gjegjësisht 590 ose 47% mendojnë se femrat në RMV rrallë disponojnë të drejtën e trashëgimisë në pronën familjare. 494 ose 39% mendojnë se femrat në RMV disponojnë të drejtën e trashëgimisë mbi pronësinë e familjes dhe 176 ose 14% mendojnë që femrat në RMV nuk disponojnë me të drejtën e trashëgimisë në pronën e familjes.

Shumica nga të anketuarit meshkuj, 378 ose 60% mendojnë se femrat në RMV disponojnë të drejtën e trashëgimisë, 218 ose 35% mendojnë se femrat rrallë disponojnë të

drejtën e trashëgimisë 134 ose 5% mendojnë se femrat në RMV nuk disponojnë me të drejtën e trashëgimisë.

Shumica nga të anketuarit femra, 372 ose 59% mendojnë se femrat në RMV rrallë disponojnë me të drejtën e trashëgimisë, 142 ose 23% nga ta mendojnë se femrat në RMV nuk disponojnë të drejtën e trashëgimisë, kurse 116 ose 18% nga të anketuarit femra mendojnë se vajzat në RMV disponojnë me të drejtën e trashëgimisë në pronësinë e familjes.

Shumica nga të anketuarit e përkatësisë nacionale maqedonase, 398 ose 53% mendojnë se femrat në RMV disponojnë të drejtën e trashëgimisë, 275 ose 37% mendojnë se femrat në RMV rrallë disponojnë me të drejtën e trashëgimisë dhe 71 ose 10% mendojnë se femrat në RMV nuk disponojnë të drejtën e trashëgimisë.

Shumica nga të anketuarit e përkatësisë etnike shqipëtare 293 ose 60% mendojnë se femrat në RMV rrallë disponojnë me të drejtën e trashëgimisë, 98 ose 20% mendojnë se femrat në RMV disponojnë të drejtën e trashëgimisë dhe 95 ose 20% mendojnë se femrat në RMV nuk disponojnë të drejtën e trashëgimisë.


Shumica nga të anketuarit e përkatësisë etnike turke 22 ose 55% mendojnë se femrat në RMV rrallë disponojnë me të drejtën e trashëgimisë, 10 ose 25 % mendojnë se femrat në RMV nuk disponojnë të drejtën e trashëgimisë, kurse 8 ose 20% mendojnë se femrat në RMV disponojnë të drejtën e trashëgimisë.

Nga rezultatet e paraqitura në grafikun e lartëshënuar vërrejmë që në aspektin gjinorë ka dallime në dhënie të përgjigjeve nga ana e qytetarëve meshkuj dhe femra. Kështu përderisa shumica nga të anketuarit meshkuj mendojnë që femrat në RMV disponojnë me të drejtën e trashëgimisë shumica nga të anketuarit femra mendojnë se femrat rrallë disponojnë me të drejtën e trashëgimisë.

Dallime vërrehen edhe tek përgjigjet e qytetarëve të nacionaliteteve të ndryshme. Kështu shumica nga pjesmarrësit maqedonas mendojnë që femrat në RMV disponojnë me të drejtën e trashëgimisë, shumica nga pjesmarrësit shqipëtarë dhe turk mendojnë se femrat rrallë disponojnë me të drejtën e trashëgimisë.


6.4.3. Analiza dhe përpunimi i të dhënave nga pyetësi për noterë

Grafiku 22. Në praktikë, si inicohet procedura për shqyrtim të pasurisë trashëgimore?




Nga 20 noterë pjesmarrës në hulumtim 16 ose 80% shprehen se procedura për shqyrtimin e procedurës trashëgimore në praktikë inicohet me kërkesën e trashëgimtarëve potencial, kurse 4 ose 20% shprehen se procedurën për shqyrtimin e procedurës trashëgimore inicon organi Komunal i gjendjes civile. Nga rezultatet e dhëna në grafikun 22, vërrejmë diskrepancë mes teorisë dhe praktikës. Kështu, sipas Ligjit mbi Trashëgimi dhe Ligjit për Noterë, organi përgjegjës për regjistrimin e vdekjes në afat prej 30 ditë nga dita kur regjistrohet vdekja, dërgon Akvdekjen deri tek Gjykata trashëgimore. Gjykata në afat prej 8 ditësh lëndën e trashëgimisë së bashku me dosjet e nevojshme ia beson për zgjidhje Noterit me seli në rajonin e Gjykatës trashëgimore dhe më pas Noteri njofton dhe thërret trashëgimtarët e mundshëm. Megjithatë, shumica nga Noterët pjesmarrës në hulumtim shprehen që përkundër teorisë, në praktikë vetë trashëgimtarët me kërkesë inicojnë procedurën trashëgimore.

Grafiku 23. Në përditshmëri, me kërkesën e cilëve trashëgimtarë më shpesh inicohet procedura për shqyrtim të trashëgimisë?




Nga 20 noterë pjesmarrës në hulumtim, 14 ose 70% shprehen se procedura trashëgimore inicohet nga të gjithë personat që kanë interes juridik pa dallim gjinor, kurse 6 ose 30% thonë që procedurën trashëgimore më shpesh e inicojnë trashëgimtarët meshkuj.

Grafiku 24. Në praktikë, Aktvdekja përpilohet:




Përderisa në aspektin teorik, organi përgjegjës për përpilimin e Aktvdekjes është Zyra e Gjendjes Civile , 14 ose 70% e noterëve pjesëmarrës në hulumtim shprehen se Aktvdekja përpilohet në Zyrën e Gjendjes Civile por edhe në lokalet e Noterisë ,kurse 6 ose 30% nga noterët pjesmarrës në hulumtim shprehen që Aktvdekja përpilohet vetëm nga Zyra e Gjendjes Civile. Nga të dhënat e mësipërme shohim dallim mes teorisë dhe praktikës.

Grafiku 25. Noteri, a bashkëpunon me institucionet tjera juridike për verifikimin e informacionit të dhënë në Aktvdekje?




Në pyetjen e lartëshënuar noterët shprehen se Noteri nuk verifikon të dhënat nga Aktvdekja por bazohen tek të dhënat që merren nga personat që kanë bashkëjetuar me të ndjerin ose personat tjerë që mund të japin informacione për të ndjerin. Megjithatë, duhet theksuar që mosbashkëpunimi me institucionet tjera juridike dhe mosverifikimi i informacionit të dhënë në Aktvdekje mund të krijojë mundësi për përpilim të Aktvdekjes me të dhëna të rrejshme si psh: fshehje të tashëgimtarëve (sidomos vajzave të martuara, të miturve jashtëmartesor dhe grupeve tjera të cënueshme).

Grafiku 26. Në praktikë, në raste të dyshimit në lidhje me fshehjen e ndonjë trashëgimtari ligjorë apo vlerësimi të gabuar të vlerës Neto të pjesës trashëgimore në Aktvdekje, Noteri a obligohet të njoftoj zyrën e prokurorit?




Shumica nga noterët që kanë marrë pjesë në hulumtim 17 ose 85% shprehen që në raste të dyshimit në lidhje me fshehjen e ndonjë trashëgimtari ligjorë apo vlerësimi të gabuar të vlerës Neto të pjesës trashëgimore në Aktvdekje, Noteri nuk ka obligim ligjorë të njoftojë zyrën e Prokurorit, që le të kuptohet se në raste të keqpërdorimit të të dhënave në Aktvdekje, është në dorë të vet trashëgimtarëve nëqoftëse ata dëshirojnë të marrin masa të mëtutjeshme apo jo, kurse Noteri nuk ka përgjegjësi dhe detyrim ligjorë që të paraqes raste në Prokurori edhe nëse dyshon në keqpërdorim të të dhënave të shënuara në Aktvdekje.

Grafiku 27. A pajtoheni se mungesa e të dhënave elektronike lidhur me organizimin familjar të qytetarëve lehtëson fshehjen e trashëgimtarëve ligjorë?




Të gjithë noterët pjesmarrës në hulumtim pyetjes nga grafiku 27 i janë përgjigjur njëzëri. Sipas tyre mungesa e të dhënave elektronike lidhur me organizimin familjar të qytetarëve ndoshta krijon mundësi për fshehje të trashëgimtarëve ligjorë.

Grafiku 28. Cila nga mënyrat e poshtëshënuara të ndarjes së pasurisë trashëgimore aplikohet më shpesh në përditshmëri?




Sipas shumicës së noterëve pjesmarrës në hulumtim, përkatësisht 12 ose 60% nga ta shprehen se pasuria trashëgimore në të shumtën e rasteve ndahet duke u bazuar në marrëveshjen paraprake mes trashëgimtarëve potencial por duke respektuar dispozitat ligjore. Kurse nga 4 noterë përkatësisht nga 20% mendojnë se pasuria trashëgimore ndahet duke u bazuar në marrëveshje mes trashëgimtarëve me çrast respektojnë traditat ose rregullat e besimit fetare të cilit i përkasin.

Grafiku 29. A mendoni se përfitohet nga mjeti ligjor “heqje dorë nga trashëgimia”, duke dal nga konteksti për të cilin është parashikuar?




Shumica nga noterët pjesmarrës në hulumtim 16 ose 80%, shprehen që ndonjëherë përfitohet nga mekanizmi ligjorë “heqja dorë nga trashëgimia”. Kurse, 4 ose 20% e noterëve shprehen se asnjëherë nuk përfitohet nga “heqja dorë nga trashëgimia”.

Grafiku 30. A pajtoheni që zbrazëtirat ligjore lënë mundësi të influencimit të rregullave të traditës patriarkale?




Shumica nga noterët pjesmarrës në hulumtim 13 ose 65% nuk pajtohen që zbrazëtirat ligjore lënë mundësi të influencimit të rregullave të traditës patriarkale. Kurse 7 ose 35% nga ta pajtohen që zbrazëtirat ligjore lënë mundësi të influencimit të rregullave të traditës patriarkale.

Grafiku 31. A pajtoheni se duhet të organizohet seancë e veçantë për trashëgimtarët që heqin dorë nga trashëgimia pronësore?




15 ose 75%nga noterët pjesmarrës në hulumtim mendojnë se nuk është e nevojshme organizimi i seancës së veçantë për trashëgimtarët që heqin dorë nga trashëgimia, kurse 5 ose 25%nga ta mendojnë se duhet të organizohet seancë e veçantë.

Grafiku 32. Noteri, a është i obliguar të informoj trashëgimtarët në lidhje me pasojat nga heqja dorë nga pasuria trashëgimore?



Të gjithë noterët pjesmarrës në hulumtim shprehen që kanë obligim ligjor t'i lajmërojnë trashëgimtarët për pasojat juridike me rastin e heqjes dorë nga trashëgimia.

Grafiku 33. Në RMV, në praktikë më shpesh aplikohet trashëgimia ligjore apo testamentare?




Sipas teorisë juridike testamenti është baza më e fortë juridike përkundrejt ligjit. Megjithatë, 20 noterët pjesmarrës në hulumtim njëzëri (100%), shprehen që trashëgimia ligjore aplikohet më shpesh se trashëgimia me testament.

Grafiku 34. Femrat më shpesh heqin dorë në cilësi të trashëgimtares ligjore apo trashëgimtares testamentare?




Të gjithë noterët pjesmarrës në hulumtim (20 ose 100%)njëzëri shprehen që femrat më shpesh heqin dorë nga pjesa ligjore e trashëgimisë atëherë kur thirren në trashëgimi sipas ligjit, kurse nga rezultatet e grafikut 33 vërrejtëm që trashëgimia ligjore aplikohet më shpesh në praktikë. Rezultati nga grafiku 34, lë të nënkuptohet që femrat heqin dorë vetëm atëherë kur thirren në cilësi të trashëgimtares ligjore por jo edhe atëherë kur trashëgojnë me testament.

Grafiku 35. Cila formë e testamenteve të poshtëshënuara aplikohet më shpesh në praktikë?




Nga rezultatet e grafikut 35 shohim që shumica nga noterët pjesmarrës në hulumti 16 ose 80% mendojnë se testamenti me akt notarial është forma që zbatohet më shpesh në RMV kurse 4 ose 20% mendojnë se më së shumti përdoret testament gjyqësor.

Grafiku 36. Trashëgimtarët testamental më shumë i përkasin gjinisë mashkullore apo gjinisë femërore?




11 ose 55% nga noterët pjesmarrës në hulumtim shprehen që në të shumtën e rasteve trashëgimtarët testamental janë meshkuj, kurse 9 ose 45% mendojnë se në të shumtën e rasteve trashëgimtarë testamental janë trashëgimtarë femra.

Grafiku 37. Në RMV më shumë trashëgojnë femrat që i përkasin besimit fetar krishter apo islam?




Sipas të dhënave nga pyetësi me noterë, sipas 16 ose 80% në RMV më shumë trashëgojnë femrat që përkasin besimit krishter kurse sipas 4 ose 20% trashëgojnë edhe femrat e besimit islam.

Grafiku 38. Në RMV më shumë trashëgojnë femrat që i përkasin nacionalitetit: shqiptarë, maqedonas, turk, rom, tjetër?




Nga rezultatet e dhëna në grafikun 38, shohim që sipas 13 ose 65% noterëve pjesmarrës në hulumtim shprehen që në RMV më shumë trashëgojnë femrat që i përkasin nacionalitetit maqedonas, kurse kurse sipas 7 ose 35% shprehen që në RMV trashëgojnë femrat e të gjitha nacionaliteteve.

Grafiku 39. A mendoni se qytetarët e RMV -së, kanë njohuri të mjaftueshme mbi të drejtën trashëgimore si e drejtë themelore që garantohet me ligj?



Shumica nga noterët pjsmarrës në hulumtim gjegjësisht 18 ose 90% mendojnë se qytetarët në RMV kanë njohuri të mjaftueshme mbi të drejtën trashëgimore. Kurse vetëm 2 ose 10% nga ta mendojnë se qytetarët nuk kanë njohuri të mjaftueshme mbi këtë tematikë.

Grafiku 40. A dallon praktika aktuale trashëgimore krahasuar me praktikat zakonore dhe praktikat tjera që kanë egzistuar para hyrjes në fuqi të Ligjit mbi Trashëgiminë dhe akteve tjera juridike përmes së cilëve garantohet barazi dhe mosdiskriminim gjinor?



Nga grafiku 40 shohim që mendimet e noterëve janë të ndryshme. Shumica nga ta (10 ose 50%) shprehen që praktika aktuale e trashëgimisë dallon nga praktikat e mëparshme ku nuk është respektuar parimi i barazisë dhe mosdiskriminimi në fushën e trashëgimisë. 7 ose 35% nga noterët pjesmarrës në hulumtim mendojnë se praktika aktuale dallon pak nga praktikat e mëparshme, kurse 3 ose 15% mendojnë se nuk ka dallim aspak.


Duke u bazuar në përqindjen më të lartë të paraqitur në grafikun 40, mund të përfundojmë se në përgjithësi praktika e trashëgimisë krahasuar me praktikat e mëparshme dallon shumë, megjithatë barazia dhe mosdiskriminimi gjinor vazhdon të ekzistojë dhe është i dukshëm edhe në ditët e sotme. Akoma ekziston hendek mes realitetit ekzistues dhe realitetit të dëshiruar mbi barazinë gjinore në trashëgimi.

Tabela. 10. Femrat më shpesh disponojnë të drejtën e trashëgimisë atëherë kur thirret në roli e bashkëshortes, vajzës, motrës, mbesës? (Rradhiti nga 1-4, 1- më shumë, 2-më pak, 3-mjaftueshëm, 4-aspak)

Bashkëshortja	Më shumë
Vajza	Mjaftueshëm
Motra, mbesa	Më pak


Sipas noterëve pjesmarrës në hulumtim, në RMV të drejtën e trashëgimisë mbi pronën familjare më shumë e disponojnë femrat që thirren në cilësi të bashkëshortes së të ndjerit, mjaftueshëm trashëgojnë vajzat e trashëgimlënsit, më pak trashëgojnë motrat dhe mbesat e trashëgimlënësit.

Grafiku 41. Në praktikën aktuale, femrat a disponojnë të drejtën për trashëgimi në pronën familjare?




17 ose 85% nga noterët pjesmarrës në hulumtim mendojnë se femrat në RMV disponojnë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare. 3 ose 15% nga ta mendojnë se femrat më rrallë disponojnë me të drejtën e trashëgimisë.

Grafiku 42. Cilët nga trashëgimtarët (meshkuj dhe femra) të shënuar në Aktvdekje më shpesh disponojnë të drejtën e trashëgimisë në pronën familjare?




Shumica nga noterët pjesmarrës në hulumtim 16 ose 80% shprehen që më shpesh të drejtën e trashëgimisë në pronën familjare e disponojnë trashëgimtarët meshkuj dhe më pak trashëgimtarët femra. Kurse 4 ose 20% nga ta mendojnë se të drejtën e trashëgimisë më shpesh e disponojnë femrat dhe më pak meshkujt.

Grafiku 43. Cilët nga trashëgimtarët e shënuar në Aktvdekje më shpesh heqin dorë nga trashëgimia në pronën familjare?



12 ose 60% nga noterët pjesmarrës në hulumtim mendojnë se nga trashëgimia në pronën familjare më shpesh heqin dorë trashëgimtarët femra, kurse 8 ose 40% nga ta mendojnë se më shumë heqin dorë nga trashëgimia trashëgimtarët meshkuj.


Grafiku 44. Në lokalet e Noterisë a mbahet evidenc statistikore për qytetarët meshkuj dhe femra që heqin dorë nga trashëgimia?



20 noterët pjesmarrës në hulumtim njëzëri shprehen se lokalet e Noterisë nuk mbajnë evidencë statistikore për numrin e qytetarëve meshkuj dhe femra që heqin dorë nga trashëgimia.


Mungesa e të dhënave statistikore lë të nënkutohet që institucionet kryesore publike nuk janë të përshira aq sa duhet në zbatimin e Ligjit të Barazisë gjinore dhe sistematizimin e të dhëna përkatëse.

Grafiku 45. Në lokalet e Noterisë a mbahet evidenc statistikore për qytetarët meshkuj dhe femra që pranojnë dhe disponojnë të drejtën e trashëgimisë?




Noterët pjesmarrës në hulumtim njëzëri shprehen se në lokalet e Noterisë nuk ka evidencë statistikore për numrin e qytetarëve meshkuj dhe femra që pranojnë dhe disponojnë të drejtën e trashëgimisë.

Grafiku 46. Sa ndikon roli i Noterit në mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtës trashëgimore në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminues?




9 ose 45% nga noterët pjesmarrës në hulumtim mendojnë që roli i Noterit ka shumë ndikim në mbrojtjen dhe zbatimin e drejtës trashëgimore. 7 ose 35% nga ta mendojnë se Noteri ka pak ndikim në zbatimin e drejtës trashëgimore në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminues, kurse 4 ose 20% mendojnë se Noteri nuk ka ndikim në mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtës trashëgimore në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminues.

Grafiku 47 Cili nga aktet noteriale të poshtëshënuara zbatohen më shpesh në përditshmëri?
 Radhit nga 1-4 , 1- Më shumë, 2- më pak,3- mjaftueshëm 4- aspak)




Nga 7 respektivisht nga 35% noterë pjesmarrës në hulumtim shprehen që nga nga aktet noteriale më shumë aplikohet kontrata për dhurim dhe kontrata për mbajtje të përjetshme, sipas 4 ose 20% më shpesh aplikohet kontrata për dorëzim dhe ndarje të pasurisë dhe 2 ose 10% nga noterët pjesmarrë në hulumtim shprehen që testament është akti notarial që më shpesh aplikohet në përditshmërinë aktuale.

Grafiku 48. A mendoni se është e nevojshme të hartohen dhe zbatohen programe dhe strategji afatgjate të cilat do të mund të ndikojnë në ndryshimin e skemave dhe modeleve paragjyquese të sjelljes për rolet e femrave dhe meshkujve në shoqëri?



11 ose 55% e noterëve shprehen që në RMV duhet të hartohen dhe zbatohen programe dhe strategji afatgjate që do të ndihmonin në ndryshimin e modeleve paragjyquese, kurse 9 ose 45% mendojnë se në RMV nuk është e nevojshme të hartohen dhe zbatohen programe dhe strategji afatgjate që do të ndikojnë në ndryshimin e skemave dhe modeleve paragjyquese në shoqëri.


Grafiku 49. A pajtoheni se është i domosdoshëm modifikimi i ligjit mbi Trashëgimi i RMV-së nën dritën e praktikave të shteteve evropiane apo edhe më gjërë?



10 ose 50% nga noterët pjesmarrës në hulumtim mendojnë se Ligji për Trashëgimi duhet të ndryshojë duke u bazuar tek Ligjet e shteteve evropiane apo edhe më gjërë . 6 ose 30% nga ta nuk kanë përgjigje në këtë pyetje kurse 4 ose 20% mendojnë se nuk është e nevojshme modifikimi i Ligjit për Trashëgimi.

Për të përmirësuar barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin gjinore në trashëgimi, për të eliminuar stereotipet dhe paragjykimet në shoqëri, janë më se të nevojshme reformat ligjore dhe institucionale bazuar në praktikat e shteteve evropiane apo edhe më gjërë, shtete që menagjojnë me sukses barazinë gjinore në trashëgiminë pronësore.


Grafiku 50. A mendoni që krahas ligjit dhe testamentit në RMV duhet të aplikohet edhe Kontrata për Trashëgimi si bazë më e fortë juridike për fitimin e trashëgimisë?



Shumica nga noterët pjesmarrës në hulumtim, përkatësisht 8 ose 40% nuk kanë përgjigje nëse duhet të aplikohet edhe Kontrata për Trashëgimi krahas Ligjit dhe Testamentit si bazë juridike për fitimin e trashëgimisë, 6 ose 30% nga ta mendojnë se duhet të aplikohet edhe Kontrata për Trashëgimi dhe 6 ose 30% mendojnë se Kontrata për Trashëgimi nuk duhet të aplikohet në sistemin juridik të RMV-së krahas Ligjit dhe Testamentit.


6.5 Analiza dhe përpunimi i të dhënave nga pyetësi për avokatë dhe Gjykatës

Grafiku 51. Në dekadën e fundit, gjatë veprimtarisë suaj si avokatë/gjykatës, më shpesh, me iniciativën e cilëve trashëgimtarë është inicuar procedurë kontestuese trashëgimore (pronësore familjare)?




Nga gjithsejs 15 avokatë dhe gjykatës që kanë plotësuar pyetësin, 8 ose 54% theksojnë që procedura kontestimore trashëgimore më shpesh inicohet me iniciativë të trashëgimtarëve meshkuj. 5 ose 33% nga ta shprehen se procedura kontestimore trashëgimore më shpesh inicohet me iniciativë të trashëgimtarëve pavarësisht gjinisë kurse sipas 2 ose 13% të avokatëve dhe gjykatësve pjesmarrës në hulumtim, procedura kontestimore trashëgimore inicohet me iniciativë të trashëgimtarëve femra.

Grafiku 52. Në përditshmëri, në Gjykatat Themelore të RMV-së më shpesh si palë procedural në rastet kontestuese trashëgimore (pronësore familjare) paraqiten:




9 ose 60% nga avokatët dhe gjykatësit pjesmarrës në hulumtim shprehen që në Gjykatat Themelore të RMV-së më shpesh si palë procedural në rastet kontestuese trashëgimore (pronësore familjare) paraqiten djemtë por edhe vajzat e trashëgimlënësit. Kurse sipas 6 ose 40% nga ta, palë në procedurë kontestimore trashëgimore më shpesh janë vetëm djemtë e trashëgimlënësit.

Grafiku 53. Në dekadën e fundit, në Gjykatën Themelore të Shkupit/Tetovës (apo tjetër), a është inicuar ndonjë procedurë kontestimore ku palë procedural janë djemtë dhe vajzat e trashëgimlënësit, ndërsa fakt kontestues është madhësia e pasurisë trashëgimore?




Sipas 12 ose 80 % të avokatëve dhe gjykatësve pjesmarrës në hulumtim në Gjykatat Themelore ku ata punojnë dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre, shumë rrallë janë inicuar raste kontestuese mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënsit , ku fakt kontestues është madhësia e pasurisë trashëgimore. Kurse, sipas 3 ose 20 % nga ta, gjatë veprimtarisë së tyre si avokatë/gjykatës nuk janë paraqitur raste të tilla kontestuese.

Grafiku 54. Në dekadën e fundit, në Gjykatën Themelore të Shkupit/Tetovës (apo tjetër), a është inicuar ndonjë procedurë kontestimore ku palë procedural janë djemtë dhe vajzat e trashëgimlënsit, ndërsa fakt kontestues është e drejta për trashëgimi?




Sipas 10 ose 67% nga avokatët dhe gjykatësit pjesmarrës në hulumtim , gjatë kohës së ushtrimit të veprimtarisë së tyre, rrallë janë inicuar raste kontestimoe mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënsit ku fakt kontestues është është e drejta për trashëgimi. Kurse, sipas 5 ose 33%, nuk janë inicuar raste të tilla kontestuese.

Grafiku 55. Në dekadën e fundit, Gjykatën Themelore të Shkupit/Tetovës (apo tjetër), a është inicuar ndonjë procedurë kontestimore mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit si palë, ku fakt kontestues është vlefshmëria apo përmbajtja e testamentit?




Sipas 11 ose 73% të avokatëve dhe gjyktësve pjesmarrës në hulumtim , gjatë kohës së ushtrimit të veprimtarisë së tyre, nuk janë inicuar raste kontestimore mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit ku fakt kontestues është vlefshmëria apo përmbajtja e testamentit, kurse 4 ose 27% nga ta shprehen se raste të tilla kontestue paraqiten shumë rrallë.

Grafiku 56. Në dekadën e fundit, Gjykatën Themelore të Shkupit/Tetovës (apo tjetër), a është inicuar ndonjë procedurë kontestimore mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit si palë, ku fakt kontestues është cenimi i pjesës së domosdoshme të trashëgimisë të trashëgimtarit femër?




14 ose 93% nga avokatët dhe gjykatësit pjesmarrës në hulumtim shprehen që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre nuk është inicuar ndonjë procedurë kontestimore mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit ku fakt kontestues është cenimi i pjesës së domosdoshme të trashëgimisë së trashëgimtarit femër. Kurse 1 nga ta shprehet që raste të tilla kontestimore inicohen shumë rrallë pasi që trashëgimtari femër shpesh heqë dorë nga pjesa e domosdoshme e trashëgimisë.

Grafiku 57. Në kadën e fundit, në Gjykatën Themelore të Shkupit/Tetovës (apo tjetër), a është inicuar ndonjë procedurë kontestimore mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit, ku fakt kontestues janë rrethanat që kanë nxitur “heqjen dorë nga trashëgimia”?




Avokatët dhe Gjykatësit pjesmarrës në hulumtim njëzëri shprehen që gjatë veprimtarisë së tyre rrallë inicohet procedurë kontestimore mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit, ku fakt kontestues janë rrethanat që kanë nxitur “heqjen dorë nga trashëgimia”.

Grfaiku 58. A mendoni se përfitohet nga mjeti ligjor “heqje dorë nga trashëgimia”, duke dal nga konteksti për të cilin është parashikuar?




14 ose 93% avokatë dhe gjykatës të lëndëve civile, pjesmarrës në hulumtim shprehen se ndonjëherë përfitohet nga mjeti ligjor “heqje dorë nga trashëgimia”, duke dal nga konteksti për të cilin është parashikuar, kurse 1 ose 7% nga ta shprehet se asnjëherë nuk përfitohet nga mjeti ligjorë “heqje dorë nga trashëgimia”.

Grafiku 59. Në praktikën aktuale, cili nga aktet juridike të mëposhtme, zbatohet për të arritur qëllimin e trashëgimlënësit- shmangia e trashëgimtarit femër (bashkëshortes, vajzave, motrave, mbesave etj) nga pjesa ligjore e trashëgimisë?



Avokatët dhe gjykatësit pjesmarrës në hulumtim njëzëri shprehen që Kontrata për dhuratë është akti juridik që zbatohet për të shmang trashëgimtarin femër nga pjesa ligjore e trashëgimisë, kurse në tabelën 4 shohim që Kontrata për dhuratë është akt juridik që zbatohet më shpesh në përditshmërinë aktuale.

Grafiku 60. A mendoni që krahas ligjit dhe testamentit në RMV duhet të aplikohet edhe Kontrata për Trashëgimi si bazë më e fortë juridike për fitimin e trashëgimisë?



13 ose 87% nga avokatët dhe gjykatësit pjesmarrës në hulumtim mendojnë se në RMV duhet të aplikohet edhe Kontrata për Trashëgimi si bazë më e fortë juridike për fitimin e trashëgimisë, kurse 1 ose 7% nga ta mendon se nuk duhet të aplikohet dhe 1 ose 6% nuk ka përgjigje për këtë pyetje.

6.6 Intervista

Për të marr informacion më të detajuar në lidhje me tematikën e trajtuar, përveç pyetësori janë zhvilluar edhe intervista me: noterë, avokatë dhe qytetarë të RMV-së.

Gjatë shprëndarjes së pyetësorëve njëkohësisht janë realizuar edhe intervista të pastrukturuara dhe gjysmë të strukturuar me disa pjesmarrës. Gjithsesi, duke pasur parasysh ngjashmërinë e përgjigjeve të dhëna nga pjesmarrësit në hulumtim, janë përzgjedhur vetëm disa prej tyre të cilat do të analizohen vecmas më gjërësisht.

Intervista me avokatë

Janë realizuar intervista të gjysmëstrukturuara me avokatët: Adem Abduramanov(Shkup), Irfan Tahiri, Fatmir Musa (Shkup) , Abidin Abduli (Tetovë) , Jusuf Huseini (Shkup) , Agron Halimi (Shkup), Hamim Iseni (Tetovë), Vjosa Xhaferi (Tetovë). Me qëllim të mospërsëritjes së përgjigjeve pothuajse të njëjta, do të analizojmë vetëm 1 intervistë.

Intervista me z. Adem Abduramanov

Intervista është zhvilluar në vendin e tij të punës në zyrën ku ai ushtron veprimatrinë e tij në Shkup, më datë 20.09.2020. Intervista është e tipit të gjysmëstrukturuar, janë parashtruar 9 pyetje, kurse avokati i është përgjigjur pyetjeve të parashtruara me shkrim.

Pyetjet kërkimore:

1. Si dhe ku përpilohet Aktvdekja?

z. Abduramanov: Aktvdekja përpilohet nga Zyra për udhëheqje me librat e gjendjes civile, vecmas nga ajo e nxjerrjes së Certifikatës së vdekjes. Përpilohet në procedurë të cëvantë ashtu sic është paraparë me dispozita ligjore.

2. Në praktikë, sa kohë kalon nga vdekja e trashëgimlënësit deri tek inicimi i procedurës për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore?

Z, Abduramanov: Në praktikë nuk ekziston kohë fikse, zakonisht nga vdekja e trashëgimlënësit deri tek inicimi i procedurës për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore kalojnë 6-12 muaj, megjithatë cdo gjë varret nga posedimi i dokumentacionit të nevojshëm.

3. Kur njoftohet Gjykata me vdekjen e personit fizik?

Z. Abduramanov: Gjykata Themelore njoftohet me vdekjen e personit fizik vetëm pas përpilimit të Aktvdekjes.

4. C'farë ndodh nëse menjëherë pas vdekjes së personit fizik, trashëgimtarët potencial nuk inicojnë procedurën për përpilimin e Aktvdekjes?

Z. Abduramanov: Në qoftë se mungon Aktvdekja atëherë nuk mund të inicohet procedura për shqyrtim të pasurisë trashëgimore.

5. Në përditshmëri, nga cilët trashëgimtarë më shpesh inicohet procedura për shqyrtim të trashëgimisë dhe mes cilëve trashëgimtarë (meshkuj apo femra) linden konteste rreth trashëgimisë së pronës familjare?

Z. Abduramanov: Procedurën trashëgimore e inicojnë të gjithë personat fizik që kanë interes juridik pa dallim gjinorë, megjithatë më shpesh inicohet me iniciativë të trashëgimatrëve meshkuj dhe më pak nga trashëgimtarët femra. Kurse më shpesh, konteste për trashëgiminë e pronës familjare paraqiten mes trashgëimatrëve meshkuj.

6. Në përditshmëri, trashëgimtarët potencial si ndajnë pasurinë trashëgimore?

z. Abduramanov: Më shpesh trashëgimtarët merren vesh mes vete për ndarjen e pasurisë trashëgimore.

7. Cilët faktorët pengojnë/ndikojnë në mospërfshirjen e femrave në pjesën ligjore të trashëgimisë?

Z.Abduramanov: Tradita dhe mentaliteti.

8. Në RMV, deri më sot femrat e cilit nacionalitet realizojnë dhe disponojnë me të drejtën e trashëgimisë në pronën familjare?

Z. Abduramanov: Gjatë veprimtarisë time si avokatë deri më sot, më shumë kërkojnë dhe e disponojnë të drejtën e trashëgimisë femrat e nacionalitetit maqedonas, por që në vitet e fundit nuk mbeten prapa as femrat e nacionaliteteve tjera si: shqiptarë dhe turq megjithëse këtë të drejtë e disponojnë më rrallë.

9. A dallon praktika aktuale e trashëgimisë nga praktikat zakonore dhe praktikat tjera që kanë ekzistuar para hyrjes në fuqi të Ligjit mbi Trashëgimi dhe Ligjeve tjera përmes së cilëve garantohet e drejta trashëgimore?

Z. Abduramanov: Po, dallon shumë.

Intervistë me noterë

Për nevojat e punimit janë zhvilluar intervista të pastrukturuara më noterë në lokalet e noterisë në Shkup dhe Tetovë. Janë intervistuar disa noterë si : Arif Neziri (Tetovë), Jasmina Kaptanova-Basnarkova (Tetovë), Zoran Mukelovski (Tetovë), Liljana Trpovska (Tetovë), Nita Xhaferi-Iseni (Tetovë), Lirim Abdili (Tetovë), Ilham Ismani (Shkup), Ermira Memeti (Shkup).

Intervistat janë të gjysmëstrukturuar, por meqenëse ka shumë ngjashmëri në përgjigjet e dhëna nga noterët me qëllim të mospërsëritjes së përgjigjeve, do të analizohet vetëm intervista me 2 noterë.

Intervista me noterë Ljiljana Trpovska (Tetovë)

Intervista është zhvilluar në lokalin e noterisë së znj. Trpovska në Tetovë, më datë 20.11. 2020.

Intervista është e gjysmëstrukturuar dhe përmban 5 pyetje të cilëve znj. Trpovska iu është përgjigjur me shkrim.

1. Ku përpilohet Aktvdekja?

Z. Trpovska: Aktvdekja përpilohet nga Zyra e Gjendjes Civile.

2. Në praktikë më shpesh zbatohet trashëgimia ligjore apo trashëgimia testamentare?

Z. Trpovska: Trashëgimia ligjore.

3. Kur heqin më shpesh dorë nga trashëgimia atëherë kur trashëgojnë në cilësi të trashëgimtares ligjore apo trashëgimtares testamentare?

Z. Trpovska: Femrat më shpesh heqin dorë nga pasuria trashëgimore atëherë kur ato trashëgojnë në cilësi të trashëgimtares ligjore.

4. Në ditët e sotme, a realizojnë realisht femrat të drejtën për trashëgimi në pronën familjare?

Z. Trpovskai: Po, femrat në RMV, gëzojnë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare.

5. A mendoni që edhe përkundër ekzistimit të dispozitave të shumta ligjore, pabarazia gjinore dhe diskriminimi gjinor në fushën e trashëgimisë vazhdon të ekzistojë?

Z. Trpovska: Po.

Intervista me noterë Ermira Memeti

Intervista është zhvilluar më datë 29.11. 2020 në lokalin e noterisë në Shkup. Intervista është e gjysmëstrukturuar, përfshin 7 pyetje të cilëve znj. Memeti iu është përgjigjur me shkrim.

1. Duke pasur parasysh që Certifikata e vdekjes dhe Aktvdekja janë dy dokumente me përmbajtje të ndryshme, në përditshmëri me nxjerrjen e Certifikatës së vdekjes, a përpilohet njëkohësisht edhe Aktvdekja?

Znj. Memeti: Jo, Aktvdekja përpilohet në procedurë të vecantë vecmas nga ajo e nxjerrjes së Certifikatës së vdekjes. Përpilohet nga Noteri.

2. C'farë ndodh nëse organi komunal përgjegjës për regjistrimin e vdekjes nuk lajmëron Gjykatën për vdekjen e ndonjë personi fizik?

Znj. Memeti: Trashëgimtarët potencial duhet vet të parashtrojnë kërkesë deri tek Gjykata, për fillimin e procedurës për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore.

3. *Cilët nga trashëgimtarët e shënuar në Aktvdekje më shpesh realizojnë të drejtën e trashëgimisë në pronën familjare dhe cilët nga trashëgimtarët e shënuar në Aktvdekje më shpesh heqin dorë nga trashëgimia në pronën familjare?*

Znj. Memeti: Të drejtën e trashëgimisë më shpesh e realizojnë dhe disponojnë trashëgimtarët meshkuj, kurse më shpesh heqin dorë trashëgimtarët femra.

4. *Cilët faktorët pengojnë/ndikojnë në mospërfshirjen e femrave në pjesën ligjore të trashëgimisë?*

Znj. Memeti: Mentaliteti dhe tradita.

5. *Cilët akte noteriale të ndarjes së pasurisë zbatohen më shpesh?*

Znj. Memeti: Kontrata për dorëzim dhe pjesëtim të pasurisë dhe Kontrata për dhurim.

6. *Femrat në RMV a disponojnë të drejtën trashëgimore në pronësinë familjare?*

Znj. Memeti: Po, ndërsa më shpesh këtë të drejtë themelore e realizon dhe disponon femra në rolin e bashkëshortes dhe ndonjëherë vajzat e të ndjerit.

7. *Ju lutem përshkruani veprimet që duhet të ndërmerren nga trashëgimtarët potencial duke filluar nga momenti i nxjerrjes së Certifikatës së Vdekjes deri tek iniciimi i procedurës për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore në lokalet e Noterisë?*

Znj. Memeti: Në fillim parashtrohet propozim në Gjykatën Themelore ku i ndjeri ka pasur vendbanimin e fundit. Gjykatat vendos kontakt me zyrën e Noterit ku është caktuar lënda. Tek Noteri dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm si : Aktvdekja, Certifikatata e lindjes, vdekjes dhe martesës të trashëgimtarëve të rradhës së parë; deklaratat e trashëgimisë, dokumentacioni mbi pronën e luejtshme, të paluejtshme ose ndonjë e drejtë tjetër që trashëgohet. Mbahet seanca e trashëgimisë, me crast trashëgimtarët potencial japin deklarat për pranim ose heqje dorë nga pasuria trashëgimore. Më pas shpallen trashëgimtarët dhe në fund Noteri jep Vendimin mbi ndarje të trashëgimisë. Dosjet Noteri i kthen në Gjykatën Civile.

6.7 Intervista me qytetarë të rastësishëm në RMV

6.7.1 Intervista me qytetarë meshkuj

Intervista me pjesmarrësit meshkuj është realizuar njëkohësisht me shpërndarjen e pyetësorëve. Intervista është e pastrukturuar.

Pyetja e hulumtimit është:

1. Me rastin e vdekjes së prindërve, si është ndarë pasuria trashëgimore mes trashëgimtarëve ligjorë?

Rasti I parë: A.N nga Shkupi (37 vjecar) thotë: *“Unë kam njohuri të mjaftueshme në lidhje me të drejtën e trashëgimisë në pronën familjare, e di që pasuria trashëgimore duhet të ndahet në mënyrë të barabartë mes të gjithë trashëgimtarëve të rradhëvs së parë, por megjithatë kushtet ekonomike e pamundësojnë një ndarje të tillë. Unë kam 1 vëlla dhe dy motra. Që të gjithë jemi të martuar. Babai kishte në pronësi vetëm një shtëpi në të cilin jetonim së bashku me vëllezërit. Me rastin e vdekjes së babait, shtëpinë e kemi ndarë në marrëveshje me vëllaun tim, kurse motrat nuk kanë trashëguar asnjë. Edhe pse ato jetojnë në kushte të vështira ekonomike nuk kanë kërkuar pjesë nga pronësia e babait. Megjithatë me rastin e martesës së tyre atyre iu janë dhuruar stoli të cmueshme po që nuk janë të vlerës që përndyshe do të duhej të trashëgonin”.*

Rasti i dytë: R.S (48 vjecar) nga Tetova thotë: *“Unë kam 2 vëllezër dhe një motër, të gjithë jemi të martuar. Nëna ka vdekur para 7 viteve kurse babai para 2 viteve. Para vdekjes së tij babai ndau të gjitha paluejtshmëritë që I kishte në pronësi. Gjithë pasurinë e tij e ndau vetëm mes ne djemve, kurse motra asnjëherë nuk ka shpreh interesim për marrje të pjesës që asaj i takon pasi që ajo jeton në Danimarkë dhe gëzon kushte shumë të mira ekonomike”*

Rasti i tretë: “A.S (49 vjecar) nga Shkupi thotë: *“Unë kam tri motra dhe nuk kam asnjë vëlla. Me vdekjen e babait gjithë pasurinë që ishte në pronësi të tij e kam trashëguar vetëm unë. Motrat e mia nuk i kanë kushtet ekonomike shumë të mira por prapëseprap ata kanë hequr dorë nga pjesa ligjore e trashëgimisë me dëshirë.”*

Rasti katërt: R.M (40 vjecar) nga Shkupi thotë: *“Unë kam 4 vëllezër dhe 3 motra dhe të gjithë jemi të martuar. Në pronësi të babait tim janë shumë paluejtshmëri dhe luejtshmëri. Me rastin e vdekjes së tij, me marrëveshje kemi ndarë pasurinë që ishte në pronësi të tij. Pasurinë e kemi*

ndarë së bashku me vëllezërit por edhe motrat duke respektuar amanetin e babait. Ne djemtë kemi trashëguar paluejtshmëritë kurse motrat kanë trashgëuar të holla.

Rasti i pestët: V.S (41 vjecar) nga Shkupi thotë: “Unë kam 2 vëllezër dhe 1 motër. 2 vëllezërit e mi jetojnë në Amerikë, kurse në RMV jetojmë unë dhe motra ime. Kushtet ekonomike janë mesatarisht të mira. Unë kam trashëguar shtëpinë ku kam jetuar me prindërit kurse 2 vëllezërit e mi dhe motra kanë hequr dorë nga trashëgimia”.

6.7.2 Intervistë me qytetarë femra

Rasti I parë: E.C (56 vjecare) nga Tetova thotë: “ Unë kam vetëm një vëlla që jeton në RMV kurse prindërit e mi shumë vite kanë punuar në Gjermani, gjatë kësaj kohe ata kanë ndërtuar një shtëpi, kanë blerë një banesë dhe 3 vetura. Babai im gjithë pasurinë e tij ia ka dhuruar vetëm vëllaut tim I cili ka 3 djem. Vëllau im jeton në kushte shumë të mira ekonomike, kurse kushtet e mia nuk janë shumë të mira. Unë gjithmonë kam dashur të marr pjesën ligjore që më takon por që cdoherë kam hasur në mosmarrëveshje me vëllaun tim aq sa marrëdhëniet tona familjare janë ftohur. Për asrye të paragjytimeve nga shoqëria unë asnjëherë nuk kam inicuar procedurë ligjore.”

Rasti I dytë: V.N (47 vjecare) nga Shkupi thotë: Unë jam vajza e vetme në familjen time. Babai im ndërroi jetë para 2 viteve. Në pronësi të babait tim ishin shtëpia në të cilën jetojmë, një veturë dhe dy dycane bashkëpronar të të cilit ishin edhe axhallarët e mi. Unë dhe nëna ime kemi trashëguar vetëm shtëpinë në të cilën jetojmë dhe veturën e babait, kurse me dëshirën e babait tim, tokën dhe dycanin me testament ia ka dhuruar vëllezërve të tij, përkatësisht axhallarëve të mi”.

Rasti i tretë: H. B (43 vjecare) nga Shkupi thotë: “ Unë kam 2 vëllezër dhe 2 motra. Të gjithë jemi të martuar. Vëllezërit e mi dhe motrat e mia gëzojnë kushte shumë të mira ekonomike. Unë jetoj me ndihmë sociale, nuk jam e punësuar kurse bashkëshorti im ndërroi jetë para 2 viteve. Babai im para 1 viti ndau pronësinë e tij vetëm mes djemve të tij përkatësisht vëllezërve të mi

me crast edhe mua më dhuruan një banesë, kurse motrat e mia nuk kërkuan asnjë pronë të luejtshme apo të paluejtshme dhe u pajtuan me këtë mënyrë të ndarjes së trashëgimisë”

Rasti i katërt: S.Z (57 vjecare) nga Shkupi thotë: *“Unë kam një vëlla që jeton në Gjermani dhe një motër që jeton në RMV. Në pronësi ë prindërve të mi ishte shtëpia në të cilën jetoj dhe një veturë. Gjatë gjithë këtyre viteve për ta jam kujdesur unë, andaj babai im gjithë pronësinë e tij ma dhuroi vetëm mua. Kurse, vëllau dhe motra ime u pajtuan me këtë ndarje.”*

Rasti i pestë: A.K (43 vjecare) nga Tetova thotë: *“ Unë kam dy vëllezër, që të tre jemi të martuar. Babai kishte në pronësi vetëm një shtëpi në të cilën jetojnë vëllezërit e mi së bashku me familjet e tyre. Duke pasur parasysh që unë gëzoj kushte të mira ekonomike ndërsa vëllezërit e mi jetojnë në kushte të vështira ekonomike, gjatë ndarjes së pasurisë trashëgimore unë vullnetarisht kam hequr dorë nga pjesa ligjore që më takon “*

Përfundimi

- ❖ Pabarazitë gjinore janë të pranuar ose edhe të tolerueshme nga shoqëria, sidomos në zonat rurale. Kjo përbën një sfidë përsa i përket zbatimit të ligjeve dhe politikave për barazinë gjinore. Ka një preferencë që paluejtshmëria t’i përcjellet trashëgimtarit mashkull.
- ❖ Npraktikën gjyqësore konstatohet se në pjesën më të madhe të rasteve, kur trashëgimlënësi e ka disponuar vullnetin e tij me testament, disponon në favor të trashëgimtarëve meshkuj. Gratë dhe vajzat ose janë përjashtuar nga trashëgimia ose kur janë caktuar si trashëgimtare testamentare, kanë për pjesë atë më të vogël të pasurisë trashëgimore.

- ❖ Tek familjet shqiptare dhe turke, tradita e trashëgimisë së pasurisë nga meshkujt është më e përhapur në krahasim me familjet maqedonase.
- ❖ Ndër faktor që vështirësojnë realizimin e drejtës trashëgimore të femrës llogaritet mënyra tradicionale e ndarjes së pasurisë dhe zbrazëtitat ligjore që mundësojnë influencim të traditës.
- Në ditët e sotme ekziston hendek i madh mes realitetit ekzistues dhe realitetit të dëshiruar mbi barazinë gjinore në trashgëimi.
- Institucionet publike nuk janë të përfshira në zbatimin e Ligjit mbi Barazi Gjinore edhe në fushën e trashëgimisë, kjo kuptohet edhe nga mungesa e statistikave për pranim apo heqje dorë nga trashgimia në bazë gjinore.
- Aktvdekja është dokumenti ligjor që përcakton trashëgimtarët e mundshëm dhe njëherit përbën akt noterial në bazë të të cilit ndahet formalisht pasuria bazuar vetëm mes trashëgimtarëve të listuar. Bazuar në Ligjin Për Procedurën Jokontestimore Aktvdekja hartohet në bazë të të dhënave që janë marrë nga personat me të cilët ka bashkëjetuar i vdekuri, si dhe nga personat e tjerë që mund të japin të dhëna që shënohen në Aktvdekje. Këto të dhëna zakonisht nuk verifikohen nga asnjë nëpunës civil dhe as nuk bëhet hulumtimi rutinë i ekzistimit të trashëgimtarëve shtesë (femra), pasi nuk ka kërkesë ligjore për një gjë të tillë.
- Mungojnë të dhëna elektronike lidhur me organizimin familjar të qytetarëve gjë që le mundësinë të deklarimeve të rregjshme apo mashtimeve të formave të ndryshme.
- Ligji për Procedurë Jokontestimore lejon që trashëgimtarët të vendosin lirisht se si të ndajnë pasurinë në mes tyre. Në kontekstin e traditës kjo mund të bëjë lehtësisht të mundur ndarjen e pasurisë në mënyrë të pafavorshme për trashëgimtarët femra.
- Ligji lejon trashëgimtarin të heqë dorë nga trashëgimia: - Shpesh përfitohet prej këtij mekanizmi apo mjeti ligjor, duke dal nga konteksti për të cilin është parashikuar. Heqja dorë nga trashëgimia realizohet me mjete të lejuara ligjore, por shpesh herë në kundërshtim me qëllimin e ligjit. Heqja dorë dhe përjashtimi i femrave nga trashëgimi realizohet edhe nëpërmjet veprimeve që mbartin në vetvete elemente të veprës penale, e që me gjithë këtë ndodh të aplikohen.

- Mos vetëdijësimi i shoqërisë në lidhje me atë se sa e rëndësishme është të trajtohen barabar fëmijët nga prindërit edhe në kontekst të pasurisë.

Rekomandimet

- Të hyjë në funksion baza elektronike e të dhënave me crast dëshmia me vdekje dhe përcaktimi i trashëgimtarëve në filim të procesit të ndarjes së trashëgimit të mos varet nga deklarata të inicuesve të procedurës, por të jenë automatike. (Nëse caktimi trashëgimtarëve do të bëhej me automatizëm në mënyrë elektronike përmes certifikatës të vdekjes atëherë mundësia për fshehje të trashëgimtarëve do të ulej).
- Të krijohet qasje e drejtpërdrejtë dhe e kontrolluar e gjykatësve dhe noterëve në bazën e regjistrit të gjendjes civile.
- Gjykata të mbykqyrin aktin e heqjes dorë. Të kërkohet një seancë e vecantë gjyqësore për trashëgimtarët që shprehin qëllimin e tyre për të hequr dorë nga trashëgimi.
- Betim solemn i trashëgimtarëve që nuk kanë dhënë deklarata të rrejshme.
- Publikim në internet- për çdo kërkesë jokontestimore të trashëgimisë; një bazë elektronike dhe publike e të dhënave e cila do të mirëmbahet nga Ministria e Drejtësisë. Publikimi i gjerë i njoftimeve të kërkesave do të ndihmojë për t'i bërë procedurat më transparente dhe për të siguruar se të gjithë trashëgimtarët e mundshëm dhe palët e interesuara kanë njohuritë e nevojshme për të kërkuar të drejtat e tyre.
- Ministria e Arsimit të fus në kurikulat e arsimit fillor dhe të mesëm informacione shtesë për të drejtat e femrave në trashëgimi.
- Fushata intensive publike në terren për të informuar qytetarët për drejtat në trashëgimi dhe njëkohësisht tërheqje e vërrejtjes për dënimet penale për fshehje, deklarime të rrejshme dhe imponimi për heqje dorë. Të organizohen trajnime për

gjykatësit, noterët me qëllim të rritjes së ndjeshmërisë ndaj rasteve të cilat kanë të bëjnë me çështjet gjinore dhe trashëgiminë pronësore.

- Ndërgjegjësimi i gruas dhe shoqërisë mbi të drejtat pronësore të grave.
- Trajnime të stafëve të institucioneve që merren me të drejtat e pronësisë, fushata sensibilizuese për informimin dhe promovimin e të drejtave të grave.

Bibliografia

1. Aliu, A. & Gashi, H. (2007) E Drejta Familjare, Prishtinë.
2. Alstott, A. (2007) "Equal Opportunity and Inheritance Taxation", Yale Laë School Yale Laë School
3. Araviashvili, M. (2014) "Gender aspects of inheritance management in Georgia cultural practices vs laë regulation" in: Problems of Management in the 21st century Vol9 No.3

4. Azīm, Sh.A (2008) Gratë Në Islam kundrejt grave në traditën judeo-kristiane : Miti-Realiteti “
5. Ashtalkovska -Gajtanoska, A. (2017)“The daughter ëho gave up her inheritance: Ethnography of ëomen’s inheritance rights and their application in contemporary Macedonian context”,Scientific article, Institute of ethnology and anthropology, Skopje, Issues in Ethnology and Anthropology , vol. 12.
6. Abazi -Gashi, J. (2014)“ FEATURE-Balkan ëomen face fight to inherit property”
7. Analizë ligjore mbi të drejtat e pronësisë së gruas në zonën bregdetare të Jugut (A.L.T.R.I), (2012)
8. Analizë mbi njohuritë dhe qëndrimet e grave dhe burrave të komunave të Kaçanikut, Vitisë e Shtërpcës rreth të drejtës në pronë dhe trashëgimi “, (2018) Publikuar nga Kosova – Ëomen 4 Ëomen, Prishtinë.
9. Agencija za fundamentalnrite prava na Evropskata Unija (2010) “Priracnik za evropskoto pravo za nediskriminacija” , Shkup.
10. Bariati, S. & Viarengo, I. & C.Villata, F. (2013) “ Toëards the entry into force of the succession regulation : Building future uniformity upon past divergencies “ University Degli Studi di Milano
11. Bicoku, N. (1984) “ E drejta e trashëgimisë e RPSSH-së , Tiranë
12. Biçoku, N. (1997) “E Drejta e Trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë”. Tiranë
13. Berisha, Lorana (2017) “Proerty right comparative analysis betëeen Kanun and laë of Kosovo”, Ljbljana
14. Begeja, K, (1984), “ E drejta familjare”, Tiranë
15. Bose, N. Das, Sh. (2014) “Can improving ëomen’s inheritance rights improve the ëelfare of ëomen?”
16. Bielenin, L. (2016) “An albanian ëife and Macedonian “ national purity” Ethnologia Polona, vol. 36: 2015 (2016), 155 – 169 PL ISSN 0137 -4079
17. Caseau, B.& R. Huebner, S. (2014) “A cross-cultural approach to succession and inheritance in the ancient and mediaeval Mediterranean” in “Inheriatance, laë and religions in the ancient and mediaeval ëorlds” edited by Béatrice Caseau & Sabine R.

Huebner, College de France- CNRS Centre de Recherche D'histoire et civilization de byzance . MONOGRAPHIES 45

18. Cenova- Mitrevska, T. (2017) "Land and gender Macedonian experience" paper prepared for presentation at the "2017 World Bank Conference on Land and Property" The World Bank Washington DC 20-24 2017
19. Centar za istraživanje i kreiranje politiki "Kon rodovo ravnopravna Makedonija"
20. CELEX (2008) "Equality between man and women in the UE" Official Journal of the European Union
21. CELEX (2013) "Gendercide: the missing women?" Official Journal of the European Union
22. CELEX (2012) Regulation (EU) No 650/2012 OF THE European Parliament and of the Council of 4 July 2012 on jurisdiction, applicable law, recognition and enforcement of decisions and acceptance and enforcement of authentic instruments in matters of succession and on the creation of a European Certificate of Succession," Official Journal of the European Union
23. CELEX (2017) "Women and their roles in rural areas" Official Journal of the European Union
24. CELEX (2014) "Role of property and wealth creation in eradicating poverty and fostering sustainable development" Official Journal of the European Union.
25. Dokmanovic, Mirjana (2016) "Gender analysis for Serbia ", Letter of Contract N°2016/377481 final report.
26. Daskalova, K. & Zimmermann, S. (2015) "Women's and Gender History" in: Irina Livezeanu, Arpad von Klimó (eds), The Routledge History of East Central Europe since 1700
27. Dragovaja, M. (1996) "Kanuni i Lek Dukagjinit, Shqipëri dhe Kanuni i Dagestanit", Tiranë.
28. Dousset-Seiden, Ch. (2012) "The French Civil Code, women and Inheritance in Southern France" XVI th World Economic History Congress, Jul 2012, Stellenbosch, South Africa.

29. European Commission (2017) "Report on equality between women and men in the EU"
ISSN: 2443-5228
30. EULEX (2016) "Women and inheritance rights to real estate in Kosovo"
31. Elezi I.(2006) " Kanuni I Labërisë" Tiranë
32. F. Radford, M. (2000) "The Inheritance Rights of Women Under Jewish and Islamic Law",
Boston College
33. Foxhall, L. "Female inheritance in Athenian law" Woman Property conference organized
by and collection edited by Deborah Lyons Raymond Westbrook
34. Gatejanu, S. L. ("Conflict of laws in matters of goods and succession" University of
Bucharest, Law School.
35. Galgano, F. (2006)" E drejta Private" Tiranë, botimi I tretë.
36. Gruevska, M. (2018) " Nasledovanje vo bratna I simejna zajednica vo R.Makedonija so
komparativna analiza" ,Manastir
37. Gjeqovi, Sh. (1933) "Kanuni I Lekë Dukagjinit" Shkodër.
38. Gjinoçi, Rr. (2016) " E drejta e grave për trashëgimi në pronë", Prishtinë
39. Halimi, K. (1994) "Studime etnologjike" IN:Prishtina: Instituti Albanologjik
40. Heine, S.(2015) "The EU approach to Gender: Limitations and Alternatives" European
policy brief, no.40
41. Htun, M. & Weldon, S. L. (2011) "State Power, Religion, and Women's Rights: A
Comparative Analysis of Family Law" Indiana Journal of Global Legal Studies, volume
18, issue 1, article 7
42. Ibrahim, Sh. (2011) " Inheritance by testament in " Institut of legacy in the testament
" Iliria International Review , Issue 2011/1
43. Joireman, S. (2015) "Resigning their rights? Impediments to Women's property
ownership in Kosovo" in Global Trends in Land Tenure reforms : Gender impact , edited
by Caroline Archambault and Annelies Zoomers, Routledge
44. Jayachandran, S. (2014)" The Roots of Gender Inequality in Developing Countries",
Northeastern University , Prepared for Annual Review of Economics.
45. Ken, Dh. (2007) " E drejta Romake", Tiranë

46. Krstevska, N. (2016) "Pravni osnovi za steknuvanje na pravoto na sopstvenost vo Republika Makedonina, so poseben osvrt na pravnata zastita na pravoto na sopstvenost" Manastir.
47. Kotevska, B. (2018) "Country report Non-discrimination The former Yugoslav Republic of Macedonia 2018"
48. Luarasi, A. (2001) "Marrëdhëniet Familjare" Botim i SHB Luarasi, Tiranë
49. Lastarria-Cornhiel, S. & Echeleer, R. (1998) "Gender, Ethnicity, and Landed Property in Albania", working paper, no.18, University of Wisconsin Madison.
50. Laurence, A. "Women and the Transmission of Property: Inheritance in the British Isles in the 17th Century"
51. Mandro-Balili, A. (2016) "Të drejtat pronësore të grave në Shqipëri - Analizë e standardeve ligjore dhe e zbatimit të tyre në praktikë", Tiranë.
52. Mandro- Balili, A. (2014) "Diskriminimi gjinor në çështjet familjare e martesore", Tiranë.
53. Mandro- Balili, A. (2016) Women's property rights in Albania - An Analysis of Legal Standards and their Application", second edition, Tiranë.
54. Meha, B. & Meha, M. (2018) "Case study: Progress analysis of property rights of women in Kosovo" Paper prepared for presentation at the "2018 World Bank Conference on land and property" The World Bank - Washington DC
55. Macula Krasniqi, Donita & Craëford, Paula (2015) " To inherit or not to inherit the role of laë" in [HTTPS://KOSOVOTËOPOINTZERO.COM/EN/TO-INHERIT-OR-NOT- TO-INHERIT-THE-RULE-OF-LAË/](https://KOSOVOTËOPOINTZERO.COM/EN/TO-INHERIT-OR-NOT- TO-INHERIT-THE-RULE-OF-LAË/)
56. Mickovic, D. & Ristov, A. (2012) "Reformite vo naslednoto I semejnoto pravo I ingerenciite na notarite" Notarius nr. 19, Shkup
57. M. Paasch, J. (2011) "Classification of real property rights – A comparative study of real property rights in Germany, Ireland, the Netherlands and Sweden", TRITA-FOB Report 2011:1, ISBN 987-91-85783-16-8, Stockholm, Sweden
58. Mitevski, N. (2017), " Normativniot system kako del od komunikativnata situacija I negovata aplikacija vo ostavinskata postapka ", Manastir

59. Naumovski, B. (2017) "Zakonskoto nasleduvanje vo Republika Makdonia so osvrt vo neкои Evropski zemji", Manastir.
60. National Committee for Family Farming (2017) "Family agricultural economy in Republic of Macedonia" Skopje
61. OECD (2015) "The SIGI regional report Europe and Central Asia"
62. Projekt i financuar nga BE i menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë dhe i zbatuar nga Konzorciumi i kryesuar nga GIZ Shërbimet Ndërkombëtare (2015) "Vlerësim ligjor i legjislacionit ekzistues për fushat në lidhje me Kodin Civil në dritën e standardeve dhe praktikës më të mirë ligjore të BE-së: Ligji për Trashëgiminë", Prishtinë.
63. Poposka, Zh. & Jovevski L. (2017) "Antidiskriminacisko" Shkup.
64. Podvorica, H. (2006), " E drejta trashëgimore ", Prishtinë.
65. Pulejkova, Z. (2018) "Family and succession laë" IV Colloque des Notariats euroméditerranéens
66. Rama, A. (2013) "Property rights issues in Albania: Challenges and perspectives" Tiranë.
67. Rab, A. & Mahmud, H. (2018) "The Quranic Inheritance Laë: The Case for a Gender-Neutral Understanding"
68. Rath – Boşca, L.D. & Barmoş , L. M. & Stănescu, I. A. (2016) "The need to harmonize the laës of the European Union regarding the succesion laë" Agora International Journal of Economical Sciences, aijes,ISSN ISSN 2067-3310, E - ISSN 2067 – 7669, VOL 10 (2016)
69. Radevska M. (2012) " Praktikum za nasledno pravo" , Kocani
70. Ristov, A. (2012)" Dali e potreben dogovorot za nasleduvanje vo makedonskoto nasledno pravo" Notarius nr.19/2012, fq.70-82. Shkup.
71. Ristov, A. (2012) "Za potreбата od ureduvanje na notarski testament vo makedonskoto nasledno pravo-de lege ferenda", Notarius nr. 32, Shkup
72. Rheeder, A. Lotter, G. (2017) "An evaluation of the cultural practices and ëomen's inheritance rights in Iboland, Eastern Nigeria: A theological- ethical study" Dissertation

submitted in fulfilment of the requirements for the Degree Master of Arts in Ethics at the Potchefstroom Campus of the North-Ėest University

73. Raport 75930 – KV (2012) “Kosova: Dallimet Gjinore në Arsim, Shëndetësi dhe Mundësitë Ekonomike”
74. Sadiku, F. (2015) “ E drejta e trashëgimisë tek Gratë – Gjyqësori dhe Nateria sfidues apo lehtësues të kësaj të drejte”, Lipjan
75. Ismaili, H.. & Sejdiu, F (2000) Historia e përgjithshme e shtetit dhe e së drejtës. Prishtinë.
76. Salihu, G. (2018) “Redesigning procedures to encourage legal recognition of informal relations to property: challenges posed by informal inheritance in Kosovo “, Paper prepared for presentation at the “2018 Ėorld Bank Conference on land and property” The Ėorld Bank - Ėashington DC,
77. Szydlík, M. (2004) “Inheritance and Inequality:Theoretical Reasoning and Empirical Evidence” IN European Sociological Review VOLUME 20 NUMBER 1
78. Sperling, Jutta “Doëry or inheritsve? Kinship, propertyand Ėoman agency in Lisbon, Venice, and Florence (1572)
79. Sergio Goekmen, A. (2016) “Succession Laë of the European Union and its effect on Sëitserland”
80. Smith, M. P. (1993)”The origin and history of Hebreë laë”, Chicago
81. Sefa, E. & Lushnje A. (2012) “Albanian Ėomen during Monarchy (1928-1939)” International Journal of Humanities and Social Science Vol. 2 No. 24 [Special Issue – December 2012]
82. Social Institutions & Gender Index (SIGI) (2014) Synthesis Report, OECD
83. Stojanoska, D. & Bianchini, S. (2006) ” Gender Equality and Human Development in Macedonia during Transition (1991-2006)”, Alma Mater Studiorum – Università degli Studi di Bologna PhD in International Cooperation and Sustainable Development Policies (XIX Cycle)
84. Stojanovic, N. (2003) “ Zasto je ugovor o nasledivanju zabranjen u nasem pravu? , Beograd

85. Shopovski, J. " Legal frameëork concerning gender equality in Republic of Macedonia"
European Scientific Journal
86. Tomevska, R. ""Ulogata na zenata vo makedonskoto opshtestvo", Uniersitet "Goce Delcev" Filoloski Fakultet
87. USAID & Minstry of Justice (2016) " Strategjia kombëtare për të drejtat pronësore në Kosovë"
88. Vorpsi, L. (2001) " Trashëgimia në të drejtën ndërkombëtare private" disertacion doktore e mbrojtur në Tiranë
89. Vërbani, M. (2013) " E drejta trashëgimore në islam", Shkup
90. Vajs, A. & Kandiq, L. (1984) "Historia e Përgjithshme e Shtetit dhe e së Drejtës". Botimi i Tretë. Universiteti i Kosovës në Prishtinë
91. Elchman, L. (2007)" Eomen and muslim family laës in Arab States An comparativ overvieë of textual development and advocacy ", Amstesrdam University
92. Eyrod, R. (2008) " Betëeen eoman's rights and men's authority: Masculinity and shifting discourses of gender difference in urban Uganda "Published in final edited form as: Gend Soc. 2008 ; 22(6): 799–823. doi:10.1177/0891243208325888.
93. E. Eilers, (1932) "Die Gesetzesstele Chammurabis" Lipsia
94. Xhafaj, J. & Nrecaj, A. "Të drejta pronësore dhe trashëgimore të grave", Prishtinë.
95. Young, A. (2002) "Eomen 's lack of identity and the mith of their security under albanian patriarchy in Albania", published in: KASER, Karl; KRESSING, Frank (eds.), Albania – A country in Transition. Aspect of Changing Identities in a South-East European Country. Baden-Baden: Nomos-Verlag 2002, pp. 91 ff.
96. Zakir Abdul Kerim Naik (2010) " Ansëers to non-mualima common questions about islam", botimi I parë.
97. Załucki, M. "Attempts to Harmonize the Inheritance Laë in Europe: Past, Present, and Future"
98. Załucki, M. (2017) "Disinheritance Against The EU Regulation on Succession (No. 650/2012) Polish Laë Perspective" European Journal of Economics, Laë and Politics, ELP June 2017 edition Vol.4, No.2 ISSN 2518-3761

Legjislacioni nacional

1. Zakon za ednakvi moznosti pomegu zenite I mazite, SI Vesnik na RM br. 66/06, 29.05.2006
2. Zakon za izmenuvanje na Zakonot za obligacionite odnosi, SI. Vesnik na RM , br. 84/2008
3. Zakon za nasledstvo, SI Besnik na RM br. 47, 12.09.1996
4. Zakon za semejstvo , SI Vesnik na RM br. 153, 20.10.2014
5. Zakon za sopstvensot I drugi stvarni prava , SI Vesnik na RM br, 18, 15.03.2001
6. Zakon za vonparnicna postapka SI. Vesnik na RM br. 9/2008.

Legjislacioni i huaj

1. Ligji nr. 7829/1.6.1994 “Për noterinë”, Shqipëri
2. Ligjit Nr. 03/L-010 për Noterin, Kosovë
3. Ligji për Tashëgiminë në Kosovë Nr. 2004/26 (1 gusht, 2006).
4. Ligji Ligji Nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës,
5. Ligjit Nr. 03/L-007 Për Procedurën Jokontestimore, Kosovë
6. Zakon za nasledivanju u R.Srpskoj, SI .glasnik 1/2009
7. Zakon za nasledovanje u Crnoj Gore, “ Sluzbeni list Crne Gore, br. 74/2008, 5.12.2008

Legjislacioni dhe materiale të Unionit Evropian

1. CEDAË (2004) , Consideration of Reports Submitted by States Parties under Article 18 of the Convention the Elimination of All Forms Discrimination against Women: From, Combined initial, Second and Third Reports of States Parties , CEDAË/C/MKD1-3, Neë, York
2. Charter of Fundamental Rights of the EU Right by Right Analysis 5/12/2017
3. Compilation on case laë of the European Court of Human Rights on Gender equality issues (2018) Strasburg
4. Regulation (Eu) No 650/2012 Of The European Parliament And Of The Council of 4 July 2012 on “Jurisdiction, applicable laë, recognition and enforcement of decisions and

acceptance and enforcement of authentic instruments in matters of succession and on the creation of a European Certificate of Succession”, OJ L 201, 27.7.2012.

Shtojca

Pyetësor për gjykatës dhe avokatë

Qëllimi i këtij pyetësi është nxjerrja e të dhënave më të detajuara mbi nivelin e realizimit të drejtës trashëgimore të femrës në RMV si dhe identifikimi i faktorëve që ndikojnë në mospërfshirjen e saj në pjesën ligjore të trashëgimisë. Të dhënat do të përdoren vetëm për qëllime akademike (disertacioni). Opinioni juaj është shumë i rëndësishëm për hulumtimin. Ju lutem, rrethoni opcionet që ju mendojnë se janë të vërtetë. Faleminderit për bashkëpunimin!

Emri dhe mbiemri i gjykatësit/avokatit _____

Qyteti _____

1. Në dekadën e fundit, në Gjykatën Themelore të Shkupit/ Tetovës (apo tjetër), procedurat kontestuese trashëgimore (pronësore familjare) më shpesh janë inicuar me kërkesë të:
 - a) Trashëgimtarit/ve meshkuj.
 - b) Trashëgimtarit/ve femër.
 - c) Trashëgimtarëve potencial pa dallim gjinor.
2. Në përditshmëri, në Gjykatën Themelore të Shkupit/Tetovës (apo tjetër), më shpesh si palë procedural në rastet kontestuese trashëgimore (pronësore familjare) paraqiten:
 - a) Vetëm djemtë e trashëgimlënësit.
 - b) Djemtë dhe vajzat e trashëgimlënësit.
 - c) Vetëm vajzat e trashëgimlënësit.
 - d) Tjetër.
3. Në dekadën e fundit, në Gjykatën Themelore të Shkupit/Tetovës (apo tjetër), a është inicuar ndonjë procedurë kontestimore ku palë procedural janë djemtë dhe vajzat e trashëgimlënësit, ndërsa fakt kontestues është e drejta për trashëgimi?
 - a) Raste të tilla kontestuese janë inicuar shumë shpesh.
 - b) Raste të tilla kontestuese janë inicuar shumë rrallë.
 - c) Deri më tani nuk janë inicuar raste të tilla kontestuese.

4. Në dekadën e fundit, në Gjykatën Themelore të Shkupit/Tetovës (apo tjetër), a është inicuar ndonjë procedurë kontestimore ku palë procedural janë djemtë dhe vajzat e trashëgimlënësit, ndërsa fakt kontestues është madhësia e pasurisë trashëgimore?
- a) Po, raste të tilla kontestuese inicohen shumë shpesh
 - b) Po, mirëpo raste të tilla kontestuese inicohen shumë rrallë.
 - c) Në Gjykatën Themelore të Shkupit/Tetovës (apo tjetër), deri më tani nuk janë inicuar raste të tilla kontestuese.
5. Në dekadën e fundit, Gjykatën Themelore të Shkupit/Tetovës (apo tjetër), a është inicuar ndonjë procedurë kontestimore mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit si palë, ku fakt kontestues është vlefshmëria apo përmbajtja e testamentit?
- a) Po, raste të tilla kontestuese inicohen shumë shpesh
 - b) Po, mirëpo raste të tilla kontestuese inicohen shumë rrallë.
 - c) Gjykatën Themelore të Shkupit/Tetovës (apo tjetër) deri më tani nuk janë inicuar raste të tilla kontestuese
6. Në dekadën e fundit, Gjykatën Themelore të Shkupit/Tetovës (apo tjetër), a është inicuar ndonjë procedurë kontestimore mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit si palë, ku fakt kontestues është cenimi i pjesës së domosdoshme të trashëgimisë të trashëgimtarit femër?
- a) Raste të tilla inicohen shumë shpesh.
 - b) Raset të tilla inicohen rrallë, trashëgimtari femër shpesh heq dorë nga pjesa e domosdoshme e trashëgimisë.
 - c) Deri më tani nuk janë inicuar raste të tilla.
7. Në kadën e fundit, në Gjykatën Themelore të Shkupit/Tetovës (apo tjetër), a është inicuar ndonjë procedurë kontestimore mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit, ku fakt kontestues janë rrethanat që kanë nxitur “heqjen dorë nga trashëgimia”?

- a) Po, raste të tilla kontestuese inicoohen shumë shpesh.
- b) Po, mirëpo raste të tilla kontestuese inicoohen shumë rrallë.
- c) Gjykatën Themelore të Shkupit/Tetovës (apo tjetër), deri më tani nuk janë inicuar raste të tilla kontestuese.

8. A mendoni se përfitohet nga mjeti ligjor “heqje dorë nga trashëgimia”, duke dal nga konteksti për të cilin është parashikuar?

- a) Cdoherë
- b) Asnjëherë
- c) Ndonjëherë

9. Në praktikën aktuale, cili nga aktet juridike të mëposhtme, zbatohet për të arritur qëllimin e trashëgimlënësit- shmangia e trashëgimtarit femër (bashkëshortes, vajzave, motrave, mbesave etj) nga pjesa ligjore e trashëgimisë?

- a) Testamenti
- b) Kontrata për mbajtje të përhjetshme
- c) Kontrata për dorëzim dhe ndarje të pasurisë.
- d) Tjetër

10. A mendoni që krahas ligjit dhe testamentit në RMV duhet të aplikohet edhe Kontrata për Trashëgimi si bazë më e fortë juridike për fitimin e trashëgimisë?

- a) Po
- b) Jo
- c) Skam përgjigje.

Pyetësor për noterë

Qëllimi i këtij pyetësi është nxjerrja e të dhënave më të detajuara mbi nivelin e realizimit të të drejtës trashëgimore të femrës në RMV si dhe identifikimi i faktorëve që ndikojnë në mospërfshirjen e saj në pjesën ligjore të trashëgimisë. Opinioni juaj është shumë i rëndësishëm për hulumtimin. Të dhënat do të përdoren vetëm për qëllime akademike. Përgjigjet e juaja do të përpunohen në mënyrë të fshehtë. Padiskutim marr përsipër ruajtjen e konfidencialitetit.

Ju lutem, klikoni në opcionet që ju mendeni se janë të vërtetë.

Faleminderit për bashkëpunimin!

1. Si inicohet procedura trashëgimore, në praktikë?
 - a) sipas detyrës zyrtare ashtu sic është paraparë me ligj d.m.th organi komunal i gjendjes civile dërgon Aktvdekjen në Gjykatë.
 - b) trashëgimtarët potencial vet inicojnë procedurën trashëgimore.

2. Në përitshmëri, me kërkesën e cilëve trashëgimtarë më shpesh inicohet procedura për shqyrtim të trashëgimisë?
 - d) Me kërkesën e trashëgimtarit/ve meshkuj
 - e) Me kërkesën e trashëgimtarit/ve femër
 - f) Me kërkesën e trashëgimtarëve potencial pa dallim gjinor.

3. Në praktikë, Aktvdekja përpilohet:
 - a) Vetëm nga noteri
 - b) Vetëm nga Zyra e Gjendjes Civile
 - c) Noteri ose Zyra e Gjendjes Civile.

4. Noteri, a bashkëpunon me institucionet tjera juridike për verifikimin e informacionit të dhënë në Aktvdekje?
 - a) Jo, bazohet tek të dhënat që merren nga personat që kanë bashkëjetuar me të ndjerin ose personat tjerë që mund të japin informacione për të.

- b) Noteri ka qasje elektronike të obligueshme për verifikim të të dhënave.
- c) Nuk ka qasje elektronike për verifikimin e të dhënave.

5. Në praktikë, në raste të dyshimit në lidhje me fshehjen e ndonjë trashëgimtari ligjorë apo vlerësimi të gabuar të vlerës Neto të pjesës trashëgimore në Aktvdekje, Noteri obligohet të njoftoj zyrën e prokurorit?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk ka obligim ligjor.

6. A mendoni se mungesa e të dhënave elektronike lidhur me organizimin familjar të qytetarëve lehtëson fshehjen e trashëgimtarëve ligjorë?

- a) Po
- b) Jo
- c) Ndoshta.

7. Cila nga mënyrat e poshtëshënuara të ndarjes së pasurisë trashëgimore aplikohet më shpesh në përditshmëri?

- a) Ndarje e pasurisë trashëgimore marrëveshjen paraprake mes trashëgimtarëve duke respektuar dispozitat ligjore,
- b) Ndarje e pasurisë trashëgimore marrëveshjen paraprake mes trashëgimtarëve duke respektuar rregullat e besimit fetar të cilit i përkasin,
- c) Ndarje e pasurisë trashëgimore marrëveshjen paraprake mes trashëgimtarëve duke respektuar traditë.

8. A mendoni se përfitohet nga mjete ligjor “heqje dorë nga trashëgimia”, duke dal nga konteksti për të cilin është parashikuar?

- a) Cdoherë
- b) Asnjëherë

c) Ndonjëherë

9. A pajtoheni që zbrazëtirat ligjore lënë mundësi të influencimit të rregullave të traditës patriakale?

- a) Pajtohem
- b) Nuk pajtohem

10. A pajtoheni se duhet të organizohet seancë e vecantë gjyqësore jashta lokaleve të noterisë, për trashëgimtarët që heqin dorë nga trashëgimia pronësore?

- a) Po
- b) Jo.

11. Noteri, a është i obliguar të informoj trashëgimtarët në lidhje me pasojat nga heqja dorë nga pasuria trashëgimore?

- a) Po, ka obligim ligjor
- b) Jo, nuk ka obligim ligjor,

12. Në RMV, në praktikë më shpesh zbatohet:

- a) trashëgimia ligjore.
- b) trashëgimia testamentare.

13. Femrat më shpesh heqin dorë në cilësi të:

- a) Trashëgimtares ligjore
- b) Trashëgimtares testamentare.

14. Cila formë e testamenteve të poshtëshënuara aplikohet më shpesh në praktikë?

- a) Testamenti gjyqësor
- b) Testamenti me akt notarial
- c) Testamenti ollograf.

15. Trashëgimarët testamental më shumë i përkasin:

- a) Gjinisë femërore
- b) Gjinisë mashkullore.

16. Numerikisht, ne RMV më shumë trashëgojnë femrat që i përkasin besimit fetar:

- a) Islam
- b) Krishter
- c) Tjetër

17. Statistikisht, ne RMV më shumë trashëgojnë femrat që i përkasin nacionaliteti:

- a) Shqiptar
- b) Maqedonas
- c) Turk
- d) Tjetër.

18. A mendoni se qytetarët e RMV -së, kanë njohuri të mjaftueshme mbi të drejtën trashëgimore si e drejtë themelore që garantohej me ligj?

- a) Po
- b) Jo
- c) Ndoshta

19. A dallon praktika aktuale trashëgimore krahasuar me praktikat zakonore dhe praktikat tjera që kanë egzistuar para hyrjes në fuqi të Ligjit mbi Trashëgiminë dhe akteve tjera juridike përmes së cilëve garantohej barazi dhe mosdiskriminim gjinor?

- a) Dallon shumë
- b) Dalon pak
- c) Nuk dallon aspak.

20. Femrat më shpesh disponojnë me të drejtën e trashëgimisë atëherë kur thirren në rolin e :
- a) Bashkëshortes
 - b) Vajzës
 - c) Motrës
 - d) Mbesës.
21. Në ditët e sotme, femrat a disponojnë të drejtën për trashëgimi në pronën familjare?
- a) Femrat në RMV, disponojnë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare.
 - b) Femrat në RMV, rrallë disponojnë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare.
 - c) Femrat në RMV, nuk disponojnë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare.
22. Cilët nga trashëgimtarët (meshkuj dhe femra) të shënuar në Aktvdekje më shpesh disponojnë të drejtën e trashëgimisë në pronën familjare?
- a) Më shpesh trashëgimtarët meshkuj dhe më rrallë trashëgimtarët femra
 - b) Më shpesh trashëgimtarët femra dhe më rrallë trashëgimtarët meshkuj.
23. Cilët nga trashëgimtarët e shënuar në Aktvdekje më shpesh heqin dorë nga trashëgimia në pronën familjare?
- a) Meshkujt
 - b) Femrat
24. Në lokalet e Noterisë a mbahet evidencë statistikore për qytetarët (meshkuj dhe femra) që heqin dorë nga trashëgimia?
- a) Po
 - b) Jo

25. Në lokalet e Noterisë a mbahet evidencë statistikore për qytetarët (meshkuj dhe femra) që pranojnë dhe disponojnë të dretjën e trashëgimisë?
- c) Po
 - d) Jo
26. Sa ndikon roli i Noterit në mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtës trashëgimore në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminues?
- a) Ndikon shumë
 - b) Ndikon pak
 - c) S'ka ndikim aspak
27. Cilat nga aktet noteriale të poshtëshënuara zbatohen më shpesh në përditshmëri?
- e) Testamenti
 - f) Kontrata për mbajtje të përhjetshme
 - g) Kontrata për dorëzim dhe ndarje të pasurisë
 - h) Kontrata për dhurim
 - i) Tjetër.
28. A mendoni se është e nevojshme të hartohen dhe zbatohen programe dhe strategji afatgjate të cilat do të mund të ndikojnë në ndryshimin e skemave dhe modeleve paragjyquese të sjelljes për rolet e femrave dhe meshkujve në shoqëri?
- a) Po
 - b) Jo
29. A pajtoheni se është i domosdoshëm modifikimi i ligjit mbi Trashëgimi i RMV-së nën dritën e praktikave të shteteve evropiane apo edhe më gjërë?
- a) Po
 - b) Jo
 - c) Nuk kam përgjigje

30. A mendoni që krahas ligjit dhe testamentit në RMV duhet të aplikohet edhe Kontrata për Trashëgimi si bazë më e fortë juridike për fitimin e trashëgimisë?

31. Po

32. Jo

33. Skam përgjigje.

Pyetësorë për meshkuj

Qëllimi i këtij pyetësori është nxjerrja e të dhënave më të detajuara mbi nivelin e realizimit të të drejtës trashëgimore të femrës në RMV si dhe identifikimi i faktorëve që ndikojnë në mospërfshirjen e saj në pjesën ligjore të trashëgimisë. Të dhënat do të përdoren vetëm për qëllime akademike. Pyetësori është anonim ndërsa përgjigjet do të trajtohen me fshehtësi.

Ju lutem, tek cdo pyetje rrethoni opcionin që ju mendoni se është i vërtetë.

Faleminderit për bashkëpunimin!

1. Mosha:
 - a) 18-25
 - b) 26-35vjet
 - b) 36-45 vjet
 - c) mbi 56 vjet

2. Niveli i arsimit:
 - a) fillor,
 - b) mesem
 - c) universitar
 - d) pasuniversitar

3. Vendbanimi:
 - a) fshat
 - b) qytet

4. Statusi martesor:
 - a) i martuar
 - b) i pa martuar

c) I ve

5. Statusi ekonomik

a) I punësuar

b) I pa punësuar

6.Përkatësia fetare

a) Musliman

b) Krishter

1. Sa keni njohuri mbi të drejtën e trashëgimisë pronësore?

a) Shumë

b) Mjaftueshëm

c) Pak

d) Aspak

2. A mendoni se trashëgimtarët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë pa dallim gjinor?

a) Po

b) Jo

c) Skam përgjigje

3. Sipas mendimit tuaj, kush duhet të trashëgojë pronësinë prindërore?

a) Ttrashëgimtarët ligjorë pa dallim gjinor.

b) Vetëm trashëgimtarët meshkuj.

c) Vetëm trashëgimtarët femra.

4. Si duhet të ndahet pasuria trashëgimore mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit?

a) Në mënyrë të barabartë mes djemve dhe vajzave.

b) Vetëm mes djemve në mënyrë të barabartë.

- c) Pjesa më e madhe e pasurisë duhet t'i jepet djalit, kurse një pjesë më e vogël vajzës.
 - d) Tjetër.
5. Sipas mendimit tuaj, vajza/ motra a duhet të trashëgojë sende të palëvizshme (shtëpi, tokë, dyqan) nëse konkurron në trashëgimi me vëllezërit e saj?
- a) Po
 - b) Jo.
 - c) Skam përgjigje
6. Sipas mendimit tuaj, a duhet vajza/motra të trashëgojë sende të lëvizshme si: veturë, para, sende të cmueshme?
- a) Po
 - b) Jo
7. A do të merrni pjesë në trashëgimi së bashku me motrën/motrat tuaja?
- a) Po
 - b) Jo
8. A do të pranoje ndarjen e trashëgimisë pronësore në mënyrë të barabartë motrën/at tuaja?
- a) Po
 - b) Jo
9. Si do të ishin marrëdhëniet familjare në qoftë se vajza/motra juaj kërkon pjesën ligjore të trashëgimisë pronësore familjare?
- a). Të mira
 - b). Jo të mira
 - c) Skam përgjigje

10.. A keni dëgjuar apo dini ndonjë rast në familjen tuaj apo më gjërë, ku pasuria trashëgimore është ndarë në pjesë të barabarata me djemve dhe vajzave të të ndjerit?

- a) Po
- b) Jo

11.A keni dëgjuar apo dini ndonjë rast në familjen tuaj apo jashtë saj, ku femra ka qenë e detyruar të heq dorë nga pjesa ligjore e trashëgimisë?

- a) Po
- b) Jo

12.A do të preferoje që vajza/motra juaj të heq dorë nga e drejta për trashëgimi në pronën prindërore?

- a) Po
- b) Jo
- c) Varret nga kushtet ekonomike

13. Cilat nga opsionet e poshtëshënuara preferoni për ndarjen e pasurisë tuaj?

- a) Pjesë të barabarta mes bashkëshortëve dhe fëmijëve pa dallim gjinor
- b) Mes bashkëshortëve dhe fëmijëve ashtuqë pjesa më e madhe e pasurisë do t'i takon djalit dhe një pjesë më e vogël për vajzat
- c) Mes bashkëshortit dhe fëmijëve ashtuqë pjesa më e madhe e pasurisë ti kalojë vajzës dhe një pjesë më e vogël për djemtë

14. Si ndikon heqja dorë nga trashëgimia në cilësinë e jetës së femrës?

- a) Pozitivisht
- b) Negativisht

15. Cilën nga mënyrat e poshtëshënuara preferoni si mënyre për ndarje të pasurisë trashëgimore?

- a) Ndarje të trashëgimisë sipas marrëveshjes paraprake mes trashgëimtarëve të mundshëm duke respektuar dispozitat ligjore
- b) Ndarje të trashgëimisë sipas marrëveshjes paraprake mes trashgëimtarëve të mundshëm duke respektuar besimin fetar të cilit i përkasin
- c) Ndarje të trashgëimisë sipas traditës.

16. A mendoni që mundësia për marrëveshje paraprake të ndarjes së pasurisë trashëgimore mes trashëgimtarëve, mundëson ndarjen e pasurisë në mënyrë të pafavorshme për trashëgimtarët femra?

- a) Po
- b) Jo
- c) Ndoshta

17. A dallon praktika aktuale trashëgimore krahasuar me praktikën zakonore dhe praktikën tjera që kanë egzistuar para hyrjes në fuqi të Ligjit mbi Trashëgiminë dhe akteve tjera juridike përmes së cilëve garantohej barazi dhe mosdiskriminim gjinor?

- d) Dallon shumë
- e) Dallon pak
- f) Nuk dallon aspak.

18. A pajtoheni që edhe përkundër ekzistimit të kornizës ligjore, institucionale e politike, dispozitat ligjore nuk zbatohen në praktikë dhe si pasojë pabarazia gjinore dhe diskriminimi gjinor në këtë fushë vazhdon të ekzistojë?

- a) Pajtohem
- b) Nuk pajtohem
- c) Edhe pajtohem edhe jo

19. Sipas mendimit tuaj, cilat nga këto faktorë pengojnë realizimin e të drejtës trashëgimore mbi pronën familjare?

- a) zbatim joefikas i ligjeve ekzistuese,
- b) praktika zakonore,
- c) mosnjohja e dispozitave ligjore nga qytetarët.
- d) mentaliteti mbizotërues.
- e) të gjithë faktorët e shënuar më lartë.

20. Në ditët e sotme, a realizojnë realisht femrat të drejtën për trashëgimi në pronën familjare?

- d) Femrat në RMV, gëzojnë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare.
- e) Femrat në RMV, rrallë gëzojnë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare.
- f) Femrat në RMV, nuk gëzojnë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare.

Pyetësorë për femra

Qëllimi i këtij pyetësori është nxjerrja e të dhënave më të detajuara mbi nivelin e realizimit të të drejtës trashëgimore të femrës në RMV si dhe identifikimi i faktorëve që ndikojnë në mospërfshirjen e saj në pjesën ligjore të trashëgimisë. Të dhënat do të përdoren vetëm për qëllime akademike. Pyetësori është anonim ndërsa përgjigjet do të trajtohen me fshehtësi.

Ju lutem, tek cdo pyetje rrethoni opcionin që ju mendoni se është i vërtetë.

Faleminderit për bashkëpunimin!

1. Mosha:

- c) 18-25
- d) 26-35vjet
- b) 36-45 vjet
- c) mbi 56 vjet

2. Niveli i arsimit:

- a) fillor,
- b) mesem
- c) universitar
- d) pasuniversitar

3. Vendbanimi:

- c) fshat
- d) qytet

4. Statusi martesor:

- a) i martuar
- b) i pa martuar
- c) I ve

5. Statusi ekonomik

- a) I punësuar
- b) I pa punësuar

6.Përkatësia fetare

- c) Musliman
- d) Krishter

1. Sa keni njohuri mbi të drejtën e trashëgimisë pronësore?

- e) Shumë
- f) Mjaftueshëm
- g) Pak
- h) Aspak

2. A mendoni se trashëgimtarët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë pa dallim gjinor?

- d) Po
- e) Jo
- f) Skam përgjigje

3. Sipas mendimit tuaj, kush duhet të trashëgojë pronësinë prindërore?

- d) Ttrashëgimtarët ligjorë pa dallim gjinor.
- e) Vetëm trashëgimtarët meshkuj.
- f) Vetëm trashëgimtarët femra.

4. Si duhet të ndahet pasuria trashëgimore mes djemve dhe vajzave të trashëgimlënësit?
- e) Në mënyrë të barabartë mes djemve dhe vajzave.
 - f) Vetëm mes djemve në mënyrë të barabartë.
 - g) Pjesa më e madhe e pasurisë duhet t'i jepet djalit, kurse një pjesë më e vogël vajzës.
 - h) Tjetër.
5. Sipas mendimit tuaj, vajza/ motra duhet të trashëgojë sende të palëvizshme (shtëpi, tokë, dyqan) në rastë se konkurren në trashëgimi me vëllezërit e saj?
- d) Po
 - e) Jo.
 - f) Skam përgjigje
6. Sipas mendimit tuaj, a duhet vajza/motra të trashëgojë sende të lëvizshme si: veturë, para, sende të cmueshme?
- c) Po
 - d) Jo
7. A do të merrni pjesë në trashëgimi së bashku me vëllezërit tuaj?
- a) Po
 - b) Jo
8. A do të pranoje ndarjen e trashëgimisë pronësore në mënyrë të barabartë me vëllaun/vëllezerit tuaj?
- c) Po
 - d) Jo

9. Si do të ishin marrëdhëniet familjare më vëllaunn/vëllezërit tuaj në qoftë së ju do të kërkonit të merrni pjesën e domosdoshme të trashëgimisë së pronës familjare?

- a). Të mira
- b). Jo të mira
- c) Skam përgjigje

10. A keni dëgjuar apo dini ndonjë rast në familjen tuaj apo më gjërë, ku pasuria trashëgimore është ndarë në pjesë të barabarata me djemve dhe vajzave të të ndjerit?

- a) Po
- b) Jo

11. A keni dëgjuar apo dini ndonjë rast në familjen tuaj apo jashtë saj, ku femra ka qenë e detyruar të heq dorë nga pjesa ligjore e trashëgimisë?

- d) Po
- e) Jo

12. A do të heqësh dorë nga trashëgimia e pronës familjare?

- a) Po
- b) Jo
- c) Varret nga kushtet ekonomike

13. Cilat nga opsionet e poshtëshënuara preferoni për ndarjen e pasurisë tuaj?

- d) Pjesë të barabarta mes bashkëshortëve dhe fëmijëve pa dallim gjinor
- e) Mes bashkëshortëve dhe fëmijëve ashtuqë pjesa më e madhe e pasurisë do t'li takon djalin dhe një pjesë më e vogël për vajzat
- f) Mes bashkëshortit dhe fëmijëve ashtuqë pjesa më e madhe e pasurisë ti kalojë vajzës dhe një pjesë më e vogël për djemtë

14. Si ndikon heqja dorë nga trashëgimia në cilësinë e jetës së femrës?

- c) Pozitivisht
- d) Negativisht

15. Cilën nga mënyrat e poshtëshënuara preferoni si mënyre për ndarje të pasurisë trashëgimore?

- d) Ndarje të trashëgimisë sipas marrëveshjes paraprake mes trashëgimtarëve të mundshëm duke respektuar dispozitat ligjore
- e) Ndarje të trashëgimisë sipas marrëveshjes paraprake mes trashëgimtarëve të mundshëm duke respektuar besimin fetar të cilit l përkasin
- f) Ndarje të trashëgimisë sipas traditës.

16. A mendoni që mundësia për marrëveshje paraprake të ndarjes së pasurisë trashëgimore mes trashëgimtarëve, mundëson ndarjen e pasurisë në mënyrë të pafavorshme për trashëgimtarët femra?

- a) Po
- b) Jo
- c) Ndoshta

17. A dallon praktika aktuale trashëgimore krahasuar me praktikat zakonore dhe praktikat tjera që kanë egzistuar para hyrjes në fuqi të Ligjit mbi Trashëgiminë dhe akteve tjera juridike përmes së cilëve garantohet barazi dhe mosdiskriminim gjinor?

- g) Dallon shumë
- h) Dalon pak
- i) Nuk dallon aspak.

18. A pajtoheni që edhe përkundër ekzistimit të kornizës ligjore, institucionale e politike, dispozitat ligjore nuk zbatohen në praktikë dhe si pasojë pabarazia gjinore dhe diskriminimi gjinor në këtë fushë vazhdon të ekzistojë?

- d) Pajtohem

- e) Nuk pajtohem
- f) Edhe pajtohem edhe jo

19.Sipas mendimit tuaj, cilat nga këto faktorë pengojnë realizimin e të drejtës trashëgimore mbi pronën familjare?

- f) zbatim joefikas i ligjeve ekzistuese,
- g) praktika zakonore,
- h) mosnjohja e dispozitave ligjore nga qytetarët.
- i) mentaliteti mbizotërues.
- j) të gjithë faktorët e shënuar më lartë.

20.Në ditët e sotme, a realizojnë realisht femrat të drejtën për trashëgimi në pronën familjare?

- g) Femrat në RMV, gëzojnë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare.
- h) Femrat në RMV, rrallë gëzojnë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare.
- i) Femrat në RMV, nuk gëzojnë të drejtën trashëgimore mbi pronën familjare.